

Seria e UNESCO-s mbi lirinë në Internet

Alfabetizimi në Media dhe Informim: Forcimi i të Drejtave të Njeriut, në Luftë kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit

Redaktorë:

Jagtar Singh është Profesor i Shkencave Bibliotekare dhe Informacionit si dhe Dekan në Universitetin e Punjabit në Patiala. Ai ka shërbyer në këtë universitet si Dekani Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Informimit, nga prilli 2008 deri në mars 2010. Ai është president i "Shoqatës indiane të mësuesve të shkencave bibliotekare dhe informimit" (IATLIS), dhe Krijues i Përbajtjes për INELI në Indi, program ky i Fondacionit të Bill dhe Melinda Gates-it.
Email: jagtardeep@gmail.com

PhD. Paulette A. Kerr, është bibliotekare e kampusit të Universitetit të Indive Perëndimore në Mona, Xhamajka. Interesat kërkimore të saj kanë të bëjnë me çështje të njohurive të informimit dhe mësimdhënies/mësimin në institucione akademike, dhe gjithashtu ka botuar në këto fusha. Ka bashkëpunuar me UNESCO-n për të zhvilluar trajnime mbi njohuri që lidhen me median dhe informimin, për profesionistë të informimit në Karaibe.
Email: paulette.kerr@uwimona.edu.jm

Esther I. Hamburger është Professore e Asociuar në Departamentin e Kinemasë, Radios dhe Televizionit në Shkollën e Komunikimeve dhe Arteve të Universitetit të Sao Paulos. Në vitin 2015 ajo ka qenë Studiuese e Ftuar në Qendrën e Studimeve Latino Amerikane të Universitetit të Harvardit (EUA). Ka titullin Doktore e Shkencave në Antropologji nga Universiteti i Çikagos. Ajo ka bërë post doktoraturë në Qendrën e Studimeve të Popullsisë në Universitetin e Teksasit në Austin, me bursë të Fondacionit Mellon. Ajo ka qenë gjithashtu Professore e Ftuar në Universitetin e Miçiganit, Ann Arbor.
Email: ehamb@usb.br

Redaktorë Ekzekutivë

Alton Grizzle punon në zyrat qendrore të UNESCO-s, Paris, si Specialist Programesh në Komunikim dhe Informim. Ai është bashkëmanaxher i veprimtarive globale të UNESCO-s mbi alfabetizimin në media dhe informim, NjMI (MIL) dhe për veprimtari lidhur me barazinë gjinore në Media. Ai ka konceptuar dhe lançuar shumë projekte; ka redaktuar dhe është bashkëautor librash dhe artikujsh akademikë mbi NjMI (MIL), zhvillimin e media dhe komunikimin.
Email: a.grizzle@unesco.org

Sherri Hope Culver shërben si Drejtore e Qendrës për Njohuritë mbi Median dhe Informimin (CMIL) në Temple University, ShBA, ku është Professore e Asociuar në Shkollën e Medias dhe Komunikimit. Sherri është anëtare e Bordit të Shoqatës Kombëtare për Edukimin në Njohuri mbi Median dhe ka qenë presidente në vitet 2008 deri 2014.
Email: shculver@temple.edu

Jordi Toront, diplomuar për Filozofi në Universitetin e Barcelonës, ka kryer studime pasuniversitare në Paris, në Universitetin e Sorbonës (Estetikë Filmi) dhe në Ecole Pratique des Hautes Etudes (Kinematografi Antropologjike). Ai ka qenë Konsulent për Njohuritë mbi Median në Departamentin e Edukimit në Bashkinë e Nju Jorkut. Që në vitin 2007, është Manaxher Projekti për iniciativat e lidhura me Alfabetizimin mbi Mediat pranë Aleancës së Qytetërimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNAOC).
Email: jordit@unops.org

**Alfabetizimi
në Media
dhe Informim:
Forcimi i të Drejtave
të Njeriut,
në Luftë Kundër
Radikalizimit
dhe Ekstremizmit**

**Redaktuar nga Jagtar Singh, Paulette Kerr
dhe Esther Hamburger**

Ky botim është mundësuar me mbështetjen financiare të Autoritetit të Medias Audiovizive. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinion i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Autoritetit të Mediave Audiovizive.



Rr. Gjin Bue Shpata, nr.8, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Bordi Këshillimor Redaksional

Dorcas Bowler, Biblioteka Kombëtare dhe Shërbime Informacioni, Bahamas
Maria Carme Torras Calvo, Kolegji Universitar në Bergen, Norvegji
Ulla Carlsson, Universiteti i Gotenburgut, Suedi
Sherri Hope Culver, Temple University, ShBA
Michael Dezuanni, Universiteti i Teknologjisë në Queensland, Australi
James Epoke, Universiteti i Kalabarit, Nigeri
Alton Grizzle, UNESCO, Paris
Victor Igwebuike, Uniersiteti Nnamdi Azikiwe, Nigeri
Paulette A. Kerr, Universiteti i Indie Perëndimore, Xhamajka
Hayward B. Mafuyai, Universiteti i Jos-it, Nigeri
Esther Hamburger, Universiteti i Sao Paulos, Brazil
Kyoko Murakami, Universiteti Hosei, Japoni
Abdullahi Mustapha, Universiteti Ahmadu Bello, Nigeri
Abdelhamid Nfissi, Universiteti Sidi Mohamed Ben Abdellah, Marok
Chido Onumah, Qendra Afrikane për Njohuri në Media dhe Informim (AFRICMIL), Nigeri
Omwoyo Bosire Onyancha, Universiteti i Afrikës së Jugut, Afrika e Jugut
Guillermo Orozco, Universiteti Guadalajaras, Meksikë
Jun Sakamoto, Universiteti i Hoseit, Japoni
Jagtar Singh, Universiteti i Punxhabit, Indi
Sami Tayie, Universiteti i Kairos, Egjipt
Jose Manuel Perez Tornero, Universiteti Autonom i Barcelonës, Spanjë
Jordi Torrent, UNAOC, ShBA
Carolyn Wilson, Western University, Kanada
Li Xiguang, Universiteti I Tsinghua-s, Kinë
Sin Joan Yee, Universiteti i Paqësorit të Jugut, Fixhi

Përmbajtja

Fjala hyrëse	11
Parathënie	13

Alton Grizzle

Hyrje	15
--------------------	-----------

FUQIZIMI I KOMUNITETIT DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Alton Grizzle & Jagtar Singh

Pesë Ligjet e Njohurive në Media dhe Informim si Lajmëtarë të të Drejtave të Njeriut: Trashëgimi e Pesë Ligjeve të Ranganathan-it në Shkenca Bibliotekare	29
--	-----------

Alton Grizzle & Jagtar Singh

Alfabetizimi në Media dhe Informim Ndërlidhës për Fuqizimin e Komunitetit në Indi	43
--	-----------

Melda N. Yildiz

Media lidh apo verbon? Hartëzimi i komunitetit dhe histori digjitale nga Klasat P20. Zbërthimi i miteve dhe i koncepteve të gabuara në edukimin global mediatik	50
--	-----------

Jun Sakamoto

Çështje Teorike dhe Praktike në Përfshirjen e Alfabetizimit në Media dhe Informim në Programet e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm	62
--	-----------

Humberto Darwin Franco Miguez

E drejta e Njeriut për Identitet dhe Rikonstruksioni Mediatik i Kujtesës së Njerëzve të Humbur në Meksikë	73
--	-----------

Matthew Johnson

Ngritja e Urave: Fuqizimi i Qytetarëve Digjitalë për të Ngritur Komunitete Pozitive Online	85
---	-----------

Li Xiguang, Wu Yanmei, Sun Lizhou & Sidra Tariq Jamil

Punëtorët migrues pa Fuqi Mediatike	93
--	-----------

GJUHA DHE NXITJA E URREJTJES

Maria Ranieri & Farnesco Fabbro

Për të Kuptuar dhe Paraqitur Diversitetin. Përgjigjja e Edukimit me Njohuri në Media ndaj Diskriminimit në Paraqitjen e Mediave të Lajmeve	107
---	------------

Marcelo Andreade & Magda Pischetola

Alfabetizimi në Media dhe Informim, Gjuha e Urrejtjes dhe Edukimi për Tolerancë: Rast studimor i Rrjeteve Sociale në Brazil	114
--	------------

Ronit Kampf

Efektet Afatgjata të Simulimeve të Kompjuterizuara në Konfliktet e Zgjatur: Rasti i Konfliktit Global 125

RADIKALIZIMI DHE EKSTREMIZMI

Thomas Röhlinger

Instrumentet MILID: të Drejtat e Njeriut. Kundër Radikalizimit: Strategjitë, Metodologjitë, Mjetet – të Freskëta nga Terreni “Glocal” 135

Tessa Jolls & Carolyn Wilson

Radikalizimi i të Rinjve në Hapësirën Kibernetike: Rrjeshtimi i Njohurive në Media dhe Informim në Betejë për Zemrat dhe Mendjet 148

Alton Grizzle & Jose Manuel Perez Tornero

Alfabetizimi në Media dhe Informim Kundër Urrejtjes Online, Përmbajtjes Radikale dhe Ektremiste: Disa Gjetje Paraprake Kërkimore në Lidhje me Rininë dhe një Projekt Kërkimor 161

Jordi Torrent

Të bashkojmë pikat: Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm, Objektivat Globalë për Zhvillim të Qëndrueshëm 183

Pavlos Valsamidis

Duke përfaqësuar “Ne” – Duke përfaqësuar “Ata”: Vizualizimi i Racizmit në Filmat e Shkollave Fillore në Greqi 191

Jagtar Singh

MILID: Ndërhyrje e domosdoshme në luftë kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhundhëm 200

Sumeer Gul & Sheikh Shueb

Twitteri si Pëllumb në Zi për Gonxhet e Sapoçelura: Analizë e Reagimit të Twitter-it ndaj Sulmit në Shkollë në Peshawar 210

TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZIA GJINORE

Anubhuti Yadav

Sulmet në Internet: Sfidë për gazetaret dhe aktivistet femra 223

LIGJËRIMET NDËRFETARE DHE NDËRKULTURORE NË MEDIA

Ahmed Al-Rawi

Edukimi me median digjitale dhe roli i tij kundërvënës ndaj ndarjeve dhe fuqizimit të identitetit kombëtar në botën arabe 233

Jessica Cohen & Jose Maria Blanco

Edukimi në fushën e medias dhe të komunikimit për të trajtuar polarizimin social në Europë 240

Fjala hyrëse

Peizazhi gjithmonë e më kompleks i medias dhe informacionit, që ka rol primar në jetën tonë të përditshme, po ndryshon me shpejtësi. Ai vazhdimisht po ndryshon mënyrën se si komunikojmë, mundëson dhe sfidon të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, aksesin universal në informacion, forcimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm dhe dialogun ndërkulturor.

Koha që po jetojmë është e jashtëzakonshme. Objektivi 16.10 i Zhvillimit të Qëndrueshëm njeh rëndësinë e aksesit publik në informacion dhe të drejta të tjera themelore. Në të njëjtën kohë, konteksti është ai në të cilin teknologjitë e komunikimit e kanë zgjeruar mundësinë e aksesit në informacionin, edhe pse shkëmbimet ndërgjuhësore kanë mbetur mbrapa. Megjithatë, njerëzit në mbarë botën po bëhen krijues të përmbajtjes, me mentalitetin e pjesëmarrjes globale qytetare në çështjet sociale, dhe jo thjesht si publik pasiv që sillet si spektator dhe votues i rastësishëm. Në shumë vende, burimet e informacionit të cilat ishin vështirësisht të arritshme, kufizohen tashmë vetëm nga aftësia jonë për të thithur sasi jashtëzakonisht të mëdha informacioni të transmetuar me shpejtësi.

Kjo sjell sfidat e veta. Njerëzit e kanë të vështirë të përcaktojnë se cili informacion është i besueshëm mes gjithë atij që qarkullon. Ndonjëherë është e paqartë dhe nuk di si të përgjigjesh, se si ta ndash dhe/ose të komentosh atë. Jo gjithmonë është e dukshme se si individët dhe kolektivat mund të kontribuojnë një përmbajtje të freskët në stokun në rritje të dijes. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sot, kur bota po dëshmon një rritje të paprecedente të polarizimit, të gjuhës së urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit si në botën online ashtu edhe jashtë saj. E mishëruar shpesh në “ligjëratën e frikës”, ajo sfidon të drejtat e njeriut dhe prish solidaritetin njerëzor. Qasja e UNECO-s për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ka tre drejtime: 1) nëpërmjet edukimit, 2) promovimit të rolit të medias së lirë, të pavarur dhe pluraliste dhe 3) duke ngritur lart diversitetin kulturor nëpërmjet narrativave alternative në mediat sociale.

NjMI (MIL) është mjet i fuqishëm, që prek kryq e tërthor kontekstet edukative, kulturore dhe sociale. Ai mund të ndihmojë për të kapërcyer dizinformimin, stereotipet dhe intolerancën që përcjellin disa media dhe hapësira online. Kësisoj, nxitja e ndjeshmërisë kritike është një nga komponentët jetikë, ku janë të shumta palët e interesuara që mund të luajnë një rol në këtë dimension të NjMI-së (MIL).

Për më tepër, NjMI (MIL) u jep mundësi njerëzve të jenë kureshtarë, të kërkojnë, të vlerësojnë në mënyrë kritike, të përdorin dhe të kontribuojnë në media me mençuri, informacion dhe përmbajtje. NjMI (MIL) kërkon që gjithëkush të ketë aftësinë që të njohë të drejtat e tij online; të luftojë gjuhën e urrejtjes në rrjet dhe bullimin kibernetik; si dhe të kuptojë çështjet etike që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e Informacionit. Kësisoj, NjMI (MIL) u mundëson njerëzve të angazhohen në media dhe Teknologjiive të Informacionit dhe Komunikimit të promovojnë barazinë, lirinë e shprehjes, dialogun ndërkulturor dhe ndërftuar, si edhe paqen.

Në 40 vitet e fundit, të cilët kanë shënuar përparime të rëndësishme në mënyrën e komunikimit si dhe në aksesin në informacion, UNESCO ka qenë mjaft aktive.

Nga Deklarata e Grünwald-it në vitin 1982 deri te Rekomandimet e Riga-s në vitin 2016, UNESCO së bashku me partnerët tanë në gjithë botën, po zhvillon në mënyrë të vazhdueshme dije për njohuritë mbi median dhe informimin, për të formuar mendje kritike. Misioni i UNESCO-s është të stimulojë shoqëri të zhvilluara për sa i përket medias dhe informimit, nëpërmjet inkurajimit të palëve të interesuara që të adaptojnë strategji gjithëpërfshirëse, me burime dhe nisma të ndryshme. Burimet tona përfshijnë zhvillim kurikulash, rritje kapaciteti, mbështetje politikash, hulumtime, rrjetëzim dhe lëvizje në media sociale, si dhe mbështetje për Aleancë Globale për Partneritet për Njohuritë në Media dhe Informim.

Brenda këtij konteksti u botua në vitin 2013 Vjetari i MILID-it me tematikë “Njohuri në Media dhe Informim dhe Dialogu Ndërkulturor”. Botimi i vitit 2014 i Vjetarit ishte mbi “Qytetarinë Globale në Botën Digjitale”, ndërsa botimi i vitit 2015 fokusohej mbi “Njohuritë në Media dhe Informim për Objektiva të Qëndrueshëm Zhvillimi”.

Botimi i këtij viti ka në fokus temën tejet të rëndësishme: “Alfabetizmi dhe Informimi mediatic: Fuqizimi i të Drejtave të Njeriut në Luftë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit”. Ai përbën një pikë e rëndësishme reference për diskutimet dhe palët e interesuara që kërkojnë të aplikojnë NjMI (MIL) si mjet kundër ekstremizmit të dhunshëm. Është e qartë nevoja për studime të bazuara në prova, matje dhe vlerësim, që mund tëna ndihmojnë të kuptojmë më saktë impaktin që kanë njohuritë në media dhe informim mbi shoqëritë. UNESCO beson se ky botim do të kontribuojnë njohuritë e vazhdueshme dhe debatin mbi këto tema.

Në mënyrë që qëllimi i ofruesve të medias dhe të gjithë llojeve të tjera të informimit të ketë vlerë, kemi nevojë për mendje kritike në publik, gjë që do të thotë të zhvillohen programe NjMI (MIL) në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Frank La Rue
Ndihmës Drejtor i Përgjithshëm
Komunikim dhe Informim
UNESCO

Parathënie

Vjetari MILID është botim akademik, iniciativë e përbashkët e UNECO-s me Programin Universitar të Bashkëpunimit mbi Alfabetizimin në Media dhe Informim UNAOC (UNESCO-UNAOC-MILID-UNITWIN), bashkë me Aleancën Globale të iniciuar nga UNESCO për Partneritete mbi Njohuritë në Media dhe Informim (GAPMIL). Programi i bashkëpunimit u lançua në vitin 2011 brenda kuadrit të Programit të UNESCO-s për Binjakëzimin e Universiteteve (UNIT WIN). Rrjeti Universitar MILID konsiston tashmë në 22 universitete nga të gjitha rajonet e botës. Vjetarët MILID për vitet 2013, 2014 dhe 2015 janë botuar në bashkëpunim me Qendrën Nordike të Informacionit për Studime në Media dhe Komunikim (NORDICOM). Këtë vit, UNESCO është angazhuar në këtë kauzë fisnike.

Ka ardhur koha që alfabetizimi në media dhe informim NjMI (MIL) të vendosen në thelb të mësimdhënies në të gjitha nivelet arsimore, dhe kjo duhet nxitur gjithashtu edhe në mjediset jo-formale dhe informale arsimore. NjMI (MIL) mund të kontribuojë në mënyrë efektive për përmirësimin e dialogut ndërkulturor, të kuptuarit reciprok, paqen, promovimin e të drejtave të njeriut, lirinë e shprehjes, si dhe për t'iu kundërvënë urreshtes, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. E vërteta është se NjMI-të (MIL) janë themelore për të prodhuar njohuri për mendimin kritik, për qytetarinë demokratike, të mësuarit e pavarur dhe qeverisjen e mirë.

Objektivat e Vjetarit janë:

- Fuqizimi dhe thellimi i dijeve që kanë të bëjnë me Njohuritë në Media dhe Informim si dhe Dialogun Ndërkulturor (MILID) në nivele globale, rajonale dhe kombëtare, duke përfshirë këtu edhe brenda kuadrit të drejtave të njeriut, dialogut, demokracisë dhe paqes.
- Zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis akademikëve dhe partnerëve në njohuritë në media dhe informim
- Vizualizimi dhe stimulimi i kërkimit dhe i praktikave si brenda ashtu edhe jashtë Rrjetit MILID UNITWIN në fushën e MILID-it duke promovuar njëkohësisht një perspektivë më gjithëpërfshirëse të Njohurive në Media dhe Informim (MIL)

Veç këtyre synimeve të përgjithshme, Vjetari MILID kërkon të adresojë çështje aktuale që lidhen me temat e përgjithshme të edukimit në media dhe informim dhe të dialogut ndërkulturor. Viti 2016, duke qenë viti i parë i implementimit të objektivave të qëndrueshëm të zhvillimit, ka ofruar mundësinë për ta vënë sërish theksin te Qasja e Bazuar mbi të Drejtat e Njeriut për zhvillim. Gjithashtu, rritja e nivelit të konflikteve kombëtare dhe globale, sikurse edhe format e reja të ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm kanë ngritur pyetje mbi rolin e MIL-it në këtë mjedis global.

Kjo është arsyeja pse “Alfabetizimi në Media dhe Informim: Forcimi i të Drejtave të Njeriut, në Luftë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit” u zgjodh si temë e vjetarit MILID për vitin 2016. Redaktorët menduan se rezultatet e diskutimeve dhe hulumtimeve në formën e këtij Vjetari do të ishin solide duke qenë se këto çështje prekin të gjitha rajonet e botës.

Thirrja për materiale për Vjetarin MILID për vitin 2016 pati një përgjigje të jashtëzakonshme. Mbas shqyrtimit rigoroz, në këtë vëllim u përfshinë 23 artikuj të shkruar nga 32 autorë nga 15 vende. Artikujt janë organizuar në pesë seksionet e mëposhtëm:

Fuqizimi i Komunitetit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Gjuha e Urrejtjes dhe Nxitja

Radikalizimi dhe Ekstremizmi

Të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore

Diskutimet Ndërfetare dhe Ndërkulturore në Media

Edhe brenda seksioneve të ndryshme, lexuesit do të gjejnë një larmi çështjesh që variojnë nga “perspektiva teorike” deri te “zgjidhjet praktike”. Gjithashtu, në këtë vëllim çështjet e ndryshme janë diskutuar në nivel lokal, kombëtar dhe global. Për qëllime reference në artikuj është përdorur Stili i APA-s.

Shprehim mirënjohjen e thellë për UNESCO-n, kontribuesit, anëtarët e Bordit Këshillimor Redaksional, për ndihmën në botimin e Vjetarit. Shpresojmë sinqerisht që Vjetari do të ndihmojë mjaft në sensibilizimin e palëve të interesuara për rolin e MIL-it në forcimin e të drejtave të njeriut dhe në luftë kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, e gjithashtu do të ofrojë perceptime të reja për akademikët, studjuesit, profesionistët, politikë bërësit dhe qytetarët globalë, në mënyrë që të bëhet dallimi mes relিকেve dhe risive në fushën e njohurive në media dhe informim.

Jagtar Singh

Paulette A. Kerr

Esther Hamburger

Hyrje

Alton Grizzle

Viti 2016 është viti i parë i implementimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Vënia sërish e theksit të një Qasjeje e Bazuar në të Drejtat e Njeriut për të gjitha format e zhvillimit vjen pikërisht në kohë. Ndonëse migrimi dhe forcimi i paqes si sfida të zhvillimit nuk janë të reja për njerëzimin, bota po përballlet me luftra dhe konflikte të vazhdueshme, por dhe me forma të reja ekstremizmi të dhunshëm që kanë sjellë rritjen e migracionit në nivele që mund të krahasohen vetëm me ato gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Si pasojë negative dhe e padëshirueshme e kësaj, në mbarë botën ka patur rritje të beftë incidentesh me individë që përdorin gjuhën e urrejtjes kundër emigrantëve, dhe pakicave ose grupeve sociale, duke i fajësuar ato për vështirësitë e tyre kombëtare. Fjalët e përdorura në politikë, në lajme, në mediat sociale, në studimet kërkimore, raportet kombëtare dhe literaturën e përgjithshme ose debatin rreth këtyre fenomeneve humane, kanë pasojë.

Historia ka treguar që eksitet retorike, ose vlerësimet e njëanëshme historike të ngjarjeve të caktuara në raport me ndonjë grup etnik, vend, kulturë ose rajon, mund të sjellin një klimë paragjyquese, diskriminuese dhe dhune. Janë pikërisht këto paragjykime, ky diskriminim dhe dhunë, që kompromentojnë shpesh të drejtat e individit ose të drejtat e barabarta për të gjithë – të drejtën e shprehjes kulturore dhe fetare, të drejtën për siguri dhe paqe, të drejtën për shprehje të lirë, të drejtën për arsim, të drejtën për informim, të drejtën për tu shoqëruar dhe lidhur, etj. Këtu shkelet Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, “Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Ata janë të pajisur me arsye e vetëdije dhe duhet të sillen karshi njëri-tjetrit më shpirt vëllazërimi”. Është pikërisht kjo mënyrë të arsytuarit dhe kjo vetëdijë që synon të arrijë alfabetizimi në media dhe informim (MIL).

Për më tepër, besimet ideologjike dhe dogmat që mbështesin fort të gjithë e kanë zanafillën në shoqërimin tonë. Shoqërimi është i mishëruar në informim dhe komunikim dhe gjithmonë e më tepër arrihet nëpërmjet platformave teknologjike, medias dhe gjithë mjedisve ku mësohet, të çdo forme qofshin. Kur këto bëhen bashkë e lidhen me episode të përdorimit të medias sociale nga ana e organizatave ekstremiste dhe të dhunshme, për të radikalizuar dhe rekrutuar në veçanti mendjet e reja, rëndësia e edukimit në media dhe informim për t'i bërë qytetarët të aftë të sfidojnë efektivisht besimet e veta dhe që të angazhohen në mënyrë kritike në këto tema, e për pasojë integrimi i MIL-it në mjedise formale, jo-formale dhe informale, bëhet më urgjent.

Një qasje drejt alfabetizimit në media dhe informim dhe zhvillimit të qëndrueshëm, e bazuar te të drejtat – duke përfshirë luftën kundër urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm – mund të luajë një rol kritik në perceptimet e “tjetrit”, duke inkurajuar

raportimin, studimin dhe analizat, gjithashtu edhe hartimin dhe implementimin e ndërhyrjeve për zhvillim, objektive, ta bazuara në prova, gjithëpërfshirëse, të besueshme, etike dhe të sakta, si dhe duke inkurajuar individët të vepronjë me force në mbështetje të të drejtat e tyre dhe të të tjerëve.

Radikalizimi, Ekstremizmi i Dhunshëm, Terrorizmi

Lufta kundër terrorizmit nuk është gjë e re për Sistemin e Kombeve të Bashkuara. Ajo bën pjesë në agjendën e Kombeve të Bashkuara prej disa dekadash. Sulmi kundër Shteteve të Bashkuara në 11 shtator 2001 bëri që Këshilli i Sigurimit të miratonte rezolutën 1373, rezultat e së cilës ishte ngritja e Komitetit Kundër Terrorizmit (CTC)¹.

Në vitin 2006, të gjitha Vendet Anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara arritën një marrëveshje pioniere mbi një kornizë kolektive e të përgjithshme strategjike për të luftuar kërcënimin që vinte nga terrorizmi. Kjo kornizë strategjike, e njohur si Strategjia Globale Anti-Terrorizëm e Kombeve të Bashkuara², është një mekanizëm unik për mbështetjen e përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për t'iu kundërvënë terrorizmit e që ka si shtyllë kryesore:

1. Adresimin e kushteve që favorizojnë përhapjen e terrorizmit;
2. Parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit;
3. Ngritjen e kapaciteteve të Vendeve Anëtare për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, si dhe për fuqizimin e rolit të Sistemit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim;
4. Sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithësi dhe sundimin e ligjit si bazë themelore në luftën kundër terrorizmit.

Ia vlen të përmenden këtu dy mekanizmat kyç që punojnë të pandarë së bashku për implementimin e Stretëgjitsë Globale Anti-Terrorizëm të Kombeve të Bashkuara. Së pari, është Task Forca për Implementimin e Anti-Terrorizmit (CTITF), e cila konsiston në 38 entitete të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera të lidhura me të. CTITF është mandatar për dy detyra kryesore: 1) të sigurojë koordinimin dhe vazhdimësinë brenda Sistemit të Kombeve të Bashkuara të luftës kundër terrorizmit dhe 2) të sigurojë asistencë për Vendet Anëtare. Së dyti, është Qendra Anti-Terrorizëm e Kombeve të Bashkuara (UNCCT). UNCCT-ja është ngarkuar dhe ka përgjegjësinë që të mbështesë Vendet Anëtare duke i ndihmuar ata të krijojnë kapacitetet e nevojshme për të konceptualizuar, hartuar dhe implementuar projekte të orientuar përkaq lufta kundër terrorizmit.

Sipas Raportit të vitit 2016 të *Reporterit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore duke luftuar njëkohësisht terrorizmin*, “nga ana konceptuale, ka qenë e vështirë të bëhej dallimi midis ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, dhe këta dy terma shpesh janë përdorur në vend të njeri-tjetrit dhe pa një përvijim të qartë të kufijve midis tyre”³. Pozicioni i Kombeve të Bashkuara është

që “ekstremizmi i dhunshëm përfshin një kategori më të gjerë manifestimesh [se sa terrorizmi], pasi në të futen të gjitha format e dhunës së motivuar ideologjikisht⁴.

Sot po shtohen me shpejtësi iniciativat për parandalimin ose luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm⁵. E megjithatë, sikurse në rastin e shumë koncepteve komplekse, nuk ka një përkufizim të pranuar në përgjithësi të ekstremizmit të dhunshëm. Koncepti mbetet ende i paqartë⁶. Në *Raportin e Reporterit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore duke luftuar njëkohësisht terrorizmin* janë ofruar disa përkufizime: Qeveria Australiane e konsideron ekstremizmin e dhunshëm si “përdorim ose mbështetje të dhunës për të arritur objektiva ideologjike, fetare ose politike”⁷. Norvegjia e përkufizon atë si veprimtari të personave dhe grupeve që synojnë të përdorin dhunën në mënyrë që të arrijnë objektiva politike, ideologjike ose fetare⁸; dhe Suedia e përkufizon një ekstremist të dhunshëm si dikë i cili “grykohet se në mënyrë të përsëritur ka shfaqur sjellje që jo thjesht pranojnë përdorimin e dhunës, por gjithashtu mbështet ose ushtron dhunë të motivuar ideologjikisht për të promovuar diçka”⁹.

Në Mbretërinë e Bashkuar, ekstremizmi përkufizohet si shprehja ose kundërshtimi aktiv i vlerave themelore, duke përfshirë këtu demokracinë, sundimin e ligjit, lirinë individuale dhe respektin reciprok e tolerancën ndaj feve dhe besimeve të ndryshme, si dhe thirrje për vrasjen e forcave të armatosura të Mbretërisë së Bashkuar brenda vendit ose jashtë¹⁰. Në Danimarkë, termi ekstremizëm përdoret për të përshkruar grupe që mund të karakterizohen nga pikëpamje simplistike të botës dhe “armikut”, të cilët nuk pranojnë vlerat dhe normat themelore demokratike, si dhe përdorin metoda ilegale e mundësisht të dhunshme për arritjen e objektivave ideologjike politike/fetare¹¹.

Në këta vitet e fundit, me rritjen e sulmeve terroriste në Europë, në Shtetet e Bashkuara e në rajone të tjera të botës, po përdoret shpesh e po njihet gjerësisht termi radikalizim, i cili ka lidhje me konceptin e ekstremizmit. Thënë më shkoqur, ai është procesi me anë të të cilit individët nxiten për të menduar ose kryer akte ekstremizmi të dhunshëm ose terrorizmi. Një grup studjuesish nga Australia dolën në përfundimin që “... e vetmja gjë mbi të cilën bien dakort ekspertët e radikalizimit është që radikalizimi është proces. Përtej kësaj ka një variacion të konsiderueshëm i cili i bën të pakrahueshme studimet ekzistuese”¹². Organizata ndërkombëtare si Komisioni European, themeluan në vitin 2011 Rrjetin e Ndërgjegjesimit për Radikalizimin¹³ (RAN). RAN-i është një rrjet i gjerë organizatash të tilla si grupe komunitare, organizata arsimore, agjenci të ushtrimit të ligjit, profesionistë dhe aktorë të tjerë lokalë të angazhuar në parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit.

Përdorimi i Informacionit, i Platformave Mediatike dhe Teknologjike, për të Zbutur ose Përhapur Radikalizimin dhe Ekstremizmin

Të gjitha palët e interesuara në mbarë botën pranojnë që Interneti ka evoluar e është shndërruar në mjet primar komunikimi. Ndonëse më shumë se pesëdhjetë përqind

e popullsisë botërore nuk ka akses në Internet, shtrirja globale e tij sa vjen e zgjerohet. Pavarësisht dobisë së jashtëzakonshme, fakti që ai është i hapur dhe kushdo mund të lidhet në të, e bën të vështirë gjurmimin e origjinës së komunikimeve dhe verifikimin e përhapjes në rritje të burimeve të informacionit. Ndërkohë, interneti ka sjellë lidhjen e paprecedente mes njerëzve në pjesë të ndryshme të botës nëpërmjet mediave sociale. Kësisoj Interneti u shndërrua në forcë për veprimtari si të mira ashtu edhe të këqia. Ai po përdoret gjithnjë e më shumë nga grupe ekstremiste për të rekrutuar simpatizantë. Por nga ana tjetër, ai mbart në vetvete një potencial të madh si mjet që kontribuon në reduktimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të të rinjve.

Në mënyrë të ngjashme, media mund të sfidojë në mënyrë direkte ose indirekte, ose të sanksionojë, retorikat ekstremiste të radikalizuara dhe të dhunshme, në sajë të fuqisë së saj të natyrshme për të transmetuar mesazhe, për të ndikuar dhe normalizuar disa besime dhe praktika sociale, duke përforcuar kësijoj narrativa të ndryshme.

Bibliotekat janë hapësira për dije kolektive të njerëzve nga breza, kultura ose kredo të ndryshme. Ato gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe diskutimeve bashkëpunuese midis qytetërimeve, duke lejuar aksesin, analizat, vrojtimit dhe ripërzierje të dijeve të mëparshme për të krijuar dije të reja. Bibliotekat janë kësijoj hapësira dialogu dhe përkatësie për këndvështrime të ndryshme me të cilat dikush mund të mos jetë dakort, si dhe mjete nëpërmjet të cilave njerëzit mund të verifikojnë raportime historike të ngjarjeve ose dukurive të rëndësishme sociale. Për fat të keq, këto çështje janë faktorë që kontribuojnë në keqkuptime të cilat çojnë në konflikte dhe mënyra ekstremiste të menduar.

Në ditët e sotme, bibliotekat mund të sigurojnë akses në një larmi burimesh të informacionit, duke përfshirë këtu materiale të printuar, produkte audiovizive dhe baza të dhënash. Digjitalizimi i bibliotekave u ka dhënë njerëzve mundësinë të hyjnë menjëherë në këto biblioteka, nga kudo që të jenë. Bibliotekat u mundësojnë lexuesve të rinj të ndjeshëm ndaj radikalizimit¹⁴ të marrin dijet e nevojshme, duke ndihmuar politikëbërësit dhe profesionistët të hartojnë strategji dhe programe më të efektshme në luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Rëndësia e Alfabetizimit në Media dhe Informim në këtë Kontekst, si Pjesë e Dialogut Ndërkulturor

Në këtë kontekst, Alfabetizimi në Media dhe Informim (MIL) si faktor ndërkulturor¹⁵ për të gjithë njerëzit, bëhet diçka e domosdoshme. Alfabetizimi në Media dhe Informim mund të bëjë të mundur lidhjen midis kulturave, ripërtëritjen e teorive sociologjike të dijes dhe të mësuarit rreth lidhshmërisë, konstruktivizmit social dhe Analizës Interpretuese Fenomenologjike.

I pari vjen konstruktivizmi social, sepse promovimi i lidhjes midis kulturave kërkon të kuptohet më thellë nga të gjithë mënyra se si krijohet dija, të kuptohet që dija është krijuar në grupe bashkëpunuese me njëri-tjetrin. Dhe teksa angazhohemi thellësisht brenda një kulture ose disa kulturave vazhdojmë gjithmonë të mësojmë. E si përfundim, të gjithë qytetarët duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë kritike se si kuptimet subjektive bëhen fakte sociale. Punimi i Peter L. Berger-it dhe i Thomas Luckmann-it në librin e tyre 'Ndërtimi Social i Realitetit' ofron një analizë iluminuese. Alfabetizimi në media dhe informim e thjeshtëzojnë këtë për të gjithë njerëzit.

Së dyti, duke promovuar lidhjen midis kulturave pranohet nevoja për të iluminuar e ndihmuar qytetarët të kuptojnë kontekstin social dhe kulturor të të mësuarit – të njohin Lidhshmërinë, e cila ka të bëjë me punën e teoricienëve Vygotsky, Engeströms dhe Teorinë e të Mësuarit Social të Bandura-s. Të gjithë qytetarët duhet të kuptojnë minimalisht raportin që ekziston midis përvojave të tyre në punë, përvojave sociale, të mësuarit dhe dijes. Ata duhet të dinë që të mësuarit përcaktohet si dije e zbatueshme ose që një ndryshim në sjellje mund ta ketë burimin jashtë vetes tonë, për shembull brenda organizatave dhe bazave të të dhënave¹⁶. Në këtë kuptim, të mësuarit fokusohet mbi lidhjen e strukturave të specializuara të informacionit ku lidhjet që mundësojnë të mësuarit marrin më shumë rëndësi se sa ato që përfaqësojnë gjendjen e dijes¹⁷. Kur flitet për njohuritë në media dhe informim flitet për të mësuarit si një proces që zgjat gjatë gjithë jetës.

Alfabetizimi në Media dhe Informim mund të inkurajojë njohjen e lidhshmërisë midis kulturave për t'iu kundërvënë radikalizimit dhe ekstremizmit, duke tërhequr vëmendjen drejt nevojës që të gjithë qytetarët të kuptojnë mënyrën se si individët, në një kontekst të caktuar, u japin kuptim përvojave të tyre – Analiza Interpretuese Fenomenologjike. Kjo është e rëndësishme sepse padyshim që njerëzit kanë përjetuar gjithmonë fenomene të ndryshme – fenomene të luftës dhe të paqes, fenomene ndërkulturore, ndërfaqetare dhe konflikte ndërraciale. Ata kanë përjetuar gjithashtu fenomene të pabarazisë, përfshirë këtu barazinë gjinore, sikurse edhe dukuri të ndryshimit klimaterik. Këtu renditen edhe fenomene të tjerë si e drejta për arsimim, liria e shprehjes, privatësia dhe fenomene të tjerë që lidhen me të drejtat e njeriut, sikurse edhe me radikalizimin e të rinjve për dhunë dhe ekstremizëm të dhunshëm. Problemi është se në shekullin e 21-të, më shumë se në çdo periudhë tjetër historike, të gjithë këta dukuri janë ndërmjetësuar nga bibliotekat, media, teknologjia dhe Interneti. Alfabetizimi në media dhe informim u mundësojnë qytetarëve të vlerësojnë në mënyrë kritike se cilat janë dimensionet e reja që media dhe teknologjia sjellin në përvojat e tyre, si dhe cilat janë mundësitë dhe rreziqet e reja që ofrojnë ato si dhe mënyrën si të kapitalizohen këto mundësi duke minimizuar në të njëjtën kohë rreziqet. Alfabetizimi në media dhe informim duhet të bëjë që njerëzit të fokusohet më shumë tek mundësitë se sa te rreziqet.

Kontributi i UNESCO-s në Luftë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm

UNESCO është organizata lider që në nivel global promovon arsimin për të gjithë. Arsimimi për të gjithë në kontekstin e një bote përherë e më të lidhur dhe të ngopur nga media – me bibliotekat në evoluim e sipër – bën që të rritet rëndësia që merr alfabetizimi në media dhe informim. Organizata është gjithashtu një nga Agjencitë drejtuese të Kombeve të Bashkuara që ndjek objektivin 16.10 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, e cila pranon rëndësinë e aksesit publik të informacioni si dhe të lirive të tjera themelore.

Kontributi i UNESCO-s për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm¹⁸ i ka rrënjët në Planin për Aksion të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm¹⁹ (PVE). Ky i fundit mbulon çështje si arsimimi, krijimi i aftësive dhe punësimi; forcimi i rinisë; interneti dhe media sociale, komunikimi dhe barazia gjinore, si dhe

fuqizimi i grave. Qasja e UNESCO-s mbështetet në tre shtylla kryesore, 1) parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet arsimit; 2) promovimi i rolit pozitiv të medias në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe 3) vlerësimi dhe promovimi i diversitetit kulturor nëpërmjet narrativave alternative në mediat sociale. Më poshtë renditen shembuj të iniciativave kyç në këto tre fusha:

- Në fushën e arsimit, një iniciativë kyç është botimi i “Një Udhëzues për Mësuesit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit”
- Në fushën e mediave dhe Internetit, UNESCO drejtoi konferencën ndërkombëtare “Rinia dhe Interneti: Lufta kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit”. Mes shumë punimeve të tjera të përgatitura, UNESCO ka publikuar së fundmi studimin “Lufta kundër Urrejtjes Online”.
- Dhe në fund, aksionet kulturore përfshijnë fushatën #unite4heritage që inkurajon të rinjtë të zhvillojnë një narrativë pozitive, alternative të propagandës sektare që zhvillohet kundër pasurisë kulturore dhe diversitetit. (po aty)
- Në vitin 2016, në bashkëpunim me shumë partnerë të tjerë, u lançua lëvizja UNESCO MIL CLICKS20, aksion ky i ngjashëm ndërdisiplinor. Vargu i gërmave MIL CLICKS do të thotë Njohuri në Media dhe Informim: mendim Kritik, Kreativitet, Njohuri, Ndërkulturor, Qytetari, Diqe dhe Qëndrueshmëri. Kjo lëvizje në mediat sociale synon të nxisë te njerëzit mendimin kritik dhe klikimin e mençur gjatë përdorimit të përdorimit e përditshëm të internetit.

Kontributi i Vjetarit për Parashikimin, Perspektivat kërkimore dhe Diskutimet mbi këtë Temë

Duke patur këtë sfond në mendje, “Alfabetizimi në Media dhe Informim: Forcimi i të Drejtave të Njeriut, në Luftë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit” u zgjodh si tema e Vjetarit MILID për vitin 2016.

Ky libër ndahet në pesë seksione:

1. Fuqizimi i Komunitetit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm;
2. Gjuha dhe Nxitja e Urrejtjes;
3. Radikalizimi dhe Ekstremizmi;
4. Të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore;
5. Diskutimet Ndërfetare dhe Ndërkulturore në Media

Artikujt e paraqitur kanë lidhje me një nga nëntemat e mësipërme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar dimensioneve ndërkulturore të këtyre fushave. Shkrimet janë përpjekur

të angazhojnë lexuesin për të kuptuar njohuritë në media dhe informim përtej vendit ku jetojnë ose fushës së kompetencave personale.

Fokusi i shkrimeve është tek alfabetizimi në media dhe informim si dhe dialogu ndërfaqor dhe ndërkulturor, duke u lidhur njëkohësisht me temën “Alfabetizimi në Media dhe Informim: Forcimi i të Drejtave të Njeriut, në Luftë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit”. Shumica e shkrimeve kanë lidhje me të paktën një nga komponentët e mëposhtëm:

1. Temën dhe nëntemat e Vjetarit
2. Dimensione të rëndësishme të Aleancës Globale për Partneritete mbështetur në Kornizën dhe Planin e Veprimit të MIL (GAPMIL)
3. Përmbajtje që përfshin gjetje studimore, teori, ose përmbajtje që reflektojnë përvojat e mësuarra dhe praktikatat më të mira të përfutuara qoftë nga aplikimi i MIL-it, mësime, hartimi i kurikulave, ose nga mënyra se si individë ose grupe përdorin kompetencat e MIL-it.
4. Subjekte me interes global që ndihmojnë në rritjen e vizibilitetit për Vjetarin MILID
5. Lidhshiri akademik, profesional ose eksperimental i autorëve në terren.

Përmbledhje e kapitujve

Kapitulli i parë i librit, “Fuqizimi i Komunitetit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm”, paraqet shtatë shkrime që diskutojnë marrëdhëniet e ndryshme që ekzistojnë midis njohurive në media dhe informim (MIL). Autorët Alton Grizzle & Jagtar Singh, duke reflektuar mbi veprën e S.R. Ranganathan-it, i njohur si “Babai i Lëvizjes Bibliotekare në Indi”, paraqesin artikullin “Pesë Ligjet e Njohurive në Media dhe Informim si Lajmëtarë të të Drejtave të Njeriut: Trashëgim i Pesë Ligjeve të Ranganathan-it për Shkencën Bibliotekare”. Autorët kanë rinovuar pesë ligjet e shkencës bibliotekare në kontekstin e shoqërive të dijes. Më pas ata kanë skicuar për herë të parë pesë ligjet e njohurive në media dhe informim duke i theksuar ata si udhëzues për të gjitha palët e interesuara që duan të jenë gardiane të njohurive në media dhe informim dhe të sigurojnë impaktin e plotë të tyre në jetën e njerëzve nëpërmjet një qasje që mbështetet në të drejtat.

Rëndësia që ka edukimi në media dhe informim për zhvillimin e komunitetit dhe mënyra se si ai mund të “fuqizojë njerëzit për të qenë më efektivë në gjetjen e informacionit me interes për ta, për zgjidhjen e problemeve të përditshme e për ta bërë këtë sa më mirë” - diskutohet në shkrimin pasues të I.V. Malhan & Jagtar Singh me titull “Ndërveprimi i Alfabetizimit në Media dhe Informim për Fuqizimin e Komunitetit në Indi”. Mes të tjerash, autorët përdorin shembujt e vetëvrases së fermerëve në Indi, pasi këto incidente po bëhen sa vjen e më të zakonshme. “Mungesa e infrastrukturës së dijes dhe informacionit nuk u ka lejuar atyre cilësinë e jetës që u takon”. Kohët e fundit, personalizimi i informacionit dhe i medias mund t’i ndihmojë njerëzit që t’i japin kuptim informacionit dhe të ndër marrin

veprime pozitive. Shkollat janë një nga shtyllat kryesore për të patur komunitete të qëndrueshme; projekti Hulumtim me Vepriimari Pjesëmarrëse (PAR) mbledhi dhe dokumentoi përvoja nga tridhjetë e pesë edukatorë në të gjithë botën.

Autorja Melda N. Yildiz, në artikullin “Hartëzimi i Komunitetit dhe Histori Digjitale nga Klasat P20, Shpërbërja (dekostruktimi) e Miteve dhe e Ideve të Gabuara në Edukimin e Medias Globale”, do të krijojë një hapësirë për një rishqyrtim të kurikulës aktuale. Por, më shumë se këtë, artikulli shpjegon platformën interaktive online që shfaq në mënyrë globale projektet gojore historike dhe historitë digjitale. Prej shumë kohësh UNESCO i është përkushtuar edukimit; Jun Sakamoto eksploron mundësitë e përfshirjes së programeve të Alfabetizimit në Media dhe Informim në programin Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD). “Ndonëse të dy janë programe të UNESCO-s për edukimin, nuk ka patur kurrë programe kaq të kombinuar,” shpjegon Sakamoto. Në artikullin e tij “Probleme Teorike dhe Praktike në Përfshirjen e Programit të Alfabetizimit në Media dhe Informim në Programin e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm”, Sakamoto tregon me anë të shembujve nga shkolla të lidhura me UNESCO-n, ku një kombinim i tillë i programeve ishte implementuar në praktikë, efektin e madh që ka patur kjo gjë. Por të dyja hapësirat, si ajo në rrjet ashtu edhe jashtë rrjetit, vijnë me vështirësitë e veta. Në artikullin e Matthew Johnson-it, “Ngritja e urave: Fuqizimi i Qytetarëve Digjitalë për Krijimin e Komuniteteve Pozitive Online”, analizohet bullimi kibernetik si problem personal dhe kulturor në komunitetet online. “Në qoftë se arrijmë t’i ndihmojmë të rinjtë të kuptojnëse kanë të drejtën e hapësirës së tyre online dhe që janë të lirë nga ngacmimi dhe diskriminimi, si dhe t’u mësojmë atyre se si të përdorin mjetet digjitale të disponueshme për të bërë t’u dëgjohet zëri, atëherë kemi arritur t’u mundësojmë kultura si në rrjet ashtu edhe jashtë, ku ata jo vetëm që nuk kanë frikë por respektohen sepse flasin me zë të lartë kundër bullimit dhe paragjykitimit”, sugjeron autori duke shtuar që “Megjithatë, për t’iu përgjigjur urrejtjes dhe shqetësimeve online, të rinjtë jo vetëm duhet të trajnohen për aftësi të veçanta në njohuritë digjitale, por edhe të aftësohen që të jenë të zotë ta thonë atë që kanë për të thënë dhe për ushtruar të drejtat e tyre të plota si qytetarë digjitalë. Por megjithatë, ushtrimi i plotë i këtyre të drejtave vazhdon të jetë një sfidë.

Autoret Li Xiguang, Wu Yanmei, Sun Lizhou dhe Sidra Tariq Jamil, në artikullin “Punëtorët emigrantë pa Pushtetin e Medias”, duke analizuar dy evente, shohin nga afër emigrantët dhe përshkruajnë ndeshjen midis pushtetit qeveritar, korporatave, punëtorëve emigrantë dhe organizatave mediatike. Dhe shumë herë është i nevojshëm fuqizimi i medias për ata të cilët janë privuar nga identiteti i tyre në garën e mediave për audiencë. Duke trajtuar rastet e personave të zhdukur në Meksikë, Dr. Darwin Franco Mígues në artikullin “E Drejta e Njeriut për Identitet dhe Rikonstruksioni në Media i Kujtimit të Personave të Humbur në Meksikë”, fokusohet në rikthimin e të drejtës për të “qenë”, nga e cila njerëzit janë privuar jo vetëm kur janë zhdukur fizikisht, por edhe kur janë zhdukur nga gjuha zyrtare dhe diskutimet mediatike.

Në seksionin tjetër, ‘Gjuha dhe Nxitja e Urrejtjes’, janë katër artikuj që prezantojnë përvoja të ndryshme globale dhe sfidat për Alfabetizimin në Media dhe Informim. Autorët Maria Ranieri & Francesco Fabbro dalin në një konkluzion të rëndësishëm empirik: zakonisht është më produktive kur i lidh analizat kritike dhe prodhimin mediatike me shqetësimet, shijet dhe identitetet e vetë studentëve, sesa kur kërkon t’i angazhosh ata në analiza abstrakte ideologjike, apo t’i bësh të mësojnë rreth medias nëpër qasje shumë

direktive. Në artikullin e tyre “Kuptimi dhe Përfaqësimi i Diversitetit, një Përgjigje e Edukimit me Njohuri në Media ndaj Diskriminimit në Përfaqësimin në Lajme”, autorët shpjegojnë se si alfabetizimi në media dhe informim ka ndikuar për shembull, që studentët e marginalizuar të jetë të zotë të ngrihen për veten e tyre, ose se si ka bërë që të përmirësojnë gradualisht kapacitetin e tyre për të menduar në raport me diskriminimin, duke e shprehur këtë ndërgjegjësim të ri nëpërmjet produkteve krijuese, duke e kthyer kështu një situatë diskriminimi në një oportunitet për fuqizim.

E megjithatë, gjuha e urrejtjes vazhdon gjithmonë e më shumë të jetë e dukshme në hapësirat online, sidomos në mediat sociale. Artikulli “Alfabetizimi në Media dhe Informim, Gjuha e Urrejtjes dhe Edukimi për Tolerancë: një Rast Studimor i Rrjeteve Sociale në Brazil”, shkruar nga Marcelo Andrade dhe Magda Pischetola, analizon rastin studimor të një konflikti të kohëve të fundit që ka të bëjë me gjuhën e urrejtjes në mediat sociale në Brazil. Autorët dalin në përfundimin që “Rezultatet e këtij studimi tregojnë se intoleranca dhe gjuha e urrejtjes janë bërë praktika të zakonshme në mjediset e mediave sociale. Toleranca si aftësi e njohurive në media dhe informim shfaqet si përgjigje ndaj intolerancës dhe si mjet për t’i bërë ballë gjuhës së urrejtjes kundër atyre që janë “të ndryshëm”. Në një studim eksperimental nga Danimarka, Ronit Kampf na prezanton me rolin e një loje në kompjuter, skenari i së cilës është vendosur në konfliktin Izrael – Palestinë. Studimi titullohet “Efektet Afatgjata të Simulimeve të Kompjuterizuara në Konfliktet e Zgjatura, Rasti i Konfliktëve Globale”. Ai tregon se si mund të ndryshojnë qëndrimet, si dhe mundësinë e përdorimit të mjeteve dhe platformave të reja, të tilla si lojrat, për të edukuar njohuritë në media dhe informim. Autori konkludon se, “Rezultatet sugjerojnë që pjesëmarrësit në këtë lojë, ndryshe nga ata që nuk luajtën, u zhvendosën drejt një perspektive më të paanshme”. Nga ana tjetër e botës, Kyoko Murakami na prezanton, “Një Studim Pilot të Mësimit Bashkëpunues dhe Kuptimit Ndërkulturor Midis Nxënësve të klasave të shtata, të teta dhe të nënta në Shkollat Japoneze dhe Kineze”, ku ekzaminon si për nxënësit japonezë ashtu edhe ata kinezë të këtyre moshave natyrën e të mësuarit bashkëpunues dhe të kuptuarit inter/ndërkulturor të kulturës dhe nxënësve homologë me ta. Sikurse shkruan autorja, rezultatet sugjerojnë që veprimtaritë që kanë të bëjnë me njohuritë në media dhe informim mund të promovojnë të kuptuarit reciprok dhe inter/ndërkulturor edhe pse ka patur konflikte dhe ndjenjë historike, ideologjike dhe politike midis vendeve.

Në seksionin “Radikalizimi dhe Ekstremizmi”, autori Thomas Röhlinger sjell një kontribut në ngushtimin e hendekut midis ambicjeve të larta në nivel politik dhe teorik, dhe nevojës urgjente për të përveshur mëngët në terren. “Kutia e instrumenteve MILID: Të Drejtat e Njeriut; Kundër Radikalizimit, Strategji dhe Metodologji – nga Fillesat “Glokal*”-e” sjell te lexuesi përvoja të tilla me mjaft vlerë si Parlamentet MILID të të Rinjve dhe Këshillat Rinore, ose lojra si Loja Machiavelli apo Loja “House of Cards”. “Kutia e instrumenteve MILID”, sigurisht që nuk është formulë magjike; ajo nuk është kurrsesi diçka e përfunduar. Por është provuar se është efektive në nivel praktik”, konkludon autori. Autori Jagtar Singh trajton të njëjtën temë në shkrimin “MILID-i: Ndërrhyrje e Domosdoshme për të Luftuar Radikalizimin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm”, ku diskuton se si njohuritë në Media dhe Informim bashkë me dialogun ndërkulturor (MILID), mund të shërbejnë si një dërrhyrje e domosdoshme për shpëtimin e të rinjve indianë nga tirania e radikalizimit dhe ekstremizmi. Duke analizuar më tej metodat edukative, autorët Tessa Jolls dhe Carolyn

Wilson, eksplorojnë hulumtimin e bërë në lidhje me fuqinë dhe efektivitetin e alfabetizimit në media dhe rëndësinë e kornizës konceptuale për edukimin mediatic.

Në dokumentin “Radikalizimi i Rinisë në Hapësirën Kibernetike: Mobilizimi i Njohurive në Media dhe Informim në Betejën për Zemrat dhe Mendjet”, ato paraqesin disa raste studimore që ilustrojnë rëndësinë e alfabetizimit mediatic kur trajtohen çështje si të drejtat e njeriut, propaganda, indoktrinimi dhe ekstremizmi. Edhe pse ka mjaftueshëm prova empirike për të theksuar lidhjen që ekziston midis gjuhës së urrejtjes dhe fenomenit të radikalizimit, nuk ka një konsensus të qartë për mënyrën se si t’i jepet përgjigje impakteve negative të gjuhës së urrejtjes online nëpërmjet një strategjie sistematike. Autorët Alton Grizzle & Jose Manuel Tornero sugjerojnë një gjë të sigurt: edukimi dhe ndërgjegjësimi mund të neutralizojnë impaktin negativ të urrejtjes, radikalizimit dhe përmbajtjes ekstremiste online. “Në këtë kontekst”, shkruajnë ata, “promovimi i edukimit në media dhe informim ka një rol kritik”, ndërkohë që artikulli i tyre “Njohuri në Media dhe Informim Kundër Urrejtjes Online, Përmbajtjes Radikale dhe Ekstremiste: Disa Gjetje Paraprake në Raport me Rininë dhe një Projekt Studimor”, prezanton një projekt studimor të cilin ata e sugjerojnë për të propozuar prova empirike që ndihmojnë në hartimin e një strategjie kundër gjuhës së urrejtjes online. Autorët analizojnë të dhëna që tregojnë, mes shumë gjetjeve të tjera, që 61% e të intervistuarve raportojnë se kanë qenë ekspozuar në mënyrë aksidentale ndaj përmbajtjes radikale dhe ekstremiste online. 14% dhanë përgjigje neutrale. 56% thonë se i injorojnë këto përmbajtje kur i hasin. 56% e të intervistuarve janë ndeshur në Facebook me përmbajtje të mbushur me urrejtje, 14% në YouTube dhe ky pasohet nga Twitter me 8%. Studimi sugjeron disa implikime dhe veprime që duhen ndërmarrë.

Jordi Torrent, në artikullin “*Connecting the Dots: Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm, Objektivat Globale për Zhvillim të Qëndrueshëm*” thotë se shumica e hulumtimeve dhe studimeve tregojnë që përjashtimi social (i vërtetë ose i perceptuar) është, në fakt, motori kryesor që i shtyn të rinjtë drejt formave të dhunshme të ekstremizmit politik dhe fetar. Në mbyllje ai thotë se NjMI mund të sigurojë një hallkë lidhëse drejt kësaj përfshirjeje. Palvos Valsamidis sugjeron se një strategji e tillë – për të angazhuar në mënyrë aktive nxënësit drejt një jete në paqe dhe harmoni – mund të jetë rezultat i dijeve audiovizuale. Në artikullin “Përfaqësimi i “Ne” – Përfaqësimi i “Atyre”: Vizualizimi i Racizmit në Filmat Grekë të Shkollave Fillore”, Valsamidis del në përfundimin që “Megjithatë, fëmijët, në tekstet e tyre audiovizuale, kërkojnë mënyra vizuale për të lehtësuar pabarazitë. Dhe si përfundim, “ata” bëhen pjesë e “ne”, duke e pranuar me respekt diversitetin”. Kapitulli mbyllet me artikullin “*Twitter si Pëllumbi në Zi për Sythet e Çelur: një Analizë e Reagimit të Twitter-it ndaj Sulmit në Shkollë në Peshawar*” nga Summer Gul dhe Sheikh Shueb, ku analizohet në mënyrë sasiore dhe cilësore përmbajtja e postimeve në Twitter pas masakrës në shkollë në Peshawar.

Seksioni mbi të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore diskuton për Alfabetizimin në Media dhe Informim parë nga disa perspektiva. Autori Vedabhyas Kundu, në artikullin “Promovimi i Aftësive në Njohuri në Media dhe Informim mes Vajzave të Reja për më Shumë Pjesëmarrje në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm” diskuton se si trainimi në NjMI u jep mundësi grave jo vetëm të kuptojnë në mënyrë kritike stereotipizimin mediatic të problemeve gjinore por gjithashtu edhe se si ai u mundëson atyre pjesëmarrjen në mbështetje të kauzave që lidhen me debate zhvillimore. Koncepti i provokimit në Internet

(*Internet Trolling*) dhe vështirësitë që rrjedhin prej tij prezantohet nga Anubhuti Yadav në artikullin “Provokimi në Internet: Sfidë për Gazetaret dhe Aktivistet Femra”. “Provokimi në Internet është bërë kërcënim për gazetaret dhe aktivistet femra. Ndërkohë që nga njëra anë keqdashësit po krijojnë telashe, nga ana tjetër, mungesa e qartësisë në reagimin karshi provokimeve në internet po dëmton hapësirën online”, shkruan autori.

Seksioni i fundit, Diskurset Ndërfetare dhe Ndërkulturore, paraqet dy diskutime. Artikulli i Ahmed Al-Rawi-t “Njohuri në Median Digjitale dhe Roli i Saj Kundër Ndarjes dhe Forcimi i Identiteti Kombëtar në Botën Arabe” argumenton për përfshirjen e edukimit me Njohuri në Media dhe Informim që në fazat e para të edukimit, pasi të kuptuarit, ndërgjegjësimi, analiza dhe vlerësimi i mesazheve të medias si aftësi kritike, kërkojnë kohë përpara se të bëhen procese automatike. Duke analizuar rajonin arab, autori del në përfundimin që “Dijet fetare dhe politike duket se janë mjetet më efektive për t’i vënë fre retorikave sektare dhe ndarëse në media me të cilat bombardohen masat arabe”.

Libri mbyllet me një artikull të Jessica Cohen dhe José Maria Blanco i cili e vë fokusin mbi Europën “Edukimi në Media dhe Informim për të t’i bërë ballë Polarizimit Social në Europë”, ku flitet për Europën në kontekstin e sfidave aktuale: terrorizmi dhe refugjatët. Disa nga vendet po përjetojnë rritje të numrit të krimeve që burojnë nga urrejtja. “NjMI mund të ndihmojë për të rrëzuar këto barriera ... Është momenti që kjo disiplinë të merret e të përdoret në luftë kundër polarizimit në rritje të shoqërive tona” përfundojnë autorët.

Shënime

- 1 <http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/presskit/2011-01-presskit-en.pdf>. Parë në 10 tetor 2016
- 2 <https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/un-global-counter-terrorism-strategy>. Parë në 10 tetor 2016.
- 3 Raport i Reporterit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë luftës kundër terrorizmit. A/HRC/31/65. Distr.: General. 22 February 2016.
- 4 A/70/674, para. 4.
- 5 Teksa Këshilli i Sigurimit i “kundërvihet” ekstremizmit të dhunshëm, Sekretari i Përgjithshëm ka zhvilluar një plan për të “parandaluar” ekstremizmin e dhunshëm, dhe OSBE i bën të dyja. Shtetet i bëjnë të dyja, ose i “përgjigjen” ekstremizmit të dhunshëm. Ky raport përdor fjalën “kundërvihet”.
- 6 OSCE/ODIHR, “Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to terrorism: A Community Policing Approach”, 2014, fq. 35. Shih gjithashtu Maleika Malik, “Extreme Speech and Liberalism”, te Ivan Hare dhe James Weinstein (eds.), Gjuha Ekstreme dhe Demokracia, Oxford University Press, Oxford 2007, cituar në artikullin e Agnes Callamard, “Religion, Terrorism and Speech in a ‘Post-Charlie Hebdo’ World”, Besimi dhe të Drejtat e Njeri, Vëllimi 10, Problemi 3, 2015, fq. 207 – 228, <http://booksandjournals.brillonline.com/content/journals/10.1163/18710328-12341288;sessionid=ehj72stfncccd7.x-brill-live-03>. Nga ana e vet, USAID ofron një përkufizim të Politikave të USAID te in “The Development Response to Violent extremism and Insurgency: Putting Principles into Practice”, Shtator 2011. Shih gjithashtu A/HRC/31/NGO/X Deklaratë e Përbashkët me Shkrim i OJQ-ve, faqe 3.
- 7 Qeveria australiane, Departamenti i Prokurorisë së Përgjithshme, Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, gjendet te: <https://www.ag.gov.au/NationalSecurity/Counteringviolentextremism/Pages/default.aspx>

- 8 Plani i Veprimit i Norvegjisë Kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, 2014, fq. 7, <https://www.counterextremism.org/resources/details/id/679/action-plan-against-radicalisation-and-violent-extremism>
- 9 Plani i Veprimit i Suedisë për Mbrojtjen e Demokracisë Kundër Ekstremizmit që Promovon Dhunë, Komunikim i Qeverisë 2011/12:44, Pika 3.2. <http://www.government.se/contentassets/b94f163a3c5941aebaeb78174ea27a29/action-plan-to-safeguarddemocracy-against-violence-promoting-extremism-skr.-20111244>.
- 10 Strategjia e Mbretërisë së Bashkuar Kundër Ekstremizmit, Tetor 2015, paragrafi 1 dhe Strategjia për Parandalim e Mbretërisë së Bashkuar, 2011, Aneksi A. Vërej që Task Forca 2013 e MB-së për Ndalimin e Radikalizimit dhe Ekstremizmit përkufizonte “ekstremizmin Islam” paragrafi 1.4.
- 11 Qeveria e Danimarkës, Parandalimi i Radikalizimit dhe Ekstremizmit, Plan Veprimi, Shtator 2014.
- 12 Minerva Nasser-Eddine, Bridget Garnham, Katerina Agostino and Gilbert Caluya, Countering Violent Extremism (CVE) Literature Review (Canberra: Qeveria Australiane, Departamenti i Mbrojtjes mars 2011), fq. 13. Sikurse citon Schmid, P. A. (2013). Radicalisation, De-Radicalisation, Counter-Radicalisation: A Conceptual Discussion and Literature Review. International Centre for Counter-Terrorism – The Hague
- 13 Radicalistion Awareness Network: Collection Preventing Radicalization to Terrorism and Violent Extremism. http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/ran_collectionapproaches_and_practices_en.pdf. Parë në 10 tetor 2016
- 14 Hearts and Minds: A Comparison of Counter-Radicalization Strategies in Britain and the United States. <http://www.inquiriesjournal.com/articles/1413/hearts-and-minds-a-comparison-of-counter-radicalization-strategies-in-britain-and-the-united-states>. Parë në 10 tetor 2016
- 15 Grizzle, A, Moore, P., et al (2013). Media and Information Literacy Policy and Strategy Guidelines. UNESCO, Paris.

Fuqizimi i Komunitetit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Pesë Ligjet e Edukimit në Media dhe Informim si Lajmëtarë të të Drejtave të Njeriut

Trashëgimia e Pesë Ligjeve të Ranganathan-it në Shkencat Bibliotekare

Alton Grizzle & Jagtar Singh

Reflektimet e sjella këtu mbi rëndësinë e trashëgimisë së Ranganathanit, që përfshijnë vizionin e tij për Alfabetizimin në Media dhe Informim (NjMI) në epokën digjitale, pasojnë pesë moto bazë. Numri pesë i zgjedhur këtu përkon me Pesë Ligjet e Ranganathan-it në Shkencën Bibliotekare. Motoja e parë merr në konsideratë një interpretim të thjeshtë të Ligjeve të Ranganathan-it në epokën digjitale dhe ngjashmërinë me shtysën e UNESCO-s për ndërtimin e shoqërive të dijes dhe “Universalitetit të Internetit”. Motoja e dytë tërheq vëmendjen te alfabetizimi në informacion dhe media ose njohurive në media dhe informim në epokën digjitale – si një konvergencë e domosdoshme. Motoja e tretë skicon për herë të parë Pesë Ligjet e Njohurive në Media dhe Informim të frymëzuar nga Ranganathani (NjMI). Motoja e katërt u bën thirrje bibliotekarëve, shkencëtarëve të angazhuar në shkencat bibliotekare dhe të informimit që të bëhen gardianë të njohurive në media dhe informim ose të njohurive të informacionit dhe medias – cilado qoftë rradha që preferojnë palët e interesuara – e që çon në ndryshimet që do donte të shihte Ranganathani. Dhe në fund, motoja e pestë e vë theksin te disa nga veprimet e ndërmarra nga UNESCO për të arritur tek alfabetizimi në media dhe informim për të gjithë. E mbyllim këtu duke sugjeruar që duhet të krijojmë një lëvizje rreth ëndrrave të Ranganathanit, duke angazhuar të rinjtë në Indi dhe në mbarë botën për njohuri në media dhe informim për të gjithë, si pjesë e vargut të të drejtave të njeriut.

Fjalë kyç: alfabetizimi në media dhe informim, zhvillim i qëndrueshëm, S.R. Ranganathan, pesë ligjet e njohurive në media dhe informim, fuqizimi i të rinjve me NjMI, UNESCO dhe konferencat e NjMI-së.

Rëndësia e Trashëgimisë së Ranganathanit

Librat dhe bibliotekat janë metafora të kujtesës së njerëzimit. Të dyja ndihmojnë “Takimin e Mendjeve” ... sepse është mendja ajo ku duhet të fokusohemi tek njeriu,

bashkëveprimi, shkëmbimi dhe krijimi i dijes, për t'i dhënë shtysë ndryshimit. UNESCO e mbështet fort këtë. Takimi i Mendjeve dhe “Uniteti i Mendjeve”, pa marrë parasysh as dallimet është ajo çfarë përfaqëson Ranganathan sine die. E vërteta është se Ranganathan ishte njeriu, vizionari, lideri, studjuesi, bashkuesi, mësuesi dhe bibliotekari mbi gjithë bibliotekarët. Ja pra pse ai njihet sot si “Babai i Lëvizjes Bibliotekare në Indi”. Por le të frymëzohemi më shumë nga ëndrra që jetoi. E megjithatë, a ka mënyrë më të mirë për të rinovuar dhe mbështetur pasionin, vizionin dhe qëllimin e asaj çfarë përfaqëson Ranganathani se sa përmes jetës së atyre që kanë lindur e jetuar një brez mbas tij e madje edhe brezave që do të vijnë. Fakti që nëpërmjet “Takimit të Mendjeve” ne mendojmë seriozisht mbi rëndësinë e trashëgimisë së Ranganathanit në epokën digjitale do të thotë që duhet të pranojmë se arritjet e tij kanë kuptim të madh për bibliotekarët, shkencëtarët e fushës bibliotekare informacionit, profesionistët e medias dhe komunikimit, ekspertët e teknologjisë e më tej, për të gjithë njerëzit. Kjo reflektohet në ligjin e tij të parë të shkencës bibliotekare: “Librat janë për tu Përdorur”. Ky besim gjen jehonë në Objektivin 4 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). (Singh, Grizzle, etj, 2015, fq. 19). Objektiv 4 lexohet si më poshtë:

Sigurimi i arsimimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë si dhe promovimi i mundësive gjatë gjithë jetës.

I rëndësishëm është edhe Objektiv 16 i cili ka të bëjë me paqen dhe shoqëritë gjithëpërfshirëse, aksesin për të gjithë te drejtësia dhe përgjegjësinë që, nga ana tjetër, përfshin të drejtën për informim dhe aksesin universal te informacioni për të gjithë.

Funksioni bazë i institucioneve të edukimit dhe i ofruesve të informacionit është krijimi dhe përhapja e dijes. Kjo bëhet duke mbështetur punën kërkimore, duke ofruar kurse të ndryshme studimi që kanë të bëjnë me detyrën e mbledhjes, përzgjedhjes, analizimit të informacionit dhe dijes, si dhe angazhimin e njerëzve. Pesë Ligjet e Ranganathanit për Shkencën Bibliotekare janë parakushte për krijimin dhe përhapjen e dijes. E vetmja gjë që na duhet të bëjmë sot është të zëvendësojmë termin “libra: me njohuri dhe “lexues” me prosumer (term i përdorur për një person i cili përdor njohuritë dhe informacionin për të krijuar njohuri të reja dhe përmbajtje).

Pesë Motot Bazë

Reflektimet e sjella këtu mbi rëndësinë e trashëgimisë së Ranganathanit, që përfshijnë vizionin e tij për Njohuritë në Media dhe Informim (NjMI) në epokën digjitale, pasojnë pesë moto bazë. Ndoshta e keni kuptuar tashmë pse kemi zgjedhur numrin pesë. Qëllimi është i thjeshtë. Ai përkon me Pesë Ligjet e Ranganathanit për Shkencën Bibliotekare. Motoja e parë merr në konsideratë një interpretim të thjeshtë të Ligjeve të Ranganathan-it në epokën digjitale dhe ngjashmërinë me shtysën e UNESCO-s drejt ndërtimit të shoqërive të dijes dhe “Universalitetit të Internetit”. Motoja e dytë tërheq vëmendjen drejt njohurive në informacion dhe media ose njohurive në media dhe informim në epokën digjitale – si një konvergencë e domosdoshme. Këtu po huazojmë karakterizimin që i bëu Sastri (sikurse citohet te Navalani & Satija, 1993, f. xi) Ranganathanit kur thotë se ai i përket Ekavakya-s – parim ky fundamental Vedas. Premisa bazë e tij është uniteti i të gjithë dijes.

Motoja e tretëskicon për herë të parë Pesë Ligjet e Njohurive në Media dhe Informim të frymëzuar nga Ranganathani. Motoja e katërt u bën thirrje bibliotekarëve, shkencëtarëve të angazhuar në shkencat bibliotekare dhe të informimit që të bëhen gardianë të njohurive në media dhe informim ose të njohurive të informacionit dhe medias – cilado qoftë rradha që preferojnë palët e interesuara – e që çon në ndryshimin që do donte të shihte Ranganathani. Dhe në fund, Motoja e pestë thekson disa nga veprimet e ndërmarra nga UNESCO për të arritur tek alfabetizimi në media dhe informim për të gjithë. E mbyllim po aty ku e nisëm, duke sugjeruar që duhet të krijojmë një lëvizje rreth ëndrrave të Ranganathanit, duke angazhuar të rinjtë në Indi dhe në mbarë botën për një alfabetizim në media dhe informim për të gjithë, si pjesë e të drejtave të njeriut.

Motoja e Parë – Pesë Ligjet e Ranganathanit: Lente të Shoqërive të Dijes bazuar mbi të Drejtat

Një kërkim i thjeshtë në Internet zbuloi disa aplikime të freskët dhe mjaft të thella të Pesë Ligjeve të Ranganathanit në informacionin aktual, peizazhin mediatik dhe teknologjik ose epokën digjitale¹. Ligjet janë vendosur paralelisht me e-librat, iTunes-et, blogjet, dëgjuesit, Netflix-in, Photoshop-in, Google Map, Blackboard-in (Dërrasë e Bardhë Elektronike), EasyBib-in, magazinat digjitale, etj. Përvetësimi i të Pesë Ligjeve të Ranganathanit, qoftë për qëllime argëtimi, komerciale, ose për korniza më konceptuale, ilustrojnë perspektiva emocionuese. Një set Ligjesh thotë:

6. E-librat janë për tu lexuar
7. Çdo dëgjuesi i-Tunes-et e veta
8. Çdo blogu një lexues
9. Kurse kohën e dëgjuesit
10. Interneti është organizëm në rritje.

Një tjetër thotë:

1. Netflix është për tu parë
2. Çdo artisti Photoshopin e vet
3. Çdo Google Map-i udhëtarin e vet
4. Kurse kohën e udhëtarit
5. Web është organizëm në rritje

Dhe një tjetër thotë:

1. Dërrasa e zesë është për të studjuar

2. Çdo studenti EasyBib-in e vet
3. Çdo magazine digjitale hulumtuesin e vet
4. Kurse kohën e hulumtuesit
5. Kutia e mjeteve të TIK është organizëm në rritje

Nuk ka pikë rëndësie nëse këto janë për qëllime argëtimi, komerciale ose për një konceptualizim më serioz. Po të flasim hapur, të gjithë i përdorim këto qasje për të transmetuar domosdoshmërinë e informacionit dhe të bibliotekave të gjithë qytetarët. Ne sugjerojmë një kornizë konceptuale që edhe Ranganathani do ta kishte parashikuar. Fillimisht, mund të zërthehet kuptimi ose konotacioni i librit. Sikurse vërejnë Navalani dhe Satija (1993,x), Ranganathani jo vetëm që artikuloi terminologji të reja për të ilustruar idetë e veta vizionare, por në punën e tij dha gjithashtu “konotacionin e çdo termi”. Në po të njëjtën frymë, ne kemi përkufizuar librin si Konteiner të Dijes, sepse në terma literalë ai është pikërisht kjo gjë. Në këtë kuptim, interpretimi në vijim i ditëve të sotme i Pesë Ligjeve të Ranganathanit i Shkencave Bibliotekare vjen e propozohet duke iu referuar qasjes së të drejtave të njeriut.

Tabela 1 Pesë Ligjet e Ranganathanit parë nga Perspektiva e të Drejtave

Pesë Ligjet e Ranganathanit të Shkencave Bibliotekare	Interpretim i ditëve të sotme	Argumente relevante/Pyetje që bazohen mbi të Drejtat
Librat janë për tu përdorur	Dija është për tu përdorur	Përdorim etik i dijes? Akses i hapur në informacion dhe dije
Çdo lexuesi librin e vet	Çdo Përdorues i Dijes fiton mençuri dhe krijon dije të reja	Të gjithë duhet të kenë lirisht akses te informacioni dhe dija
Çdo libër i lexuesin e vet	Të gjitha Dijet kanë përdoruesit e tyre	Njerëzit kanë të drejtë për informacion dhe dije të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse, gjithashtu edhe për liri të shprehjes dhe të drejtë për të zgjedhur
Kurse kohën e lexuesit	Shto mirëqenien e përdoruesit të dijes	Njerëzit kanë të drejtë për zhvillim njerëzor të mundësuar nga aksesit te informacioni dhe dija
Biblioteka është organizëm në evolucion	Dija është dinamike, përherë në rritje	Njerëzit kanë të drejtë të provojnë, analizojnë dhe ndërtojnë mbi informacione dhe njohuri ekzistuese për të krijuar informacione dhe njohuri të reja

Dija përfaqëson si të renë asht dhe të vjetrën. Ashtu si Pesë Ligjet e Ranganathanit të Shkencave Bibliotekare kanë qenë dhe do të jenë domethënëse në të gjitha kohërat, po ashtu do të vazhdojë të jetë edhe dija. Si rezultat të idesë së Shoqërisë së Informacionit të Samitit të parë Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit, drejtuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit dhe UNESCO², kemi termin Shoqëri me bazë Dijen. UNESCO i promovon Shoqëritë me bazë Dijen duke u mbështetur në katër parime³:

1. Edukim Cilësor për të Gjithë
2. Liri e Shprehjes
3. Akses Universal në Informacion
4. Multilingualizëm në Hapësirën Kibernetike që nënkupton gjithashtu Diversitet Kulturor.

Inkuadrimi i arsimit si përvetësim dhe përdorim i dijes, arsim cilësor për të gjithë, dhe e drejtë për informim dhe akses universal në informacion, është reflektim i besimit të Ranganathanit të libra për të gjithë ose shërbime bibliotekare për të gjithë. “Çdo Lexuesi Librin e vet” dhe “Çdo libri një lexues” do të thotë diversitet informacioni dhe dije për të gjithë, liri zgjedhjeje dhe liri të shprehjes. Multilinguizmi dhe diversiteti kulturor janë të pandashëm nga krijimi i dijes, magazinimi dhe përhapja. Ranganathani u është përkushtuar Pesë Ligjeve të Shkencave Bibliotekare dhe parimin e katërt e ka praktikuar gjatë gjithë jetës dhe punës së vet. Si “Dijetar Oriental” ai e lidhi dijen me Lindjen dhe Perëndimin për të krijuar një shkencë të re, të njohur si Shkenca Bibliotekare.

Në lidhje me Internetin, nxitur nga teknologjitë digjitale, UNESCO ka artikulluar një kornizë të re dhe komplementare për të theksuar atë që organizata e quan Universalitet të Internetit³ (Universaliteti i Librave). Ranganathani do ta kishte përqafuar Internetin si një konteiner të ri të dijes, sikurse duket qartë në Ligjin e Pestë të tij, “Biblioteka është një Organizëm në Rritje”. Ky konteiner i ri nuk i zëvendëson librat por i plotëson ata. Marrëdhënia e këtyre konteinerëve është në simbiozë me njëri-tjetrin.

“Në mënyrë që Interneti të përmbushë potencialin e vet historik, duhet të arrijë me të drejta të plota “Universalitetin”, bazuar në fuqinë dhe ndërvarësinë e sa më poshtë:

- norma që Interneti bazohet në të Drejtat e Njeriut (që në këtë dokument është kuptimi në thelb i një “Interneti të lirë”)
- norma që ai është i “Hapur”
- norma që thekson “Aksesin për të Gjithë”, dhe
- norma që ai ushqehet nga Pjesëmarrja e shumë palëve të interesuara”

Brenda kësaj kornize, katër parimet kardinale bazë janë përmbledhur në inicialet R-O-A-M (Rights, Openness, Accessibility, Multi-stakeholder) [p.1]

Motoja e dytë – Maksimalizimi dhe Ekologjia e NjMI-së përmes “Minimalizmit”

A e dini se si arrihet universaliteti i Ranganathanit për librat e për pasojë bibliotekat dhe universalitetin e propozuar nga UNESCO për Internetin? Ekzistojnë disa mënyra, politika, rregullore, ligje, inovacione, partneritete publike-private, etj. Për këtë ka shumë shembuj nga India dhe në mbarë botën. Vetë Ranganathani ishte pionier i Ligjit të Modelit të Bibliotekës Publike. Kohët e fundit, Fondacioni M.S. Swaminathan Research (MSSRF) dhe Fondacioni i Bill dhe Melinda Gates-it kanë iniciuar në Indi Projektin International Network of Emerging Library Innovators (INELI, Rrjeti Ndërkombëtar i Novatorëve të Bibliotekave të Reja). UNESCO është bashkuar me ta në mbështetje të kësaj iniciative duke u fokusuar në angazhimin e grave analfabete pranë bibliotekave dhe Qendrave të Informimit Komunitar.

Një tjetër mënyrë kritike në gjurmët e universalitetit të këtyre dy konteinerëve të dijes, librave dhe Internetit, është nëpërmjet asaj çfarë UNESCO e quan alfabetizimi në media dhe informim për të gjithë, ose informacion dhe njohuri në media për të gjithë. Ranganathani ishte shembulli tipik i frymëzimit për këtë – për shkurtim do të themi MIL sepse është më thjeshtë në shqiptim, ndihmon të lexohet shpejt dhe shkurt. Ai ishte njeri me dije të thella që dinte si ti thjeshtonte kompleksitetet.

Le të rikujtojmë dhe reflektojmë shkurtimisht mbi atë se çfarë është MIL-i nga pespektiva e UNESCO-s dhe të japim disa nga debatet teorike që lidhen me këtë fushë. MIL-i nuk është thjesht një organ i dijes, i huazuar më së shumti nga fusha e informacionit, bibliotekat, mediat dhe teknologjia, MIL-i është mënyrë të menduari dhe vepruari – mësimdhënie dhe mësimi (Grizzle dhe Wilson, 2011). Është pikërisht kjo që i bën të jashtëzakonshme Pesë Ligjet e Shkencës Bibliotekare të Ranganathanit – ai synonte që ata të ishin të tillë dhe i jetoi si mënyrë të menduari dhe të vepruari – mësimdhënie dhe mësimi – duke krijuar, depozituar dhe përhapur dije.

Tashmë kemi mbërritur në moton e dytë të kësaj narrative dhe duke folur për njohuritë në media dhe informim (MIL), dëshirojmë të shpjegojmë arsyen për këtë: sikurse e dimë të gjithë, historikisht, njohuritë në media dhe njohuritë në informim janë trajtuar si fusha të ndara dhe përfshijnë disa nocione të dijes, por tani UNESCO po e promovon MIL-in si një koncept të përbërë.

Rezultatet e Mësimit të Edukimit në Informim

Këto përfshijnë:

1. Përkufizimin dhe artikulumin e nevojave të informimit
2. Lokalizimi dhe aksesin në informacion
3. Organizimi i informacionit

4. Përdorimi etik i informacionit
5. Komunikimi i informacionit, dhe
6. Përdorimi i aftësive në TIK për përpunimin e informacionit.

Rezultatet e Mësimi të Edukimit Mediatik

Këto janë:

1. Të kuptohet roli dhe funksionet e medias në shoqëritë demokratike dhe në zhvillim
2. Të kuptohen kushtet brenda të cilave media mund të përmbushë funksionet e veta
3. Vlerësimi në mënyrë kritike i përmbajtjes mediatike në dritën e funksioneve të medias,
4. Angazhimi në media për të shprehur veten dhe për pjesëmarrje demokratike, duke promovuar dialogun ndërkulturor dhe ndërfetar, barazinë, paqen, të drejtat, duke luftuar urrejtjen dhe duke u angazhuar në zhvillimin e qëndrueshëm;
5. Për të prodhuar përmbajtje të gjeneruar nga përdoruesit nevojiten aftësi shqyrtuese (përfshirë ato në TIK).

Duke patur parasysh që vetë Ranganathani ishte njeri i matematikës, duke përdorur konceptin e teorisë së bashkësive, do të tregojmë lidhjen konceptuale dhe debatet teorike midis IL dhe ML. E vërteta është se në themelet e veta Ranganathani ishte po aq preciz sa është edhe disiplina e matematikës dhe po aq i thellë sa është subjekti i filozofisë.

Janë disa shkolla mendimi që dalin nga raporti midis këtyre dy fushave konvergjente. Së pari, në disa mjedise njohuritë në informim konsiderohen si fushë më e gjerë studimi e cila përfshin dhe njohuritë në media. Për të tjerë, njohuritë në media konsiderohen si fushë e gjerë studimore dhe njohuritë në informim si komponent i saj. Në të dy skenarët, fusha e përfshirë trajtohet normalisht si më pak e rëndësishme se sa fusha më e “madhe” (Grizzle dhe Torras, 2013).

Disa aktorë të fushës i shohin ato si fusha të dallueshme dhe të ndara. Ekspertë të tjerë pranojnë që ka një nivel ndërthurje dhe mbivendosje midis ML-së dhe IL-së, por ngulin këmbë që mbeten disa veçanti.

UNESCO propozon që të marrim bashkimin ose setin e plotë të kompetencave në media dhe informim që ofrojnë ML dhe IL; e në këtë mënyrë, këto dy fusha që më parë ishin të dallueshme, të kombinohen e bashkohen nën një term ombrellë: Alfabetizim në Media dhe Informim (MIL). Është thelbësore që ndërsa kërkojmë të forcojmë fëmijët, të rinjtë dhe qytetarët në përgjithësi – për të universalizuar librat edhe Internetin – njohuritë në media dhe informim duhen konsideruar si një e tërë, e cila përfshin kombinimin e kompetencave të ndërthurura në media dhe informim (dije, aftësi dhe qëndrime).

Alfabetizimi në Informim plus Media = Alfabetizim në Media dhe Informim. Kjo qasje, e cila sheh përpara, harmonizon dhe ndoshta qetëson debatin teorik. Ajo është harmonizuese sepse përfshin nocionet e shumta të njohurive të afërta ose multi-njohurive.

Këto përfshijnë: njohuri bibliotekare, njohuri në lajme, njohuri digjitale, njohuri në kompjuter, njohuri në Internet, Lirinë e Shprehjes dhe Lirinë e Aksesit të njohuritë e Informimit, njohuri në televizion, njohuri në reklamim, njohuri në kinema, njohuri në lojra dhe ndoshta shpejt do të dëgjojmë rreth njohurive në rrjetet sociale (po aty).

Kjo qasje e përbërë në MIL është formuluar me kompetenca⁵ të gjera siç tregohet më poshtë në Figurën 1


Kompozimet në Figurën 1A dhe 1B janë frymëzuar nga teoria e minimalizmit të krijuar nga Carl Andre, i cili thuhet se ka ndryshuar historinë e skulpturës. Ai kompozonte mbi dysheme një pirg blloqesh duke u dhënë forma të ndryshme. “Kontributi më i rëndësishëm i tij ka qenë distancimi i skulpturës nga gdhendja, modelimi ose konstruksioni, dhe realizimi i punimeve që kishin thjesht të bënin me ndarjen dhe vendosjen”⁶. Në mënyrë

Figura 1A



© dizenuar nga D3 images - Freepik.com

Figura 1B



metaforike kjo gjen implikim në njohuritë në media dhe informim si një koncept i përbërë. Duke patur parasysh daljen me shumicë të teknologjive të ndryshme dhe konceptualizimin e kompetencave të nevojshme për të gjithë njerëzit në shekullin e 21-të, UNESCO bëri përpjekje për t'i reduktuar këto në minimum të MIL-i, duke identifikuar, ndarë dhe kompozuar kompetenca të afërta në forma të thjeshta dhe të lehta për tu kuptuar.

Fuqia e Teknologjisë

Ky model konceptual i propozuar i MIL-it është forca shtytëse që qëndron mbas strategjisë së UNESCO-s për MIL-in dhe duhet inkurajuar në nivel global. Ai pranon rëndësinë e të gjitha formave të medias dhe ofruesit e tjerë të informacionit si Interneti, bibliotekat, arkivat, muzeumet, etj. Kjo qasje është gjithashtu progresive sepse bazohet në konvergencën e telekomunikimeve dhe transmetimeve televizive, si dhe në shumë forma të tjera mediatike dhe informuese. Nëpërmjet platformave të zakonshme të përhapjes dhe pajisjeve të zakonshme të aksesit në të, çdokush ka akses në radio, televizione, lojra, biblioteka dhe arkiva digjitale, të gjitha këto në një vend të vetëm; për shembull në një smartphone. Dhe në fund, ajo është progresive sepse integrimi i MIL-it në sistemet arsimore (formale dhe jo formale) ose gjenerimi i MIL-it si një lëvizje kritike e edukimit qytetar kërkon një strategji të unifikuar, jo të fragmentuar. MIL-i nuk duhet rezervuar vetëm për elitat, për studentët universitarë, por duhet të jetë i përballeshëm për të gjithë qytetarët, kudo përtej kufijve. Ai është zgjatim i të drejtave të njeriut. Sikurse e përshkruan edhe Sastri, e përmendëm dhe më sipër, Ranganathani i përkiste Ekavakya-t:

“parim ky fundamental Vedas. Premisa bazë e tij është uniteti i të gjithë dijes”. Sastri shkruan “Një mendje Ekavakya-të si ajo e Ranganathanit është e uritur për të kuptuar dhe asimiluar forcat e reja të sapo çliruara, dhe sfidon konvencionet dhe praktikën e zbrazëta; ajo është e gatshme të marrë pjesë në atë çka është e re dhe stimuluese”.

Ai vazhdon: “Ekavakya-të jo vetëm që ushqeu intensivisht imagjinatën e tij, por ishte burim frymëzimi i cili ndryshoi vetë qëndrimin e tij, madje në thelb edhe shpirtin e tij. Ai nisi të mendojë e të flasë, të mësojë e predikojë në atë gjuhë”. (po aty) A nuk është e fuqishme kjo? Na thërret Ekavakya-të për përhapjen e MIL-it për të gjithë!

Motoja e Tretë – Pesë Ligjet e Alfabetizimit në Media dhe Informim

Moroja e tretë skicon për herë të parë Pesë Ligjet e Alfabetizimit në Media dhe Informim të frymëzuar nga Ranganathani. Teksa udhëtojmë të gjithë së bashku drejt universalitetit të librave dhe Internetit, nëpërmjet alfabetizimit mediatik dhe informativ për të gjithë si

zgjerim i të drejtave të njeriut, çfarë mund të perceptohet si Pesë Ligje të Njohurive në Media dhe Informim? Po e shpjegojmë më poshtë:

1. **Ligji një** – Informacioni, komunikimi, bibliotekat, media, teknologjia, Interneti dhe të gjitha format e tjera të ofruesve të informacionit janë që të përdoren për një angazhim kritik qytetar dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ato kanë staturë të barabartë dhe asnjëra nuk është më e rëndësishme se tjetra, e as duhen trajtuar ndonjë herë si e tillë.
2. **Ligji dy** – çdo qytetar është krijuar i informacionit/dijes dhe ka një mesazh. Ata duhen mundësuar për të patur akses te informacioni/dija e re dhe për të shprehur veten. MIL-i është për të gjithë – njësoj për burrat dhe gratë – dhe zgjerim i të drejtave të njeriut.
3. **Ligji tre** – Informacioni, dija dhe mesazhet nuk kanë gjithmonë vlerë neutrale, ose nuk janë gjithmonë të pavarura dhe të paanëshme. Çdo konceptualizim, përdorim dhe aplikim i MIL-it duhet ta bëjë transparente dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët këtë të vërtetë.
4. **Ligji katër** – Çdo qytetar dëshiron të dijë dhe të kuptojë informacionin, dijet dhe mesazhet e reja, gjithashtu edhe të komunikojë, edhe kur nuk është i ndërgjegjshëm ose e ndërgjegjshme për këtë gjë, nuk e pranon ose nuk shprehet që e do. Megjithatë, të drejtat e tij apo të saj asnjëherë nuk duhen kompromentuar.
5. **Ligji pesë** – Njohuritë në media dhe informim nuk fitohen përnjëherë. Ato janë përvojë dhe proces dinamik që jetojnë. Njohuritë janë të plota kur përfshijnë dije, aftësi, qëndrime, kur mbulojnë aksesin, vlerësimin, përdorimin, prodhimin dhe komunikimin e informacionit, të përmbajtjes mediatike dhe teknologjike.

Motoja e katërt – Gardianë të MIL-it

Bazuar në Pesë Ligjet e Alfabetizimit në Media dhe Informim, Motoja e katërt u bën thirrje bibliotekarëve, shkencëtarëve të angazhuar në shkencat bibliotekare dhe të informimit, profesionistëve të medias, komunikimit dhe gazetarisë, gjithashtu të gjithë njerëzve që të bëhen gardianë të alfabetizimit në media dhe informim – cilado qoftë rradha që preferojnë palët e interesuara – e që çon në ndryshimin që do donte të shihte Ranganathani.

Fjala gardian këtu duhet parë si metaforë. Gardian “është personi që ka autoritetin ligjor (dhe detyrimin përkatës) të kujdeset për interesat personale dhe pronësore të një personi tjetër dhe quhet rojtari”⁸⁹.

Në qoftë se bibliotekarët dhe shkencëtarët e informimit, si dhe profesionistët e medias, komunikimit dhe gazetarisë do të bëhen gardianë të MIL-it për të gjithë, atëherë kjo do të kërkojë kurikula të reja dhe trajnim të ri për të dy grupet.

Motoja e pestë – disa ndërhyrje të UNESCO-s në lidhje me MIL-in

Në mbyllje të këtyre reflektimeve, Motoja e pestë nënvizon disa aksione të ndërmarra nga UNESCO për realizimin e alfabetizimit në media dhe informim për të gjithë.

Programi gjithëpërfshirës i UNESCO-s mbulon zhvillimin e kurikulave dhe burimeve, udhëzime për politika dhe artikulum strategjie, zhvillim kapacitetesh ku përfshihen Kurse Online të Hapura eMasive (MOOC), monitorim dhe vlerësim, ngritje e rrjeteve, studime kërkimore dhe angazhim i të rinjve.

- UNESCO ka përgatitur një model Kurikule për Mësues për Alfabetizimin në Media dhe Informim, të disponueshme në 13 gjuhë. Kurikula e MIL-it u hartua në kontekst ndërkombëtar, me qasje gjithëpërfshirëse, jo normative dhe duke patur në mendje adaptimin. Futja e MIL-it në kurikulën e shkollës formale do të ngrejë një urë midis asaj çka mësojnë në klasë fëmijët dhe të rinjtë (edukimi formal) dhe asaj çfarë mësojnë në botën e tyre – virtuale (mjedisi jo/informal i edukimit formal). UNESCO po punon me vendet në mbarë botën për të përshtatur këtë kurikulë e për të integruar MIL-in në formimin e mësuesve.
- Arritja e dijeve në media dhe informim për të gjithë do të kërkojë formulimin e politikave kombëtare dhe të programeve të udhëhequr nga qëllimi. Si pjesë e strategjisë së përgjithshme të MIL-it, UNESCO ka botuar Udhëzime për Politikën dhe Strategjinë e Njohurive në Media dhe Informim. Këto udhëzime ofrojnë një qasje të harmonizuar e cila nga ana tjetër u mundëson Vendeve Anëtare të artikulojnë politika dhe strategji më të qëndrueshme kombëtare për MIL-in.
- Mbi bazën e këtij burimi, UNESCO mbështet Vendet Anëtare që t'i përshtasin këto udhëzime me realitetet lokale nëpërmjet konsultimeve të hapura dhe gjithëpërfshirëse kombëtare. Objektivi final është përgatitja e politikave dhe strategjive kombëtare të MIL-it të integruara me politikën, rregulloret dhe ligjet që kanë të bëjnë me aksesin në informacion, lirinë e shprehjes, lirinë kulturore dhe fetare, mediat, bibliotekat, edukimin dhe TIK. Në vende si Nigeria, Filipinet, India, Libani, Serbia, Turqia etj., po zhvillohen projekte pilot. UNESCO në partneritet me Këshillin e Europës po i aplikon të dy mjetet në vendet e Europës Lindore dhe në Liban.
- Për të siguruar monitorimin dhe aksesin në MIL, UNESCO hartoi Kuadrin e Vlerësimit të Njohurive Globale në Media dhe Informim (MIL), i cili siguron një kornizë konceptuale dhe teorike për MIL si dhe prezanton përsiatjen dhe metodologjinë për kryerjen e një vlerësimi i cili do të tregojë nëse një vend është ose jo gati dhe nëse ekzistojnë ose jo kompetencat në MIL në nivel kombëtar. Ai përfshin gjithashtu hapat praktike për adaptimin e rekomandimeve të veta në nivel kombëtar. Ky kuadër është pilotuar në Brazil, Kolumbi, Ekuador, Grenada, Guatemala, Honduras dhe Peru.
- Në fushën e lidhjes në rrjet, UNESCO bashkë me partnerët kanë ndërmarrë Aleancën Globale për partneritet në Alfabetizimin në Media dhe Informim (GAPMIL). Kjo është përpjekje novatore për promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në mënyrë që

të gjithë qytetarët të kenë akses te kompetencat në media dhe informacion. Janë afro 500 organizata nga mbi tetë vende që kanë pranuar të bashkohen forcat e të ngrihen së bashku për ndryshim. Në të gjitha rajonet e botës janë krijuar Kapituj Rajonalë për GAPMIL-in.

Dialogu ndërkulturor, radikalizimi ndërfaqës dhe solidariteti njerëzor janë temat qendrore të këtyre eventeve. Këto pritet të kontribuojnë në identifikimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, gjithashtu edhe në hartimin e programeve për bashkëpunim ndërkombëtar në hartimin e udhëzimeve për politika, ngritjen e kapaciteteve dhe për përgjigje novative. MIL-i konsiderohet si kyç dhe mjaft urgjent për t'u dhënë të gjithëve kapacitetin e duhur në mënyrë që t'i bëjnë ballë intolerancës, urrejtjes dhe pikëpamjeve radikale, ekstremiste dhe të dhunshme.

UNESCO ka zhvilluar gjithashtu Udhëzimet për Transmetuesit për të promovuar MIL-in dhe Përbajtje që gjenerohet nga përdoruesit.

Në fushën kërkimore, UNESCO dhe UNAOC kanë themeluar Rrjetin e parë Ndërkombëtar Universitar MILID, Programin e Bashkëpunimit UNITWIN për Njohuritë në Media dhe Informim dhe Dialog Ndërkulturor (UNESCO-UNAC UNITWIN) me anëtarë nga të gjitha rajonet e botës. UNESCO-UNAOC-MILID UNITWIN kërkon të sigurojë që dija dhe ekspertiza kolektive të zhvillohen nëpërmjet dialogut reciprok, mirëkuoptimit dhe respektit.

Në mbyllje, i referohemi filmit “A Beautiful Mind” – që bazohet në jetën e John Nash-it, matematicien i ngjashëm me Ranganathanin. John Nash dhe Alicia Nash, e shoqja, vdiqën tragjikisht kohët e fundit e urojmë që shpirti i tyre të prehet në paqe. Russell Crowe, aktori që luan rolin e John-i Nash-it jeton ende.

Ranganathan kishte mendje të bukur. Të gjithë kemi mendje të bukura – të gjithëve natyra na ka dhuruar mendje të bukura. Jetojmë akoma. Ne duhet të jetojmë e të conceptualizojmë si Ranganathani. Mesazhi i tij në Pesë Ligjet e Shkencës Bibliotekare është mjaft i qartë. Ai ka të bëjë me promovimin e përdorimit të dijes, sigurimin e aksesit të barabartë, masiv e të përballeshëm në informacion, duke e çliruar dijen nga shtrëngimi i interesave komerciale, duke e bërë informacionin dhe dijen të aksesueshëm për këdo e për të gjithë në formate që përdoren lehtë, si dhe duke ndihmuar progresin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në qoftë se bëjmë një analizë të kujdesshme të Pesë Ligjeve të Shkencës Bibliotekare, do të shohim se këta ligje janë pesë shtyllat e njohurive në media, informim dhe dialog ndërkulturor, të të mirave të përbashkëta krijuese dhe burimeve të hapura të edukimit (OER). Në fakt, Pesë Ligjet e Ranganathanit janë flamurtarët e parë të stafetës “Dije për të Gjithë”, dhe Pesë Ligjet e Njohurive në Media dhe Informim janë flamurtarët e sotëm të së njëjtës filozofi egalitare. Le t'i bashkohemi me pasion kësaj gare. Tiffany Shlain na thotë me anë të një videoje në YouTube që Interneti është burim jashtëzakonisht i gjerë me një trilion faqe në rrjet dhe 100 trilion lidhje. Në qoftë se i konsiderojmë neuronet si faqe në rrjet dhe komunikimin midis neuroneve (sinopset) si lidhje – do dali që truri i një të rrituri ka 300 trilion lidhje të tilla. Por mos harroni, truri i një fëmije ka një kuadrilion lidhje, 10 herë më shumë se lidhjet që ka Interneti. Fokusi në impaktin e medias dhe teknologjisë mbi qytetarët duhet balancuar me një fokus të barabartë mbi mënyrën se si burrat dhe gratë e të gjitha moshave mund t'ijapin formë informacionit, medias dhe teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm. Njohuritë në media dhe informim bëjnë

pikërisht këtë gjë. Ato formësojnë mendjet të cilat janë shumë më të fuqishme se mediat dhe i gjithë Interneti. Na duhet të ndryshojmë mendjet që do të krijojnë ndryshimin – ndryshimin e qëndrueshëm! Atëherë me të vërtetë mund të ndryshojmë e t'i japim formë zhvillimit. Në video, Tiffany Shlain thekson, “Vëmendja është burimi më i madh i trurit. Le t'i kushtojmë vëmendje asaj ku kemi përqendruar vëmendjen, në mënyrë që të hedhim themelet për ndjeshmëri botërore, novacion dhe shprehje humane”. – Ne i shtojmë kësaj VËRTETËSI dhe VËLLAZËRI (cf. Grizzle. 2015)!

Referencat

- Grizzle, A. (2015) Measuring Media and Information Literacy: Implications for the Sustainable Development Goals. In Media and Information Literacy for the Sustainable Development Goals redaktuar nga Jagtar Singh, (2015). International Clearinghouse on Children, Youth and Media NORDICOM University of Gothenburg.
- Grizzle, A, Moore, P. and Torras, M.C. (2013). Media and Information Literacy Policy and Strategy Guidelines. UNESCO, Paris
- Grizzle, A. and Wilson, C. (2011). Media and Information Literacy: Curriculum for Teachers: UNESCO, Paris
- Jagtar Singh, (2015). MILID Yearbook 2015: Media and Information Literacy for the Sustainable Development Goals. Goteborg, Sweden: NORDICOM.
- Navalani, K. & Satija, M.P. (Eds.) (1993). Petits Petals: A Tribute to S. R. Ranganathan. NewDelhi: ABC Publishing.
- Ranganathan, S. R. (1931). The Five Laws of Library Science. Madras: Madras Library Association.

Shënime

1. http://www.infodocket.com/wp-content/uploads/2014/06/2014-06-30_08-46-06.jpeg. Parë në 30 shtator 2016.
2. <http://www.itu.int/net/wsis/>. Parë në 30 shtator 2016.
3. <http://en.unesco.org/themes/building-knowledge-societies>. Parë në 30 shtator 2016.
4. shihInternet Universality: A Means Towards Building Knowledge Societies and the Post-2015 Sustainable Development Agenda
5. Cf. Grizzle, A, Moore, P. et al (2013). Media and Information Literacy Policy and Strategy Guidelines. UNESCO, Paris
6. Carl Andre, American Sculptor, Movements: Minimalism, Conceptual Art. Found on the website, The Art Story: Modern Art Insight. <http://www.theartstory.org/artist-andre-carl.htm>, Parë në 30 shtator 2016.
7. Shih hyrjen te Petits Petals: A Tribute to S. R. Ranganathan
8. https://en.wikipedia.org/wiki/Legal_guardian. Parë në 30 shtator 2016.

Alfabetizimi në Media dhe Informim Ndërlidhës për Fuqizimin e Komunitetit në Indi

I.V. Malhan & Jagtar Singh

Universitetet e themeluara me fonde publike janë të detyruar t'i kthejnë komuniteteve respektive idetë, dijet e reja dhe mekanizmat që mund të ndihmojnë progresin social dhe ngritjen e kapaciteteve për të shtuar kësisoj kontributin e tyre në zhvillimin kombëtar. Mungesa e ndërgjegjësimit për oportunitetet po i bën mjaft njerëz, sidomos në fshatra, thjesht të plogësht duke thërmuar kështu energjitë potenciale që do të mund të përdreshin për angazhimin e tyre në veprimtari që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit dhe avancimin në nivel kombëtar. Informacioni sjell ndërgjegjësim për oportunitetet dhe njohuri për praktikata e punës të bazuara në nevojë, si dhe rrit cilësinë e jetës e të punës së tyre. Ky punim përshkruan se si intervenimi i njohurive në media dhe informim mund t'i ndihmojë njerëzit të gjejnë në mënyrë më efektive informacionin që u intereson për zgjidhjen e problemeve të përditshme e për ta bërë këtë në mënyrë më të mirë. Më tej ai diskuton se si përshtatja e informacionit dhe e medias mund t'i ndihmojë njerëzit t'i nxjerrin kuptim informacionit dhe të iniciojnë aksione pozitive. Ai thekson gjithashtu rolin e universiteteve në ndërlidhjen me komunitetet respektive dhe praktikata intensive të punës që promovojnë dijen nëpërmjet intervenimeve të njohurive në media dhe informim.

Fjalëkyç: të Drejtat e Njeriut, protesta të fermerëve, zhvillim i komunitetit, ngritje e kapaciteteve, model i njohurive në media dhe informim, ndërlidhje e komunitetit universitar.

Hyrje

Informacioni për ne është nevojë e katërt në rradhë mbas ushqimit, veshmbathjes dhe strehimit; dhe një burim i menjëhershëm fuqie për të gjithë. Informacioni mund të përkufizohet si entitet i pakapshëm që rritet sa më shumë përdoret dhe garanton pasuri, siguri, kontroll dhe argëtim. Por shkëmbimi i informacionit midis dhe brenda kombeve dhe institucioneve në botë po rritet dita ditës. Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) si dhe Interneti i kanë dhënë një goditje vdekje prurëse kufizimeve tradicionale të hapësirës dhe kohës. Informacioni sot është i disponueshëm për këdo, kudo dhe në çdo kohë: me kusht që ai që kërkon informacion të ketë kapacitetin të paguajë për të dhe gjithashtu kompetencat relevante për të përcaktuar nevojat e veta për informacion,

të gjejë e të marrë informacionin e nevojshëm, ta vlerësojë atë, dhe në fund të krijojë e përdorë në mënyrë etike dhe efektive. Por pavarësisht të gjitha këtyre zhvillimeve, sot po rritet dita ditës hendeku midis atyre që janë të pasur në informacion dhe të varfër në informacion. Hendeku i aftësive është boshllëku më i madh dhe ngritja e urave mbi të është detyrë mjaft e vështirë për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim të botës. Në Indi hendeku është më serioz në përgjithësi për banorët e zonave rurale dhe në veçanti për komunitetin e fermerëve. Kësisoj, nevojiten ndërhyrjet e duhura për t'u dhënë mundësi këtyre segmenteve jo elitare të shoqërisë. Njohuritë në media dhe informim mund të bëjnë mjaft për të fuqizuar komunitetin e fermerëve që, në fakt, është faktor kritik suksesi për progresin e Indisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Përparimi ekonomik i një kombi arrihet me potencial të plotë vetëm atëherë kur njerëzit e tij kanë kapacitetin dhe mundësitë për të marrë pjesë e për të dhënë kontributin që u takon në rritjen dhe zhvillimin e vendit. Infrastruktura e dijes dhe e informimit luan gjithashtu rol kritik në përmirësimin e nivelit të informacionit të njerëzve, duke i njohur ata me rrugët e disponueshme për të avancuar, duke i motivuar në mënyrë që aksionet e dëshiruara të përmirësojnë e çojnë në përdorim efikas të programeve të mbështetjes sociale të lançuara nga qeveria. Informacioni hedh dritë mbi atë çfarë po bëhet aktualisht dhe çfarë mund të bëhet më shumë për krijimin e një vizioni për të ardhmen, për të përmirësuar kushtet e tyre te jetesës dhe mjedisit si dhe për zhvillim të qëndrueshëm. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut shpall që “kushdo ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së vet”. Sipas vlerësimeve më të fundit, në vitin 2012, 12.7 % e popullsisë në botë jetonte me 1.90 dollarë në ditë ose më pak. Kjo do të thotë në që vitin 2012, 896 milion njerëz jetonin me më pak se 1.90 dollarë në ditë. (Banka Botërore, Vështrim mbi Varfërinë). Lehtësimi i varfërisë është detyrë herkuliane për disa vende, për t'u siguruar njerëzve dinjitet dhe mundësi për të përballuar vetë jetesën. “Përshpejtimi i reduktimit të varfërisë ekstreme përbën një sfidë të jashtëzakonshme si në Afrikën subsahariane ashtu edhe në Azinë e Jugut, duke pasur parasysh që këto rajone kanë respektivisht rreth 400 milion dhe 500 milion njerëz ekstremisht të varfër”. (Banka Botërore, Reduktimi i Varfërisë dhe Barazia). Këto rajone janë të pasura në rezerva natyrore e megjithatë mjaft njerëz jetojnë të privuar e vazhdojnë të mbeten të tillë sepse shumica e tyre nuk kanë akses në informacionin me potencial për t'u ndryshuar jetën.

Vetëvrasjet e fermerëve

Në Indi, 67 % e popullatës jeton në zonat rurale dhe 70 % e familjeve në këto zona, në masën dërrmuese e kanë jetën të varur nga bujqësia dhe profesionet e afërta me të. Një numër i madh i banorëve ruralë janë fermerë të marginalizuar, punëtorë të vegjël dhe tregtarë të vegjël. Popullsia në rritje dhe mungesa e infrastrukturës së dijes dhe informacionit nuk u ka lejuar atyre të jetojnë cilësinë e jetës që u takon si e drejtë edhe shumë dekada mbas fitores së pavarësisë. Kostoja në rritje e inputeve bujqësore po i zhyt fermerët në borxhe. Një numër fermerësh marginalë dhe të vegjël janë prodhues por jo

konsumatorë të ushqimeve të kërkuara. Kësisoj, familjet e fermerëve të marginalizuar dhe të vegjël në Indi kanë një numër të madh njerëzish të kequshqyer. Kjo ka sjellë protesta të fermerëve dhe gjithashtu në shumë vende janë raportuar vetëvrasje të fermerëve. Disa organizata janë hedhur në veprim për të ndihmuar fermerët të kapërcejnë krizën dhe që të përmirësojnë prodhimin bujqësor duke ndërhyrë me dije. Për shembull, organizata Sri Sri Ravishankar i ndihmoi fermerët të përmirësojnë prodhimin e kulturës së domates. Veç kësaj gjithashtu, Objektivi 2 i Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm i referohet “Dhënies fund urisë, arritjes të sigurisë së ushqimit dhe përmirësimit të të ushqyerit, duke promovuar bujqësinë e qëndrueshme”. (Jagtar, 2015, f.19). Nëntema 4 e Komisionit Kombëtar të Dijes interpretohet si më poshtë:

“Promovon novacionin dhe sipërmarrjen, bashkë me aplikimin e dijes në bujqësi, industri dhe kujdes shëndetsor”. (NKC, 2005, f.1). Në fakt, shpirti i Komisionit fokusohet në krijimin e dijes, përhapjen e dijes dhe aplikimin e dijes brenda skenarit të diversitetit Indian. Në mënyrë të ngjashme, mandati i universiteteve dhe i institucioneve të tjera të edukimit është krijimi dhe përhapja e dijes. Kjo do të thotë që aksesin në kohë të informacioni përkatës, në mënyrë të përbalueshme dhe me një format të lehtë në përdorim, është e drejtë bazike njerëzore për komunitetin e fermerëve. Prandaj, qeverisjet vendore, shtetërore dhe të bashkuara në Indi duhet të bashkëpunojnë me organizatat e tjerë bujqësore për të bërë ndërhyrjet e duhura që do të nxisin bujqësinë.

Përshtatja e informacionit

Kriza agrare mund të kapërcehet në masë të madhe duke u dhënë fermerëve shërbime më të efektshme këshillimore dhe duke transferuar te ata teknologjinë më të fundit bujqësore. E megjithatë, një numër fermerësh nuk kanë akses te teknologjitë e fundit bujqësore. “Sipas një Raporti Kombëtar mbi Organizimin e një Sondazhi Kampion, 60 % e fermerëve në Indi nuk kanë akses te teknologjia bujqësore” (Suryamurthy, 2005). Edhe mbas një dekade situata nuk është përmirësuar në nivelin e dëshiruar, për sa i takon aksesit te teknologjia moderne dhe këshillimit teknik në fushën e bujqësisë. Sipas sondazhit më të fundit të Organizatës Kombëtare të Sondazhit Kampion, në nivel të gjithë Indisë, vetëm 41 % e familjeve kultivuese kishin akses te ndihma teknike nga një prej agjencive/burimeve të listuara gjatë periudhës korrik 2012 – dhjetor 2012”. (NSS Report, 2014). Një numër fermerësh janë analfabetë ose të paarsimuar deri në një nivel të arsyeshëm për të kuptuar me lehtësi e t'i nxjerrin kuptim informacionit teknologjik që transferohet te ata. Ndaj mbetet sfida jashtëzakonisht e madhe përshtatja e informacionit në përputhje me nivelin e përdoruesve dhe prezantimi i informacionit në një format mediatik që ndihmon të kuptohet sa më mirë. Për shembull, Nalluswamy Andaraja, djali i një fermieri, krijoi një kompakt disk multimedial interaktiv të thjeshtë për fermerët dhe testoi efektivitetin e tij për transferimin e teknologjisë fermere. Ai përgatiti një CD multimediale që t'u mësonte fermerëve në tre fshatra të bllokut Thandamuthur të qarkut Coimbatore, në shtetin Tamil Nadu mbi arsyet pse *bryphyte*-t ulnin prodhimin e arrave të kokosit. Ai raportoi që njohja e parazitit dhe menaxhimi i tij mes fermerëve u rrit nga 2 % në 50 % (Kumar, 2007).

Iniciativat e GOI-t

Kohët e fundit, qeveria e Indisë (GOI) ka marrë iniciativën të shkojë deri thellë në Indinë rurale nëpërmjet ndërhyrjeve me teknologji, për të kapërcyer krizën agrare dhe për të përmirësuar aksesin në informimin bujqësor. Disa kompani celulare kanë iniciuar gjithashtu shkëmbime informacioni për fermerët me bazë celulare. Kompania Indiane e Duhanit ka krijuar fshatrat *e-choupals* për të vënë në dispozicion të fermerëve informacion me vlerë për ta. Por duhet bërë shumë më tepër dhe nevojiten një seri masash të përbashkëta në bashkëpunim me institucione të niveleve të ndryshme dhe departamenteve qeveritare për të realizuar impaktin e perceptueshëm të planeve dhe aksioneve për zhvillim rural dhe produktivitet bujqësor në mënyrë që të rritet fuqia blerëse e fermerëve dhe e banorëve të tjerë në fshat. Një institucion i tillë që mund të luajë rol kritik në fuqizimin dhe zhvillimin e komunitetit është universiteti, angazhimi i të cilit në bashkëpunim me agjenci të tjera zhvillimore mund të sjellë ndryshimin në jetën e komuniteteve fshatare.

Ndërhyrje në favor të fermerëve

Një universitet duke ndërhyrë vetë dhe në bashkëpunim me departamentet e qeverisë dhe organizatat jo qeveritare mund të luajë rol kritik në rritjen e dinjitetit dhe përparimin e komuniteteve nëpërmjet përhapjes së informacionit relevant, vlerësimit të situatave dhe promovimit të aplikimeve të përshtatshme të njohurive. E vërteta është se kontributi universitar është i mundur në dimensione të shumta të jetës dhe punës së banorëve ruralë që variojnë nga udhëzimet për karrierë deri te fuqizimi i komunitetit nëpërmjet njohurive në kompjuter dhe duke parandaluar sëmundjet e shmangshme nëpërmjet njohurive rreth informacionit shëndetsor. Mund të bëhen gjithashtu përpjekje për reduktimin e varfërisë duke iniciuar ndihmën reciproke dhe duke krijuar kooperativa. Të tjera ndërhyrje që mund të bëjnë universitetet janë inkurajimi i novatorëve në terren dhe edukimi i tyre për punë novatore me ekspertizë të studjuesve universitarë, duke filluar nga puna për ngritjen e bibliotekave publike rurale dhe të qendrave të informimit të komunitetit, me mbështetjen e këshillit të fshatit, anëtarëve të asamblesë legjislative, departamenteve të qeverisë dhe OJQ-ve. Fusha të tjera të mundshme veprimi janë krijimi i grupeve lokale për zhvillim në mediat sociale si Facebook, WhatsApp, për shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimin dhe duke marrë në konsideratë përdorimin mundësisht të teknologjisë së informacionit për përmirësimin e mjaft fermerëve.

Ngritja e kapaciteteve

Kaimowitz (1990) i referohet impaktit të teknologjisë së re (përfshirë informacionin si komponent i fshehtë) në bujqësi mbi bazën e aspekteve të tilla si rritja e të ardhurave në fermë, reduktimi i riskut, ruajtja e burimeve, përmirësimi i shëndetit, siguria (ushqimi)

më e mirë, dhe rritja ekonomike në përgjithësi. Kudo që është e mundur, zhvillimi i kapaciteteve të komuniteteve lokale nëpërmjet një trainimi të shkurtër dhe planifikimit duke promovuar idetë e tyre për zhvillim, mund të jetë një propozim i dobishëm për një rol më të madh nga ana e universitetit. Rogers (1992) pohon që trainimi i ndihmon njerëzit në komunitetet rurale për të zgjeruar horizontet, për të rritur perceptimet, për të shtuar kompetencat, rritur sensin e perspektivës dhe vetëvlerësimin. Ofrimi i informacionit të bazuar te nevoja për zhvillimin e komuniteteve rurale dhe trainimi për aktivitete me bazë zhvillimin është vetëm njëra anë. Sfidat tjerë të rëndësishme janë përshtatja e përmbajtjes së informacionit dhe dhënia e trainimeve në atë nivel që të jetë i kuptueshëm për marrësit dhe kumtimi i njohurive në media dhe informim të bëhet konform aftësive dhe në nivelin e atyre që mësojnë, në mënyrë që të mund të kuptojnë se si ta kërkojnë në mënyrë efektive informacionin me interes për ta e ta përdorin në mënyrë të dobishme për përmirësimin e praktikave të punës.

Fuqizimi i komunitetit

Një nga mënyrat më të mira për të iniciuar punën për zhvillimin e komunitetit është fuqizimi i komuniteteve për të kërkuar në mënyrë efektive informacion që mund të sjellë ndryshimin në veprimtaritëzhvillimore. Megjithatë, programet e njohurive në media dhe informim duhen hartuar në përshtatje me nevojat e informacionit zhvillimor të komunitetit që synohet dhe programi duhet dhënë në atë formë dhe gjuhë që mund ta ndihmojë komunitetin të kuptojë lehtë mënyrën se si të kërkojë informacionin me efektivitet dhe ta përdorë atë. Rritja e ndërgjegjësimit për mundësitë e disponueshme dhe riorientimi i praktikave të tyre të punës mund të rrisë gjithashtu mirëqenien ekonomike duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm. Nga njëra anë, universiteti mund të lokalizojë, identifikojë dhe të grumbullojë burimet e informacionit që janë konform me nevojat e zhvillimit të komuniteteve lokale dhe të krijojë një portal të burimeve të tilla ekzistuese, dhe nga ana tjetër, të gjejë mënyrat për dhënie e programeve të njohurive në media dhe informim për nivele të ndryshme të anëtarëve të komuniteteve në mënyra formale dhe informale, për t'i bërë ata të aftë që të mund të gjejnë vetë informacion që i motivon, i frymëzon dhe i bën të ndërgjegjshëm për mundësitë e reja për përparimin social dhe ekonomik të komunitetit dhe të atyre vetë.

Lidhja Universitet – Komunitet

Në kuadrin e programit *Unnat Bharat Abhyian*, celula e zhvillimit social e Central University of Himachal Pradesh (CUHP), Dharamshala, adoptoi pesë fshatra e pikërisht Chatreri Shiun, Bhaniar, Jhalahr dhe Manjgran, që ndodhen në Shahpur tehshil të qarkut Kangra. Dharamshala e CUHP-së ofron gjithashtu kurse laboratorike komunitare në departamente të ndryshme ku studentët vizitojnë fshatrat fqinjë dhe mbledhin të dhëna

socioekonomike për të studiuar se si mund të përmirësohen kushtet e fshatarëve me aplikimin e dijeve të disiplinës së tyre. Duke qenë se CUHP adoptoi pesë fshatra dhe studentët e tij të shkencës bibliotekare dhe informimit janë regjistruar gjithashtu për një kurs në laborator komunitar, mund të zhvillohet një Model i Njohurive në Media dhe Informim i përshtatur për secilin fshat për t'i pajisur ata me aftësinë që me mënyra të thjeshta dhe efektive të gjejnë informacion në interes të tyre. Çdo student i kursit të laboratorit komunitar viziton një fshat të adoptuar dhe mbledh të dhëna socioekonomike nga të paktën dhjetë familje për të vlerësuar nevojat e tyre për informacion lidhur me veprimtaritë e mundshme zhvillimore. Me këto të dhëna mund të hartohet një raport i përgjithshëm i nevojave të tyre për informim. Studentët, nga ana tjetër, mbledhin informacion mbi burimet globale të informimit dhe praktikat më të mira relevante për nevojat lokale të zhvillimit si dhe kanë potencialin të iniciojnë aksione për zhvillimin dhe përparimin e banorëve të fshatrave të adoptuar nga universiteti. Më pas çdo studenti mund t'i kërkohet të strukturojë një program dhe të hartojë një metodë për të dhënë njohuri në media dhe informim, të zgjedhë dhjetë familje e t'i mësojë njohuri në kompjuter të paktën një pjestari për çdo familje, për të rritur nivelet informuese të tyre dhe për t'i ndërgjegjësuar për mundësitë që kanë përpara, mundësi kjo e re individuale dhe kolektive për një jetë më të mirë.

Përfundim

Kushtet thelbësore të çdo kombi për bashkekzistencë paqësore dhe zhvillim socioekonomik janë liria e shprehjes dhe liria e aksesit në informacion, respekti për dallimet në opinion, cilësia e edukimit për të gjithë, barazia, drejtësia dhe ndërhyrjet në kohë e specifike sipas domenit. Në kontekstin e komunitetit të fermerëve në Indi, në qoftë se miqtë e fermerëve dhe qeverisjet vendore, shtetore dhe të bashkuara duan të venë nën kontroll protestat e fermerëve dhe vetëvrasjet, ata duhet të formulojnë politika dhe strategji të përshtatshme për fermerët e gjithashtu të hartojnë ndërhyrje të bazuara te njohuritë në media dhe informim. Universitetet bujqësore, organizatat e drejtuara nga të rinjtë, dhe punëtorët e përkushtuar e të angazhuar në diversifikimin e bujqësisë dhe mirëqenien e fermerëve, nëpërmjet iniciativave të tyre novatore mund të risjellin buzëqeshjen te fytyrat e tyre. Bashkëpunimi dhe partneriteti me organizata dhe programe si Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) dhe, Aksesit të Kërkimit Global Online në Bujqësi (AGORA) mund të shërbejnë gjithashtu si strategji të mira për të mundësuar dhe fuqizuar komunitetin e fermerëve në Indi e për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm në Indi.

Referenca

Jagtar Singh, et al. (2015). *MILID Yearbook 2015: Media and Information Literacy for the Sustainable Development Goals*. Goteborg, Sweden: NORDICOM. Kaimowitz, D., Synder, M. & Engel, P. (1990). A Conceptual Framework Studying the Links between Agricultural Research and Technology Transfer in Developing Countries. In D.

- Kaimowitz (Ed.) *Making the link: agricultural research and technology transfer in developing counties*. Boulder, Co : Westview Press, p. 238.
- Kumar, B.A. (2007, Jan, 04) Technology Transfer Paramount, *The New Indian Express*, Chennai.
- National Knowledge Commission (2005). Report of Working Group on Libraries: http://knowledgecommission.archive.nic.in/downloads/documents/wg_lib.pdf
- National Sample Survey (2014). *Key Indicators of Situation of Agricultural Households in India*. NSS 7th Round, p38.
- Poverty overview: World Bank. www.worldbank.org/en/topic/poverty/overview
- Poverty Reduction & Equit: https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/State_of_the_poor_paper_April17.pdf
- Rogers, A. (1992). *Adults Learning for Development*. London: Chassell, p.137.
- Suryamurthy, R. (2005). ICAR Revamp to Beneficiaries Farmers. *The Tribune*, Sept 27, 2.

Media lidh apo verbon?

Hartëzimi i komunitetit dhe histori digjitale nga Klasat P20

Zbërthimi i miteve dhe i koncepteve të gabuara në edukimin global mediatik

Melda N. Yildiz

“Gënjeshtër mund të ketë bërë gjysmën e rrugës përreth botës ndërkohë që e vërteta ende po mbath këpucët”

- Anonim

Projekti kërkimor i aksionit me pjesëmarrje (PAR), brenda kontekstit të edukimit global mediatik, synon të avancojë dijet shkencore të edukimit të drejtësisë sociale, si mjet për promovimin e aftësive në edukimin mediatik në programet edukimit të mësuesve dhe përpiket të trajtojë ideologjitë dhe idetë e gabuara të ngulura thellë të pabarazisë sociale, duke krijuar hapësirë për një riekzaminim të kurikulës ekzistuese, duke e vënë atë përballë kurikulës transformuese, bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse.

Për të hartuar një kurikul të përgjegjshme nga pikëpamja kulturore dhe linguistike, kandidatët për mësues investiguan modelet transformative të të mësuarit duke i parë ato me lentet e edukimit multikulturor, semiotik dhe të njohurive në media në kontekstin e edukimit global. Për planet mësimore, pjesëmarrësit zbërthyen dhe vlerësuan kurikulën kombëtare, kornizat dhe standardet; intervistuan studentë dhe edukatorë, dhe dokumentuan historitë e tyre për të artikuluar realitetet e kushteve në shkollë nëpërmjet punës kërkimore të tyre, analizave dhe dialogut. Nëpërmjet procesit të rizbulimit, kandidatët për mësues eksploruan dhe hartuan strategji, kurikula dhe programe për përmirësimin e rezultateve të studentëve, dhe integruan njohuri të shumëfishta si mjet për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave globale të studentëve P20 dhe aftësive shekullit të 21-të teksa rimendojnë dhe riprojektojnë veprimtari novatore në procesin e mësimin.

Ky PAR promovon edukimin mediatik në zbërthimin e miteve dhe të ideve të gabuara në klasat P20, integron hartëzimin e komunitetit dhe rrëfimin digjital në kurikula, ofron sugjerime krijuese për të prodhuar me burime dhe pajisje minimale media në klasat mësimore, dhe ekspozon projekte novatore dhe gjithëpërfshirëse si dhe praktikatat më të mira për zhvillimin e autonomisë të një rëndësie kritike, të kompetencave globale dhe aftësive të shekullit të 21-të në programet e edukimit të mësuesve. Duke qenë se edukimi transformues ndërthuret me të drejtat e njeriut, korniza

e edukimit global mund të përdoret si mjet për edukimin e drejtësisë sociale. Duke huazuar dhe zgjeruar punën e teoricienëve kritikë, Henry Giroux dhe Paulo Freire, pjesëmarrësit studjuan Pedagogjinë Transformative Kritike dhe eksploran tre tema kyçe për të kuptuar përvojat e edukimit global të kandidatëve për mësues: gamën e gjerë të kuptimeve që edukatorët i shoqërojnë me mite dhe ide të gabuara në klasat P20; impaktin e objekteve (moduleve) ndërdisiplinore dhe inovative multimediale në zhvillim dhe vlerësimin e strategjive mbi reagimin e studentëve, dhe të kuptuarit e problemeve globale; si dhe mënyrat në të cilat studentët i përgjigjen veprimtarive Multikulturore, Multilinguale, Multimediale.

Fjalëkyç: Hartëzim i Komunitetit, rrëfim digjital, njohuri mediatike, semiotike, aksion me pjesëmarrje, edukim i mësuesve, kompetenca globale.

Hyrje

Në verën e vitit 1995, mora pjesë në një Seminar për Edikumin në Media që ofronte departamenti i komunikimit në Universitetin e Masaçusetsit, Amherst. Bashkë me edukatorët e tjerë eksploruam mënyrën se si të integrohet media në kurikula. Në këtë seminar u prezantuam me teorinë e njohurive në media dhe me praktika si Autonomia e Len Mastermanit, Fondacioni për Edukim Mediatik i Sut Jhally-t (MEF) dhe video klipje nga *Gardiani* që tregonin kënd vështrime alternative.

“Narratori (Perspektiva e Gardianit): Një ngjarje e parë nga një kënd i caktuar të jep një përshtypje të caktuar. Kur shihet nga një tjetër këndvështrim, të jep përshtypje mjaft të ndryshme. Por vetëm kur shihni kuadrin e plotë mund të kuptoni plotësisht atë që ndodh”.

Qysh në vitin 1998, si edukator mësuesish, fillova të integroj njohuritë në media dhe të njohuritë në informim në kurset e mia të edukimit të mësuesve. Edukimi me Njohuri në Media u bë korniza e hulumtimeve dhe e punës sime në mësimdhënie, gjithashtu edhe shërbim. Në vitin 2009, fillova të integroj edukimin mediatik në kurset e mia të edukimit global. Ky material bazohet në rrugëtimin tim të edukimit me njohuri globale mediatike (GMLE) që vendos të eksplorojë arsyen pse arrinë të depërtojnë mitet dhe idetë e gabuara në edukim. Pse vazhdojmë ende të besojmë se stinët ndodhin për shkak të rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe jo për shkak të pjerrësisë së aksit të Tokës? Pse besojmë që Rosa Parks ishte ulur në fillim të autobuzit në vend që të pranojmë se po qëndronte në mes të autobusit, ku ishte vendi i caktuar për afroamerikanët dhe që atë ditë asaj iu kërkua të zhvendosej një ndenjese më pas? Pse ngjyra e gjakut të deoksigjenuar është blu dhe jo e kuqe? A ndodh kjo sepse media shtrembëron mesazhet të cilat më pas sjellin idenë e gabuar apo mesazhet mediatike janë thjesht reflektim i shoqërisë që ka këto ide të gabuara? A na verbon media e na pengon të lexojmë, shkruajmë e të mendojmë më thellë sepse mesazhet i japin formë botëkuptimit tonë apo media na lidh e na bën të bashkëpunojmë, na jep akses dhe na bën të sfidojmë botëkuptimet e shtrembëruara për të promovuar mesazhe alternative?

Në një intervistë në Radion Publike Kombëtare (NPR) mbi epideminë e fruthit dëgjova frazën: “Gënjeshtria mund të ketë bërë gjysmën e rrugës përreth botës ndërkohë që e vërteta ende po mbath këpucët”. Intervista fliste për idenë e gabuar lidhur me vaksinimin dhe epideminë e fundit që kishte rënë kohët e fundit në Kaliforni me mbi 100 raste të raportuara. Fraza i atribuohet Mark Twain-it. Doja ta përfshija këtë citat në prezantimin tim. Në faqen *Quote Investigator* në internet gjeta disa variante të tjera si për shembull “Gënjeshtria ka shkuar nga Mein në Xhorxhia, ndërsa e Vërteta po mbathte çizmet”. Ajo i atribuohet disa njerëzve të tjerë. Ashtu sikurse thotë edhe Adele në këngën e vet *Rumor Has it*, në qoftë se gënjeshtria/thashethemi del nga goja, është vështirë të ndryshohet. Faqe në internet si *Snopes*, *Urban Legends*, *Hoax-slayer* dhe *Urban Legends Online* mbledhin dhe përpiqen të demistifikojnë mitet urbane dhe idetë e gabuara.

Një kolege e imja kishte zakon të përcillte email-e me tematika të ndryshme alarmuese. Një herë më dërgoi një email me një poemë që fliste për ata që ngasin makinën të dehur. Në të kërkohej që mesazhi të kopjohej, firmosej e t’u përcillej të tjerëve. Poema titullohej *Mami shkova në një festë*. Ajo fliste për një vajzë e cila nuk kishte pirë alkool por që në fund u vra nga një shofer i dehur. Njësoj si ky peticion që qarkullonte online, shumica e legjendave urbane kanë tendencën të kujdesen për të spërkatur pakës të vërtetë dhe një leksion moral. Nga ana tjetër, ato mund të përdorin emocionet tona për të shitur një ide ose besim.

Shkova në festë, Mami’
Shkova në festë,
Dhe nuk harrova çfarë më the
Më the të mos pi, Mami
Ndaj mora vetëm një Sprite.

I pyeta kandidatët për mësues në klasën time se çfarë do të kishin bërë po të merrnin një email si ky. 10 nga 22 kandidatë që kishte klasa thanë që do ta kishin përcjellë email-in. Vetëm tre thanë që nuk do ta përcillnin. 9 të tjerët u përgjigjën që mund ta përcillnin ose jo në varësi të natyrës së email-it. Mbasi e zbërthyem email-in dhe kontrolluam faqet e legjendave urbane, zbuluam që peticione të tillë jo vetë që s’ishin të dobishëm por ishin të dëmshëm për organizatën *Mothers Against Drunk Driving* (MADD). Faqja kërkon 5000 firma por nuk jep informacion se ku duhet dërguar kjo info në qoftë se jam personi i fundit që firmos peticionin. Sipas artikullit të *Snopes-it* Dikush Duhet t’ia Kishte Mësuar: peticion i padobishëm për ngarjen e makinës në gjendje të dehur, këto peticione mund të ngadalësojnë organizatat për shkak të volumit të madh të email-ave dhe të telefonatave. Njëri nga kandidatët për mësues bëri pyetjen, “A është futur ndonjë produkt në këtë poemë?” e më pas vazhdoi të pyesë se pse ishte përdorur fjala *Sprite* në vend të fjalës *Lëng* i Gazuar. E vërteta është se gjetëm edhe një adresë tjetër ku përdorej fjala *Lëng* i Gazuar.

Interneti është i mbushur plot me rrengje. Ndër faqet e njohura në internet që përdorin zakonisht bibliotekarët në seminarët për njohuritë në informacion, janë dhe Dihydrogen Monoxide (DHMO) dhe shtatzania në meshkuj. Duke u bazuar në faqe të tilla me informacion të rremë në internet janë shkruar edhe ese nga studentët. Studentët kanë shkruar për Holokaustin që nuk ka ndodhur kurrë, e tema të tjera të ngjashme. Për shembull, Alan November (1998) shkroi një artikull, “Të mësojmë Xakun të mendojë”.

Eseja e Xakut për lëndën e historisë pretendonte që Holokausti nuk ka ndodhur kurrë, duke cituar faqen në internet të një profesori universitar. Historia e Xakut është shembull i qartë i rëndësisë që merr njohja e mediave të reja. “Thjesht fakti që gjendet në Rrjet nuk e bën të jetë e vërtetë”. (Nëntor, 2001). Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë se kush është autori, si prezantohet ai, çfarë idesh komunikon, kush përfiton prej tyre, dhe këndvështrimi i kujt prezantohet.

Një kandidatë për mësuese tregoi faqen *Dihydrogen Monoxide* (DHMO). Studentëve iu desh ca kohë të kuptonin që *dihydrogen monoxide* në fakt është H₂O. Studentët i ngatërroi emri i panjohur kimik që ishte përdorur në vend të fjalës *ujë*. Nga ana tjetër, ky ishte ushtrim shumë i mirë për studentët që zbuluan se faqja ishte krijuar nga një 14 vjeçar si projekt shkencor në shkollë. Ata arritën ta zbërthejnë faqen e të eksplorojnë mënyrën se si mund të ekzagjerohet informacioni e se si mund të formohen idetë e gabuara.

Marshal (2001) vë në diskutim rolin e edukatorëve në botën e saturuar nga media. Thuhet që, “Janë të paktë ata që nuk do të ishin dakort me idenë që mësuesit e mirëngulitin kurikulumin në jetën e studentëve të tyre. Por çfarë ndodh kur jetët e fëmijëve dhe të rinjve saturohen nga influenca e korporatave që promovojnë vlerat e konsumit, konkurrencës, hierarkisë, seksizmit, homofobisë, racizmit dhe përbuzjes së barazisë?” Si mund t’i ndihmojmë studentët tanë të dallojnë faktet nga propaganda? Si mund ta përdorin median për të lidhur e jo për të qorrur veten?

Standardet dhe Kuadri Teorik

Studimi PAR fokusohet mbi rolin e njohurve në media në kontekstin global. Ne kemi përdorur disa korniza teorike dhe standarde. Disa nga kornizat teorike janë: njohuri në media (Len Masterman, 1985), Buckingham, 2003), semiotika (Chandler, 2014), dhe edukimi multikulturor (Nieto, 2013). Studimi ekzaminonte rolin e mediave dhe teknologjive të reja në transformimin e kurikulës së edukimit për mësuesit duke përafuar standardet dhe kornizat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare: 1) Shoqata Kombëtare për Edukimin e Njohurive në Media (NAMLE); 2) Shoqëria për Teknologjinë e Informimit dhe Edukimin e Mësuesve (SITE); 3) Shoqata për Mbikëqyrjen dhe Zhvillimin e Kurikulave (ASCD); 4) Partneritet për Aftësitë e Shekullit të 21-të (P21); 5) Këshilli i Krerëve të Shkollave Shtetërore (CCSSO) dhe Partneriteti i Shoqërisë së Azisë për Kompetenca Globale; 6) Qendra Kombëtare e Dizajnit Universal për të Mësuar në Qendrën për Teknologjitë Speciale të Aplikuara (CAST); 7) Shoqëria Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE).

Hulumtime mbi Veprimtarinë me Pjesëmarrje

Mësimdhënia dhe dijet e mia kanë marrë formë nga përvojat e mia profesionale dhe personale. Studimi kërkimor i veprimtarive me pjesëmarrje (PAR) më ka dhënë mundësi

të fokusohem në transformimin e edukimit të mësuesve për kapërcimin e problemeve racore, gjinore, të të drejtave të njeriut dhe globale duke përdorur median dhe teknologjitë.

Ky projekt i hartëzimit me pjesëmarrje i komunitetit/rrëfyes digjital dokumenton zërat globalë dhe problemet me të drejtat e njeriut, grumbullon dijet dhe përvojat nga 35 edukatorë në mbarë botën dhe zhvillonë një platformë interaktive dhe ndërdisiplinore online që bazohet te komuniteti, e cila ekspozon projekte gojore historike dhe histori digjitale nga Australia, Islanda, Izraeli, Nepali, Turqia, Turkmenistani dhe Shtetet e Bashkuara. Platforma online përdor teknologjitë e lëvizshme si *Global Positioning System* (GPS) dhe *Google Earth*. Ajo shërben si magazinë e hartave interaktive dhe magazinë e kërkueshme të dhënash e ideve për mësim dhe projekte.

Studimi kryhet në kurset e mia të edukimit të mësuesve duke bashkëpunuar njëkohësisht me edukatorë të tjerë në mbarë botën. Ai investigonte 35 pjesëmarrës, 24 studentë (19 vajza dhe 5 djem) dhe përvojat e tyre. Në dialogun tonë merrnin pjesë me anë të bisedave në Skype njëmbëdhjetë edukatorë. Ata ishin nga (1) Australia, (1) Islanda, (1) Izraeli, (1) Nepali, (3) Turqia, dhe (4) Turkmenistani. Trembëdhjetë studentë ishin në vitin e tretë të studimeve dhe njëmbëdhjetë të tjerë në vitin e fundit në Northeastern University. Ata morën pjesë në këtë projekt kërkimor të veprimit me pjesëmarrje gjatë pranverës së vitit 2015.

Investigimi ynë u udhëhoq nga këto pyetje:

1. AUDIENCA – Cilat janë përvojat personale të pjesëmarrësve dhe reagimet ndaj veprimtarive të GMLE-së? Si mund t'i përgatisin edukatorët kandidatët për mësues për një pedagogji të përgjegjshme kulturore dhe linguistike?
2. PROBLEME – Cilat janë problemet e përbashkëta të pjesëmarrësve në veprimtaritë e tyre?
3. SUGJERIME – Çfarë sugjerimesh ofruan pjesëmarrësit për eliminimin e miteve dhe ideve të gabuara në edukim?
4. NJOHURI NË MEDIA – Çdo të thotë të jesh njeri i ditur që jeton në një kulturë të pasur me media? Përse duhen studjuar njohuritë në media?
5. DIZAJNI – Si i dizajnojmë kurikulat e lidhura globalisht duke integruar njohuritë në media?

Metodologjia përfshin analizimin e sondazheve, reflektimin dhe përgjigjet për veprimtaritë online si dhe procesin e hartimit të planeve mësimore projekteve kurikulare të lidhura globalisht. Studimi eksploronte gamën e gjerë të kuptimeve që pjesëmarrësit e shoqëronin me edukimin në media; impaktin e veprimtarive ndërdisiplinore në planin mësimor K12; dhe mënyrat në të cilat ata integronin edukimin mediatik në programet e tyre mësimore.

Objektivat e PAR-it: pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- argumentojnë sfidat dhe avantazhet e integritit të njohurive në media dhe kompetencave globale në programet mësimore;

- zhvillojnë aftësi në zbërthimin e kurikulave ekzistuese dhe burimeve digjitale duke demistifikuar njëkohësisht mesazhet mediatike;
- ekzaminojnë procesin e integritit të mediave të reja si mjet mësimdhënije dhe të mësuarit;
- ofrojnë këndvështrime historike, edukative dhe globale mbi rolin e mediave në klasën K12,
- hartojnë module eksperimentale të bazuar në punën kërkimore për mësimin e njohurive në media, plane mësimore, mjete vlerësimi, udhëzues për programe mësimore që inkorporojnë mediat e reja dhe teknologjitë nga klasa në klasë dhe në lëndë të ndryshme,
- krijojnë projekte për programe mësimore duke integruar kuadrin global edukativ të njohurive në media dhe duke zhvilluar në të njëjtën kohë kompetenca dhe aftësi të shekullit të 21-të të kandidatët për mësues/studentët;
- demonstrojnë strategji krijuese dhe mundësi për angazhimin e mësuesve kandidatë nëaktiviteteve të bazuara në projekte e të lidhur globalisht si dhe në projekte programesh mësimore në të gjitha fushat e përmbajtjes (p.sh. matematikë, gjeografi, studime kulturore, gjuhë të botës).

Shembuj projektesh për Programe Mësimore

Kandidatët për mësues në studim bashkonin planet mësimore dhe burimet në portofolet e veta elektronike. Ata krijojnë blogje dhe përdornin mediat sociale për të propaganduar një pedagogji të përgjegjshme kulturore dhe linguistike për studentët e tyre. Nga projektet me ecje si Historia e Sheqerit, Depresioni i Madh dhe Të Drejta Humane për Këdo: Emigracioni, ata krijuan një galeri të hapur. Ata skicuan një listë dokumentarësh, filmash vizatimorë, imazhe vizuale informative, gjithashtu edhe burime online për edukatorët e mësuesve dhe mësuesit e klasave K12, si dhe ftuan edukatorët e tjerë në gjithë botën të eksplorojnë projektet e tyre e të japin mendime.

Njëri nga kandidatët për mësues përdori për planet e veta mësimore Projektin Uniteti Global. Mësimi i tij është përshtatur nga programi Duke Regjistruar një Gjuhë që Vdes dhe fokusohet mbi rëndësinë e ruajtjes së kulturave dhe gjuhëve. Qysh me themelimin e tij në vitin 2006, Projekti Uniteti Global ofron histori multikulturore pa pagesë si dhe planet mësimore shoqëruese për shkollat e mesme dhe kolegjet. E gjithë përmbajtja dhe burimet e tyre është e disponueshme pa pagesë, pa reklama dhe pa patur nevojë për tu regjistruar. Ai përdori hartën e Gjuhëve të Rrezikuara dhe ftoi edukatorët në gjithë botën të bashkëpunojnë mbi Padlet-in për të hapur klasën e dialogut për komunitetet globale.

Shih me sy që të besosh!


Kandidatët për mësues panë tre fotografi të ndryshme arinjsh nga tre kultura të ndryshme. Njëra ishte fotografia e Ariut Yogi nga filmat vizatimorë Perëndimorë i cili

mund të shihet is qen në qoftë se dikush nuk ka parë ndonjëherë më parë filma vizatimorë. Një tjetër fotografi ariu nga Indigenët e Amerikës së Veriut, fotografia e ariut Tsimshian, nuk duket aspak si ari për shumicën prej nesh. Apo vizatimi me dorë i një ariu mund të perceptohet thjesht si një mori vijash për dikë që nuk ka mësuar kurrë të shohëfotografinë e ariut në atë mënyrë (Mangan, 1981). Sikurse argumentohet në tezën e doktoratës së James Mangan-it (1981), *Të mësuarit nëpërmjet fotografive* ofron shembuj interesantë për të ilustruar kufizimet si kulturore ashtu edhe ato konjitive të aftësive për të kuptuar imazhet. Edhe pse mund të jemi duke parë të njëjtin imazh, bazuar në bagazhin e dijeve tona, perceptimi mund të jetë i ndryshëm. Mangan thotë që “Diferencat kulturore në perceptim janë më të mprehta dhe më të shumta në numër nga ç’mendojnë shumica e edukatorëve”. Këto kufizime duhen marrë parasysh kur hartohen materialet mësimore jo vetëm për fshatarët e zonave rurale por gjithashtu edhe për klasat tona të lidhura në mënyrë globale.

Rosa Parks

Në vitin 1955, Rosa Parks refuzoi t'i lëshonte vendin një pasagjeri të bardhë në një autobus publik në Montgomeri të Alabamas. Akti i saj frymëzoi fillimin e Lëvizjes Moderne për të Drejtat e Njeriut. A e dini se çfarë ndodhi ekzaktësisht atë ditë? Vajza ime solli në shtëpi një detyrë. Në njërën nga pyetjet thuhej: Një grua me ngjyrë u ul në pjesën _____ të një autobusi në Alabama. Vajza ime rrethoi **a. përpara** dhe mori pikë të plota.

Duke përdorur *polleverywhere.com* si mjet sondazhi, i bëra të njëjten pyetje kandidatëve të mi për mësues. Tek opcionet shtova përgjigjen e saktë: në mes. Kandidatët për mësues iu përgjigjën pyetjes duke përdorur telefonët celularë. Ashtu sikurse dyshoja, 17% u përgjigjën **a. përpara** dhe askush nuk u përgjigj **në mes**.



Mbasi pamë intervistën e Rosa Park-ut të dhënë në 2 qershor 1995, shqyrtuam arsyet pse shumica prej nesh besonim që ajo kishte qenë ulur në pjesën përpara të autobusit në 1 dhjetor 1955.

Një grua me ngjyrë u ul në pjesën _____ të autobusit në Alabama.

71%	1. A- Përpara
18%	2. B- Mbrapa
0%	3. C- në Anë
12%	4. D- Dritare
0%	5. E- në Mes

Rosa Parks: U arrestova në 1 dhjetor 1955 sepse refuzova të ngrihem sipas urdhërit të shoferit të autobusit, mbasi karriget për të bardhët ishin zënë në pjesën përpara. Dhe natyrisht, unë nuk isha në fillim të autobusit sikurse kanë shkruar shumë njerëz dhe kanë thënë se unë isha – që kisha hipur në autobus dhe kisha zënë një karrige përpara, por nuk e kisha bërë. Unë kisha zënë një karrige që ishte mbrapa vendit ku uleshin njerëzit e bardhë, në fakt ishte ndenjësja e fundit.

Gjetëm imazhin nga një tekst shkollor ku Rosa Parks qëndron ulur përpara një burri të bardhë. Kjo foto ishte marrë në 21 dhjetor 1956, mbasi Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara vendosi që veçimi në sistemin e autobusave të qytetit ishte i paligjshëm. Mbas Rosa Parks-it ishte Nicholas C. Chriss, reporter i United Press International (UPI) i cili mbulonte ngjarjen.

Sklevër apo Punëtorë

Kandidatët për mësues zbuluan gabime në tekstet shkollore. Për shembull, diskutuam përdorimin në një tekst shkollor të fjalës punëtor në vend të fjalës skllav. Holohan (2015) shpërndau linkun e videos dhe të fotografisë së një faqeje të një libri shkollor që tregonte një gabim faktik rreth skllavërisë. Në një kapitull rreth emigracionit në botë, në tekstin e McGraw – Hill, Gjeografia Botërore, shkruhej: “Tregtia e Sklevërve në Atlantik mes viteve 1500 dhe 1800 solli miliona punëtorë nga Afrika drejt pjesës jugore të Shteteve të Bashkuara

për të punuar në plantacionet bujqësore”. Kandidatët për mësues u prezantuan me punën e James Loewen-it (1995) i cili shkroi një libër me titull: “*Gënjeshtra që më ka thënë mësuesi: Gjithçka që është gabim në tekstin e historisë së Amerikës*”. Shumica e studentëve e blenë librin dhe reflektuan në ditarët e tyre. Sikurse thonte njëri nga kandidatët: “Ky libër u bë diskutimi ynë në tryezën e bukës. Nuk resht dot së foluri për të me familjen”. Një tjetër shkruante, “Më shumë se materialet e kursit, ky kurs më ndihmoi të reflektoj mbi paragjykimet e mia dhe si të hartoj Pedagogjinë e Shumicës për klasën time”.

Projekti i Kuzhinës Globale

Në një nga aktivitetet tona GMLE, u shpjegova kandidatëve për mësues Projektin tim për Kuzhinën Globale që e kam zhvilluar me vitet e dyta dhe të treta. Industria e shëndetit, duke filluar nga ushqime e deri te barnat, ka qarkulluar shumë mite dhe ide të gabuara. Në këtë studim, vitet e dyta dhe të treta krahasuan familjet e tyre dhe ushqimin e tyre javor me familjet në librin me titull *Planeti i Uritur* (Menzel, 2005). Ata eksploruan esenë fotografike të Planetit të Uritur. Njërit grup iu dha detyra të krahasonte familjen në Çad me familjen në Amerikë. Grupi bëri pyetjen, “Si ka mundësi që në Çad njerëzit shpenzojnë më pak para dhe hanë më shëndetshëm se ne?” Në aktivitetin final studentëve iu kërkua që të vizatonin një vakt ushqimor të shëndetshëm duke përdorur modelin *Chose My Plate* USDA, i cili është me një pirun dhe një pjatë me vija të veçanta për frutat, perimet, drithrat, proteinat, dhe me një tjetër rreth për bylmetin. Njëri nga studentët vizatoi një fetë picë, duke shpjeguar drithrat, perimet dhe bylmetin që gjëndeshin të gjitha në një fetë. Të tjerët pyetën “pse jo një tas?” “pse vetëm pirun”, dhe “ku janë shkopinjtë?” Përse e Departamenti Amerikan i Bujqësisë (USDA) prezanton modelet për një mënyrë të shëndetshme të ushqyeri?

Përfundim

Duke angazhuar në mënyrë aktive kandidatët për mësues në prodhimin e medias (p.sh. wikis, blogje, rrëfime digjitale), zbërthimin e teksteve dhe planeve mësimore, dhe duke bashkëpunuar me edukatorët në gjithë botën e në të njëjtën kohë duke hulumtuar artefakte historike dhe histori, si dhe duke zhvilluar harta komunitare nëpërmjet projekteve të lidhur në nivel global, pjesëmarrësit përmirësuan kompetencat e tyre globale, identifikuan mitet dhe idetë e gabuara në edukim, fituan këndvështrime alternative mbi problemet e botës, dhe rinovuan interesin dhe angazhimin për të drejtat e njeriut. Duke qenë se ata bëhen prodhues të medias së tyre, ata bëhen njëkohësisht konsumatorë të informuar dhe qytetarë të botës.

Sikurse thotë Umberto Eco (1976), “Një civilizim demokratik do ta shpëtojë veten vetëm në qoftë se e shndërron gjuhën e imazhit jo në ftesë për hipnozë por në një stimul për reflektim kritik”.

Dialog i mëtejshëm

Nuk do ta harroj kurrë kur pyeta mësuesen e vitit të tretë të vajzës për arsyen pse ime bijë kishte marrë notë të ulët në seksionin për Shkencën të testit Terra Nova. Zj. Tirri, e cila ishte mësuese me 33 vjet përvojë, tha, “Kam dy mastera. Njërin në edukim. Ju e dini se jeni vetë edukator mësuesish. Djemtë janë mirë në matematikë dhe shkencë, vajzat janë mirë në gjuhë, arte dhe studime sociale”. Ikigai (koncept japonez që ka kuptimin “arsye për të ekzistuar”) im më thotë që t’i zhduk këto ide të gabuara dhe të fus në edukim njohuritë në mediat globale si mjet për dialog.

Në klasat e mia për edukimin e mësuesve, theksoja: “Edukimi duhet të fillojë me zgjidhjen e kontradiktës mësues-student, duke koordinuar polet e kontradiktës në mënyrë që të dy të jenë njëkohësisht mësues dhe student” (Freire, 1972). Në fillim, kandidatët për mësues e kuptonin ngushtë teorinë e edukimit të bazuar në nocionin që mësuesit u thonin informacion studentëve – gjë që një teknologjist mund ta quajë modeli telefon i edukimit ose që Freire mund ta quajë modeli i bankës të edukimit. Nëpërmjet PAR-it, kemi grumbulluar një repertor më të madh filozofish të edukimit dhe teorish që bazohen, pjesërisht, mbi idetë e John Dewey-t (1998), Len Masterman-it (1985, Carol Dweck-ut (2007) dhe pasuesve të tjerë që e vënë theksin mbi një program mësimor të bazuar te mendimi kritik, autonomia kritike, dhe metoda mësimdhënieje që kanë në qendër të tyre studentin.

Programi për të vegjëlit në fëmijërinë e hershme thotë: “Unë nuk besoj në ndryshimin e mendjeve për të ndryshuar botën. Unë besoj në zhvillimin e kureshtjes dhe të motivimit për të mësuar. Roli im është të frymëzoj e të ofroj burime, mjete dhe drejtim për t’i lejuar nxënësit të formojnë kuptimin e tyre në mënyrën e vet krijuese. Unë inkorporoj përbajtjen “lokale” dhe “globale” për shtjellimin e rasteve studimore. Unë sjell këndvështrime alternative dhe i inkurajoj ata të eksplorojnë ide dhe strategji të reja, u mësoj nxënësve se si të mësojnë, dhe çka është më e rëndësishme kultivoj rritjen mendore të tyre”.

Programi për të vegjëlit në shkollat fillore thotë: “Unë e pranoj privilegjin që kam si edukator. Mua jo vetëm që më pëlqen t’u mësoj fëmijëve por kuptoj gjithashtu edhe përgjegjësitë që kam. Duke vazhduar të mësoj, të shkruaj, të hulumtoj, të prezantoj dhe të ndaj punën time me nxënësit, të cilët kanë qenë mësuesit e mi të mëdhenj, do të ndihmoj për të bërë të mundur që të gjithë individët në botë të kenë të njëjtat mundësi dhe privilegje që kam e për të cilat kujdesem. Unë do të vazhdoj të eksploroj dhe dokumentoj përvojat e nxënësve të mi, t’i ndihmoj ata të ngrenë zërin, të rrëfejnë historitë e tyre dhe të njohin perspektivat, të zhvillojnë dijet e veta dhe të krijojnë projekte unike multimediale dhe histori digjitale. Unë i konsideroj nxënësit e mi si bashkëpunëtorë në punën time kërkimore dhe si kolegë të ardhshëm”.

Programi i edukimit special për klasat e larta thotë: “Synimi im është të sjell në kurset e mia gjuhë dhe këndvështrime të shumta, të stimuloj dialogun e të krijoj bashkëpunim midis studentëve, fakultetit dhe studjuesve në gjithë botën.

Unë do të përdor metoda dhe teknologji novatore vlerësi si harta interaktive, afate kohore, lojra, video dhe instrumente sondazhi. Studentët e mi punojnë për portofolet e veta individuale elektronike dhe projekte multimediale si histori digjitale, projekte historie me gojë, objekte të ripërdorshëm për mësim dhe pyetësorë në rrjet. Objektivi është që të krijojmë së bashku dije si grup e ndonjë herë e gjithë klasa bashkë”.

Programi për klasat e larta të shkollës së mesme thotë: “Media dhe teknologjitë e reja më ndihmojnë të përgatis plane mësimore ndërdisiplinore. Çdo mësim do të integrojë mediat dhe teknologjitë e reja, aftësitë dhe lidhjet e karrierës së shekullit të 21-të. Një nga objektivat madhorë është të sjell në kurset e mia gjuhë dhe kultura të shumëfishta, për të stimuluar dialogun mes nxënësve dhe kolegëve të tyre në të gjithë botën. Nxënësit në kurset e mia do të zhvillojnë projekte shumëgjuhësh e multikulturorë në formate multimediale”.

Programi për të vegjëlit në shkollat fillore thotë: “Çdo semestër do të ridizenjoj kurset, bibliografinë, burimet online dhe rubrikat e vlerësimit duke u bazuar në vlerësimet, sugjerimet dhe idetë e zhvilluara nga klasat e mëparshme. Unë do të integroj Dizajnin Universal për Mësimin (Universal Design for Learning, UDL) dhe modelet e përbysura (përziera) për zhvillimin e kurseve të mia. Unë do t'i rishikoj kurset gjatë semestrit në mënyrë që të trajtoj nevojat e gjithë nxënësve të mi”.

Programi për klasat e larta për mësimin e gjuhës angleze në shkollën e mesme thotë: “Unë i përfshij nxënësit në proceset e dizenjimit dhe të mjeteve të vlerësimit. Unë e shoh vlerësimin si jo thjesht për të marrë një notë në kursin final. Unë fokusohem te procesi i të mësuarit e jo thjesht te produkti. Unë i vlerësoj nxënësit jo vetëm për produktin e tyre final por në të gjitha hapat dhe proceset që përdorin në zhvillimin e projekteve. Unë u lejoj rishikime të shumta të projekteve dhe i nxjerr ata në podium mbas përfundimit me sukses të punës. Unë e rishikoj stilin dhe teknikat që përdor në mësim në qoftë se nuk arrij rezultat me nxënësit. Unë e konsideroj veten të dështuar në qoftë se nxënësit nuk kanë sukses. Rubrikat e mia kanë një kutizë shtesë për nxënësit të cilët mund të shtojnë kriteret e veta që nuk ishin vlerësuar ose marrë në konsideratë nga instruktori. Unë mbaj një kanal të hapur komunikimi me nxënësit. Unë dua të sigurohem që të gjithë e kuptojnë se kujdesem për ta dhe i ndihmoj derisa të përfundojnë me sukses projektet e klasës”.

Programi për klasat e ulta të shkencave sociale në shkollat nëntë vjeçare thotë: “Objektivi im kryesor është të motivoj nxënësit e t’u siguroj atyre një mjedis ku të mësojnë me respektin më të madh, drejtësi dhe entuziazëm. Unë i hartoj orët mësimore me veprimtari interaktive dhe projekte në grup që i motivojnë nxënësit me aftësi të ndryshme teknike për të avancuar ndërkohë që asistoj dhe inkurajoj nxënës të tjerë të cilët e konsiderojnë veten me vështirësi teknike. Unë i ftoj nxënësit të bisedojnë në *chat*, të blogojnë, të përdorin *google voice* dhe *skype*”.

Programi i klasave të larta për mësimin e gjuhës angleze në shkollë të mesme thotë: “Në klasat e mia është e rëndësishme gjithashtu të krijoj një mjedis të mësuarit me standarde të larta, me rregulla dhe objektiva të qarta. Këto standarde të larta janë të rëndësishëm për t’i inkurajuar nxënësit e të gjitha racave dhe gjinive që të arrijnë ëndrrat e tyre. Nxënësit inkurajohen të provojnë ide të reja pa patur frikë të bëjnë gabime. Në orët e mësimin që zhvilloj, theksoj: “Kjo klasë është mjedis i sigurt, ku mund të bëni gabime e të provoni teknologji, mjete e strategji të reja. Ne nuk duam të bëjmë gabime në botën reale. Le t’i bëjmë gabimet këtu e të mësojmë prej tyre”.

Si përfundim, objektivi im kryesor është shtrirja e një lidhjeje natyrore midis studimeve ndërdisiplinore kurikulare dhe mediave e teknologjive të reja, dhe t’i përdor ato për të bashkuar studentët me kolegët e mi, për të zhvilluar më tej mënyrën se si një qasje kritike të studimi i mediave të reja kombinon njohuritë, reflektimin dhe veprimin për të promovuar barazinë në edukim; dhe i përgatit të rinjtë që të bëhen anëtarë shtesë të përgjegjshëm të një shoqërie multikulturale, globale dhe demokratike.

Referencat

- Dewey, J. (1998). *Experience and education*. West Lafayette, IN: Kappa Delta Pi.
- Dweck, C. S. (2006). *Mindset: The new psychology of success*. New York, NY: Random House.
- Eco, U. (1976). *A Theory of semiotics*. Bloomington: Indiana University Press.
- Freire, P. (1972). *Pedagogy of the oppressed*. London, UK: Penguin Books.
- Holohan, M. (2015, October) Mom's viral video gets textbook company to changen factual error about slavery. Today Parents. Marrë nga <http://www.today.com/parents/moms-viral-video-gets-textbook-company-change-factual-error-about-t48476>
- Loewen, J. W. (1995). *Lies my teacher told me: Everything your American history textbook got wrong*. New York: New Press.
- Marshall, E., & Sensoy, O. (2011). *Rethinking popular culture and media*. Milwaukee, WI: Rethinking Schools, p1. Marrë nga http://www.rethinkingschools.org/publication/rpcm/rpcm_intro.shtml
- Mangan, J. W. (1981). Learning through pictures: a study of cultural and cognitive aspects of visual images. Thesis (Ed.D.) University of Massachusetts.
- Masterman, L. (1985/2001). *Teaching the media*. New York: Routledge.
- Menzel, P., & D'Aluisio, F. (2005). *Hungry planet: What the world eats*. Napa, CA: Material World Press.
- November, A. (1998). Teaching Zack to think. November Learning. Marrë nga <http://novemberlearning.com/assets/teaching-zach-to-think.pdf>
- November, A. (2001, March). Teaching kids to be web literate. *Technology and Learning*, vol. 21, pp. 42-46.

Shënime

1. Media Education Foundation- <http://www.mediaed.org/>
2. Guardian Perspectives https://www.youtube.com/watch?v=s6wh_5xdGvA
3. CDC Director: 'Unfortunately, I'm Not Surprised' By Measles' Rise <http://www.npr.org/2015/02/04/383860494/cdc-director-unfortunately-im-not-surprised-by-measles-rise>
4. Quote investigator Exploring the Origins of Quotations <http://quoteinvestigator.com/2014/07/13/truth/>
5. Snopes <http://www.snopes.com/>
6. About Entertainment: Urban Legends <http://urbanlegends.about.com/>
7. Hoax Slayer <http://www.hoax-slayer.com/>
8. Urban Legends <http://urbanlegendsonline.com/>
9. Petition http://activerain.com/blogsvie/745989/went-to-a-party-mom?show_all=true
10. <http://www.snopes.com/inboxer/petition/drunck.asp>
11. <http://www.dhmo.org/>
12. Recording a dying language <http://www.globalonenessproject.org/resources/lesson-plans/recording-dying-language>
13. One World, Many Voices: Endangered Languages and Cultural Heritage <http://storymaps.esri.com/stories/2013/endangered-languages/>
14. Padlet <http://padlet.com/gallery>
15. Rosa Park Interview- <http://www.achievement.org/autodoc/page/par0int-1>
16. Hungry Planet <http://www.time.com/time/photogallery/0,29307,1626519,00.html>
17. <http://www.choosemyplate.gov/>

Çështje Teorike dhe Praktike në Përfshirjen e Alfabetizimit në Media dhe Informim në Programet e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm

Jun Sakamoto

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së programit Alfabetizimi në Media dhe Informim (MIL) në programin e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD). Ndonëse të dy janë programe edukative të UNESCO-s, nuk ka patur kurrë më parë programe të kombinuar si këta në botë. Komisioni Kombëtar Japonez për UNESCO-n (JNCU) dhe Ministria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Shkencës dhe Teknologjisë (MEXT) kanë qenë fokusuar te ESD dhe promovimi i shkollave të asociuara me UNESCO-n, por megjithatë nuk ka patur ndonjë politikë për MIL-in në Japoni. Megjithatë, Universiteti Hosei iu bashkua rrjeteve UNITWIN MILID (Binjakëzim i Universiteteve për Njohuri në Media dhe Informim e Dialog Ndërkulturor) si anëtar i asociuar në vitin 2014. Më pas Universiteti Hosei aplikoi dhe përshtati partneritetin ESD për të mbështetur projektin e burimeve globale njerëzore që u prezantua në vitin 2015 nga JNCU dhe MEXT si ofertë publike.

Programet MIL dhe ESD kanë të përbashkët parime të qasjes si konvergjenca, fuqizimi, diversiteti kulturor dhe lingistik, gjinia dhe zhvillimi, si dhe të drejtat e njeriut. Programi MIL teorikisht do të theksojë qasjen e bazuar te shoqëria e dijes, praktikën e volitshme të njohurive në media dhe qasjen drejt të mësuarit me bazë hulumtimin.

Në vitin 2015, partneriteti ESD në Fukushima dhe Universiteti Hosei prezantuan programet e prodhimit të videove në dy shkolla fillore të asociuara me UNESCO-n për prezantimin e ESD-ve. Njëra nga shkollat fillore i dërgoi një letër me video një shkollë në Nepal, e cila kishte pësuar dëme nga tërmeti.

Nëpërmjet përvojës së projektit të partneritetit ESD në Fukushima, i cili zgjati një vit, do të doja të ngrija tre çështje që lidhen me praktikën MIL+ESD. 1) Duke qenë se MIL dhe ESD kanë qasje dhe vlera të përbashkëta, shkollat e asociuara me UNESCO-n që angazhohen në ESD janë të gatshme të përshtasin programet MIL. 2) Megjithatë, sikurse e tregoi projekti ynë, praktika ESD+MIL nuk shihet thjesht si kombinim i këtyre dy programeve. MIL ofron një sërë kompetencash për shekullin e 21-të në të gjitha aspektet e praktikës së ESD-së. 3) Koncepti i Njohurive në Media dhe Informim dhe Dialogu Ndërkulturor duhen lidhur me konceptin e ESD-së i cili është i fokusuar për t'i bërë njerëzit të mendojnë në mënyrë të ndërgjegjshme për botën me të cilën është e lidhur jeta e tyre e përditshme.

Fjalëkyç: njohuri në media dhe informim, edukim për zhvillim të qëndrueshëm, objektiva për zhvillim të qëndrueshëm, shkëmbim letra me video, shkollë e asociuar me UNESCO-n

Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së programit Alfabetizimi në Media dhe Informim (MIL) në programin e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD). Komisioni Kombëtar Japonez për UNESCO-n (JNCU) dhe Ministria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Shkencës dhe Teknologjisë (MEXT) kanë qenë të fokusuar te ESD si dhe promovimi i shkollave të asociuara me UNESCO-n, por nuk ka patur ndonjë politikë të veçantë lidhur me MIL-in në Japoni. Megjithatë, Universiteti Hosei iu bashkua rrjeteve UNITWIN MILID (Binjakëzim i Universiteteve për Njohuri në Media dhe Informim e Dialog Ndërkulturor) si anëtar i asociuar, në vitin 2014. Më pas Universiteti Hosei aplikoi dhe përshtati partneritetin ESD për të mbështetur projektin e burimeve globale njerëzore, të prezantuar në vitin 2015 nga JNCU dhe MEXT. Propozimi i Universitetit Hosei kishte për objektivi përhapjen gjerësisht të ESD-në nëpërmjet MIL-it, në të gjitha zonat e prekura nga Tërmeti i Madh i Japonisë Lindore në Fukushima, të cilat rrezikoheshin nga Stacioni i Energjisë Bërthamore Fukushima Daiichi, i Kompanisë së *Tokio Electric Power*.

Në 11 mars 2011, tërmeti dhe tsunami që goditën brigjet e Paqësorit në verilindje të Japonisë shkaktuan nja katastrofë shkatërrimtare. Deri tani, si rezultat i dëmeve numërohen në afro 16,000 persona të vdekur ose të humbur. Gjithashtu, më shumë se njëqind mijë njerëz u detyruan të evakuohen nga zona e kontaminuar me radioaktivitet në Fukushima. Edhe sot e kësaj dite këta njerëz nuk mund të kthehen në shtëpi. Unë shkova në zonat e prekura për të ndihmuar në shërimin e zemrave të thyera të fëmijëve nëpërmjet muzikës dhe aktiviteteve ritmike. Qysh nga qershori 2011, kam bërë bashkë me studentët e mi një sërë videosh me dokumentarë. Nga këto përvoja mësova që mësuesit e shkollave të asociuara me UNESCO-n shpresonin të zhvillonin te nxënësit aftësinë për t'u shprehur përpara botës pa ndihmën ose mbështetjen e medias. Për këtë arsye krijuam një slogan për partneritetin ESD në Fukushima: “Shtëpia adoptuese, Lidhja me botën”.

Probleme të tilla të vështira janë të pranishme jo vetëm në Fukushima, por në të gjithë botën. Për shembull, në 25 prill 2015, Nepali u godit nga një tërmet i fuqishëm, prej të cilit u prekën rreth 8 milion vetë, me 8,500 të vdekur ose të humbur. Ka kaluar më shumë se një vit, dhe situata mbetet ende larg zgjidhjes. Organizata *Save the Children*, e cila vazhdon të mbështesë fëmijët në Nepal, tha që ishin shkatërruar afro 5000 shkolla. E megjithatë, raportet në media mbi situatën në atë kohë sa vinin e rralloheshin. Për pasojë, fëmijët japonezë mendojnë për tërmetin e madh në Nepal si diçka që ndodhi në një botë të largët që nuk lidhet aspak me ta.

Çfarë është Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm?

Pikënisja e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD) qe Samiti Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (WSSD), mbajtur në Johannesburg në vitin 2002. Kjo ishte 10 vjet mbas Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Samiti i Tokës) i mbajtur në Rio de Janeiro në vitin 1992. Qeveria japoneze dhe OJQ/NPO-të propozuan në konferencë programin “Dekada e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm

(DESD)”. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e pranoi atë në vitin 2005. Megjithatë, në vitin 2014 DESD-ja u mbyll. Në vitin 2014, UNESCO pranoi Programin Global të Veprimit (GAP) në Konferencën Botërore mbi ESD-në në Nagoya.

GAP ka dy objektiva. Njëri prej tyre është “të riorientojë edukimin dhe të mësuarit në mënyrë që gjithkush të ketë mundësinë të përftojë dije, aftësi, vlera dhe qëndrime që u japin mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm”. Një tjetër është “të fuqizojë edukimin dhe të mësuarit në të gjitha agjendat, programet dhe veprimtaritë që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm”. (UNESCO. *Roadmap for Implementin the Global Action Programme on Education for Sustainable Development*. 2014. Fq.34). Veç këtyre bazohet në shtatë parime. Parimi i dytë është që “ESD kërkon përfshirjen e çështjeve kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm në proceset e mësimdhënies dhe të të mësuarit, nëpërmjet metodave novatore, me pjesëmarrje në mësimdhënieje dhe të mësuar, të cilat i ndihmojnë dhe i motivojnë nxënësit të ndërmarrin veprime për zhvillim të qëndrueshëm”. ESD-ja promovon aftësi si mendimi kritik, sisteme komplekse të kuptuari, përfytyrim të skenarëve të ardhshëm, dhe marrje vendimesh në mënyrë pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese”. E treta është: “ESD-ja i ka rrënjët te qasja e bazuar te të drejtat në edukim”. (Po aty. Fq.33). E rëndësishme është që ai tregon qartazi pedagogjinë bazë dhe aftësitë, një qasje e bazuar te të drejtat që ESD-ja promovon. Megjithatë, më duhet të shtoj që ato nuk i referoheshin eksplicitetit të MIL-it por i referohen medias si një nga palët e interesuara.

Në shtator 2015, u mbajt samiti i Kombeve të Bashkuara për pranimin e agjendën e titulluar “Të Transformojmë Botën tonë”: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm”, përfshirë 17 Objektivat e Qëndrueshëm të Zhvillimit (SDGs)”, të cilat u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme në datë 25. Objektivi i katërt i SDG-ve është të “Sigurojë edukim cilësor gjithpërfshirës e të paanshëm, dhe të promovojë mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë”, dhe një nga nën objektivat është: “Të sigurojë që deri në vitin 2030 të gjithë nxënësit të fitojnë dijet dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë, mes të tjerash, nëpërmjet edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe stil jete të qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, barazi gjinore, promovim i kulturës së paqes kundër dhunës, qytetari globale dhe vlerësim i diversitetit kulturor dhe i kontributit të kulturave për zhvillimin e qëndrueshëm” (Kombet e Bashkuara. 2015). Si rezultat, aftësitë dhe qasjet të cilat GAP i tregon si objektiva u bënë pjesë e SDG-ve që çdo vend anëtar i Kombeve të Bashkuara duhet t’i ndjekë.

Raporti midis ESD-së dhe MIL-it

Programi MIL ka shumë të përbashkëta me programin ESD. Në vitin 2008 në Paris UNESCO mbajti Takimin Ndërkombëtar të Grupit të Ekspertëve mbi programet mësimore të trainimit të mësuesve për Edukimin në Media dhe Informim. Sikurse citohet më poshtë, José Manuel Pérez Tornero nxori në pah rëndësinë e madhe që koncepti i MIL-it ka për ESD-në.

Koncepti i edukimit në media dhe in johurive mediatike mund të konceptualizohet brenda dy rekomandimeve të UNESCO-s – qasja në programim e bazuar te të

drejtat e njeriut dhe krijimi i Shoqërive të Dijes. Aksesi te përmbajtja cilësore mediatike dhe pjesëmarrjanë programim janë parime që promovohen nga edukimi mediatik dhe njohuritë në informacion, dhe janë gurët e themelit të së drejtë universale të shprehjes së lirë. Në të njëjtën mënyrë, edukimi mediatik dhe dijet e lehtësojnë ndërtimin e Shoqërive të Dijes. Në këtë kuptim, koncepti i njohurive në media dhe informim duhet lidhur me edukimin për zhvillim të qëndrueshëm (ESD), parim ky i shënuar për Kombet e Bashkuara nëpërmjet Dekadës për Edukim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2005 – 2014 për të cilën UNESCO është agjencia lider në implementimin e skemës. Synimi është që të integrohen parimet, vlerat dhe praktikatat e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha aspektet e edukimit dhe të mësimi. (UNESCO. Teacher Training Curricula for Media and information Literacy Background Strategy Paper. 2008. f.13)

Nga kjo mund të deduktojmë dy pika. E para është që programi MIL ishte hartuar për tu lidhur me ESD qysh me konceptimin e kurikulës për trainimin e mësuesve. Së dyti, edukimi në media dhe të mësuarit në termat e traditës së UNESCO-s konsiderohet që lehtëson ndërtimin e Shoqërive të Dijes. Ky koncept çoi në programin MIL. Të dy programet, MIL dhe ESD, kanë të përbashkët parime të qasjes si kovergjencia, forcimi, diversiteti kulturor dhe gjuhësor, gjinia dhe zhvillimi, dhe të drejtat e njeriut. Programi MIL teorikisht do të shtojë ose theksojë qasjen e bazuar te shoqëritë e dijes, praktikën e volitshme të njohurive në media dhe qasjen drejt të mësuarit me bazë hulumtimin. Ai do të përdorë gjithashtu bibliotekat si qendër mësimi për programin ESD.

Deklarata e parë mbi Njohuritë në Media dhe Informim u miratua në Marok në vitin 2011 në një forum ndërkombëtar në Fez. Ai ishte organizuar në partneritetit midis UNESCO-s, UNAOC-ut, Universitetit Sidi Mohamed Ben Abdellah, Organizatës për Edukim Islamik, Shkencor dhe Kulturor (ISESCO) dhe Byrosë Arabe të Edukimit për Vendet e Gjirit (ABEGS). Deklarata proklamoi që “MIL-i është e drejtë themelore e njeriut, sidomos në epokën digjitale të shpërthimit të informacionit dhe të konvergencës së teknologjive të komunikimit” dhe “duke patur parasysh që MIL-i rrit cilësinë e jetës së njeriut bashkë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe qytetarinë”. Mund të zbulojmë që MIL ka rëndësi për konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm si objektivizim i atij vetë. Aty gjithashtu përmendet: “MIL mund të luajë rol në ndërtimin e kulturës së paqes drejt dialogut ndërkulturor, dijeve reciproke dhe mirëkuptimit midis qytetarëve”. (UNESCO. 2011).

Deklarata konfirmonte këto parime dhe propozonte disa strategji konkrete për përhapjen e programeve MIL. Duhet theksuar që ne duhet të “integrojmë MIL-in si në sistemin formal ashtu edhe në atë jo formal, në mënyrë që (i) çdo qytetari t’i sigurohet e drejta për këtë edukim të ri qytetar, (ii) të përfitojmë nga efekti i shumëfishtë i edukatorëve për të trainuar nxënës që mendojnë në mënyrë kritike dhe dinë të analizojnë, (iii) të pajisen si mësuesit ashtu edhe nxënësit me kompetenca të MIL-it për ndërtimin e shoqërive të pasura me njohuri në media dhe informim, duke i hapur rrugën krijimit të shoqërive të dijes”. (po aty)

Politika dhe strategjia e MIL-it kanë gjashtë qasje, domethënë: konvergencën, të drejtat e njeriut, fuqizimin, diversitetin kulturor dhe gjuhësor si dhe shoqëritë e dijes. Pavarësisht faktit që të gjitha këto i ka edhe ESD-ja, qasja karakteristike e MIL-it është ajo që bazohet

te Shoqëria e Dijes. Sipas UNESCO-s, shoqëri e dijes quhet ajo “shoqëri e cila ushqehet nga diversiteti dhe kapacitetet e veta”. (UNESCO. Towards Knowledge Societies. 2003. f.17.) Kështu pra, mund të themi që Alfabetizimi në Media dhe Informim është një element i rëndësishëm për arritjen e dijes.

Tema me të cilën prezantohet “Vjetari MILID 2015” është: “Alfabetizimi në Media dhe Informim për Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm”, të cilët duhet të jenë të nevojshëm për të kuptuar raportin midis MIL-it dhe ESD-së. Hyrja e këtij libri është një ekstrakt i përshtatur i Kuadrit dhe i Planit të Veprimit të Aleancës Globale për Partneritete në Edukimin në Media dhe Informim, të udhëhequr nga UNESCO (GAPMIL). Ajo nxjerr në pah që koncepti i MIL-it është “majft në unison me Objektivin 16 të SDG-së”, në të cilin thuhet se: “Promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofron për të gjithë akses te drejtësia, duke ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. Ajo përmend që: “MIL-i i fuqizon qytetarët, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, me kompetenca në lidhje me median, informacionin, TIK dhe aspekte të tjera të njohurive të nevojshme për shekullin e 21-të. (GAPMIL. Vjetari MILID 2015. f.21). Kësisoj, ajo vë në dukje lidhjen me Objektivin 16 të SDG-së dhe thekson që MIL është një grup kompetencash për shekullin e 21-të. Në temra konkrete: aftësia për të patur akses, për të gjetur, vlerësuar dhe përdorur informacionin që u duhet në mënyrë etike dhe efektive, për të kuptuar rolin dhe funksionet e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit si bibliotekat, muzeumet dhe arkivat, për të kuptuar kushtet në të cilat ofruesit e medias dhe të informacionit mund të përmbushin funksionet e tyre; për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin dhe përmbajtjen mediatike; për tu angazhuar me ofruesit e medias dhe informacionit për tu vetëshprehur, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për pjesëmarrje demokratike dhe qeverisje të mirë; dhe e fundit, prodhimi i përmbajtjes ka nevojë për aftësi të përditësuar.

Duke qënë se MIL-i përmban aftësitë bazë dhe kompetencat për shekullin e 21-të dhe objektivi i tij është të përshtatet me SDG-të, ai bëhet baza për programet e tjera edukative të UNESCO-S, përfshirë ESD. Kësisoj, sa herë që UNESCO ndërmerr vendime të Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së, implementon të dy programet. Si rrjedhojë, të dy programet kanë në themel ide dhe politika të përbashkëta, që përfshijnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

MIL + ESD Praktikë e Partneritetit për Edukim për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Fukushima

Në vitin shkollor 2015, partneriteti për edukim për zhvillimin qëndrueshëm (FEC) dhe Universiteti Hosei ngritën një rrjet të bordeve të shkollave, NPO-ve, shkollave publike, shkollave të asociuara me UNESCO-n dhe kompanive duke përfshirë dhe mediat. Fillimisht prezantuan krijimin e filmateve për ESN-në dhe një program shkëmbimi letrash në format video si program MIL+ESD për dy shkolla të asociuara me UNESCO-n. Futja MIL-it në programin e shkollave publike në mënyrë të drejtpërdrejt ishte e vështirë nga që ata nuk kanë asnjë njohuri nga programi MIL. Megjithatë, mësuesit e shkollave të asociuara me UNESCO-n i kuptojnë elementët e MIL-it të tillë si rëndësia e mendimit

kritik, qasja e bazuar te të drejtat e njeriut, të mësuarit duke vënë nxënësit në qendër dhe qytetarinë globale. Kjo sepse ata e kanë ndërmarrë tashmë detyrën e zotërimit të programit ESD. Mënyra më mirë për të prezantuar konceptet e MIL-it në shkollat e asociuara nga UNESCO është duke shtuar konceptet MIL në praktikat ESD. Ne kemi implementuar një qasje në dy nivele të ESD-së nëpërmjet praktikave MIL, siç tregohet më poshtë.

Niveli i parë përdorte prodhimet mediatike si shtojcë e metodave tradicionale që përdorin lapsa dhe letër për tu shprehur ose prezantuar në procesin e të mësuarit të ESD-së. Për shembull, në shkollën fillore Asahi, e cilë është në një zonë të largët, Tetsuya Masujima, mësuesi i klasës së gjashtë, i vuri nxënësit të punojnë me video për të shprehur idetë e tyre se si të përmirësojnë qytetin ku jetojnë, në kuadrin e studimit të zhvillimit lokal në Periudhën e Studimit të Integruar. Emri i njësies ishte: “Mendo për qytetin tonë dhe shprehu, Tadami”. Ata ftuan një anëtar të stafit të minibashkisë për t’i treguar punimet në video dhe për të diskutuar me të. Mjaft i impresionuar, ai i çoi videot e tyre në takimin e këshillit të qytetit për përmirësim. Mësuesi theksoi që nxënësit e tij ftuan aftësinë të strukturojnë një ngjarje në bashkëpunim me nxënësit e tjerë dhe demonstruan mendim kritik nëpërmjet krijimit të videove.

Niveli dytë ishte prezantimi i programit të shkëmbimit të letrave në format video për ESD-në. Ky program ka disa aspekte të elementëve të MIL-it, si të menduarit kritik, kuptimin e funksioneve të medias, aftësi komunikimi, diversitet kulturor dhe dialog interkulturor. Në shkollën fillore Shirakata në një zonë të prekur nga tërmeti i madh dhe incidenti me uzinën bërthamore, Takuto Fukumoto, mësuesi i klasës së gjashtë vuri në jetë programin e shkëmbimit të letrave në format video me shkollën fillore Chandaikadevi në zonën e dëmtuar nga tërmeti i Madh në Nepal, si pjesë e ESD-së. Nga dhjetori deri në janar, nxënësit hartuan një letër në trajtën e një filmimi për fëmijët e Nepalit, të cilën unë e çova në Nepal në mes të janarit 2016. JNCU thekson që “ESD-ja është e fokusuar te nevojat që njerëzit në mënyrë të ndërgjegjshme të mendojnë për çështje të ndryshme, që ndodhin në një botë të largët e cila nuk lidhet me ta”. (JNCU. The Guidebook for Promoting ESD Botim i parë. 2016. f.4.). Programi i shkëmbimit me letra filmike është një nga mënyrat më të mira për implementimin e parimit të ESD-së nëpërmjet MIL-it, sepse mundëson lidhjen e çështjeve lokale dhe të ndërgjegjes së njerëzve me ato të një vendi të largët në një botë të largët si për shembull një vend në zhvillim. Përveç synimit për të lidhur dy zona rurale të botës, ai ka edhe një ndikim tjetër anësor. Në këtë rast, praktika e shkëmbimit të letrave në format video jo vetëm që ka ndikuar mbi nxënësit, mësuesit, prindërit dhe banorët e Japonisë, por gjithashtu edhe mbi Nepalin, nëpërmjet reagimit reciprok. Kjo mund të quhet qasje bilaterale ose multilaterale.

Fukumoto raportonte që në procesin e bërjes së videos, vështirësia më e madhe ishte të menduarit e asaj se çfarë lloj mesazhi t’i dërgohej fëmijëve në Nepal. E për këtë nxënësit u detyruan të kërkonin në librarinë e shkollës për mjedisin në Nepal e të përfytyronin situatën e fëmijëve të Nepalit. Sa më e madhe që ishte vështirësia në bërjen e letrës filmike, aq më e madhe qe surpriza dhe kënaqësia kur morën përgjigje nga Nepali. Si rezultat, ata mund të shkëmbejnë në praktikë shpresat dhe vështirësitë e fëmijëve të tjerë. Fukumoto shkruante që fëmijët ftuan 4 aftësi, domethënë: 1) të projektojnë imazhin e së ardhmes dhe bëjnë plane; 2) të kuptojnë dhe respektojnë kultura të tjera; 3) të jenë bashkëpunues me të tjerët; 4) të mendojnë në mënyrë kritike. Ai tha: “Nxënësit zhvilluan shumë aftësi nga përvoja në praktikë. Kjo u bë e mundur vetëm sepse nxënësit u detyruan të mendojnë

vazhdimisht për të tjerët nëpërmjet bërjes së videos. Kuptova që mund t'i mbështesim fëmijët në një këndvështrim global dhe shpirt bashkëpunues me aftësinë për të dalë përpara dhe udhëhequr të tjerët në zhvillimin e qëndrueshëm, në të gjithë botën, për të ardhmen” (Takuto Fukumoto. 2016.f.43).

Tap Raj Pant, drejtues i Programit Kombëtar të zyrës së UNESCO-s në Kathmandu tha: “Kjo lloj initiative ka nevojë të përshkallëzohet. Shumë shkolla në Japoni dhe Nepal kanë nevojë në thelb që të lidhen e të bëjnë këtë lloj pune. Kjo jo vetëm që promovon përmbajtje mediatike por do të përmirësojë padyshim edhe mësimin. Sot Objektivi 4 i Zhvillimit të Qëndrueshëm është fokusuar fort në arsimin gjithëpërfshirës me cilësi të njëjtë për të gjithë dhe në promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo është arsyeja pse Nepali është angazhuar me SDG4-ën. Në qoftë se jemi në gjendje ta përshkallëzojmë më lart këtë punë, Nepali do të përmbushë me doemos kushtet e promovimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës brenda këtij projekti”. Komentet e tij rreth programit tregojnë se si lidhet ai me SDG në krahun e Nepalit.

Vlerësimi për ESD-në dhe MIL-in

Mendoj se ka patur një problem me vlerësimin në praktikë të ESD-së. Instituti Kombëtar për politikat Kërkimore në Edukim (NIER) propozon gjashtë koncepte të ESD-së (Larmi, Ndërvarësi, Kufizim, Drejtësi, Bashkëpunim dhe Përgjegjësi) dhe shtatë aftësi dhe qëndrime për futjen e ESD-së në shkolla në një mënyrë që kuptohet lehtë. (Shigeki Kadoya & Masakazu Goto. 2013. p.48). Shtatë aftësitë dhe qëndrimet janë (1) Aftësi për mendim kritik, (2) Aftësi për të parashikuar imazhin e së ardhmes e për tëbërë plane, (3) Aftësia për të menduar në mënyra të shumëllojshme dhe gjithëpërfshirëse, (4) Aftësia për të komunikuar, (5) Aftësia për të bashkëpunuar me njerëz të tjerë, (6) Qëndrimi me respekt karshi lidhjeve, (7) Aftsi për të marrë pjesë me vullnet. Ndonëse këta modele po mbizotërojnë në shkollat e asociuara me UNESCO-n, mësuesit përballen me problemin se si t'i vlerësojnë ata. Një mësuese shkroi një artikull për “Education News”, ku thoshte që shumica e mësuesve janë konfuzë e nuk e dinë se cila është mënyra e përshtatshme për të vlerësuar suksesin. (Toshio Teshima. 2016).

Sipas NIER-it, shtatë aftësitë dhe qëndrimet janë hartuar në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga “projekti Përkufizimi dhe Përzgjedhja e Kompetencave” i OECS-së (DeSeCo). Kadoya dhe Goto shkruanin: “Ato ishin organizuar duke lidhur shtatë aftësitë dhe qëndrimet me kompetencat kyç që kishin marrë vëmendje si standard ndërkombëtar për aftësitë akademike”(po aty. F.53). Kësisoj, kompetenca e parë kyç e OECD-së: “Mjetet përdoren në mënyra interaktive” përputhet me aftësitë (1)-(3) të shtatë aftësive dhe qëndrimeve. E dyta, “Ndërveprimi në grupe heterogjene” përputhet me aftësitë (4) dhe (5) dhe e treta “Veprimi në mënyrë autonome” përputhet me qëndrimet (6) dhe (7). UNESCO iu referua gjithashtu kompetencave kyç, pasi “qasja e DeSeCo-s duket domethënëse për vështirësinë e vlerësimit të niveleve të MIL-it. Individët në të gjitha shoqëritë kanë nevojë për një gamë të gjerë kompetencash në mënyrë që të kapërcejnë vështirësitë komplekse të shoqërisë së sotme të informacionit”. (UNESCO. 2011, Towards Media and Information Literacy Indicators.) Ata ekzaminuan studimin e EAVI-t të vitit 2009). UNESCO nxori në pah një “kornizë brenda së cilës mund të arrihen konceptet më të gjera të kompetencave

të domosdoshme për pjesëmarrje aktive civile dhe sukses në Shoqërinë e Informacionit”. “Zhvillimi i vazhdueshëm dhe fuqizimi njerëzor varen nga të kuptuarit e këtyre kompetencave dhe variabla kyç që lidhen me to, në mënyrë që të mund të zhvillohen në të ardhmen tregues specifikë dhe të matshëm” (UNESCO. Ibid, f.36). Kriteret MIL të kompetencave si niveli i dytë i kornizës globale të vlerësimit janë një nga “tregues specifikë dhe të matshëm” konceptuar nga UNESCO. (Global Media and Information Literacy Assessment Framework: Country Readiness and Competencies. 2013. p.55)

Kjo do të thotë që teoritë e MIL-it mund të ofrojnë indikatorë ose kritere kompetencash për ESD-në sepse si në teoritë e edukimit për Njohuri në Media dhe Informim ashtu edhe në fushat praktike janë akumuluar mjaft studime vlerësimi. Në praktikën e letrave në format video, nxënësit panë në mënyrë kritike imazhet filmike, realizuan në mënyrë krijuese letrat në format video, hulumtuan me kureshtje për kulturën e Nepalit dhe komunikuan me nxënësit në Nepal. Prandaj mësuesit e shkollës fillore në Shirakata ishin në gjendje të kuptonin se si po përmirësoheshin nxënësit përgjatë gjithë fazave.

Mundësia e bibliotekës shkollore në Japoni

Botimi i dytë i Udhëzimeve për Bibliotekën e Shkollës i IFLA-s (Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare) u botua në vitin 2015. Aty përmendet kurikula e UNESCO-s për MIL-in dhe thuhej, “Bibliotekarët në shkollë pranojnë rëndësinë e një kornize sistematike për mësimin e aftësive në media dhe informim, dhe ata kontribuojnë për shtimin e aftësive të nxënësve nëpërmjet punës bashkëpunuese me mësuesit”. Ky pohim ka të ngjarë të ndikojë në sferën e bibliotekave shkollore madje edhe në Japoni.

Emiko Takahashi, kryetar i Shoqatës së Bibliotekave në Japoni (JLA), Divizioni i Bibliotekave Shkollore, dhe nënpresident i Qendrës së Edukimit me Njohuri në Media dhe Informim për Azinë-Pacifikun (AMILEC), përktheu një pjesë të librit të Renee Hobbs-it “Njohuri Digjitale dhe Mediatike: Lidhja e Kulturave dhe e Klasave” (Renee Hobbs. 2011) dhe tha: “Bashkëpunimi midis specialistëve të medias në Biblioteka dhe mësuesve është i nevojshëm ashtu siç përshkruhet në këtë libër. Për të ardhmen e bibliotekave shkollore është i rëndësishëm angazhimi në edukimin e njohurive në media”. (Takahashi. 2016). Në asamblenë verore të Divizionit të Bibliotekave Shkollore të Shoqatës së Bibliotekave në Japoni që u mbajt në vitin 2014 mbajta fjalimin mbi konceptin e MIL-it të UNESCO-s dhe bëra një seminar mbi rrëfimin digjital në vitin 2015. Veç kësaj, Shoqëria për Studimin e Bibliotekave të Shkollës në prefekturën e Kanagawa-s ka investiguar dhe praktikuar në vazhdimësi qysh herët Edukimin me Njohuri në Media. Divizioni i Bibliotekave të Shkollave i Shoqatës së Bibliotekave në Japoni promovon “teorinë e hetimit në formë spirale” si një teori të edukimit në Informim.

Sikurse u përshkrua pak më lart, mundësia e edukimit të MIL-it ka qenë kultivuar në formën e krijimit të integritetit të njohurive në Informim dhe Njohurive në Media si standard profesional për specialistët e Mediave Bibliotekare në fushë. Veç kësaj, partneriteti ESD në Niihama fokusohet te përdorimi i bibliotekave të shkollave dhe i bibliotekarëve për të promovuar ESD-në. Këto lëvizje mund të çojnë te promovimi i MIL-it përmes bibliotekave shkollore në Japoni.

Përfundim

Në 20 shkurt 2016, Partneriteti ESD në Fukushima mbajti konferencën e parë për të prezantuar rezultatet e projektit me bibliotekën publike të qytetit Koriyama të prefekturës së Fukushima-s. Në takim morën pjesë rreth 80 vetë, duke përfshirë mësues, profesorë, prindër, stafin mësimdhënës, bibliotekarë, qytetarë të zakonshëm dhe anëtarë të shoqatës lokale të UNESCO-s. Presidenti i një kompanie alternative elektrike, kryemësuesit e shkollave fillore të Asahi-t dhe Shirikata-s, nxënësit e shkollës fillore të Shirikata-s, mësuesit e shkollave të mesme Adachi dhe Futaba Mirai Gakuen si dhe nxënësit e shkollës së mesme Adachi bashkë me një nxënës të Universitetit Hosei prezantuan praktikat e tyre ESD dhe MIL. Veç këtyre u shfaqën letrat në format video të shkollave fillore Shirakata dhe Chandikadevi dhe një film dokumentar i shkëmbimit të letrave në format video midis tyre. Në një datë më të vonë stacioni lokal FM transmetoi prezantimet e nxënësve. Sipas një sondazhi, 41.9% e pjesëmarrësve nuk kishin dëgjuar për MIL-in përpara takimit, 96.8% e tyre u përgjigjën se u ishte rritur interesi të MIL-i, duke përfshirë këtu “shumë” dhe “pak”. 90.4% e tyre u përgjigjën se ishin të kënaqur me konferencën, duke përfshirë “shumë” dhe “pak”. Jo vetëm prezantimet e mësuesve por edhe prezantimet e nxënësve i prekën pjesëmarrësit e konferencës.

Në fillim të konferencës, Alton Grizzle, specialisti i programit MIL në sektorin e Komunikimit dhe Informimit në UNESCO, inkurajoi pjesëmarrësit e rinj duke thënë që “ju nuk jeni vetëm e ardhmja, ju jeni e sotmja. Ju mund të merrni pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e qëndrueshëm sot”. Më pas Grizzle theksoi me një video mesazh rëndësinë e lirisë së shprehjes për ESD-në dhe tha që duhej rënë dakort për veprime të qarta mbi mënyrën se si do të çohet përpara në Fukushima, në gjithë Japoninë por dhe globalisht, agjenda për edukim për një zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet edukimit në media dhe informim. Kjo konferencë tregoi “një paradigmë të re për edukimin për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet njohurive në media dhe informim dhe qytetari globale” siç e përshkroi ajo (Grizzle 2016). Mbas konferencës, UNESCO ngarkoi në faqen në internet të GAPMIL-it, në Kapitullin Rajonal të Azi-Pacifikut, disa fotografi nga konferenca dhe letrat në format video të shkollave fillore në Shirakata dhe Chandikadevi.

Megjithatë, JNCU dhe MEXT morën vendimin të mos mbështesin projektin e Partneritetit ESD në Fukushima për vitin fiskal 2016. Njëra nga arsyt është që padyshim MIL-i është një formë e ESD-së, por ka edhe forma të tjera të tij, prandaj kapaciteti për evoluim i projektit nuk është i mjaftueshëm. Ky duket si një problem sa teorik aq edhe praktik për studjuesit. Problemi kryesisht është nëse MIL-i është thjesht një formë e ESD-së apo themeli i tij. Sikurse shkrova më lart, mendoj që MIL-i, si kompetencë e shekullit të 21-të, është imperativ në të gjitha aspektet e praktikave të ESD-së.

Për ta përmbledhur, dua të ngre tre çështje të praktikës MIL+ESD nëpërmjet përvijës së projektit të Partneritetit ESD në Fukushima që zgjati një vit. I pari, duke qenë që si MIL-i dhe ESD kanë qasje dhe vlera të përbashkëta, shkollat e asociuara me UNESCO-n që janë të angazhuara me ESD-në e përshtatën me shpejtësi programin MIL. E dyta, gjithsesi, sikurse e tregoi projekti ynë, praktika ESD+MIL nuk shihet thjesht si kombinim i këtyre dy

programeve. MIL-i siguron një numër kompetencash për shekullin e 21-të dhe reformën e të mësuarit nëpërmjet bibliotekave shkollore/publike dhe medias qytetare, në të gjitha aspektet e praktikës së ESD-së. E treta, koncepti i Njohurive në Media dhe Informim dhe Dialogu Ndërkulturor duhen lidhur me konceptin e ESD-së i cili fokusohet e synon t'i bëjë njerëzit të mendojnë në mënyrë të ndërgjegjshme për botën me të cilën janë të lidhura jetët e tyre. Dua t'u propozoj njerëzve dhe palëve të interesuara të përfshira në programet MIL dhe ESD që të vazhdojnë bashkëpunimin me njëri-tjetrin për arritjen e SDG-së.

Referenca

- UNESCO. (2014). Roadmap for Implementing the Global Action Programme on Education for Sustainable Development. United Nations. (2015). Sustainable Development Knowledge Platform. Marrë në 24 prill, 2016 <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>
- UNESCO. (2008). Teacher Training Curricula for Media and information Literacy Background Strategy Paper International Expert Group Meeting. Prepared by José Manuel Pérez Tornero Parë në 24 prill, 2016 http://portal.unesco.org/ci/en/ev.php-URL_ID=27064&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=-465.html
- UNESCO et al. (2011). Declaration on Media and Information Literacy adopted by Fez International Forum. Marrë në 24 prill, 2016 http://portal.unesco.org/ci/en/ev.php-URL_ID=31456&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html
- UNESCO. (2003). Towards Knowledge Societies. Marrë në 24 prill, 2016 from: <http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001418/141843e.pdf>
- GAPMIL. (2015) Introduction - Towards a Global Media and Information Literacy Movement in Support of the Sustainable Development Goals. Media and Information Literacy and Intercultural Dialogue Year book 2015. (Eds. J. Singh, A. Grizzle, S. J. Yee & S. H. Culver). Bohus, Sweden: Nordicom.
- Dokumenti origjinal gjendet në faqen e mëposhtme në internet. Retrieved April 24, 2016. http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/pdf/Events/gapmil_framework_and_plan_of_action.pdf
- Japanese National Commission for UNESCO (JNCU). (2016). Guidebook for Promoting ESD (first edition).
- Origjinali është shkruar në japonisht Marrë në 24 prill, 2016. http://www.mext.go.jp/component/a_menu/other/micro_detail/___icsFiles/afieldfile/2016/04/05/1369326_02_1.pdf
- Fukumoto, T. (2016). Four abilities students acquired. Children in Fukushima and Nepal, a way of encounter by video letter. (Ed. Jun Sakamoto). Kawaguchi, Japan: Digital Skip Station. Origjinali është shkruar në japonisht në 24 prill, 2016. http://cq.i.hosei.ac.jp/?action=common_download_main&upload_id=3155
- Kadoya, S. and Goto, M. (2013). The Past, Present and Future of ESD in Japan How to develop and disseminate ESD at School with the Network of the Local Community. NIER Research Bulletin. No142.
- Teshima, T. (2016). Quell the confusion in the field of UNESCO associate school. The Education Newspaper. March 10 2016. Origjinali është shkruar në Japonisht.
- UNESCO. (2011). Towards Media and Information Literacy Indicators.

- Marrë në 24 prill 2016.
<http://www.ifla.org/files/assets/information-literacy/publications/towards-media-and-Information-literacy-indicators.pdf>
- European Association for Viewers' Interests et al. (2009). Study on Assessment Criteria for Media Literacy Levels.
 Marrë në 24 prill 2016.
http://ec.europa.eu/culture/library/studies/literacy-criteria-report_en.pdf
- UNESCO Communication & Information Sector. (2013). Global Media and Information Literacy Assessment Framework: Country Readiness and Competencies.
 Marrë në 24 prill 2016.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002246/224655e.pdf>
- IFLA. (2015). School Library Guidelines 2nd revised edition.
 Marrë në 24 prill 2016.
<http://www.ifla.org/publications/node/916>
- Hobbs, R. (2011), Digital and Media Literacy: Connecting Culture and Classroom.
 USA:Corwin.
- Takahashi, E. (2016). Foreword to Newsletter No.7. AMILEC News No.7(April) . Asia pacificMedia and Information Literacy Education Centre (AMILEC). Origjinali është shkruar në japonisht.
- Grizzle, A. (2016). Video Message from UNESCO. UNESCO ESD Fukushima News No.3(April). pp.3-6. Origjinali është përkthyer në japonisht.
 Retrieved April 24, 2016.
<http://www.hosei.ac.jp/documents/gakubu/careerdesign/shokai/society/News3.pdf>

Shënime

1. Intervistë e Jun Sakamoto dhe Kyoko Murakami në zyrën e UNESCO-s në Kathmandu. (23 Janar 2016). Video gjendet nw linkun e mëposhtëm të YouTube. Marrë në 24 prill 2016.
2. Faqja në Internet e Kapitullit Rajonal Azi – Pacifik të GAPMIL – konferenca e parë e Partneritetit ESD në Fukushima.
 Marrë nga: <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/media-development/media-literacy/global-alliance-for-partnerships-on-media-and-information-literacy/about-gapmil/gapmil-aisa-pacific-regional-chapter/>

E drejta e Njeriut për Identitet dhe Rikonstruksioni Mediatik i Kujtesës së Njerëzve të Humbur në Meksikë

Darwin Franco Miguez

Ky tekst do të zbulojë punën e bërë nga organizatat e familjeve të personave të humbur në Meksikë, sidomos në shtetin Jalisco dhe Nuevo Leon, për të rifituar disa nga të drejtat njerëzore identitare që u janë marrë të dashurve të tyre, duke patur parasysh se si diskutimet qeveritare dhe ato në media i kanë reduktuar në numra dhe statistika. Theksi do të vihet mbi fuqizimin qytetar dhe mediatik që këto familje, në veçanti nënat, kanë përjetuar deri në atë pikë sa ato sot nuk janë më thjesht viktimat të dhunës, por gjithashtu avokate të të drejtave të njeriut.

Meksika po kalon një krizë të rëndë në fushën e të drejtave të njeriut, e cila është rritur në mënyrë eksponenciale qysh kur qeveria federale ndërmori luftën kundër krimit të organizuar. Kjo luftë, e cila filloi në vitin 2006, rezultoi në zhdukjen e më shumë se 28,000 njerëzve dhe vdekjen e 150,000 të tjerëve.

Që me fillimin e luftës, familjet e viktimave janë ngritur në këmbë në të gjithë vendin duke kërkuar drejtësi për secilin nga të vrarët dhe kthimin gjallë të personave të humbur. Ndonëse prania e tyre në sferën publike dhe në hapësirën mediatike nuk ka qenë aksidentale ose thjesht akt i familjeve, por një përgjigje masive qytetare, kanë filluar të dalin zëra për versionin mediatik që po përpiqet ta mbulojë këtë gjë duke thënë jo vetëm që është çështje viktimash kolaterale por gjithashtu që, në shumicën e rasteve, viktimat ishin të lidhur me krimin e organizuar.

Vizibiliteti botëror i 43 studentëve të humbur të Escuela Normal Rural "Raul Isidro Burgos" në Ayotzinapa, në 26 shtator 2014, nga dora e policisë dhe e anëtarëve të karteleve të drogës, ka tërhequr vëmendjen e organizatave për të drejtat e njeriut në Meksikë, duke qenë se asnjë tjetër vend në botë nuk ka një numër kaq të madh njerëzish të humbur, dhe as një numër të tillë shkellesh të të drejtave të njeriut, produkt i dhunës sociale dhe institucionale (OSJI, 2016). Duke mbajtur parasysh këtë situatë, ky punim do të paraqesë mënyrën se si është prezantuar në median mexikane problem i personave të humbur dhe si të zhvillohet një strategji e njohurive mediatike për t'i emërtuar ata pa dhunuar të drejtat e tyre.

Fjalëkyç: Njerëz të humbur, konstruksion mediatik, të drejta të njeriut.

Zhdukja e njerëzve në Meksikë

Vëmendja mediatike për zhdukjet në Meksikë u shtua pas zhdukjes të 43 studentëve nga Escuela Normal Rural “Raul Isidro Burgos”, në Ayotzinapa, të cilët ofricerët e policisë bashkiake të Cocula dhe Iguala në Guerrero, ia kishin dorëzuar kartelitet *Guerreros Unidos*, në 26 shtator 2014.

Ky rast, i cili sot konsiderohet si emblematik për zhdukjet e ndodhura në Meksikë, për fat të keq nuk ka qenë i vetmi sepse, sipas të dhënave zyrtare të qeverisë mexikane, që kur filloi lufta kundër krimit të organizuar në vitin 2006, në vend janë zhdukur 28,156 njerëz, nga të cilët 20,662 meshkuj dhe 7,494 femra (RNPED, 2016). Megjithatë, grupet e familjarëve të personave të humbur të formuar në gjithë Meksikën pretendojnë që për çdo person ta humbur të raportuar janë dy të tjerë të paraportuar nga frika ose mosbesimi të autoritetet.

Mungesa e hetimeve dhe kërkimeve, mungesa e aksesit të drejtësia dhe pandëshkueshmëria e fajtorëve për vdekjet, përfshirë atë të 43 studentëve, përbëjnë skenarin që ka shkaktuar *krizën serioze të drejtave të njeriut nga e cila po lëngon vendi, e cila rrezikon të bëhet e vazhdueshme*, sikurse u shprehën Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (IAHR, 2015). Të dy këta organizma ndërkombëtarë kanë zhvilluar hetime në Meksikë për të zbuluar të vërtetën rreth krimeve si zhdukjet, torturat dhe ekzekutimet pa gjyq; në analizën dhe investigimin që kanë bërë ata pajtohen në atë që dhunimi i të drejtave të njeriut është një dukuri e përgjithshme, sepse në shumicën e krimeve ka një marrëveshje të fshehtë dhe komplicitet midis autoriteteve dhe grupeve të ndryshme të trafikut të drogës.

Megjithatë, denoncimi ndërkombëtar i dhunimeve të të drejtave të njeriut në Meksikë nuk ka gjetur jehonë të madhe në mbulimin mediatik të dy rrjeteve kryesore televizive në vend, Televisa dhe Tv Azteca, sepse që të dy i lanë vend vetëm versionit zyrtar, i cili mohon “krizën e të drejtave të njeriut”. Ky manipulim i informacionit, natyrisht, ka impakt mbi konstruktionin social lidhur me zhdukjet dhe të humburit, sepse i bën të padukshëm zërat e viktimave në lajme, duke i mbyllur gjithashtu gojën kritikave kundër qeverisë mexikane.

Kjo situatë është dramatikisht ndryshe nga ajo që raportojnë grupet e familjarëve që përfaqësojnë viktimat e zhdukjeve, të cilët, duke përdorur blogjet ose rrjetet sociale si Facebook, Twitter, YouTube ose Instagram raportojnë statusin aktual të hetimeve të tyre dhe dhunimet e shumta të të drejtëve të njeriut që u janë bërë atyre vetë dhe viktimave nga ana e agjentëve shtetrorë sa herë që kërkojnë informacion rreth investigimit ose kur vendosin që për shkak të mosveprimit të qeverisë të ndërmarrin vetë kërkime.

Ky tekst do të prezantojë një vështrim të përgjithshëm të llojit të mbulimit mediatik nga ana e medias mexikane në lidhje me zhdukjet; theksi i analizës tonë do të bjerë mbi zhdukjen e 43 studentëve, pasi ky është rasti më ikonik i zhdukjeve në Meksikë e kësajsoj, ai që ka patur edhe më shumë mbulim.

Më vonë do të prezantojmë dy shembuj për të ilustruar punën e ndërmarrë nga grupet e familjarëve të personave të humbur në mënyrë që: 1) të nxisë një shpeshiti të mbulimit mediatik që do të ruante si të drejtën për identitetin ashtu edhe dinjitetin e personave të humbur. 2) të diskutojë lidhur me versionin zyrtar të ngritur rreth zhdukjes dhe personave të humbur, si nga qeveria ashtu edhe nga ana e medias. Përpjekjet për të treguar do të

jenë ato të sjella nga kolektivat *Fuerzas Unidas por Nuestros Desaparecidos dhe Nuevo León* (Forcat e Bashkuara për Personat e Humbur, FUNDENL) dhe nga *Por Amor A Ellos, familiares de desaparecidos de Jalisco* (Për Hir të Dashurisë për ta, PAE).

Shtylla kurrizore e këtij teksti do të jetë rifitimi i të drejtës për të “qenë”, nga e cila janë privuar këta njerëz, jo vetëm të zhdukur fizikisht, por gjithashtu të zhdukur sërish në ligjërimet zyrtare dhe diskutet mediatike, duke i reduktuar në thjesht statistika ose kur kriminalizimi ia del të njollosë identitetin dhe dinjitetin e tyre.

Nga e Vërteta Historike te Imponimi Mediatik

Referimi për personat e zhdukur bëhet gjithmonë në kohën e tashme, asnjëherë në të shkuarën, sepse me përkufizim person i zhdukur është “ai person i cili nuk dihet se ku ndodhet, nuk dihet nëse është i gjallë apo jo” (RAE, 2016); kjo është arsyeja pse për ta duhet të flasim gjithmonë në kohë të tashme, kjo është e vetmja mënyrë për të respektuar “të drejtën e tyre për të qenë”, që do të thotë, nuk duhet t’u referohemi në të shkuarën për sa kohë nuk ka asnjë siguri se ku dhe si janë ata.

Duke iu përmbajtur kësaj të drejte që ka çdonjëri prej personave të humbur, është parë si prioritet që përpara se t’i quajmë me emra dhe t’u referohemi 43 studentëve në të njëjtën mënyrë si bëri media në raportet mediatike dhe lajme, do të shpenzojmë disa minuta për të renditur emrat e studentëve që edhe në ditët e sotme mbeten të zhdukur: Felipe Arnulfo Rosa (20 vjeç), Benjamin Ascencio Bautista (19 vjeç), Jose Angel Navarrete Gonzalez (18 vjeç), Marcial Pablo Baranda (20 vjeç), Jorge Antonio TizapaLegideno (19 vjeç), Miguel Angel Mendoza Zacarias (33 vjeç), Marco Antonio Gomez Molina, Cesar Manuel Gonzalez Hernandez, Julio Cesar Lopez Patolzin (25 vjeç), Abel Garcia Hernandez (21 vjeç), Emiliano Alen Gaspar de la Cruz (23 vjeç), Doriam Gonzalez Parral (19 vjeç), Jorge Luis Gonzalez Parral (21 vjeç), Alexander Mora

Venancio (21 vjeç), Saul Bruno Garcia, Luis Angel Abarca Carrillo (18 vjeç), Jorge Alvarez Nava (19 vjeç), Christian Tomas Colon Garnica (18 vjeç), Luis Angel Francisco Arzola (20 vjeç), Carlos Ivan Ramirez Villarreal (20 vjeç), Magdaleno Ruben Lauro Villegas (19 vjeç), Jose Luis Luna Torres (20 vjeç), Bernardo Flores Alcaraz, Israel Caballero Sanchez (21 vjeç), Arturo Vazquez Peniten, Jesus Jovany Rodriguez Tlatempa (21 vjeç), Mauricio Ortega Valerio (18 vjeç), Jose Angel Campos Cantor, Jorge Anibal Cruz Mendoza (19 vjeç), Giovanni Galindes Guerrero (20 vjeç), Jhosivani Gro de la Cruz (21 vjeç), Leonel Castro Abarca (18 vjeç), Miguel Angel Hernandez Martinez (27 vjeç), Antonio Santana Maestro, Carlos Lorenzo Hernandez Munoz (19 vjeç), Israel Jacinto Lugardo (19 vjeç), Adan Abrajan de la Cruz (24 vjeç), Christian Alfonso Rodriguez (21 vjeç), Martin Getsemany Sanchez Garcia (20 vjeç), Cutberto Ortiz Ramos (22 vjeç), Everardo Rodriguez Bello (21 vjeç), Jonas Trujillo Gonzalez (20 vjeç) dhe Jose Eduardo Bartolo Tlatempa (19 vjeç).

Të 43 studentët u zhdukën në 26 shtator 2014¹ në bashkinë e Iguales, Guerrero, shtet ky në jug të Meksikës, popullsia e të cilit është nga më të varftrat në vend. Ata u zhdukën sepse disa oficerë policie vendosën t’ua dorëzojnë të rinjtë një grupi kriminal të njohur si *Guerreros Unidos*, sepse me sa duket një nga pesë autobuzët ku kishin hipur në Terminalin Qendror të Autobuzëve në Iguala për t’u kthyer në shkollë, Escuela Normal Rural, që

ndodhet në komunën Ayotzinapa, në bashkinë e Tixla-s, kishte me vete një ngarkesë me lulekuqe e cila duhet transportohej nga Guerrero në Shtetet e Bashkuara.

Kjo linjë investigimi, e injoruar nga Procuraduria General de la Republica (Prokuroria e Përgjithshme e Republikës), organi qeveritar i ngarkuar për rastin, u hetua nga Grupo Interdisciplinario de Expertos Independientes (Grupi Ndërdisciplinor i Ekspertëve të Pavarur (IACHR)², është njëra nga hipotezat që mund të shpjegojë pse në natën e datës 26 dhe mëngjesin e datës 27 shtator, 2014, studentët u sulmuan si nga policët e bashkisë ashtu edhe nga *Guerreros Unidos*; gjithashtu edhe pse hetimet e kryera u përpoqën të fshihnin ekzistencën e autobuzit të pestë (CIDH, 2016).

Megjithatë, ky lloj informacioni që është jetik për sqarimin e ngjarjeve, nuk është zakonisht pjesë e mbulimit mediatic të zhdukjes së 43 studentëve; madje ndodhte krejt e kundërta, gjithçka që vinte në pikëpyetje versionin zyrtar, nuk merrte shumë kohë transmetimi në stacionet televizive, ose hapësirën e duhur gjatë mbulimit të gazetave më të rëndësishme të vendit.

Le të japim një shembull për sa më lart, zhdukja e studentëve ndodhi të premten, në 26 shtator 2014; megjithatë, lajmi filloi të zerë një vend të rëndësishëm në mediat meksikane midis datave 30 shtator dhe 11 tetor të atij viti, sepse pikërisht në këto data studentët e mbijetuar filluan të thyejnë heshtjen dhe të tregojnë në rrjetet sociale si Facebook dhe YouTube, përmasat e tragjedisë që kishin përjetuar në Iguala. Ishte komunikata e studentëve ajo që zbuloi se 43 studentë ishin zhdukur pjesërisht për shkak të veprimeve të policëve të bashkisë, të cilët më parë kishin bërë shoshë me plumba autobuzin ata ku udhëtonin.

Në analizën e mbulimit mediatic të ditëve të para për atë çka ndodhi me 43 studentët³, organizata për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, NENI 19, dokumentonte mënyrën në të cilën katër gazeta kombëtare (*La Jornada*, *Reforma*, *Excelsior* dhe *El Universal*), raportonin incidentin nga dy variabla: 1) numri i ditëve në të cilat incidenti u shfaq në faqe të parë dhe burimi i informacionit të përmbajtur në raport. (Autoritet qeveritar, deklaratë e Presidentit, dëshmi e viktimave, intervista të organizatave qytetare dhe informacion mbi protestat. Rezultatet ishin si më poshtë:

1. Zhdukja e 43 studentëve u shfaq në faqe të parë në të gjitha gazetat gjatë muajit të parë të mbulimit.
2. Incidenti u mbulua nga këndvështrimi i deklaratave zyrtare për zhdukjen, duke bërë që viktimat të zbrisnin për nga rëndësia informative në një nivel të dorës së dytë ose të tretë. Përveç gazetave *La Jornada* dhe *El Universal*, ku vetëm një e katërta e shkrimeve të tyre fokusohet mbi viktimat, pjesa tjetër e gazetave i hartonte raportet nga konferencat e shtypit, buletinet ose disa deklaratat zyrtare.
3. Zyrtari publik që ishte publicizuar më shumë ishte Presidenti i Meksikës, Enrique Peña Nieto, i cili guxoi të flasë për zhdukjen e 43 studentëve vetëm mbas 11 ditësh pas ngjarjes, në 6 tetor. Që nga ajo ditë deri në 5 nëntor, fjalët e tij për incidentin ishin gjithmonë në faqe të parë të gazetave si *Excelsior*.

Rezultatet e kësaj analize janë që ky vizibilitet i rastit të zhdukjes së 43 studentëve nuk jo gjithmonë u shoqërua nga trajtimi kritik i atyre që në mënyrë direkte ose indirekte ishin

përgjegjës për këtë zhdukje. Madje ndodhte krejt e kundërta, merrnin prioritet veprimet e qeverisë; kjo është arsyeja pse protagonistë të lajmit nuk ishin viktimat.

Duke përdorur të njëjtin segment kohor si dhe *ARTICLE 19*, ky autor përdori një analizë për të parë se si mediat iu referoheshin studentëve thjesht si persona të humbur dhe si zhdukja konsiderohej thjesht si një ngjarje. Në rradhë të parë, në shumicën e lajmeve thuhej që Escuela Normal Rural “Raúl Isidro Burgos”, në Ayotzinapa, kishte qenë përherë një terren pjellor për guerrillas si Lucio Cabanas, prandaj dhe studentët shfaqnin qëndrime dhe ideologji subversive, të manifestuara edhe më parë në akte të dhunshme, siç kishte ndodhur gjatë marshimeve ose protestave. Veç kësaj, theksohej gjithmonë që për shkak të kushteve të tyre sociale (klasa të ulta shoqërore), ata mund të kishin patur ndonjë lloj lidhjeje me trafikun e drogës.

Në këtë rast, personat e humbur jo vetëm që ishin pa asnjë shpresë sepse ishin të rinj dhe studentë, por gjithashtu edhe sepse ishin të varfër dhe fshatarë. Kjo përkthehej në formimin e nocionit gazetaresk në të cilin personi i humbur prezantohet si subjekt vendimet e të cilit në jetë e bënin atë bashkëpërgjegjës për zhdukjen e vet. (Robledo, 2015). Duke formuar këtë imazh të personit të zhdukur, zhdukja e krimit ose e veprimit kriminal, minimalizohej sepse Shteti nuk ishte bashkëpërgjegjës, pasi ishin veprimet e këtyre individëve që çuan në këtë situatë limit, përtej faktit që tashmë dihej publikisht që 43 studentë i ishin dhënë në dorë trafikantëve të drogës nga oficerët e policisë.

Objektivi i këtij trajtimi ishte që të flitej më pak për zhdukjen e dhunshme, e planifikuar dhe ekzekutuar nga oficerët e shtetit, për ta bërë atë të dukej më shumë si pasojë e veprimeve personale të vetë studentëve, çka përforconte versionin e mbajtur nga zyrtarët publikë të cilët për të mos regjistruar rastet e personave të humbur të raportuara në stacionet e policisë, përdorin fjalë si: “Vajza jote ka ikur me të dashurin”, “djali yt nuk shfaqet se nuk ka qenë në udhë të mbarë”, “nuk duken se ndoshta kanë zënë shoqëri të keqe, rrinë me tipat e gabuar” ose “ka të ngjarë që djali yt të jetë në plazh”.

Të gjitha këto kontribuan në faktin që gjatë muajit të parë të mungesës së studentëve u krijua një lloj polarizimi midis atyre që i identifikonin ata si viktimat, dhe atyre që i shihte si studentë reaksionarë që kishin vjedhur autobuzët, prandaj dhe u erdhi kjo tragjedi.

Një nga pikat kyçe të mbulimit mediatik që ka zgjatur për më shumë se një vit e gjysmë mbas zhdukjes së 43 studentëve, ndodhi në 28 janar 2015, kur ish Gjenerali i Përgjithshëm i Republikës, Jesús Murillo Karam, lajmëroi përfundimin e hetimit mbi rastin, ku, pa paraqitur asnjë provë, informoi publikun që studentët ishin vrarë dhe djegur nga anëtarët e *Guerreros Unidos* në fushën e plehrave të qytetit Cocula, dhe që për shkak të intensitetit të zjarrit fragmentet e kockave të gjetura aty ishte e pamundur të identifikoheshin.

Kjo “e vërtetë historike”, si e quajti ai, shënon një pikë kthese në mënyrën se si shumica e mediave filluan t’i referohen studentëve të humbur dhe zhdukjes së tyre. Së pari, duke i konsideruar të vdekur, filluan t’u referohen atyre në kohën e shkuar, dhe së dyti, duke qenë se ishte aprovuar një version zyrtar, shumica e mediave vendosën të ndalojnë hetimet dhe të pranojnë si të vërtetë atë që kishte thënë ish prokurori i përgjithshëm.

Rrjetet e televizioneve kombëtare Televisa dhe Tv Azteca ishin ato që e përsërisnin më shumë këtë version; kjo është arsyeja pse në 10 mars 2015, prindërit e studentëve organizuan një rrethim të godinave të Televisao-s për të kërkuar të drejtën e tyre për t’u përgjigjur, duke qenë se besonin që raportimi i vetëm një versioni të fakteve në televizionin kombëtar ishte e dëmshme jo vetëm për përpjekjet e tyre, por gjithashtu për të drejtën

e tyre për informacion. Felipe de la Cruz, babai i njërit nga studentët, në një intervistë me autorin shpjegoi: “nuk duhet të përgjithsojmë, por duket se disa media vendosën ta mbyllin këtë rast, madje çka është edhe më keq, ka të tjerë që kanë diskredituar lëvizjen tonë dhe organizatat e të drejtave të njeriut që na kanë shoqëruar në kërkimin e së vërtetës”.

Ky qëndrim i një pjese të mirë të medias meksikane u bë edhe më i dukshëm mbas 24 prillit 2015, në ditën kur Grupi Ndërdisciplinor i Ekspertëve të Pavarur (GIEI) nga Komisioni Ndëramerikan mbi të Drejtat e Njeriut prezantoi Raportin Ayotzinapa (CIDH, 2015), zbulimi më i rëndësishëm i të cilëve ishte që vërtetuan me prova shkencore që nuk kishte patur kurrë ndonjë zjarr në Cocula, fushën e plehrave në Guerrero, prandaj rezultonte që 43 studentët nuk ishin vvarë ose djegur atje.

Prezantimi i kësaj të vërtete historike të krijuar nga qeveria ishte gjithashtu një goditje shumë e fortë për disa media që kishin pranuar atë që ish Prokurori i Përgjithshëm e pat quajtur një fakt të pakontestueshëm. Që nga ajo kohë, disa media kanë ndërmarrë një fushatë diskreditimi kundër anëtarëve të GIEI-t dhe IACHR-së, e cila konsiston në prezantimin e kundër argumenteve shkencore që mbështesin versionin zyrtar: studentët ishin djegur në Cocula dhe për shkak të kushteve të mbetjeve njerëzore të gjetura është e pamundur të kryhen testet për përputhjen e ADN-ve që prindërit kanë ofruar për autoritetet.

Ky version zyrtar është përqaftuar dhe mbështetur nga ana e qeverisë meksikane. Familjet e 43 studentëve nuk e pranojnë këtë të vërtetë, sepse ai është version që qeveria e ka ngritur nëpërmjet ushtrimit të torturës mbi ata që në dukje janë përgjegjës për djegien e studentëve, gjë që u konfirmua dhe nga raporti i dytë i GIEI-t, i prezantuar në 24 prill 2014. Hetimet e GIEI-t në shumicën e mediave dhe kryesisht në rrjetet televizive u paraqitën si ngjarje sekondare, sepse përparësi pati zëri zyrtar sipas të cilit ata i pranonin rezultatet por nuk i aprovojnë ato aspak sepse ishin ngritur mbi versione që nuk korrespondojnë me atë që sjellin autoritetet.

Përpara se të prezantojmë atë që po bëjnë familjet e personave të humbur për të përmbytur interpretimin zyrtar dhe mediatik që i është bërë zhdukjes dhe personave të humbur, e gjykojmë me vend të theksojmë atë çka ne meksikanëve na detyrohen si audiencë dhe qytetarë, përse i përket transmetimit të lajmit që ishte po aq i rëndësishëm sa ai në Ayotzinapa.

Kush ishin të Drejtat e Audiencës në Respekt të Lajmeve si ai i Ayotzinapas?

Neni 238 i Ley Federal de Telecomunicaciones y Radiodifusión (Akti Federal i Telekomunikacioneve dhe i Transmetimeve) vendos se e vetmja masë rregullatore për shfaqjen e lajmeve, që: “Me synimin që të shmangët transmetimi i publicitetit mashtrues, pa ndikuar lirinë e shprehjes dhe të përhapjes, është e ndaluar të transmetohen reklama ose propagandë e prezantuar si gazetari ose informacion lajmesh”.

I njëjti legjislacion shkon edhe më tej kur Neni 256 përmend që: “shërbimi publik i transmetimit në interes të përgjithshëm do të prezantohet në kushtet e kompetencave dhe barazisë, në mënyrë që të përputhet me të drejtat e audiencave, të cilat, nëpërmjet

transmetimit të tyre do të sigurojnë përfitime kulturore, duke ruajtur pluralitetin dhe vërtetësinë e informacionit”. Kjo do të thotë që mediat ligjërisht janë të detyruara të ofrojnë një pluralitet informacioni që do t’u lejojë njerëzve të kuptojnë të gjitha anët e problemit dhe gjithë zërat ekzistues rreth një ngjarjeje me interes publik.

A i respektuan Televisa dhe Tv Azteca, si mediat me shtrirjen më të madhe në vend, të drejtat tona si audiencë në emisioneve të tyre të lajmeve në mbulimin që i bënë me informacion zhdukjes së 43 studentëve nga Ayotzinapa? Në qoftë se i qëndrojmë Neni 256 të Ley Federal de Telecomunicaciones y Radiofusión, përgjigjja është jo.

Së pari, sepse të dy rrjetet televizive priten derisa morën versionin e parë zyrtar për të filluar mbulimin e incidentit. Që do të thotë, eventin ndodhi në datat 26 dhe 27 shtator, por të dyja kompanitë e filluan raportimin thuajse një javë më vonë.

Së dyti, sepse për llogari të versionit zyrtar, ata e kufizuan të drejtën tonë për “ruajtjen e pluralitetit dhe vërtetësisë së informacionit”, duke e mbështetur informacionin e tyre të versionit zyrtar; në rastin e mbulimit të ngjarjes së Ayotzinapas kjo nuk ndodhi sepse zëri i studentëve dhe ai i familjeve të personave të humbur që i kushtëzuar nga versioni zyrtar; që do të thotë se deklaratat e tyre nuk paraqiteshin si elemente thelbësorë të fakteve gazetareske, por thjesht si reagime ndaj veprimeve qeveritare. Duke bërë këtë, në sajë të vetë produktit televiziv dhe informativ, studentët dhe prindërit e tyre dukeshin në ekran thjesht si jokonformisë, por jo si kontribues të investigimeve siç ishte në të vërtetë rasti.

Së treti, duke qenë se ata pyeteshin thjesht si jokonformistë (që ankoheshin për veprimet e qeverisë), e drejta e tyre për tu shprehur nuk respektohej dhe nuk u tregua asnjë kujdes që audiencia të kishte një informacion që të: “përmbushë shprehjen e diversitetit dhe pluralizmit të ideve dhe opinioneve” (Neni 256, par. II).

Së katërti, duke qenë se ata ndërmorën një mbulim informativ me këto karakteristika, shprehja e fakteve ishte subjekt i një procesi editorial ku nuk “bëhej qartazi dallimi mes informacionit dhe opinionit të atyre që e shprehnin atë” (Neni 256, paragrafi III), kështu lejonin shprehje si “Pallati i Bashkisë në Iguala u dogj nga vandalët dhe studentët”, “persona me kapuç dhe studentë kryen vandalizma në Chilpancingo”, “njerëz të armatosur dhe studentë përmbysën kioska dhe dogjën disa makina me një dhunë të jashtëzakonshme”. Këto janë shprehje të marra nga programet e lajmeve të Joaquín Dóriga dhe Javier Alatorre, në datat 10, 11 dhe 12 nëntor⁴.

Të shprehesh “edhe studentët”, pa ofruar ndonjë provë është dhunim i paragrafit VIII të Neni 256, pasi ky akt është diskriminues, madje është akt kriminalizues kur studentët dhe pjesëmarrësit në demonstrime përshkruhen si: “të dhunshëm, vandalë dhe të rrezikshëm”. Ky paragraf, për shembull, ndalon: “të gjitha llojet e përpjekjeve për diskriminim kundër dinjitetit dhe që kanë si objektiv të anulojnë ose minojnë të drejtat dhe liritë”. T’i etiketosh e t’i përshkruash studentët si të tillë, pa prova, minon jo vetëm dinjitetin e tyre, por gjithashtu të drejtat e tyre të njeriut, sepse atyre nuk u është dhënë kurrë e drejta të përgjigjen kur akuzohen si individët kryesorë përgjegjës për aktet e dhunshme që janë kryer në demonstrime të ndryshme në të gjithë vendin.

Çfarë të drejtash kemi ne, audiencat, në Meksikë? Të marrim informacion pluralist, të vërtetë e që kontribuon për të kuptuar një ngjarje me interes publik. Kur them për të *kuptuar*, dua të them të drejtë për të dëgjuar të gjithë zërat dhe perspektivat e përfshira, por jo në mënyrë reaguese (sikurse u bë për 43 studentët dhe familjet e tyre), por si një element

qendror i një eventi informativ, në mënyrë të atillë që të na lejojë t'i shohim si qytetarë dhe jo vetëm si viktime ose idhnakë qaramanë që nuk pranojnë versionin zyrtar.

Alfabetizimi mediatic, sikurse e tregon Orozco (2014), nuk është vetëm proces që duhet fokusuar te fuqizimi i audiencave, por gjithashtu edhe i prodhuesve, pasi pikërisht ata duhen edukuar në mënyrë që nëpërmjet mesazheve të programeve dhe përmbajtjes që gjenerojnë, praktikave të reja e më të mira, të mund të nxiten që t'i përmendin njerëzit pa dhunuar të drejtat e tyre ose tiparet e identitetit.

Në qoftë se producentët, drejtuesit e emisioneve dhe gazetarët do të bëhen objekt i fushatës së alfabetizimit mediatic, ata do të mësojnë t'i referohen personave të humbur në kohën e tashme dhe jo në të shkuarën; ata do të mësojnë të flasin për ta pa i kriminalizuar ose stigmatizuar; ata do të mësojnë se viktime është shumë më tepër se një person i pashpresë. E gjitha kjo do të thotë një ndryshim mjaft i rëndësishëm në mbulimin e zhdukjeve në Meksikë, gjë e cila – sikurse e pamë në ushtrimin e mëparshëm rreth zhdukjes së 43 studentëve – nuk kryhet me perspektivën e të drejtave të njeriut që do ta ndihmonin publikun të “kuptonte” çfarë ka ndodhur, përse kanë humbur dhe pse qeveria meksikane pretendon që 43 studentët kanë vdekur dhe jo humbur, sikurse ngulin këmbë familjet.

Nga ana tjetër, alfabetizimi mediatic duhet të synojë krijimin e audiencave kritike në gjendje të njohin se çfarë të drejtash kanë përballë lajmeve të këtyre përmasave, si dhe të dinë se çfarë hapash mund të ndër marrin për ta penguar këtë lloj mbulimi që të mos dhunojë të drejtat e njeriut të personave të humbur dhe të familjeve të tyre.

Një proces alfabetizimi mediatic që mund të implementohet është aksioni politik dhe komunikativ që është ndërmarrë prej disa vitesh nga grupime familjarësh të personave të humbur në Meksikë; ata kanë vënë në praktikë fushata mediatike dhe aksione ku jo vetëm denoncojnë mungesën e një hetimi të vërtetë në kërkim të personave të humbur por gjithashtu po propozojnë forma përfaqësimi për të treguar se cila është mënyra e duhur për t'i quajtur ata.

Një Shembull e Alfabetizimit për të Drejtat e Identitetit dhe Kujtesës së Personave të Humbur

Shtetet Nuevo León dhe Jalisco i ndajnë vetëm 793 kilometra. Të dy këta, bashkë me Ciudad de México, konsiderohen si shtetet më të rëndësishme në vend, pasi përfaqësojnë një nivel të lartë zhvillimi ekonomik dhe industrial. Megjithatë, përtej këtyre lidhjeve makroekonomike, fshihet një realitet i egër i ndërthurur me dhunën në rritje në të dy shtetet që nga viti 2006. Një nga pasojat e kësaj janë zhdukjet e njerëzve, pasi Nuevo León dhe Jalisco renditen mes pesë shteteve me numrin më të madh të personave të humbur në vend: Jalisco ka 3,179 dhe Nuevo León, 2,167 (RNPED, 2016).

Sikurse ndodh zakonisht me investigimet e ekspertëve dhe deklaratat zyrtare për rastin në Ayotzinapa, familjet e personave të humbur në Nuevo León dhe Jalisco vuajnë gjithashtu nga mungesa e hetimeve dhe e kërkimit për të afërmit e humbur ndaj, për shkak të mungesës së mundësisë për të patur drejtësi për të gjitha familjet, që nga viti 2012 ato kanë vendosur të grupohen në kolektivat *Fuerzas Unidas por Nuestros Desaparecidos de*

Nuevo León (FUNDENL) dhe *Por Amor A Ellos*. Që të dyja kanë si objektiv kërkimin dhe lokalizimin e të afërmeve të tyre dhe të të gjithë personave të humbur në shtetet respektive; për më tepër, ata ndërmarrin aksione për të ndryshuar imazhin e personave të humbur, për t'iu dhënë atyre komponentin njerëzor, nga i cili privohen kur flitet vetëm për statistikat dhe jo për personat e humbur.

Për Leticia Hidalgo, e cila është anëtare e FUNDENL-it dhe nëna e Roy Riveras – i humbur që nga 11 janari 2011 – është e qartë ata duhet: “të ndërjegjësojnë publikun rreth çështjes së personave të humbur, për të zhveshur kujtimin e tyre nga ngjyrat e kriminalizimit që autoritetet dhe disa media u kanë dhënë”. Për ta arritur këtë janë dashur përpjekje titanike nga ana e saj dhe e grupit, përpjekje që kanë përfshirë fushatat në rrjetet sociale për ta bërë publikun të shohë që personat e humbur janë njerëz shumë më të ngjashëm me ne nga sa mendojmë, pasi ata nuk janë kriminelë por njerëz të thjeshtë e mjaft pa fat që shkuan e u përballën me skenarin e dhunës dhe të pandëshkueshmërisë që lehtësoi zhdukjen e tyre.

Anëtarët e FUNDENL-it ekzekutuan një ushtrim kujtuese (dhe alfabetizimi) kur vendosën të përvetësojnë dhe ridizenjojnë një hapësirë publike në qytetin Monterrey të Nuevo León, që njihej me emrin “La Plaza de la Transparencia” (Sheshi i transparencës). Në atë shesh gjendej një monument i punuar në metal dhe xham ku filluan të vendosin emrat e të afërmeve të tyre të humbur me synimin që kur të ktheheshin, vetë ata të mund të hiqnin emrat nga ky monument. Sot ky vend njihet si “La Plaza de Los Desaparecidos” (Sheshi i Personave të Humbur) dhe monumenti u transformua në një hapësirë për kujtimin e tyre e ku është e mundur të shihen emrat e të gjithë njerëzve të humbur në Nuevo León.

Në Jalisco, Rosario Cervantes, një nga anëtarët e *Por Amor A Ellos*, është përballur gjithashtu me stigmën përreth zhdukjes së të birit Osvaldo Javier Hernández Cervantes – i cili u zhduk në 22 korrik të vitit 2014 - : “Nuk do të mund ta bëjmë shoqërinë të na ndihmojë për të afërmit tanë të zhdukur derisa të arrijmë ta bëjmë atë t'i shohë ata si të barabartë. Shumica e njerëzve besojnë ende atë që u thotë qeveria ose media për fëmijët tanë, si të përzier në disa punëra të errëta, por kjo nuk është e vërtetë”.

Organizatës *Por Amor A Ellos*, dhe përpara saj *Familias Unidas por Nuestros Desaparecidos*, i është dashur të ndërmarrë një numër masash për ta bërë veten të dukshme në hapësirën publike dhe të zerë vend në agjendën mediatike në Jalisco, e cila përpara krijimit të tyre në vitin 2012 nuk e kishte përparësi çështjen e zhdukjeve. Përpjekjet e tyre dhe marshimet e vazhdueshme të dielën e fundit të çdo muaji, ua kanë bërë të mundur të mbajnë gjallë denoncimet dhe kërkesat e tyre në hapësirat publike dhe mediatike.

Njësoj si FUNDENL-i, *Por Amor a Ellos* zuri një shëtitore në qendër të qytetit të Guadalajara-s dhe e shndërroi në “Pasillo de los desaparecidos de Jalisco” (Koridori i Personave të Humbur në Jalisco). Ata kanë kërkuar ndihmën e shoqërisë për të shkruar aty emrat e të afërmeve të tyre të humbur në kordele të gjelbra të cilat më pas varen nëpër pemë si dëshmi që Jalisco është shteti i dytë në Meksikë për sa i takon numrit të personave të humbur.

Shtegu ku kanë hyrë të dyja organizatat konsiston në ndërmarrjen e një strategjie me tre fronte: frontin politik, frontin ligjor dhe frontin mediatik.

- Fronti politik mbështetet nga pjesëmarrja e vazhdueshme në hapësirat publike për të manifestuar kërkesat e tyre. Përveç dhunimit të të drejtave të njeriut ata vuajnë edhe në proceset e veta të kërkimit.
- Fronti ligjor ka të bëjë me të mësuarit rreth ligjeve dhe gjenerimin e teksteve ligjore që synojnë gjetjen e burimeve ligjore që do t'u lejonin atyre akses nëpërmjet gjykatave të informacion të cilin autoritetet që hetojnë rastet e tyre ua mohojnë.
- Fronti mediatik ka dy akse; së pari, hartimin e dosjeve kërkimore me informacion rreth çdo personi të humbur, në mënyrë që të mund ta përhapin nëpërmjet rrjeteve sociale e të marrin ndonjë lloj informacion. I dyti është rritja e ndërgjegjësimit dhe fokusohet në përpjekjet për ta bërë publikun të shohë që zhdukjet “nuk janë diçka normale”, që personat e humbur “nuk janë kriminelë por njerëz”.

• Atyre u është dashur të bëjnë përpjekje të mëdha për të materializuar këtë pikë të fundit, sepse rrethanat e jetës i kanë detyruar ta edukojnë veten për sa i takon përdorimit të medias dhe teknologjive. Ata e kanë fituar këto dije nga që s'donin të lejonin që të jenë tjerët ata që ndërtojnë imagjinatën sociale të personave të humbur, sepse e dinë që po s'vëpruan, ekziston dhe mundësia që të fitojë versioni tjetër, ai i autoriteteve, që duan t'i shohin “zhdukjet” si çështje të rëndomta ose personale dhe jo si çështje publike, që kanë ardhur duke u agravuar pas dështimit të strategjisë mbi sigurinë që qeveria meksikane ka implementuar që nga viti 2000 në luftë kundër trafikut të drogës.

E drejta për të “qenë”, nga e cila janë privuar personat të zhdukur me dhunë, e drejtë e cila u është mohuar gjithashtu dhe nga organet publike dhe ligjore që duhet të udhëhiqnin kërkimin për ta, është objektivi që ndjekin organizata si FUNDENL dhe PAE. Këto familje, pavarësisht dhimbjes së tyre, janë hedhur me mish e me shpirt në veprim për ndryshim, të udhëhequr nga dashuria dhe shpresa, identiteti dhe imazhi social që projektohet sot mbi personat e zhdukur në Meksikë. Përpjekjet e tyre të përditshme e të guximshme për të folur rreth personave të humbur e për t'i portretizuar ata siç janë në të vërtetë, s'pajtohet me sensin e humbjes dhe dorëzimit që të tjerët kërkojnë t'u imponojnë kur e përqendrojnë diskutimin te vdekja por jo te drejtësia.

Dija për të rikonfiguruar imazhin social dhe mediatik të personave të humbur është detyrë urgjente për komunikatorët meksikanë dhe edukatorët pasi nuk është aspak e drejtë të vazhdohet përsëritja e “stigmës kriminalizuese” në media rreth afro 28,000 personave të humbur në Meksikë. Dija për të çrrënjësuar stigmën, parë nga këndvështrimi i Goffman-it (2010), do të ndihmojë të shpegohet se si shfaqet ky proces, proces i cili ka impakt – nëpërmjet raporteve asimetrike të fuqisë – mbi eliminimi e tipareve të tjetrit (të personit të humbur) e për t'i dhënë atij një karakteristikë të përgjithshme (atë të një krimineli).

Në këtë aspekt, Robledo (2015) shpjegon që “duke qenë se ky kuadër mungon, marrëdhëniet historike veprojnë si mbështetja e vërtetë për ekzistencën dhe vazhdimësinë e stigmës, e cila u mohon personave të humbur biografite dhe u jep atyre një sërë atributesh dhe shenjash sociale që janë të huaja për ekzistencën e tyre” (f.100).

Puna me programin e njohurive në media për të përmbysur këta mekanizma jo vetëm që është urgjente por gjithashtu e nevojshme në kontekstin aktual ku zhdukjet janë një nga dhunimet më serioze të të drejtave të njeriut që prekin Meksikën. Heqja e stigmës

së personave të humbur që ekziston në media dhe qëllimi social do të ndihmojnë për të kapërcyer “krizën e përfaqësimit” (Gatti, 2006) që vuajnë sot ata dhe familjet e tyre.

“Në kontekstin e luftës kundër drogës, që në fillimet e pranisë së tyre në arenën publike në vitin 2011, shumica e përpjekjeve të bëra nga familjet e personave të zhdukur ka konsistuar në kthimin e nderit të të dashurve të tyre dhe vënien në diskutim të diskurseve që i etiketojnë viktimat si dëme kolaterale, si pjesëmarrës ose bashkëfajtorë të konfliktit. Kjo përpjekje mbështetet nga qëllimi për të kapërcyer krizën e përfaqësimit që i ka zhveshur individët nga identiteti i tyre për të qenë mbartës të attributeve gjenerale që i desubjektivizojnë. Në këtë proces paraqitet një ligjëratë e dyfishtë fajësimi dhe viktimizimi; është fjala për një ligjërim që vë në rrezik pranimin e personave të zhdukur”. (Robledo, 2015; f.101)

Referenca

- CIDH (2015). *Informe Ayotzinapa. Recomendaciones generales en torno a la desaparición en México*. Washington: CIDH.
- Gatti, G. (2006). Las narrativas del detenido-desaparecido (o de los problemas de la representación ante las catastrofes sociales). *Confines*, 2, 27-38.
- Goffman, E. (2010). *Estigma: la identidad deteriorada*. Buenos Aires: Amarrortu Ley Federal de Telecomunicaciones y Radiodifusión (2014). Retrieved on March 21, 2014 from http://www.diputados.gob.mx/LeyesBiblio/pdf/LFTR_181215.pdf
- ONU (2013). *Informe Misión a México. Grupo de trabajo sobre desapariciones forzadas o involuntarias*. Mexico: ONU.
- Orozco, G. (2014). *Televidencias: Comunicación, Educación y Ciudadanía*. Mexico: UdeG.
- OSJI (2016). *Undeniable Atrocities: Confronting Crimes against Humanity in Mexico*. New York: Open Society Foundations.
- RNPED (2016). *Registro Nacional de Personas Extraviadas y Desaparecidas*. Retrieved on April 24, 2014 from www.rnped.gob.mx
- Robledo, C. (2015). El laberinto de las sombras: desaparecer en el marco de la guerra contral las drogas. *Revista de Estudios Políticos*, 23, 89-108.

Shënime

1. Është e rëndësishme të theksojmë që në të njëjtën ditë kur u zhdukën 43 studentët, studentët Daniel Solis Gallardo, Julio Cesar Mondragon Fuentes dhe Julio Cesar RamirezNava bashkë me tre njerëz të tjerë humbën jetën kur u qëlluan nga plumbat e policisë bashkiake të Iguales dhe Coculas.
2. Ky grup u krijua me kërkesën e regjistruar nga prindërit e 43 studentëve të IACHR-së, e në këtë mënyrë ky organ kreu një investigim të pavarur nga ai i shtetit mexikan. Qeveria mexikane i autorizoi këta ekspertë të kenë akses në informacionin e dosjeve gjyqësore për më shumë se një vit në mënyrë që ata të mund të jepnin perspektivën e tyre mbi rastin. Grupi publikoi dy raporte mbi rastin Ayotzinapa dhe iu desh të ndërpriste punën kur u përfundoi autorizimi në 30 prill 2015 dhe qeveria refuzoi t’ua zgjaste lejen për të vazhduar hetimin.

3. Analiza u zhvillua nga 1 tetori deri në 5 nëntor 2014.
4. Prezantuesit kryesorë në rrjetet kombëtare meksikane, López Dóriga nga Televisa dhe Alatorre nga Tv Azteca.

Ngritja e Urave: Fuqizimi i Qytetarëve Digjitalë për të Ngritur Komunitete Pozitive Online

Matthew Johnson

Ky dokument e sheh bullizmin në internet si çështje kulturore e gjithashtu personale në komunitetet online. Ai raporton rezultatet e një sondazhi të të rinjve kanadezë në hapësirat online në aspekte të ndryshme të bullizmit në internet, racizmit, seksizmit dhe ngacmimit. Sondazhi nxjerr gjithashtu në pah ndërhyrje të ndryshme për t'iu kundërvënë taktikave të tilla të ngacmimit. Ai sugjeron gjithashtu masa për të dhënë aftësi në njohuritë digjitale mes të rinjve për t'i zhvilluar ata si qytetarë të përgjegjshëm në epokën digjitale.

Fjalëkyç: komunitete online, fuqizim i të rinjve, bullizëm në internet, qytetar digjital, Kanada.

Fuqizimi i të rinjve

Media digjitale u ofron të rinjve mundësi unike për t'u angazhuar, për të folur, e për të sjellë ndryshime si në rrjet ashtu edhe jashtë tij. Ndonëse të rinjtë kanadezë besojnë që hapësira online duhet të jetë e lirë nga racizmi, seksizmi dhe ngacmimet (Steeves, 2014), shpesh ata ngurojnë të flasin kundër paragjykimeve dhe bullizmit online (Craig, 2014). T'i ndihmohet të rinjtë të kuptojnë të drejtat e tyre – si konsumatorë, si anëtarë të një komuniteti, si qytetarë dhe si qenie njerëzore – ka një rëndësi kritike për t'i bërë ata të aftë të përballen me bullizmin, gjuhën e urrejtjes dhe ngacmimet online. Prandaj, kur hartojmë përkufizimet e njohurive digjitale dhe qytetarisë digjitale, është e rëndësishme të kujtojmë që qytetaria sjell me vete jo vetëm përgjegjësi, por edhe të drejta.

Deri kohët e fundit, shumica e përpjekjeve për njohuri digjitale dhe qytetari digjitale janë fokusuar kryesisht për t'u mësuar të rinjve se si të mbrohen online. Ky fokus mbi sigurinë fëmijëve ka qenë me ndikim të jashtëzakonshëm për një numër arsyesh: së pari, shumica e programeve edukative janë ofruar ose janë zhvilluar në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit; (Jones, Mitchell & Walsh, 2012); së dyti, përmbajtja e këtyre programeve ka krijuar perceptimin, kryesisht si rezultat i raportimeve në media, që mjediset digjitale janë në veçanti të rrezikshme krahasuar me hapësirat jashtë rrjetit (Roberts & Douai, 2012); së treti, një tendencë kulturore drejt “juvencia” – term ky i shpikur nga David Finkelhor nga Qendra Kërkimore për Krimet Kundër Fëmijëve për

të përshkruar “një frikë të ekzagjeruar rreth ndikimit të ndryshimeve sociale mbi fëmijët dhe të rinjtë” (Finkelhor, 2012). Mbulimi mediatic i bullizmit në internet ka ndjekur një model të ngjashëm, duke u fokusuar shpesh mbi rastet më sensacionale dhe ekstreme dhe duke i portretizuar ato si epidemi (Ferguson, 2013); si rezultat, shkollat dhe ligjvënësit janë përgjigjur shpesh me masa dorështrënguar që synojnë kriminalizimin e çdo sjelljeje që mund të quhet me atë emër. Studentët, nga ana tjetër, shpesh u kanë thënë studjuesve që bullizmi në internet është më pak problem nga sa e perceptojnë të rriturit (Steeves, 2014) – ndonëse edhe ata, në shumë raste, e vlerësojnë atë më shumë nga sa është në të vërtetë (Hinduja & Patchin, 2012).

Çështja e bullizmit në internet

Për ta kuptuar plotësisht bullizmin në internet duhet ta shohim jo vetë si çështje *kulturore* por gjithashtu dhe personale, e cila ka të bëjë si me vlerat e perceptuara të hapësirave që zënë të rinjtë, po aq edhe me marrëdhëniet personale midis autorit të bullizmit dhe objektivit të tij. Hulumtimi i MediaSmart-it gjeti që në shumica e rasteve arsyeja që jepej për sjelljet e këqija online ishte “Po bëja shaka”, e cila mund të mbështesë ndjesinë e shprehur shpesh nga të rinjtë sipas të cilëve shumë nga ato që të rriturit i perceptojnë si “bullizëm”, në të vërtetë s’janë veçse ngacmime pa zarar. Tre të katërtat e nxënësve binin dakort me pohimin që “ndonjëherë prindërit ose mësuesit quajnë bullizëm kur fëmijët në të vërtetë thjesht po bënin shaka”. (Interesante është që ata nxënës që kishin provuar ose kishin qenë pre e kërcënimeve online ose e ngacmimeve, kishte më shumë gjasë të ishin dakort) (Steeves, 2014). Ndonëse studimi ynë zbuloi që relativisht pak nga ngacmimet e bëra online i referoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë racës, besimit, etnicitetit ose orientimit seksual (Steeves, 2014), studimi tregoi që qenia anëtar i një grupi me disavantazhe ose minoritet, si për shembull nga një familje me të ardhura të pakta (Cross, Piggan, Vonkaenal-Platt & Douglas, 2012), me paaftësi (Livingston, 2011), anëtar i një grupi minoritar (Craig, 2014), apo me status LGTB (Hinduja & Patchin, 2011), u jep të rinjve më shumë gjasa të bëhen target i kërcënimeve dhe ngacmimeve online. Edhe pse autori i bullizmit nuk është se i zgjedh në mënyrë të ndërgjegjshme targetet e pambrojtur, një kulturë që normalizon konfliktin online mund të jetë mjedisi më toksik për të disavantazhuarit ose të marginalizuarit; edhe kur konflikti online është reciprok, nëse njëri nga njerëzit e përfshirë është më i pambrojtur shpesh kjo mund të çojë fare lehtë në situata që shihen si “thjesht po bëja shaka” nga njëra palë, ndërkohë që për tjetrin janë vëtetë të dhimbshme.

Termi i përdorur më shpesh në kulturën e të rinjve për të përshkruar një konflikt mes dy personave (në rrjet ose jashtë tij) është termi “dramë”, të cilën të rinjtë e dallojnë nga bullizmi ose forma të tjera të konfliktit, sepse ai “mjegullon dallimin midis seriozes dhe mendjelehtësisë, gjithashtu midis asaj që është thjesht një shaka dhe asaj që lëndon vërtetë” (Marwick & Boyd, 2011). Ky koncept është i përfaqësuar mirë në studimin tonë, qoftë si një arsye për të ngacmuar të tjerët – mbas “thjesht po bëj shaka”, dy arsyet e tjera më të zakonshme për të sulmuar dikë në internet ishin “ai/ajo u soll keq me mua” dhe “ai/ajo u soll keq me shokun/shoqen tim/e” (Steeves, 2014) – edhe për të mos ndërhyrë: rreth gjysma e

nxënësve thanë që nuk ndërhyj sepse nuk e “nuk e di nëse është ndonjë teatër ose bullizëm” (48% e atyre që nuk kanë qenë target, 56% e atyre që kanë qenë target) (Craig et al., 2014).

Marwick dhe Boyd vënë në dukje se ‘drama’ mund të jetë një konstrukt me vlerë si për objektivin ashtu edhe për autorin e bullizmit në internet: “Shpërfillja e konfliktit duke e parë atë si thjesht një dramë, u lejon të rinjve të fusin dinamikat sociale dhe impaktin emocional brenda një kornize që i karakterizon si të parëndësishme, duke i lejuar kësajose të “shpëtojnë faqen” në vend që të veshin mantelin e bullit ose të viktimës” (Marwick & Boyd, 2011). E njëjta gjë vlen edhe për dëshmitarët: në qoftë se një situatë nuk është bullizëm por dramë, ata ndjehen të çliruar nga detyrimi për të vepruar, faktor ky për thuhet se 90 % të nxënësve që morën pjesë në sondazh (Craig et al., 2014). Një kulturë që toleron bullizmin – qoftë në mënyrë eksplicite ose duke e përkufizuar atë si dramë – është ndoshta arsyeja pse gjysma e nxënësve të sondazhit tonë zgjedhin të mos ndërhyjnë, duke patur frikë që ndërhyrja mund t’i përkeqësojë gjërat për objektivin (numër që u rrit në 59% për ata që ishin bërë vetë objektivi kohët e fundit) dhe pse dy të tretat nuk ndërhyjnë ngaqë kanë frikë se kjo mund t’i bëjë ata vetë target (Craig et al. 2014).

Ndoshta nuk duhet habitur, por strategjia më e preferuar nga të rinjtë në sondazhin tonë ishte për tu larguar tërësisht nga sfera publike, duke e ngushëlluar objektivin në mënyrë private (77% e nxënësve thanë se kjo do ishte e dobishme) (Craig et al., 2014). Ka një numër arsyesh pse kjo mund të jetë strategji me vlerë – studimet për bullizmin jashtë rrjetit kanë treguar që shprehja në mënyrë private e mbështetjes mund të jetë po aq efektive, ose madje edhe më shumë, se ndërhyrjet aktive për lehtësimin e efekteve negative të bullizmit (Davis & Nixon, 2013) – por preferenca e fortë për të sugjeron gjithashtu që të rinjtë preferojnë strategjitë jo publike edhe sepse nuk ndejnë ndonjë presion social për të zgjedhur ato publike: thuhet se tre të katërtat e të rinjve të sondazhit (73%) thanë se do të ndërhyjnë në qoftë se “të tjerët do më respektonin për atë që do të bëja” (Craig et al. 2014). Kjo i shton një dimension të rëndësishëm zbulimeve që kur të rinjtë besojnë se sjellja e bullizmit është normë dhe që ajo ka përfitime sociale, ka më shumë gjasa ta manifestojnë atë dhe ta tolerojnë – por kur të rinjtë bëhen të ndërgjegjshëm se sa i pazakontë është në të vërtetë bullizmi, atëherë shifrat e bullizmit bien (Craig & Perkins, 2008). Ndërkohë që duhet t’u mësojmë të rinjve se si të bëhen dëshmitarë aktivë të bullizmit dhe të formave të tjera të ngacmimit në internet, një strategji gjithëpërfshirëse për trajtimin e konflikteve online duhet të marrë parasysh të gjitha kulturat. Për ta bërë këtë duhet të krijojmë lidhjen midis bullizmit në nivel individual dhe hapësirave më të gjera armiqësore online, duke përfshirë madje në të edhe gjuhën e urrejtjes.

Sikurse me bullizmin, duket se të rinjtë kanadezë kanë mjaft besime kontradiktore rreth asaj se sa lënduese është një përmbajtje raciste dhe seksiste. Numri më i madh pranuan që “njerëzit thonë gjëra raciste dhe seksiste për të sharë njerëz të tjerë” (69%), por një numër i rëndësishëm (52%) mendonte se “njerëzit thonë gjëra raciste dhe seksiste nga që janë të pandjeshëm dhe, jo sepse duan të lëndojnë dikë”. (Natyrisht, është e mundur që të dyja këto të jenë të vërteta në raste të ndryshme.) Kur u pyetën se si mendojnë ata që njerëzit duhet të reagojnë ndaj racizmit ose seksizmit online, 78 % pranuan që “është e rëndësishme të thuhet diçka në mënyrë që njerëzit ta dinë që është e gabuar”, por 45% mendonin që “është gabim, por nuk më takon mua të them ndonjë gjë”. Kishte një dallim të ndjeshëm midis nxënësve të rinj, të cilët deri diku ishin me të prirur të pranonin pohimin e parë (82% e nxënësve të klasave të shtata krahasuar me 77% të nxënësve të klasave të

njëmbëdhjeta), dhe shumë më pak prireshin të pranonin pohimin e dytë (37% e atyre në klasë të shtatë krahasuar me 50% të atyre në klasë të njëmbëdhjetë) (Steeves, 2014). Ky rezultat është në njëfarë mënyre surprizë, sepse dikush mund të presë që adoleshentët, më shumë se nxënësit e rinj, të ndjehen më të prirur e të autorizuar për të folur; një shpjegim i mundshëm për këtë është që ndërsa nxënësit e rinj e shpenzojnë kohën në mjedise online të populluar kryesisht me moshatarë të tyre, më të rriturit shpenzojnë më shumë kohë në mjedise të përbashkëta me të rinj më më mëdhenj se ata në moshë dhe adultë, si për shembull në lojrat me shumë lojtarë (Steeves, 2014).

Përmbajtja raciste

Djemtë dhe vajzat ndeshen me përmbajtje raciste dhe seksiste thuajse në të njëjtat raporte (djemtë ka të ngjarë ta shohin këtë pak më shumë se një herë në ditë ose një herë në javë, vajzat diçka më shumë se një herë në muaj ose një herë në vit, dhe gjasa për të dyja palët që të mos e kenë hasur asnjëherë është e njëjtë) por ndërsa djemtë ndeshen me përmbajtje të tillë më shpesh, duket se vajzat preken më shumë prej saj: në thelb më shumë vajza (57% krahasuar me 34% të djemve) thonë që shakatë raciste dhe seksiste i lëndojnë ndjenjat e tyre, dhe shumë më pak vajza (36% krahasuar me 52% të djemve) thonë që ato dhe mikeshat e tyre i thonë njëra tjetrës gjëra raciste ose seksiste thjesht për tu argëtuar (Steeves, 2014). Kjo mund të shpjegohet me faktin që shumica e hapësirave online që frekuentohen nga të rinjtë – në veçanti lojrat me shumë lojtarë – karakterizohen nga një fjalor tejet agresiv dhe shpesh racist, mizogjinist dhe homofobik (Gray, 2012): në një studim është konstatuar që duke luajtur *Halo 3* me zë femëror dhe emër të identifikueshëm si femër, çonte në tre herë më shumë komente negative se kur ajo luhej me zë mashkullor dhe emër të identifikueshëm si mashkull ose pa zë dhe me një emër neutral. Ka patur gjithashtu rritje të lëndës online të mbushur me urrejtje drejtuar veçanërisht kundër grave, dhe, njësoj si format e tjera të urrejtjes, retorikat e saj mund të influencojnë në kulturën e hapësirave të tendencës (Gerstenfeld, Grant & Chiang, 2003) – gjë e cila mund të shpjegojë pjesërisht gjetjen tonë që ka më pak të ngjarë që vajzat ta shohin Internetin si vend të sigurt krahasuar me djemtë (Steeves, 2014). Disa prej këtyre rasteve mund të kenë profil të lartë, si për shembull sulmet mbi kritiken Anita Sarkeesian mbasi lançoi një fushatë online për financimin e një serie me video që bënin fjalë për seksizmin në videolojra (Zerbisias, 2013), por edhe gratë që nuk janë figura publike tërheqin armiqësinë online. Ndonëse shumica e mizogjinisë online nuk ka lidhje me grupet tradicionale të urrejtjes, ajo mbështetet në të njëjtat “ideologji” të urrejtjes si tjetërsimi dhe dehumanizimi i grupit target dhe portretizimi i grupit të urrejtjes si viktimë (Rowland, 2008), dhe në mënyrë të ngjashme u drejtohet të rinjve – në veçanti djemve dhe burrave të rinj në moshë – të cilët ndjehen të izoluar nga shoqëria (Blazak, 2001).

Në mënyrë që të mund të përballen me këtë lloj përmbajtje, të rinjtë duhen edukuar rreth dëmeve që sjellin përmbajtje që kanë brenda urrejtje, qoftë kjo e bazuar mbi racën, besimin, gjininë, orientimin seksual ose ndonjë tjetër terren. Ata duhen pajisur gjithashtu me aftësitë e nevojshme për njohuri digjitale dhe mediatike në mënyrë që të njohin kur një mesazh përmban urrejtje – për shembull të kuptojnë treguesit e një argumenti të bazuar

mbi urrejtjen – si dhe të njohin e dekodifikojnë teknika të ndryshme bindëse të përdorura nga grupet e urrejtjes për të formuar solidaritetet në grup e për të rekrutuar besimtarë të rinj, teknika si keqinformimi (Meddaugh & Kay 2009), mohimi dhe revizionizmi (Mcnamee, Peterson & Pena, 2010) gjithashtu edhe pseudoshkenca (Meddaugh & Kay 2009). (Një studim i vitit 2003 raporton që kur studentëve të vitit të parë të një universiteti iu kërkua të vlerësonin në mënyrë kritike adresën e internetit *martinlutherking.org*, adresë e rreme e krijuar nga grupi i urrejtjes Stormwatch, pothuajse asnjëri nuk ishte në gjendje të kuptonte që ishte i njëanshëm ose të identifikonte këndvështrimin e autorit të saj (Gerstenfeld, Grant & Chiang, 2003); njëri nga mësuesit në studim raportoi një përvojë të ngjashme me nxënësit e një shkolle të mesme kanadeze, (Seeves, 2014). Kjo është arsyeja pse MediaSmart ka përshtatur një qasje gjithëpërfshirëse, e cila pranon që aftësitë e ndryshme që përbëjnë njohuritë digjitale nuk mund të veçohen plotësisht (Johnson, 2015). Në trajtimin për shembull të materialeve online të urrejtjes, të rinjtë duhet jo vetëm të jenë në gjendje të njohin dhe të dekodifikojnë përmbajtjen (e cila do të përfshihej në kategorinë tonë të aftësive për të gjetur dhe verifikuar), por gjithashtu edhe të kuptojnë nëse janë apo jo anëtarë të grupit target; të kuptojnë si do të prekte ajo përmbajtjedikëqë tërhiqej nga aftësitë e etikës dhe ndjeshmërisëdhe të zhvillojë aftësitë e angazhimit në komunitet – të njohë të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë për zgjidhjen e situatës brenda ligjeve kanadeze dhe ndërkombëtare – për të vendosur se si të përgjigjet.

Megjithatë, për t'i dhënë përgjigje urrejtjes dhe ngacmimit online, të rinjtë jo vetëm që duhen trajnuar me aftësi të posaçme në dijet digjitale, por duhet të aftësohen për të folur dhe ushtruar të drejtat e tyre të plota si *qytetarë* digjitalë. Ndonëse termi qytetari digjitalë është një term kuptimi i saktë i të cilit është ende në evoluim e sipër (Collier, 2010), ajo që mund të ketë më shumë vlerë se hartimi i përkufizimit të saktë është qasja drejt saj si *rezultat* ideal i edukimit me njohuri digjitale, si dhe ta shohësh atë në terma jo thjesht të përgjegjësive por edhe të të *drejtave* të qytetarit digjital. Kjo qasje siguron një lidhje thelbësore midis mësimi të të rinjve se ç'mund të bëjnë për të influencuar vlerat në hapësirat e tyre në internet dhe jashtë tij dhe ndërgjegjësimit për ta bërë këtë në jetë. Kanadezët e rinj duhet të dinë që kur futen në internet nuk kanë hequr dorë nga të drejtat dhe, në fakt, mund të kenë të drejta për të cilat as nuk janë të ndërgjegjshëm. Për shembull, Karta Kanadeze për të Drejtat dhe Liritë dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve u sigurojnë të rinjve të drejtat esenciale të privatësisë, të shprehjes së lirë, të edukimit dhe aksesit në informacion, si dhe që të jenë të lirë nga diskriminimi, frika, dhuna dhe ngacmimet. Në qoftë se të rinjtë nuk janë të ndërgjegjshëm për këto të drejta, ata mund të zgjedhin që të mos angazhohen plotësisht me median digjitale, gjë që mund të sjellë ngushtim të oportuniteteve dhe, si rezultat tjetër ironik, nivele më të ulta në aftësitë për të besuar, për të qenë elastikë dhe të sigurt (Third, 2014).

Qytetaria Digjitale

Qytetaria digjitale mund të përfshijë përdorimin e mediave digjitale për tu angazhuar me çështje të komunitetit lokal ose politika shtetërore, dhe mund ta zgjerojë fokusin e vet deri te tarifat e studimit (Sifry, 2010), ose ta ngushtojë jo më larg se cilësia e ushqimit në shkollë (Toppo, 2013): studimi ynë zbuloi që 35 % e të rinjve kanadezë ishin bashkuar ose

kishin mbështetur një grup aktivistësh online të paktën një herë (Steeves, 2014). Qytetaria digjitale mund të fokusohet sidomos te ndikimi i komuniteteve online, për fushata të tilla si ato që synojnë përmirësimin e klimës së mediave sociale (Bolt, 2012). Për shkak të natyrës korporative të thujasë të gjitha mjediseve online që frekuentohen nga të rinjtë (vetëm njëra nga dhjetë adresat në Internet në krye të listës së adresave që frekuentohen nga të rinjtë kanadezë, Wikipedia, nuk është në zotërim të një korporate për qëllime fitimi) (Steeves, 2014), është gjithashtu e rëndësishme që në përkufizimin e qytetarisë digjitale të përfshijmë edhe aktivizmin e konsumatorit. Kjo ka të bëjë me pranimin e natyrës korporative të shumicës së “komuniteteve” online dhe të “hapësirave publike”, si dhe me të kuptuarit e të drejtave që zotërojnë të rinjtë si konsumatorë dhe si t’i ushtrojnë ato, përfshirë këtu përdorimin e mekanizmave të ankimimit në platforma dhe organizimin e fushatave për presion publik (të tilla si përpjekja për ta bërë Facebook-un më reagues ndaj ankesave për materiale që përmbajnë urrejtje). (Chemaly, 2013)

Pavarësisht nëse e shohim bullizmin kibernetik në nivel personal apo në nivelin makro të mjediseve armiqësore e të mbushur me materiale që përmbajnë urrejtje, duhet të adresojmë kulturat që normalizojnë ligësinë dhe mizorinë në internet. Lajmi i mirë është që kjo është e mundur: hapësirat online që kanë hedhur hapa për krijimin e kulturave ku nuk tolerohen racizmi dhe seksizmi kanë patur sukses dhe i kanë bërë ngacmimet më pak të zakonshme (Hudson, 2014). Megjithatë, në mënyrë që të arrihet kjo, përdoruesit – sidomos të rinjtë të cilët përbëjnë pjesën demografike më me vlerë – duhet ta kërkojnë atë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme t’i ndihmojmë të rinjtë të kuptojnë se kanë të drejtën dhe fuqinë të ndryshojnë kulturat në të cilat normalizohen këto sjellje – në veçanti në hapësirat online, ku të rinjtë janë në gjendje të marrin pjesë si qytetarë të plotë për të zhvilluar normat dhe vlerat si dhe për të ndikuar mbi to. Në qoftë se i fuqizojmë të rinjtë për të influencuar në kulturat e tyre online në mënyrë që respekti të bëhet normë, mund t’u japim dëshmitarëve forcën të hidhen në veprim – dhe ndoshta t’i bëjmë më të sigurta format më të drejtpërdrejta të ndërhyrjes (ndonëse do të ketë gjithmonë situata kur ndërhyrjet indirekte janë ide më e mirë). Të rinjtë duhet të dinë gjithashtu që duke folur mund të arrijnë të bëjnë ndryshime: studimi ka treguar që sikur edhe vetëm dhjetë përqind e anëtarëve të një grupi të ketë besim të patundur, ky besim do të përhapet edhe te shumica (Xie, J., et al. 2011). Në fakt, të rinjtë mund të influencojnë vlerat e kulturave të tyre edhe në qoftë se nuk e kapërcejnë atë kufi: studime të tjera kanë gjetur që anëtarët e një grupi ka shumë më pak të ngjarë të pajtohen me qëndrimet e grupit sikur edhe një i vetëm ndër ta të shprehë një opinion të ndryshëm (Dean, 2010). Në qoftë se mund t’i ndihmojmë të rinjtë të kuptojnë që kanë të drejtën e hapësirave online të lira nga ngacmimi dhe diskriminimi, dhe t’u mësojmë atyre si të përdorin mjetet digjitale në dispozicion për ta bërë zërin e tyre që të dëgjohet, mund t’i aftësojmë për kulturat në internet dhe jashtë ku jo vetëm nuk kanë frikë por respektohen sepse ngrënë zërin kundër bullizmit dhe paragjykitimit.

Referenca

Blazak, R. (2001). White Boys to Terrorist Men: Target Recruitment of Nazi Skinheads. *American Behavioral Scientist*, 44(6): 982-1000.

- Boldt, M. (2012). Osseo High-Schooler Battles Taunts with Tweets. Marrë nga http://www.twincities.com/education/ci_21656149/osseo-high-schooler-battles-taunts-tweets.
- Chemaly, S. (2013). An Open Letter to Facebook. The Huffington Post, May 21
- Collier, A. (2010). Why digital citizenship's a hot topic [Web log post]. Marrë nga <http://www.netfamilynews.org/why-digital-citizenships-a-hot-topic-globally>
- Craig et al. (2014). Young Canadians' Experiences with Online Bullying. Ottawa: MediaSmarts.
- Craig, D. W., and Perkins, H. W. (2008). Assessing Bullying in New Jersey Secondary Schools: Applying the Social Norms Model to Adolescent Violence. National Conference on the Social Norms Approach. Marrë nga: <http://www.youthhealthsafety.org/BullyNJweb.pdf>
- Cross, E.J., Piggan, R. Vonkaenal-Platt, J. and Douglas T. (2012). Virtual Violence II: Progress and Challenges in the Fight against Cyberbullying. London: Beatbullying.
- Davis, S., and Nixon, C. (2013). Youth Voice Project: Student insights into bullying and peer mistreatment.
- Dean, J. (2010). Conformity: Ten Timeless Influencers [Web log post]. Marrë nga <http://www.spring.org.uk/2010/02/conformity-ten-timeless-influencers.php>
- Ferguson, Christopher J. (2013). Adolescents, Crime, and the Media. Springer
- Finkelhor, D. (2012). The Internet, Youth Safety and the Problem of 'Juvenoa.' Durham, NH: Crimes Against Children Research Center. Marrë nga: <http://www.unh.edu/ccrc/pdf/Juvenoa%20paper.pdf>.
- Gerstenfeld, P. B., Grant, D. R., & Chiang, C. (2003). Hate Online: A Content Analysis of Extremist Internet Sites. *Analyses of Social Issues and Public Policy Analyses Soc Iss & Publ Pol*, 3(1): 29-44.
- Gray, K. L. (2012). Deviant bodies, stigmatized identities, and racist acts: Examining the experiences of African-American gamers in Xbox Live. *New Review of Hypermedia and Multimedia*, 18(4): 261-276.
- Hinduja, S., and Patchin, J. (2011) 'Cyberbullying Research Summary Factsheet: Bullying, Cyberbullying and Sexual Orientation.'
- Hinduja, S., and Patchin, J. W. (2012). *School climate 2.0: Preventing cyberbullying and sexting one classroom at a time*. Thousand Oaks: Corwin Press
- Hudson, L. (2014). *Curbing Online Abuse Isn't Impossible. Here's Where We Start*. *Wired*, May 15.
- Johnson, M. (2015, March 31). *Use, Understand and Create: Towards a Comprehensive Canadian Digital Literacy Curriculum* [Web log post]. Marrë nga <http://mediasmarts.ca/blog/use-understand-create-towards-comprehensive-canadian-digital-literacy-curriculum>
- Jones, L. M., Mitchell, K. J., and Walsh, W. A. (2012). *Evaluation of Internet Child Safety Materials Used by ICAC Task Forces in School and Community Settings, Final Report (Rep.)* Durham, NH: Crimes Against Children Research Center, 201 2. <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/242016.pdf>.
- Livingstone, S., et al. (2011) *EU Kids Online Final Report*.
- Marwick, A. and Boyd, D. (2011). *The Drama! Teen Conflict, Gossip, and Bullying in Networked Public. A Decade in Internet Time: Symposium on the Dynamics of the Internet and Society*.
- McNamee, L. G., Peterson, B. L., and Pena, J. (2010). A Call to Educate, Participate, Invoke and Indict: Understanding the Communication of Online Hate Groups. *Communication Monographs*, 77(2): 257-280.
- Meddaugh, P. M., and Kay, J. (2009). Hate Speech or "Reasonable Racism?" The Other in Stormfront. *Journal of Mass Media Ethics*, 24(4): 251-268.
- Roberts, S., and Douai, A. (2012). Moral Panics and Cybercrime: How Canadian Media Cover Internet Child Luring. *Journal of Canadian Media Studies*, 10(1).
- Rowland, R. C. (2008). The Symbolic DNA of Terrorism. *Communication Monographs*, 1(75): 52-85.

- Sifry, M. L. (2010). Children's Crusade: A Primer on How Britain's Students Are Organising Using Social Media. *TechPresident*. Marrë nga: <http://techpresident.com/blog-entry/childrens-crusade-primer-how-britains-students-are-organising-using-social-media>.
- Steeves, V. (2014). *Young Canadians in a Wired World, Phase III: Encountering Racist and Sexist Content Online* (Rep.). Ottawa: MediaSmarts.
- Third, A. (2014). Children's Rights in the Digital Age: A Download from Children Around the World (Rep.). Melbourne: Young and Well Cooperative Research Centre.
- Toppo, G. (2013). Kids Upload and Unload on School Cafeteria Lunches. USA Today. Marrë nga <http://www.usatoday.com/story/news/nation/2013/12/02/school-lunch-photos/3784625>
- Xie, J., et al. (2011). Social consensus through the influence of committed minorities. *PhysicalReview E Phys. Rev. E*, 84(1).
- Zerbisias, A. (2013). Internet trolls an online nightmare for young women. The Toronto Star. January 18

Punëtorët migrues pa Fuqi Mediatike

Li Xiguang, Wu Yanmei, Sun Lizhou & Sidra Tariq Jamil

Bazuar në analizat e dy ngjarjeve të lidhura me punëtorët migrues (njëri rast është ai i një punëtori migrues i cili vdiq mbasi kërkoi t'i jepej rroga në Shanxi; rasti tjetër është i disa punëtorëve migrues në provincën Sichuan, të cilët dolën përpara gjykatës publike sepse kërkuan rrogat), autorët e këtyre artikujve përshkruajnë luftën mes pushtetit qeveritar, korporatave, punëtorëve migrues dhe organizatave mediatike. Ky artikull diskuton gjithashtu përpjekjet e përbashkëta të qeverisë dhe të korporatave mbrapa marginalizimit të migruesve dhe mungesës së fuqisë së tyre në media

Fjalëkyç: punëtorë fshatarë, të drejta të njeriut, pushtet mediatik, punëtorë ruralë migrues.

Preludi dhe Perspektiva Historike

Mbas implementimit në vitin 1978, të sistemit të përgjegjësive familjare në Kinë, një numër i madh fshatarësh u zhvendosën në qytete, duke punuar në ndërtim, fabrika dhe në industrinë e shërbimeve. Ata u bënë punëtorë urbanë me regjistrim familjar rural. Nga njëra anë, këta punëtorë migrues zotërojnë toka në qytetet e origjinës në zonat rurale, nga ata tjetër, ata jetojnë dhe punojnë në qytete, kështu, studjuesit e zakonshëm kinezë dhe media i quan “punëtorë fshatarë”.

Si të huaj në qytet, punëtorët migrues përballen me pabarazi përse i përket të drejtave të njeriut. Për shkak të sistemit të regjistrimit të familjeve në Kinë, ata duan fort të ruajnë identitetin si fshatarë pa garanci punësimi pavarësisht se punojnë dhe jetojnë në qytet. Pabarazitë mund të krijohen në shumë aspekte, si kushtet e punës, të banimit, edukimi, kujdesi shëndetsor, mirëqenia, etj. Këto pabarazi bëhen molla e sherrit dhe prekin thuajse të gjitha aspektet e jetës së tyre (Yu, 2010). Ajo çka është më serioze, sistemi i regjistrimit të familjeve (sistemi Hukou) që bazohet në strukturën duale urbane-rurale është bërë shkaku themelor për vonesat e pagave të tyre nga korporatat. Ky sistem dual ka ruajtur identitetin social të punëtorëve migrues në vend që t'i kthejë plotësisht në punëtorë urbanë. Ky sistem rezulton në disa rutina mjaft speciale, si asnjë pagesë mujore – pagesat bëhen në fund të çdo viti ose kur ata donin të ktheheshin në shtëpi, ose vonesa për një pjesë ta pagave për shkak të kushteve të këqia të biznesit (Li, 2011). Të tilla fakte ishin të volitshme për vonesat dashakeqe të ndërmarrjeve në pagesa.

Ky dallim në të drejta shkaktoi stres të jashtëzakonshëm dhe probleme shëndetsore për punëtorët migrues. Një sondazh zbuloi se 63% e punëtorëve migrues ishin në rrezik të ëvuanin nga sëmundje mendore (Wong & Li & Song, 2007) mbasi shqetësoheshin për pagesat, nuk kishin kohë të pushonin, përballeshin me trajtim të padrejtë dhe nuk kishin ndjesinë e sigurisë financiare.

Gjeneza e Problemit

Në çështjet e të drejtave civile dhe të drejtave njerëzore të punëtorëve migrues janë tre forca madhore: punëtorët migrues, autoritetet qeveritare dhe ndërmarrjet që punësojnë punëtorët migrues. Që nga fillimi i “Reformës dhe i Hapjes”, reforma ekonomike e Kinës u bazua në futjen e kapitalit dhe fuqizimin e marrëdhënieve të kapitalit, por strukturat e punësimit treguan fenomene si kapitali i fuqishëm dhe krahu i dobët i punës. Në rastet e mosmarrëveshjeve në punë, rrallë herë fitonin punëtorët migrues. Kur i drejtoheshin qeverisë dhe kanaleve ligjore, gjërat nuk shkonin gjithmonë mbarë (Li, 2011). Prandaj media u bë qasja e fundit për punëtorët migrues për të kërkuar drejtësi dhe forca e katërt që mund të ketë efektin e vet në çështjen e të drejtave të punëtorëve migrues. Në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, media luan një rol të ndryshëm krahasuar me atë të qeverisë, ndërmarrjes dhe punëtorëve migrues. Mediat janë spektatorë dhe në të njëjtën kohë ato bëhen palë në formimin e ndërgjegjes sociale dhe politike lidhur me punëtorët migrues, duke i “Dhënë – Kuptim” (Harley, 1996) evolucionit të strukturës sociale dhe sistemit të migruesve ruralë në Kinë. (Sun, 2014)

Ndonëse është shpresa e fundit për mbrojtjen e të drejtave të tyre, jo gjithmonë media është shpëtimtare e punëtorëve migrues. Në fakt, duke u përballur me kontrollin e qeverisë mbi opinionin publik, kapitalizimin e medias dhe ndërgjegjen e barazisë dhe drejtësisë sociale, media është vënë në një pozicion të komplikuar dhe ka patur qëndrime kontradiktore.

Në fillim të viteve 1980, mbas implementimit të plotë të sistemit të përgjegjësive familjare, një numër i madh punëtorësh rural të tepërt u spostuan drejt qyteteve dhe gllabëruan punët e vështira që punëtorët urbanë nuk dëshironin t'i bënin. Kjo ishte vala e parë e fshatarëve që u zhvendosën në qytete mbas fillimit të “Reformës së Hapjes”.

Roli i Medias në Ndërtimin e Perceptimeve

Media i përshkruante këta punëtorë migrues si “pa cilësi” dhe “dritëshkurtër”, si “njerëz që lëvizin qorrazi”. “Tronditja numër një e Kinës në vitin 1989” botuar nga *China Youth Daily* ishte një nga raportet më të hershëm që analizonte në thellësi temën e baticës së punëtorëve migrues”. Ky raport ngrinte “çështjen e punëtorëve fshatarë” si një problem për krahun e tepërt rural të punës dhe punëtorët migrues i portretizonte si “fluksi i verbër” në sytë e qytetarëve urbanë: punëtorët rreckamanë migrues ishin shkaku i mbipopullimit urban dhe ndikonin keqazi mbi sigurinë e qytetit. (Sun, 2011) Mund të themi që mediat kryesore në kuadrin e pozitës binare urbane dhe rurale krijuan konceptin e “punëtorëve

migrues.” Nga njëra anë qëllimisht mediat kryesore theksonin përmirësimet që ishin bërë në jetën e punëtorëve migrues në sajë të Reformës dhe Hapjes; nga ana tjetër, linin të nënkuptoheshin dallimet në identitet midis qytetarëve urbanë dhe punëtorëve migrues, si dhe krijuan imazhin e punëtorëve migrues si shtresa më e ulët e shoqërisë.

Në vitin 2003 u rritën me shpejtësi raportimet rreth punëtorëve migrues që kërkonin pagat e prapambetura dhe mbronin të drejtat e tyre në punë, kjo për shkak të zgjimit të profesionalizmit në gazetari dhe nevojës së qeverisë për ndërtimin e një shoqërie harmonike nën lidhshimin e Hu Jintao-s. (Luo, 2010) Në vitin 2003 në Chongqing, një fshatare me emrin Xiong Deming i kërkoi një drejtuesi të qeverisë kineze që kishte shkuar për vizitë në Chongqing të ndihmonte të shoqin për të zgjidhur problemin e rrogave të prapambetura. Mbasi Agjencia e Lajmeve Xinhua raportoi këtë ngjarje, punëtorët migrues lançuan një “furtunë kombëtare në kërkim të pagave”. Sipas statistikave relevante në fund të vitit 2003, pagat e prapambetura në shkallë vendi për punëtorët migrues ishin 100 miliardë Yuan; raporti i rrogave të papaguara në kompanitë e ndërtimit arrinte në 72.2%. Ndër 150 milion punëtorë migrues, vetëm 6% e tyre merrnin rroga mujore. Përveç vonesës së pagave, mediat i kushtuan shumë vëmendje edhe pneumokoniozës dhe sëmundjeve të tjera profesionale, aksidenteve në miniera si dhe lëndimeve në vendin e punës. Në këtë periudhë media u bë qasja kryesore e punëtorëve migrues në mbrojtje të të drejtave të tyre.

Pakësimi i Përpjekjeve në Media dhe Programi i Qeverisë

Në vitin 2008 në Kinë u zhvilluan Lojrat Olimpike të Pekinit. Gjatë këtij viti ranë ndjeshëm lajmet negative në mediat kryesore, ndërsa qeveria rriti mbrojtjen për investitorët dhe kapitalin për shkak të krizës ekonomike globale. Ndërkohë, pati një lodhje të ndjenjës së mëshirës nga ana e publikut për punëtorët migrues, gjë që bëri që dhe lajmet për ta, në mbrojtje të të drejtave të tyre, të pakësoheshin (Sun, 2014).

Gjatë viteve të fundit, me rënien në përgjithësi të ekonomisë në Kinë, vonesat e pagave, trajtimet e lëndimeve në vendin e punës, pushimet e paligjshme nga puna dhe mosmarrëveshjet e tjera në punë u rritën mjaft. Shpesh kishte greva, protesta dhe evente të tjera massive, gjithashtu edhe vetëvrasje të punëtorëve migrues, veprimtari kriminale dhe incidente të tjera. Lajmet rreth punëtorëve migrues që kërkonin pagat duke sulmuar policinë, duke prishur rendin publik e me sjellje të tjera të paligjshme, si dhe duke u hakmarrë ndaj shoqërisë në mënyra kriminale mbasi ishin trajtuar padrejtësisht u bënë tendencë në media, gjë e cila solli transformimin e punëtorëve migrues nga një grup i thjeshtë, i sjellshëm dhe i pambrojtur në lumpen proletariat.

Ne zbuluam që mediat kryesore në Kinë janë kontradiktore me veten në mbështetjen e punëtorëve migrues. Nga njëra anë, gjatë disa periudhave punëtorët migrues mundën t'i zgjidhnin problemet duke iu drejtuar mediave. Nga ana tjetër, media mund të demonizojë punëtorët migrues. Imazhi i punëtorëve migrues u bënë “cilësia e ulët, shëmnia, vetëvrasja, hedhja nga maja e godinave, gjuha e ndyrë, etj”, gjë e cila thelloi diskriminimin kundër punëtorëve migrues nga pjesa më e madhe të shoqërisë. Nëpërmjet studimit të gazetave lokale, disa studjues vunë re që punëtorët migrues portretizoheshin si grupe me arsim të

ulët, leshko dhe njerëz impulsivë, të cilët fare lehtë kalojnë në veprime ekstreme (Rui & Zhang, 2008).

Diskursi Mediatik dhe Formësimi i Mjedisit

Ku e kanë filluesën diskursët kontradiktore në media? Ne mund ta shohim të gjithë mjedisin e diskursit mediatik si “fushë”, emërtim ky që ia ka vënë Bourdieu, dhe që ka kuptimin e “sintezës së forcave sociale dhe faktorëve të formuar në raport me faktorë specifikë në një hapësirë sociale”. Media është sintezë e një larmie forcash konkurruese dhe diskursi mediatik rreth punëtorëve migrues është i gërshetuar me forca të ndryshme. Këto forca dominojnë pozicionin dhe rolin e kapitaleve të ndryshëm dhe të gjitha së bashkë ndikojnë mbi shkaqet dhe ndryshimet e diskurseve (Luo, 2010). Sot, qeveria dhe kapitali dominojnë fushat më të mëdha mediatike të Kinës: grupet e kapitalit kontrollojnë shumicën e mediave komerciale të Internetit në Kinë si dhe mediat tradicionale për të shprehur vullnetin e tyre përmes lajmeve në media; qeveria drejton thujtë të gjitha mediat e brendshme publike dhe kontrollon politikisht lajmet në media. Si rezultat, forca e punëtorëve migrues dhe e prodhuesve të lajmeve sa vjen e dobësohet në diskursin mediatik.

Analiza e Shkaqeve Themelore

Në këtë material, duke analizuar performancën e opinionit publik për eventet madhore që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve migrues, autori përshkruan konkurrencën mes autoriteteve qeveritare, kapitalit, punëtorëve migrues, prodhuesve të lajmit, dhe zbulon shkaqet themelore që ndikojnë në fuqinë mediatike të punëtorëve migrues.

Vdekja e një punëtoreshë migruese në Shanxi në 13 dhjetor 2014, sepse kërkoi rrogat

Në 13 dhjetor 2014, fshatarja Zhou Xiuyun nga Handan, e cila punonte në Taiyuan, Provinca Shanxi, u rrah për vdekje nga policia kur po kërkonte pagesën. Zhou Xiuyun, bashkëshorti i saj dhe djali i tyre punonin në një kantier ndërtimi në Taiyuan. Në fund të vitit ata ende nuk ishin paguar. Në 13 dhjetor familja e Zhou Xiuyun bashkë me punëtorë të tjerë migrues donin të shkonin në kantier të kërkonin pagat por filluan të zihen me rojet e sigurisë së kantjerit, të cilët thirrën policinë. Mbas ardhjes së policisë, filloi konfrontimi i punëtorëve migrues me policinë dhe aksidentalisht policët e rrahën Zhou Xiuyun për vdekje.

Në 20 dhjetor, të afërmit e Zhou Xiuyun-it e ekspozuan këtë event online, gjë që nuk tërhoqi shumë vëmendje. Në 24 dhjetor, rrjeti Kina raportoi mbi ngjarjen e mbas kësaj filluan dhe të tjerë, si Netease, Tencent, Xinhua dhe China Youth Network ta përcjellin.

Lajmi bënte të ditur që policia nuk do ta bënte kurrë një gjë të tillë dhe pretendonte që publikuesi po keqinformonte qëllimisht përdoruesit e Internetit.

Në 29 dhjetor, u botua në faqen zyrtare të Byrosë Publike të Sigurisë së Taiyuan-it “Raporti mbi vdekjen e panatyrshme në rastin 12 – 13”, i cili deklaronte që shkak i vdekjes kishte qenë hyrja e punëtores migruese në kantjer pa helmetë, duke mos pranuar se ishte rezultat i konfliktit të shkaktuar për shkak të kërkesës së rrogave të papaguara. Ai deklaronte gjithashtu që shkak i vdekjes së Zhou Xiuyun-it kishte qenë rezistenca e saj e dhunshme karshi policisë. Mbas kësaj, raportimet në media u rritën menjëherë.

Në 20 janar, CCTV Focus transmetoi programin “Monitorim i Plotë i Rastit Zhou Xiuyun: Punëtorja migruese u vra nga policia sepse pengoi forcat e rendit”, lajm i cili nxiti sërish një bum në media. (Figura 1)

Figura 1



Një rast i tillë konfliktit ishte mjaftushëm dramatik për të tërhequr vëmendjen e publikut, por mediat kryesore nuk e raportuan atë menjëherë. Ata nuk e ndoqën rastin derisa kur Byroja Publike e Sigurisë në Taiyuan raportoi zyrtarisht për të. Dhe vetëm mbas lajmit të CCTV, i cili përfaqëson qëndrimin zyrtar, mediat e tjera filluan ta raportojnë atë gjerësisht; kur rasti thuhet se humbi krejt vëmendjen, programi “Focus Report” i CCTV-së ngacmoi sërish me sukses mbulimin masiv.

Është zbuluar që në ngjarjet që lidheshin me punëtorët migrues, nuk do të nxitonte më të shkonte në vendngjarje që në momentin e parë, por pret për njoftimin e qeverisë ose lajmin mediatic zyrtar dhe më pas raporton ose komenton. Por si do t'i raportonte media zyrtare këto ngjarje? Shkak për këtë ngjarje ishte fakti që punëtorja migruese nuk kishte patur helmetë kur kishte hyrë në kantjer, dhe vdekja e Zhou Xiuyun-it kishte qenë pasojë e rezistencës së saj të dhunshme kundër policisë.

Mbas transmetimit, ndodhi një ndryshim i plotë në opinionin publik: viktimja Zhou Xiuyun u quajt nga *netizenët* “bushtër”, “ngatërrestare”, “e cila nuk kishte veshur helmetë”, dhe që “i kishte bërë rezistencë forcave të rendit”, gjë që shkonte në një linjë me imazhin e injorancës, të kundërshtarëve të ligjit, punëtorëve fshatarë të pacivilizuar të krijuar nga mediat kryesore. Në sajë të autoritetit të Fokus-it, ky version raportimi u pranua gjerësisht


dhe kjo ngjarje u shndërrua në historinë absurde që punëtorja migruese vdiq ngaqë kishte insistuar të mos vishte helmetë kur kishte hyrë në kantjer.

Fokus Report thjesht pranoi fjalët e policisë dhe shmangu dëshmitë e punëtorëve migrues. Në mënyrë dashakeqe manipuluan sekuencat video për ta nxjerrë Zhou Xiuyun si provokuese dhe qëllimisht shmangën faktin që punëtorët migrues kishin ardhur të kërkonin pagat.

Mbas transmetimit të Focus Report-it, familja e Zhou Xiuyun-it sqaroi faktet në mediat sociale dhe publikoi video të regjistruara nga punëtorë të tjerë në terren, por këto nuk u përhapën gjerësisht dhe as nuk u raportuan nga mediat, por vetëm u përcollën nga 151 netizenë në Sina Weibo.

Figura 2

Përhapja e burimit në raportet mediatike



Në aspektin mediatik lidhur me këtë ngjarje, mediat zyrtare, përfaqësuese të kapitalit dhe të qeverisë luajnë rol dominues dhe arsyeja e vërtetë që ishte “kërkesa për pagat” u mbulua nëpërmjet tranzicionit nga “vdekja e punëtores migruese për pagat” te “konflikti i shkaktuar ngaqë nuk veshi helmetë”. Mediat më të mëdha u fokusuan te konflikti midis gruas fshatare dhe policisë; dhe palët e përfshira të cilat duhet të shërbejnë si burim i rëndësishëm lajmi për këtë ngjarjeje, patën impakt minimal në fushën mediatike.

Punëtorët Migrues të vënë përpara Gjyqit Publik sepse kërkuan Pagat


Në 16 mars 2016, Gjykata Popullore në Langzhong, në Provincën Sichuan, zhvilloi një seancë të hapur publike në qytetin jugor të Langzhongut për të gjykuar një rast të bllokimit

të biznesit publik. Në 29 gusht të vitit 2015, në kompleksin e një projekti banimi u mblodhën me qindra punëtorë që kërkonin rrogat; më pas ata shkuan në zonën e njohur piktoreske të Langzhong-ut, Nanjinguan, dhe që të arrinin qëllimin bllokuan hyrjen. Tetë “demagogë” u nxorrën përpara gjyqit publik dhe u futën në burg për 6–8 muaj. Faqja zyrtare e Gjykatës Popullore të Langzhong-ut dhe një media lokale publikuan një lajm mbi këtë ngjarje, duke pretenduar që ky “prononcim” bëri që “shumë njerëz të marrim edukatë ligjore” dhe “Gjykata Popullore e Langzhong-ut e paralajmëroi publikun që të ngulisë mirë konceptin e ligjit, duke i shprehur kërkesat në mënyrë të arsyeshme dhe racionale”.

Në Ligjin e Procedurës Penale të Kinës nuk ekziston një lloj i tillë shfaqjeje publike, “prononcimi”. Ky qëndrim i Gjykatës së Langzhong-ut ka dhunuar qartazi të drejtat e njeriut të punëtorëve migrues të cilët ishin “grupe të pambrojtur (Ruo shi qun ti)” të papaguar. Megjithatë, kjo ngjarje nxiti vetëm 229 raportime dhe komente në media, të gjitha në rrjet dhe në mediat lokale, ndërsa Agjencia e Lajmeve Xinhua, People’s Daily dhe media të tjera zyrtare nuk raportuan asgjë për këtë ngjarje.

Mediat, kur komentonin çështjet e lidhura me lajmin, fokusoheshin te gjykata lokale dhe qeveria, dhe kritikonin qëndrimin e gabuar të gjykatës si dhunuese e të drejtave njerëzore të mbrojtësve dhe e shpirtit të ligjit. E megjithatë, një tjetër tipar i këtij eventi, “kërkesa për pagat”, u prek fare pak. Punëtorët migrues u dënuan sepse kishin kërkuar pagat në mënyrë të paligjshme, por çështja nëse kompania ua pagoi rrogat punëtorëve apo jo dhe nëse sjellja e kompanisë ishte e paligjshme u prek shumë pak. Mbase kjo ngjarje shkaktoi shpërthimin e opinionit publik, Gjykata Popullore e Langzhong-ut e hoqi lajmin dhe dënoi gjykatësin, por punëtorët migrues nuk morën kompensim dhe asgjë nuk u përmend për rrogat e punëtorëve migrues.

Figura 3



Nga perspektiva e medias duket sikur “dinjiteti” i punëtorëve migrues ishte më i rëndësishëm se interesat e tyre materiale. Në fakt, shkeljet e Gjykatës kundër të drejtave njerëzore të punëtorëve migrues ishin më tërheqëse se dhunimi nga ana e kompanisë i të drejtave ekonomike të punëtorëve migrues dhe konflikti midis punëtorëve dhe gjykatës ishte më shumë në një linjë me perspektivën e mediave komerciale.

Faktorë që Prekin Pushtetin Mediatik të Punëtorëve Migrues

Sikurse u analizua më sipër, qeveria dhe kapitali patën rol dominues në fushën e medias lidhur me çështjen e punëtorëve migrues. Vetë punëtorët migrues, si thelbi i problemit, u trajtuan si të padukshëm. Ndërkohë, forca e mediave, e cila luajti rol në ruajtjen e paanësisë dhe drejtësisë, u bë gjithashtu gjithmonë e më e dobët.

Ndonjëherë, në shpërndarjen e pushtetit mediatik, qeveria dhe kapitali do t'i japin punëtorëve migrues pjesë nga ky pushtet në shkëmbim të stabilitetit social. Megjithatë, në vitet e fundit, me kapitalizimin e medias, shpërndarja e pushtetit midis qeverisë, kapitalit, punëtorëve migrues dhe medias është shpesh një lojë me shumatore zero.

Katër Dimensionet e Ndikimit të Medias mbi Punëtorët Migrues

1. Vullneti i Qeverisë – Media është Thikë me dy Presa për Ruajtjen e Stabilitetit

Disa studjues kanë treguar që pavarësisht bashkekzistencës së një larmie të drejtash të fjalës, praktikuesit e lajmeve duhet të flasin me kujdes në mënyrë që të punojnë të qetë (Wu Fei, 2009). Kësisoj, qeveria luajti rol kyç në fushën e mediave lidhur me punëtorët migrues. Agjenda e drejtësisë sociale e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve migrues është thikë me dy presa për qeverinë: nga njëra anë, zgjidhja e problemeve të punëtorëve migrues nëpërmjet lajmeve mediatike mund të kënaqë punëtorët migrues dhe të lehtësojë kontradiktat sociale; nga ana tjetër, teprimi me lajme negative mund të shkaktojë pakënaqësi kundër qeverisë dhe kapitalit, gjë e cila do të intensifikojë kontradiktat sociale. Ndërkohë, mbulimi me simpati i ngjarjes do ta vendosë ndërmarrjen në opozitë, gjëe cila nuk është e favorshme për interesat e investitorëve dhe të kapitalit. Kjo është arsyeja pse në incidente të veçuar nga njëri-tjetri që kanë të bëjnë me punëtorë migrues qeveria ka tendencën të ndërmarrë zgjidhje të ndryshme, madje edhe në konflikt me njëra-tjetrën.

Për të pajtuar këtë kontradiktë, shpesh gjuha zyrtare i portretizon punëtorët migrues si grupe të pambrojtur dhe i bën thirrje shoqërisë që të “kujdeset” për ta. Në Festivalin Gala të Pranverës në CCTV, (Chun Wan), mishërim i ideologjisë kombëtare dominuese, punëtorët migrues shpesh shfaqen me veshje fshatarake dhe flasin në dialekt, gjë që u jep punëtorëve migrues tiparet e “kllounit” të mirë, të thjeshtë e gjithashtu injorant. Ndërkohë, intelektualët dhe kapitalistët shfaqen si “filantropë”, të cilët kanë pushtetin dhe burimet e që me mirësi e në mënyrë aktive ndihmojnë grupet e pambrojtur (Nie, 2010). Një ndihmë e tillë reciproke urbane dhe rurale mishëron pabarazinë midis dy palëve dhe tregon qëllimin e qeverisë për të edukuar punëtorët migrues: qeveria ka nevojë të ndërtojë imazhin e punëtorëve migrues që robtohen në punë pa mendime politike dhe jo atë të “ngatërrestarëve” që luftojnë për të drejtat e tyre ekonomike dhe politike. Ndaj për sjellje ekstreme në mbrojtje të të drejtave, si hedhja nga maja e ndërtesave dhe eventet me grupime, media zyrtare ka tendencën t'i tregojë ato si imazhe tipike negative dhe të theksojë që punëtorët migrues duhet të respektojnë ligjin dhe të ndërmarrin masa të ligjshme.

Me fjalë të tjera, në çështjen e punëtorëve migrues, qeveria e konsideron median si mjet për ruajtjen e stabilitetit social dhe për lehtësimin e kontradiktave sociale. Kanalet e ofruar për punëtorët migrues janë vetëm një valvul shkarkimi për dhimbjen e tyre e për të lehtësuar konfliktet sociale. Qeveria nuk mund t'u japë pushtet të vërtetë mediatic punëtorëve migrues. Për sa kohë që ekonomia është në rrezik, qeveria shpesh sakrifikon të drejtat mediatike të punëtorëve të medias mbashkë me të drejtat e tyre ekonomike dhe politike për të siguruar interesat e kapitalit dhe shpejtësinë e rritjes ekonomike.

2. Kapitalizimi i Medias – Logjika e Tregut e Pagesës së Qerasë dhe e Kërkimit të Sensacionit

Për afro tre dekada, ndryshimet në sistemin mediatic të Kinës ishin një proces ri-institucionalizimi bazuar në karakteristikat themelore të kapitalizimit. Ai ishte proces i kombinimit të pushtetit politik me forcën e kapitalit, dhe pushteti politik përdorte forcën e kapitalit për të vazhduar kontrollin politik. Në këtë proces, forca e kapitalit u bë gradualisht forcë dominuese në diskutet mediatike, dhe me ndihmën e pushtetit politik arriti të siguronte një kthim edhe më fitimprurës të kapitalit. (Hu, 2004)

Ky kapitalizim reflektohet në dy aspekte: në njërin aspekt, me gjithë kapitalizimin dhe marketimin në strukturën e kapitalit aksioner të modelit operativ, media komerciale i kushton përherë e më shumë vëmendje përfitimeve ekonomike, ku si standard janë reklamat komerciale dhe klikimet; në aspektin tjetër, media, sidomos ajo zyrtare, shkëmben pushtet mediatic në formën e pagesës së qerasë për tu prezantuar në media.

Në ditët e sotme, shumica e mediave zyrtare kanë përfunduar reformën e marketizimit dhe kolektivizimit. Interesat komerciale në vend atyre të partisë bëhen targeti kryesor për prodhimin e lajmeve në këto media.

CCTV është përfaqësuesi tipik i kapitalizimit të mediave zyrtare në Kinë. Duke patur frikë nga forca e fuqishme politike e CCTV-së, shumë kompani hedhin sasi të mëdha reklamash te CCTV; në të njëjtën kohë, organizmat mjaft të mëdhenj burokratikë të CCTV-së u sigurojnë një pushtet të madh politik punonjësve të niveleve të ndryshëm që e përdorin atë për përfitime ekonomike (Hu, 2004). Ky shkëmbim midis mediave kryesore dhe kapitalit i kthen këto media nga zëdhënese e vetme e qeverisë në përfaqësuese të përbashkët të kapitalit dhe qeverisë.

Përveç medias zyrtare të kapitalizuar, më të përhapurat në tregun e fjalës në Kinë janë mediat komerciale. Shpesh media komerciale në mënyrë selective ose të gabuar raporton ngjarje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrues. Media komerciale është gjithmonë zëdhënese e kapitalit.

Përveç kësaj, mediat komerciale me një gamë më të gjerë përhapjeje kanë si standard numrin e klikimeve dhe sensacionin për vlerën e lajmit. Në dhjetë vitet e kaluar, publiku u lodh me keqardhjen për punëtorët migrues (Cohen, 1973) pasi janë të shpeshta rastet kur ata protestojnë për pagat, lëndohen në punë, vuajnë nga sëmundje profesionale apo ndodhin incidente të tjera. Në këto kushte për të tërhequr vëmendjen e mediave punëtorëve migrues u është dashur të kërcënojnë se do të hidhen nga ndërtesat e larta. Ndërkohë, pjesa më e madhe e audiencës target të mediave komerciale është grupi i klasës së mesme me

kapacitet më të lartë konsumi dhe jo punëtorët migrues me kapacitet të ulët, të ardhura të pakta dhe cilësi të ulët jetese (Sun, 2014). Prandaj është e vështirë të gjesh në emisionet informative të flitet mbi interesat jetike të punëtorëve migrues.

Nevoja për të paguar qeranë dhe rendja mbas eficiencës ekonomike që solli kapitalizimi dhe marketizimi i medias vazhdon të shtrydhë hapësirën e punëtorëve migrues në fushën e mediave dhe është shkaku kryesor i humbjes së pushtetit mediatik të punëtorëve migrues.

3. Profesionalizmi në Gazetari – Perspektiva Elitare “Më Vjen Keq për Fatkeqësinë e tyre, por jam i Zemëruar me Paaftësinë e tyre”

Mbas vitit 2003, një numër i madh lajmesh në media që kishin të bënin me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve bazoheshin në profesionalizmin gazetaresk, i cili theksonte funksionin social të lajmit—“në emër të ndërgjegjes së shoqërisë”, dhe u kërkonte reporterëve të gërmonin për të vërtetën. Shumica e profesionistëve në media e kanë konsideruar këtë si integritet profesional. Ata interesoheshin për njerëzit e shtresës së fundit të shoqërisë dhe ruanin paanësinë dhe drejtësinë sociale. Raportimi i tyre ishte burimi kryesor me anë të të cilit punëtorët migrues ushtronin të drejtën e fjalës.

Megjithatë, në fakt, edhe pozita e atyre që besonin në profesionalizmin e gazetarit ishte kontradiktore kur bëhej fjalë për punëtorët migrues. Me fjalë të tjera, punëtorët migrues ishin jo vetëm grupe të pambrojtur të drejtat e të cilëve shkeleshin, por gjithashtu njerëz të pacivilizuar e të marginalizuar të dorës së fundit (Zhang, 2007). Punëtorët migrues përshkruheshin si të varfër e të mërzitshëm: ata ishin mysafirë të pafuar të qytetit, që prishnin jetën e qytetit dhe shkelnin interesat e qytetarëve urbanë. Thënë ndryshe, atyre u vinte keq për fatin jo të mirë të punëtorëve migrues, por ishin të zemëruar me paaftësinë e tyre (Sun Wanning, 2014). Kur mbronin interesat e punëtorëve migrues, në mënyrë indirekte ata gjithashtu stigmatizonin punëtorët migrues. E drejta për të përdorur median, që u ishte dhënë punëtorëve migrues, ishte “kompromentuar”. Një studim zbuloi që 47.91% e lajmeve të dhëna në median urbane i portretizonte punëtorët migrues si grup i dobët në vështirësi (Yu, 2015).

Me kapitalizimin e medias dhe forcimin e kontrollit të qeverisë, atyre që besonin në profesionalizmin e gazetarit iu desh të vinin në plan të parë përfitimet ekonomike dhe misionet politike. Roli i profesionalizmit gazetaresk në fushën mediatike u bë gjithmonë e më i dobët. Si përfundim, e drejta e medias së “kompromentuar” që iu ishte dhënë punëtorëve migrues nuk do të ekzistonte më.

4. Mungesa e Pushtetit Mediatik të Punëtorëve Migrues -- Mungesa e Zëdhënësve

E vërteta është që punëtorët migrues nuk kanë patur kurrë pushtet mediatik. Atyre u mungon kapaciteti, burimet dhe kanalet. Në shpërndarjen e pushtetit mediatik, ata zor se kanë ndonjë media që i mbështet dhe kanal për të folur, ata varen vetëm te shpirtbutësia e titullarit të medias. Nën ndikimin e profesionalizmit gazetaresk dhe të nevojës së qeverisë

dhe kapitalit për të ndërtuar një shoqëri harmonike dhe për të lehtësuar konfliktet midis krahut të punës dhe menaxhimit, punëtorët migrues arritën një herë të kërkojnë për ndihmë dhe të mbrojnë të drejtat e tyre me ndihmën e medias. Megjithatë, sot, kur fokusi i kapitalit bie mbi përfitimet pa u kujdesur që të lehtësojë konfliktet e punës, punëtorët migrues nuk gëzojnë më mbështetjen e medias dhe mungesa e pushtetit mediatic është bërë mjaft evidente.

Është gjetur që vetëm 19.7% e lajmeve rreth punëtorëve migrues në mediat metropolitane intervistonin vetë punëtorët migrues si burim informacioni, dhe burimi më i zakonshëm i informacionit për këto raportime rreth punëtorëve migrues janë mediat e tjera, studjuesit dhe qeveria (Yu, 2015). Është e qartë pra që rrallë herë media u jep punëtorve migrues kanal ku të shprehen, madje edhe në lajmet që u përkasin atyre.

Ndonëse shfaqja e mediave sociale i shpërndau burimet mediaticke dhe mbas viteve 90^{te} punëtorët migrues herë mbas here janë në gjendje të shprehen në mediat sociale, përparimet në teknologjinë e informacionit nxjerrin përpara kërkesa më të larta për marrësit e informacionit. Shpesh, punëtorët migrues nuk kanë as aftësinë për të shmangur informacionin negativ dhe të rremë dhe as aftësinë për të përhapur lajmin e për të tërhequr vëmendjen e publikut. Prandaj, zgjerimi i hendekut të dijës do ta përkeqësojë statusin e tyre (Li, 2015).

Në vitet e fundit ka patur disa ente kuture të shqetësuar për të drejtat në punë, si për shembull shoqata Troupe e punëtorëve të rinj dhe programe të lidhura me punën, por për shkak të mungesës së fondeve dhe presionit të censurës dhe qeverisë, është e vështirë për ta të ngrihen në nivelin e rrjedhës së përgjithshme. Si përfundim, në shpërndarjen e pushtetit mediatic, punëtorët migrues vështirë se kanë ndonjë kanal për të folur.

Mënyra për të ecur përpara

Mbasi u analizuan katër dimensionet që ndikojnë mbi pushtetin mediatic të punëtorëve migrues, u zbulua që ndonëse ekziston një luftë komplekse midis pushteteve të ndryshëm, hegjemonia kulturore e përmendur nga Antonio Gramsci sot në Kinë kontrollohet nga grupet e kapitalit, të cilat kontrollojnë masmedian, ndërsa interesat e aleancës së kapitalit me burokratët kanë monopolizuar tregun e diskursit (Wei, 2014). E njëjta gjë ndodh në fushën politike, sepse 300 milion punëtorë migrues nxjerrin vetëm rreth 30 deputetë në Kongresin Kombëtar të Popullit, afro një përqind të totalit. Punëtorëve migrues u mungon mundësia për tu shprehur si në media ashtu edhe në politikë për shpërndarjen e padrejtë të burimeve sociale.

Rekomandime

Në aspektin e pushtetit mediatic krahasuar me situatën në fushat ekonomike dhe politike, punëtorëve migrues iu shkon më mirë emërtimi “grup i pambrojtur” (Ruo shi qun ti). Veçanërisht sot, me kapitalizimin e medias dhe lidhjen e afërt të qeverisë me kapitalin, media zyrtare mban qëndrim kundër punëtorëve migrues në incidentet më të mëdha që

kanë të bëjnë me të drejtat e tyre. Mungesa e pushtetit mediatic të punëtorëve migrues i vë ata në pozita më të disfavorshme, gjë e cila ua vështirëson të kuptuarit e të drejtave në punë, të demokracisë politike dhe të drejta të tjera bazë.

Marketizimi, industrializimi, urbanizimi dhe globalizimi kërkojnë lëvizje të lirë të punës dhe të qytetarëve, por ato nuk çojnë në mënyrë spontane në arritjen e barazisë dhe të të drejtave civile. Për të luftuar për pushtetin mediatic, punëtorët migrues nuk duhet të mbështeten vetëm në lëmoshën e shtresave të larta të shoqërisë ose në revoltën spontane sporadike, por nëpërmjet zgjimit të tyre politik duhet të kultivojnë media që përfaqësojnë interesat e tyre. Vetëm kështu punëtorët migrues mund të mbrojnë të drejtat e veta në punë, demokracinë politike dhe të drejtat e tjera bazë njerëzore.

Referenca

- Daniel Fu Keung Wong., Chang Ying Li., Xue Song. (2007). Rural migrant workers in urban China: living a marginalized life. *International Journal of Social Welfare*, 16(1).
- Hu Zhengrong. (2004). Rent-seeking, Industry Consolidation and Medium Capitalization Process --The Analysis of the Media Institutional Change. *Media Research*, (1)
- Li Haiming. (2011). Causes and Governance of Wage Arrears of Migrant Workers—Taking the Cases in the Construction as Example. *Hebei Law*, (7): 26-37.
- Li Hongyan. (2015). Watching and Being Watched --Research on the Relationship of the Media and Migrant Workers Since the Reform and Opening-up. Beijing: China Yanshi Press, 2015: 6.
- Luo Zhen. (2010). Historical Changes of Migrant Workers' media power. Unpublished doctoral dissertation, Fudan University, Shanghai.
- Nie Kuanmian. (2010). Research on the Images of Migrant Workers on the Spring Festival Gala for 27 Years. Unpublished doctoral dissertation, Academy of Social Sciences, Beijing.
- Sun Chaofang. (2011). Media Image Shaping of Migrant Workers in Agenda Setting. Unpublished doctoral dissertation, Southwest University of Political Science, Chongqing.
- Sun Wanning. (2014). Subaltern China: Rural Migrants, Media, and Cultural Practices. Maryland: Rowman & Littlefield.
- Wei Sujin. (2004). Mass Media and Discourse Right of Farmers--start with migrant farmers' jump show. *Journalism & Communication*, (2): 16-20.
- Wu Changchang. (2008). Media, Modernity and Subjectivity of the Working Class. Unpublished doctoral dissertation, Fudan University, Shanghai.
- Wu Fei. (2009). Journalistic Professionalism Study. Beijing: China Renmin University Press, 303.
- Yu Keping. (2010). Changes of New Migratory Movements, Citizenship and System—Political Interpretation of Peasant Workers' Moving into the City Since the Reform and Opening-up. *Economic and Social Comparison*, (1): 1-11.
- Yu Ting. (2015). The Research on Media Image of the New Generation of Migrant Workers in Urban Newspaper in China. Unpublished doctoral dissertation, School of journalism and communication, Central China Normal University, Wuhan.
- Zhang Shidi. (2015). New Reading on "Sorrow, Blame" -- Taking Migrant Workers' Media Image as an Example. *Southwest University of Political Science and Law*, (6), 119-124.
- Zhao Yuezhi. (2012). The Media and Class Politics in the Context of Globalization. *Culture Crossings*, (3): 44-49.

Gjuha dhe nxitja e urrejtjes

Për të Kuptuar dhe Paraqitur Diversitetin

Përgjigjja e Alfabetizimit Mediatik ndaj Diskriminimit në Paraqitjen e Lajmeve

Maria Ranieri & Farnesco Fabbro

Ky material synon të prezantojë edukimin me alfabetizimin në media (MLE) si strategji pedagogjike për t'i ndihmuar të rinjtë të kuptojnë në mënyrë kritike paraqitjen në mjetet e informimit të minoriteteve, gjithashtu si një mundësi konkrete për ta angazhuar brezin e ri në prodhimin e narrativave mediatike që reflektojnë dhe i japin vlerë diversitetit të zërave në shoqëritë bashkëkohore. Parë nga kjo perspektivë, edukimi me njohuri mediatike mund t'i shërbejë qëllimit të një mjeti potencialisht të fuqishëm për të sfiduar dhunën simbolike që karakterizon disa paraqitje në mjetet e informimit të Tjetrit nëpërmjet aprovimit të praktikave kritike të raportimeve. Këto praktika mund të kuptohen, nga ana tjetër, si vepra më të gjera të qytetarisë demokratike. Në këtë artikull fokusohemi mbi ndërhyrjet e bazuara te klasat që trajtojnë përfaqësimin e grupeve të diskriminuara. E fillojmë me një hyrje në qasjet teorike që l dhanë formë hartimit të veprimtarive të edukimit në media, më pas ilustruam dhe diskutuam praktikat efektive të zhvilluara në shkollë. Në fund e mbyllim me disa konsiderata rreth potencialit të MLE-së për të inkurajuar qytetarët e rinj që të vënë në pikëpyetje diskriminimin në përfaqësimet mediatike, si dhe për të mbështetur aftësinë e tyre për paraqitjen e diversitetit.

Fjalëkyç: Edukim me njohuri në media, diversitet, diskriminim, pjesëmarrje, shkollë e mesme

Hyrje

Që në vitet 1980 Edukimi me Njohuri në Media (MLE) është njohur gjithmonë e më shumë në nivel ndërkombëtar si komponent kritik i edukimit për një qytetari demokratike (p.sh. UNESCO 2014). Duke folur më gjerësisht, MLE është strategji pedagogjike që synon në promovimin e të kuptuarit kritik dhe prodhimin e ndërgjegjshëm (ose përdorimin) e medias. Nga kjo perspektivë, në shoqëritë e saturuara nga media, të mësosh se si të 'lexosh' dhe të 'shkruash' paraqitjen mediatike të botës – por gjithashtu edhe se si këto paraqitje mund të prekin mendimet dhe ndjenjat tona për veten dhe njerëz të tjerë – është themelore të mbështetet. duke vënë në lëvizje një pjesëmarrje aktive dhe kritike e qytetarëve të rinj në jetën demokratike. Duke filluar nga ky supozim, e-Angazhimi Kundër Dhunës (e-EAV, [www.HYPERLINK "http://www.engagementproject.eu/"](http://www.engagementproject.eu/).[engagementproject.eu](http://www.engagementproject.eu/)), projekt dy vjeçar (2012 – 2014) i mbështetur financiarisht nga Komisioni Europian dhe i koordinuar

nga Universiteti i Firences, zhvilloi dhe implementoi një sërë instrumentesh multimediale për njohuritë në media dhe qytetari. Projekti përfshiu gati 500 nxënës nga shtatë vende europiane (Austria, Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar) në eksperimentimin e materialeve inovative edukative për edukimin në media dhe qytetari, me fokus të veçantë mbi: marrjen dhe prodhimin i informacionit (Moduli 1); fiksionin dhe ideologjitë audio-vizive (Moduli 2); videolojrat dhe qytetarinë (Moduli 3); komunikimin politik dhe propagandën (Moduli 4); aktivizmin online dhe lidhjen në rrjet (Moduli 5). Në këtë artikull paraqesim katër ndërhyrje edukative të fokusuara mbi strategjitë mediatike të (keq)përfaqësimit të Tjetrit në mediat informative dhe me një qasje pedagogjike për të zhvilluar jo vetëm të kuptuarit kritik të strategjive të tjetërsimit, por gjithashtu kapacitetin për t'i dhënë zë diversitetit si vlerë në shoqëritë bashkëkohore.

Në sa vijon, prezantojmë fillimisht sfondin teorik të projektit, më pas ilustruam disa shembuj pozitivë dhe negativë të përvojave të edukimit me njohuri në media. Artikulli mbyllet me disa konsiderata rreth rolit të edukimit mediatik për të promovuar ndërgjegjësimin e studentëve për strategjitë mediatike të diskriminimit dhe të zhvillojë kapacitetin e tyre për të shprehur dhe vlerësuar diversitetin.

Sfondi Teorik

'Politikat e pasqyrimit (mediatik)' –përgjatë linjave të klasës sociale, gjinisë, racës dhe seksualitetit – mund të shihen si tipari kyç i MLE-së, sidomos kur perceptohen si formë e edukimit qytetar kritik. Padyshim, MLE-ja i kushton vëmendje të veçantë rolit ideologjik të medias në prodhimin e sistemeve të pasqyrimit që i shërbejnë interesave dhe identiteteve të posaçme të disa të preferuarve të medias mbi të tjerët, e kësaj në mënyrë sistematike shtrembërojnë pasqyrime të caktuara dhe mbështesin sistemet e pushtetit dhe të pabarazisë (Hall 1997). Për shembull, mediat e informimit, si të gjitha mediat e tjera, ofrojnë interpretime të caktuara dhe përzgjedhje të realitetit, gjë e cila në mënyrë të pashmangshme mishëron vlera dhe ideologji të caktuara.

Kësisoj, veprimtaritë e orientuara nga MLE-ja, në veçanti në rastin e mediave informative, u japin përgjigje pyetjeve rreth autoritetit, besueshmërisë dhe paanshmërisë, dhe gjithashtu bëjnë thirrje për një debat më të gjërë rreth zërave të atyre që janë dëgjuar dhe përfaqësuar dhe për të tjerët që nuk janë.

Analizat në media shpesh shihen si aktivitet kyç për t'u mundësuar të rinjve "demistifikimin" e ideologjive dominuese dhe për vendosjen e distancës kritike nga paraqitjet mediatike, për shembull nga stereotipet seksiste ose raciste (Masterman 1985; Ramasubramanian 2007). Sigurisht, një qasje e mençur kritike përforcohet duke "mos parë botën sociale dhe tekstet e saj si natyrale dhe neutrale, por si të ndërtuara në mënyra që natyralizojnë funksionimin e pushtetit dhe të diskriminimit (p.sh. racizmit, islamofobisë, homofobisë). Gjithashtu, prodhimi mediatik në ditët e sotme shihet gjithnjë e më shumë si mjet për të rinjtë që të reflektojnë mbi investimet e tyre emocionale në media dhe më gjerësisht për formimin e identitetit (DeBlock dhe Buckingham 2007), si dhe për të ofruar përfaqësime alternative të grupeve të marginalizuara krahasuar me ato që hasen në mediat më të mëdha (Yanovski 2002). Sidoqoftë, mjaft studime të mbështetura në orët e

mësimit mbi të mësuarit antiracist dhe antiseksist nëpërmjet edukimit mediatic tregojnë gjithashtu disa tensione ose kontradikta që mund të shfaqen kur jep mësim rreth “gjinisë”, “seksualitetit” ose “racës” në media. Për shembull, është parë se nocionet simplistike të imazheve “pozitive” dhe “negative” janë problematike pasi kanë tendencën të prodhojnë stereotipe një dimensionale që ofrojnë burime të varfra për krijimin e identiteteve komplekse (Buckingham 1998; Bragg 2002). Kësisoj, disa studjues kanë mbështetur forma më pak normative të edukimit kulturor, duke çuar në prodhime mediatiche të narrativave multidimensionale për eksplorimin e tensioneve midis llojeve të ndryshme të identiteteve (Buckingham 2003; Gutiérrez 2008). Studjues të tjerë bëjnë thirrje për ta vënë më pak theksin mbi debatet e konkurrencës të shoqëruara me performancën e identiteteve, dhe më shumë vëmendje te dialogu i hapur dhe aksesit të dallimit dhe diversitetit gjenuine (Haydari dhe Kara 2015; Hobbs 2012).

Në seksionin tjetër prezantojmë dhe diskutojmë disa shembuj praktikash të bazuara në orët e mësimit që përpiqen të çlirojnë potencialin e MLE-së për të kuptuar dhe për të paraqitur në mënyrë kritike diversitetin në mjetet e informimit.

Raste studimore

Shembujt e praktikave të cilat do të fokusohemi në këtë paragraf u përkasin katër grupeve të nxënësve (rreth 25 nxënës për çdo grup) në shkollë të mesme, dy në Mbretërinë e Bashkuar dhe dy në Itali. Nxënësit e tre grupeve (dy në Itali dhe një në Mbretërinë e Bashkuar) përshkruhen nga mësuesit si nxënës me probleme në sjellje dhe të mësuar, që lidhen me disleksinë, mungesën e dijeve ose çrregullime të hiperaktivitetit dhe mungesës së vëmendjes. Veç kësaj, ata karakterizohen nga një mjedis i ulët socio-ekonomik (MSE), ndërsa vetëm njëri grup ka MSE të nivelit të mesëm. Shumica e pjesmarrësve ishin femra. Disa nga grupet ishin me etni të përziera, me shumë nxënës që vinin nga mjedise të përziera etnike (p.sh. grupi i Mbretërisë së Bashkuar me nxënës nga familje me të ardhura të ulta), të tjerët ishin më homogjenë me vetëm disa nxënës që vinin nga vende të tjera (p.sh të dy grupet në Itali).

Të gjitha grupet punonin me njësi nga Moduli 1. Ky modul fokusohet mbi mënyrën se si mjetete e informimit paraqesin, në vend që të reflektojnë, botën sociale. Seksioni analitik i tij trajton stereotipet verbale dhe vizuale që lidhen me gjininë, etninë, racën dhe paaftësinë e mishëruar në narrativat e ndryshme jo të shpikura mediatiche, në veçanti artikujt e gazetave, emisionet e lajmeve në TV dhe blogjet informative. Ndërsa veprimtaritë e orientuara nga prodhimi i ftojnë nxënësit të bëjnë zgjedhje rreth mënyrës se si të paraqesin ngjarjet e vërteta, sidomos ato që lidhen me diskriminimin dhe dhunën.

Në shembujt e raportuar më poshtë analizohen, natyrisht, si pikat e forta ashtu edhe ato të dobta të përvojave të përfituara në shkollë me qëllim identifikimin e faktorëve mundësues të strategjive efektive pedagogjike në MLE. Për të mësuar më shumë shihni gjithashtu Ranieri (2015, 2016) dhe Ranieri dhe Fabbro (2016)

Shembulli 1: Angazhimi i nxënësve me analiza kritike

Të gjitha grupet që morën pjesë në program kryen të paktën një aktivitet mbi paraqitjen e ndryshimeve në mediat e lajmeve. Ora e mësimit trajtoi teorinë e stereotipizimit, sidomos pesë teknikat e “stereotipizimit negativ” që mund të kontribuojnë për formimin si të Tjerë të grupeve sociale specifike. Fillimisht mësuesi prezantoi pesë teknikat bashkë me shembujt e aplikimeve të tyre konkrete në disa artikuj gazetash online. Mbas kësaj, nxënësve iu kërkua të identifikonin, analizonin dhe diskutonin më thellë rastet e mekanizmave të stereotipizimit në një artikull gazete online.

Shumë larg nga ajo çfarë prisnim, pjesëmarrësit nuk u angazhuan në këtë lloj analize. Mund të renditen pengesa të shumta që u hasën për realizimin e këtij aktiviteti në klasë (p. sh. akses i kufizuar në TIK, mungesë e njohurive rreth adresave në internet të mediave të lajmeve, koha e shkurtër), edhe pse kohëzgjatja e vërtetë e tyre në kohë dhe impakti negativ varionin nga një kontekst në tjetrin. Gjithashtu, të gjithë mësuesit identifikuan si barrierë kryesore të përbashkët mësimin e nxënësve brenda kornizës analitike të mishëruar në formularët që konsideroheshin “shumë të komplikuar” për tu aplikuar në adresat e lajmeve mbi baza ad hoc. Sipas mësuesve, prezantimi formal i pesë teknikave mbeti mjaft i paqartë për shumicën e nxënësve. Këto vëzhgime përputhen me mungesën në përgjithësi të angazhimit të nxënësve me këtë aktivitet specifik. Sigurisht, këtu vetëm pak nxënës ishin në gjendje, në rastin më të mirë, të aplikonin teorinë e dhënë që më parë, por pa ngritur pyetje mbi këtë teori në dritën e përvojave konkrete. Si përfundim, ky shembull i parë tregon se si korniza analitike nuk u ofron nxënësve ndonjë skemë të rëndësishme që do t’i ndihmonte në analizën e vërtetë kritike të stereotipizimit të medias së lajmit. Më gjerësisht, mund të deklarojmë që mësimi në fjalë dështoi dhe nuk arriti të lidhë teorinë rreth stereotipizimit me praktikën e analizave kritike.

Shembulli 2: Raportimi i diversitetit në mjetet e informimit

Një shembull i dytë konsistonte në një aktivitet të orientuar nga prodhimi që merrej me raportimin e diversitetit në mjetet e informimit. Në këtë aktivitet që u kërkonte nxënësve të rishkruanin një ngjarje të marrë nga lajmet pa riprodhuar stereotipet negative të mishëruara në artikullin origjinal të gazetës, u angazhuan të gjithë. Edhe në këtë rast detyra ishte mjaft përshkruese pasi në thelb i ftonte nxënësit të shmangnin “stereotipet negative”. Megjithatë, nxënësve nuk iu kërkua të ndiqnin udhëzime specifike për të raportuar diversitetin. Veç kësaj, ata kishin rol më proaktiv pasi mund të modifikonin tekstin e medias dhe të hartonin “alternativën e tyre paraqitëse”. Aktiviteti filloi me një punë grupi që “theu akullin”, duke i ftuar nxënësit të analizonin dhe diskutonin se si portretizohej një grup në minorancë në një ngjarje specifike të marrë nga lajmet. Tema e artikullit të gazetës në Itali ishte një incident që kishte ndodhur në një fabrikë kineze në Toskanë, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar ishte statusi i mirëqenies së emigrantëve rumunë. Në këtë analizë kritike u angazhuan me sukses të gjitha grupet. Në përgjithësi ata treguan deri diku aftësi për të kuptuar se si tiparet specifike gjuhësore dhe vizuale të artikullit kontribuonin në paraqitjen e emigrantëve kinezë dhe rumunë në një dritë negative. Kjo,

bashkë me përparimin e nxënësve që u vu re në përfundim të aktivitetit nëpërmjet një pyetësori final, sugjeron përmirësimin e tyre në të kuptuarin e mënyrës se si ngjarjet në lajme mund të riprodhojnë prezantime esenciale dhe/ose nënçmuese të minoriteteve etnike. Megjithatë, dy grupet e nxënësve në Itali nuk ishin në gjendje të ofronin prezantime alternative nëpërmjet produksioneve të veta mediatike. Sipas mësuesit të tyre, vështirësia në “raportimin e diversitetit” qëndronte në faktin se ata kishin të bënin me një gjini të panjohur të shkruari (raportimi gazetaresk), por mbi të gjitha për shkak të interesit të ulët të nxënësve drejt fakteve specifike dhe minoritetit etnik që trajtohej në artikull. Në dallim me ta, në Mbretërinë e Bashkuar, mundësia për nxënësit për të trajtuar atë çka në përvojën e tyre ishte çështje e spikatur dhe kontroverse ishte e një rëndësie kritike për tu angazhuar më shumë dhe për të mësuar më në thellësi rreth diversitetit. Mësuesi perceptoi te studentët një shqetësim të fortë lidhur me emigracionin dhe një qëndrim negativ të trashëguar nga prindërit, shumë prej të cilëve e shihnin emigracionin si kërcënim potencial ekonomik. Veç kësaj, përbërja e përzier etnike e këtij grupi e rriti më tej rëndësinë e emigracionit midis nxënësve. Si përfundim, grupi doli në konkluzionin që shumë nga shqetësimet e tyre mbi emigracionin në mediat e informimit ishin rezultat i hiperbolës dhe që kur jeton pranë emigrantëve dhe kupton formimin e tyre kulturor e shoqëror, shqetësimet kanë tendencën të zhduken.

Shembulli 3: Prezantimi i diversitetit nëpërmjet gazetarisë bashkëpunuese

Dy grupe, njëri në Mbretërinë e Bashkuar dhe tjetri në Itali, u angazhuan për të shkruar në bashkëpunim me njëri-tjetrin e në mënyrë jo diskriminuese një ditar që synonte diversitetet respektive. Ky aktivitet u karakterizuar nga tre detyra të ndërthurura që fillonin nga hartimi i një plani pune për mbledhjen e informacionit, duke u përpjekur të ishin sa më pluralistë që të qe e mundur, deri te përcaktimi i politikave për ditarin pjesëmarrës mbi diversitetin në shkollë. Ndonëse përvojat çuan në rezultate të ndryshme, ato ishin domethënëse për të nxjerrë në pah përfitimet direkte dhe indirekte të këtij aktiviteti.

Grupi në Mbretërinë e Bashkuar manifestoi deri diku interes në mundësinë për tu shprehur përmes një ditari online. Megjithatë, ata u përballën me vështirësi të mëdha në punën bashkëpunuese, sidomos kur i referoheshin çështjeve gjinore si dhe me të shkruarin. Gjatë punës në grup u hasën konflikte midis vajzave dhe djemve, ku djemtë shfaqnin sjellje të dhunshme për t'u mbyllur gojën vajzave ose duke i sulmuar ato. Megjithatë, sikurse theksoi një mësues, ky aktivitet solli përfitime të rëndësishme për sa i përket përfshirjes sociale, duke iu referuar në veçanti brezit të parë të emigrantëve të cilët kishin mundësinë t'u bashkoheshin grupeve që më parë kishin qenë të mbyllur. Veç kësaj, pati edhe disa episode të paplanifikuar të produkteve mediatike ku vajzat krijuan një faqe në Facebook kundër racizmit, ose nxënësit i shkruan letër anëtarëve të një këshilli duke sugjeruar një impakt pozitiv në praktikat e përditshme. Sa për aktivitetin me shkrim, ndonëse nxënësve iu duk i vështirë, disa prej tyre kërkuan nëse mund ta përsërisnin duke e organizuar këtë herë projektin final si një “produkt të përfunduar filmik” dhe jo thjesht si një detyrë me shkrim. Kjo kërkesë bashkë me komentet e mësuesit që theksonte se përdorimi intensiv i teksteve të shkruar për të përshkruar aktivitetet mund të jetë pengesë për pjesëmarrjen e

plotë tregon që prëdorimi më i madh i formateve multimediale mund të rrisë përfshirjen. Me fjalë të tjera, angazhimi i studentëve me veprimtari gazetarie nuk ishte problem në vetvete, por për të arritur një pjesëmarrje më të madhe duheshin parashikuar edhe gjuhë të tjera.

Duke u rikthyer te grupi italian, nxënësit arritën të prodhojnë pesë artikuj që mbulonin forma të ndryshme të diskriminimit. Njëri nga artikujt titullohej *Kthehu prapë në vendin tënd! Një vajzë 11 vjeçare italo-amerikane e diskriminuar* trajtonte temën e diskriminimit në lidhje me origjinën gjeografike dhe bënte fjalë për historinë e një nxënëseje që ngacmohej për origjinën e vet derisa qe detyruar të ndërronte shkollë. Një artikull tjetër i titulluar *Viterbese* (dialekti i folur në Vitervo, shënim i redaktorit): *Ky nuk është italian* shkruante për zhgënjimin e një vajze nga Vitervo e cila kritikohet nga moshatarët e saj sepse fliste me theks të ndryshëm nga ai fiorentinas. Çështjet gjinore ishin në qendër të artikullit *Shërbyese? Jo, faleminderit!*, ku një vajzë denonconte dhe kritikonte “stereotipin e gruas shërbëtore” (nxjerrë nga artikulli i nxënëses). Ky stereotip u shfaq nga një akt diskriminimi (d.m.th një ftesë për të marrë pjesë në një festë, por thjesht për të pastruar dhomat), i bërë nga moshatarët e saj. Çështja e diskriminimit gjinor ishte gjithashtu subjekt i artikullit *Homofobia në shtëpi* që akuzonte paaftësinë e familjes për të pranuar “një diversitet në sferën seksuale të famijës së tyre” (nxjerrë nga artikulli i nxënësit), që tregonte historinë e A.G., një vajzë 17 vjeçare nga Firenze, e cila zbuloi se kishte rënë në dashuri me një vajzë, por që babai i së cilës nuk donte ta pranonte këtë realitet.

Dhe artikulli i fundit titullohej *Bullizmi në shkolla ka të bëjë me çështjen e aftësisë së kufizuar*. F.F. ankohej publikisht për herë të parë rreth fyerjeve që i bëheshin vazhdimisht një moshatari të tij për shkak të bëlbëzimit dhe i karakterizonte këto fyerje si akt bullizmi.

Këta artikuj treguan që nxënësit jo vetëm ishin të aftë të kuptonin në mënyrë kritike diskriminimin por gjithashtu ta lidhin veten me të dhe të shkëmbejnë përvojat personale të lidhura me diskriminimin brenda komunitetit të tyre. Ndonëse mjedisi shoqëror ishte i ngjashëm me atë të bashkëmoshatarëve të tyre në Mbretërinë e Bashkuar, ka të ngjarë që ata e përmbushën detyrën më mirë falë një klime më pozitive që karakterizonte klasën dhe që u lejonte të shkëmbejnë histori sensitive personale të diskriminimit.

Mësimet e Nxjerra dhe Konkluzionet

Ndërhyrjet MLE të paraqitura dhanë prova se janë veçanërisht të rëndësishme nga dy këndvështrime. Në disa raste, ato favorizonin zhvillimin e dinamikave gjithëpërfshirëse brenda klasës, me anë të të cilave nxënësit më të margjinalizuar dolën në skenë për të kontribuar në aktivite ose për të denoncuar (verbalisht ose psikologjikisht) episodet e dhunës me të cilat ishin përballur në shkollë ose jashtë saj. Në raste të tjera, përmirësuan gradualisht kapacitetin e tyre për të menduar për veten në raport me diskriminimin, duke shprehur ndërgjegjësimin e ri nëpërmjet materialeve krijuese (p.sh. duke shkruar një artikull në lajme) dhe ndryshimittë një situatë diskriminimi në mundësi për të fituar fuqi. Megjithatë, në po të njëjtën linjë me studime të spikatura të fushës (p.sh. DeBlock dhe Buckingham 2007), shembujt tanë sugjerojnë se si në përgjithësi është më produktive kur analizat kritike dhe produktet mediatike lidhen me shqetësimet e vetë nxënësve, shijet dhe

identitetet se sa kur i angazhon ata në analiza më abstrakte ideologjike, apo detyrohen të përshtasin qëndrime të mësuarit rreth medias që janë shumë direktive. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të promovohet të kuptuarit kritik i mediave të informimit dhe i diskriminimit nëpërmjet MLE-së duhet të jemi të ndërgjegjshëm se si zgjedhjet tona, për sa i përket termave të përmbajtjes, metodave dhe gjuhëve, mund të mbështesin ose, në disa raste, të pengojnë pjesëmarrjen e nxënësve në përfshirjen sociale. Duke qenë se nxënësit mund të vijnë nga mjedise kulturore të ndryshme, veprimtaritë MLE mund të transformohen në akte qytetarie kur analizat mediatike dhe produktioni lidhen me interesat dhe pasionet e nxënësve.

Referenca

- Bragg, S. (2002) Wrestling in wholly gloves: Not just being 'critically' media literate. *Journal of Popular Film and Television* 30(1), pp. 42–52.
- Buckingham, D. (ed.) (1998) *Teaching Popular Culture: Beyond Radical Pedagogy*. London: UCL Press.
- Buckingham, D. (2003) *Media education. Literacy, learning and contemporary culture*. Cambridge: Polity Press.
- De Block, L. and Buckingham, D. (2007) *Global Children, Global Media: Migration, Media and Childhood*. New York: Palgrave Macmillan.
- Gutierrez, K.D. (2008) Developing a sociocritical literacy in the Third Space. *Reading research quarterly*, 43(2), pp. 148-164.
- Hall, S. (1997) *Representation: Cultural Representations and Signifying Practices*. London: Sage.
- Haydari, N. and Kara, M. (2015) A collaborative media production project on human rights: Bridging every day and media education. *Innovations in Education and Teaching International* 52(4), pp. 383–392.
- Hobbs, R. (2012) *Digital and Media Literacy: Connecting Classroom and Culture*. Thousand Oaks, CA: Corwin/Sage.
- Masterman, L. (1985) *Teaching the media*. London: Comedia.
- Ramasubramanian, S. (2007) Media-based strategies to reduce racial stereotypes activated by news stories. *Journalism and Mass Communication Quarterly* 84(2), pp. 249–264.
- Ranieri, M. (ed.) (2015) *e-Engagement against Violence: Tools for Media and Citizenship Education*. Rome: ARACNE International.
- Ranieri, M. (ed.) (2016) *Populism, Media and Education: Challenging Discrimination in the Digital Contemporary Societies*. London-New York: Routledge.
- Ranieri, M. and Fabbro, F. (2016) Questioning discrimination through critical media literacy. Findings from seven European countries. *European Educational Research Journal*, pp. 1-18. DOI: 10.1177/1474904116629685.
- Synder, I. (2015) Discourses of 'curation' in digital times. In R. H. Jones, A. Chik and C. A. Hafner (eds), *Discourses and Digital Practices: Doing Discourse Analysis in the Digital Age*, pp. 209–223. Abingdon: Routledge.
- UNESCO (2014) *Global Citizenship Education: Preparing Learners for the Challenges of the 21st Century*. Paris: UNESCO.
- Yanovski, R. (2002) *Reporting Diversity. A Guide to Reporting Diversity*. Sofia, Bulgaria; ACCESS Association.

Alfabetizimi në Media dhe Informim, Gjuha e Urrejtjes dhe Edukimi për Tolerancë

Rast studimor i Rrjeteve Sociale në Brazil

Marcelo Andreade & Magda Pischetola

Zgjerimi i mediave sociale në dekadën e fundit ka patur pasoja që nuk priteshin lidhur me radikalizimin, ekstremizmin dhe gjuhën e urrejtjes. Mundësia e anonimatit, mungesa fizike e interlokutorëve dhe izolimi në një moment kur individit po ndërton arsyetimin e vet argumentues janë faktorë të mundshëm që kontribuojnë drejt këtij fenomeni. Ky artikull fokusohet mbi rëndësinë e Alfabetizimit në Media dhe Informim (MIL) në këtë peizazh. Ai paraqet një rast studimor brazilian të një konflikti të kohëve të fundit në lidhje me gjuhën e urrejtjes, e cila u rrit në mediat sociale, dhe përfshinte një anëtar të Kongresit federal dhe revistën edukative Nova Escola. Në një mesazh video në faqen e tij mjaft të ndjekur në Facebook, politikani sulmoi revistën për shkak të imazhit në kopertinë ku një djalë i ri shfaqet i veshur si princeshë. Veç kësaj, ai vazhdon të kritikojë materialet e edukimit seksual që ofron qeveria, sidomos ngaqë ato e përmendin homoseksualitetin si diçka "normale". Analiza jonë e komenteve më të përhapura mbi videon tregon se si gjuha e diskriminimit dhe e urrejtjes dominojnë në masë të madhe opinionet e përdoruesve. Nga ana tjetër, përgjigjja e revistës nëpërmjet një forme të edituar të mesazhit origjinal video, përfaqëson një përpjekje të qartë për të korriguar informacionin e burimet e tij si dhe për tu dhënë mundësinë qytetarëve të sfidojnë besimet e veta, në mënyrë që të angazhohen në mënyrë kritike me këto çështje. Në mbyllje, artikulli diskuton MIL-in në dialog me edukimin për tolerancë. Ai argumenton që zhvillimi i tolerancës në mediat sociale do të kërkojë zhvillimin e tre aftësive themelore: (i) aftësinë për të kërkuar burimet e informacionit dhe për të ndërtuar sensin kritik; (ii) aftësinë për të respektuar dhe vlerësuar dallimet midis qenieve njerëzore dhe shoqërive multikulturore; (iii) aftësinë për të pranuar dhe artikuluar, në një perspektivë etike, konceptet e "minimumit të drejtësisë" dhe "maksimumit të lumturisë". Mënyra se si zhvillojmë aftësitë për MIL-in dhe si i shoqërojmë ato me edukimin për tolerancë do të përcaktojë nëse promovojmë dialog kritik dhe të respektueshëm në mediat sociale apo do t'i dorëzohemi gjuhës së urrejtjes që përhapet online.

Fjalëkyç: Alfabetizimi në Media dhe Informim (MIL), gjuha e urrejtjes, edukim për tolerancë, media sociale

Mediat sociale dhe “gjuha e urrejtjes”

Mediat digjitale dhe Interneti kanë sjellë ndryshime thelbësore në të gjitha aspektet e jetës njerëzore. Sot përfshijmë mundësinë e të qenurit jo vetëm konsumatorë por gjithashtu prodhues të informacionit dhe krijues të përmbajtjes, gjithashtu jemi në gjendje të arrijmë audiencën të gjera online. Në dekadën e fundit, mediat sociale e kanë transformuar natyrën e grupeve dhe marrëdhëniet e pushtetit, duke u lejuar individëve të shoqërohen dhe të organizohen vetë në mënyrë spontane, bazuar në interesat e përbashkëta, brenda një sistemi që paraqet fleksibilitet shoqëror dhe rrjedha të shpejta komunikimi (Gee, 2009).

Në këtë kuadër ka qenë e nevojshme të rishikohet kuptimi i konceptit të “alfabetizimit” për të përfshirë aftësi të tjera, përtej zotësisë për shkrim e këndim, si: përzgjedhja e përmbajtjes, interpretimi edhe në formate dhe gjuhë të ndryshme; gjykim dhe mprehtësia për të vlerësuar burimet e informacionit; analiza kritike; aftësitë për tu shprehur dhe komunikuar; praktikat e bashkëpunimit mes hapësirave të ndryshme të ndërveprimit. Koncepti i Njohurive në Media dhe Informim, nga theksi mbi aftësitë teknike, ka kaluar drejt një fokusi mbi subjektin dhe potencialin e tij për të shprehur veten. Gjithashtu, ai ka përfshirë një aspekt reflektiv rreth konteksteve sociale të shkrimit dhe leximit. Duke patur në thelb përfshirjen sociale, MIL-i është interpretuar gjithashtu si aftësi për të marrë pjesë në procese demokratike nëpërmjet përdorimit të kanaleve të komunikimit online (Carpentier, 2012; Warschauer, 2003).

Megjithatë, studime të dekadës së fundit kanë zbuluar që mediat sociale mund të bëhen gjithashtu mjedis pjellor për shprehjen e urrejtjes. Ato përfaqësojnë një hapësirë publike të aftë për të replikuar dhe radikalizuar konfliktet prezente në realitetin social (Daniels, 2008; Duffy, 2003). Anonimiteti që supozohet të kenë, mungesa fizike e interlokutorëve dhe izolimi në momentin kur individit ndërton arsyetimin e vet argumentues janë faktorë të mundshëm që kontribuojnë drejt këtij fenomeni: përhapja e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale.

Por si mund të identifikojmë (dhe përkufizojmë) gjuhën e urrejtjes? Konceptualizimi i urrejtjes nuk është detyrë e lehtë. Nga njëra anë, ajo duket se është ndjenjë zemërimi ose shprehje e dhunës. Nga ana tjetër, ajo kuptohet thjesht si e kundërta e dashurisë ose paaftësia për të dashur (Gerstenfeld, 2003). Nga kjo perspektivë, urrejtja do të ishte thjesht një mungesë, kaq, mungesa e ndjenjave të mira dhe do të shkaktohej nga mungesa e oportunitetit për të provuar të mirën, ose për tu edukuar në një mjedis të dashur.

Sipas Fjalorit të Akademisë Braziliene të Letrave, urrejtja përkufizohet si “ndjenjë indinjate ose zemërimi kundër dikujt ose diçkaje”. Ajo përshkruhet gjithashtu si “armiçësi, neveri dhe antipati”. Megjithatë, ajo nuk është vetëm një emocion kalimtar ose momental. Ajo nuk duhet ngatërruar me ndonjë formë acarimi. Urrëjtja është ndjenjë e fortë, e thellë dhe që zgjat.

Përtej identifikimit të urrejtjes si ndjenjë, Gluckmann (2007, p.11) pretendon që “urrejtja ekziston”, është përvojë konkrete, dhe që “të gjithë e kemi hasur, si në mikro shkallën e individit ashtu edhe thelb të kolektivave jashtëzakonisht të mëdha”. Në këtë mënyrë, urrejtja është më shumë se një ndjenjë e fortë, e thellë dhe që zgjat. Ajo reziston dhe përjetësohet si gjuhë, të cilën Gluckmann (2007, f.12) e quan “gjuhë e urrejtjes”:

Me ornamentet e veta tradicionale – zemërim, tërbim, kafshëri, egërsi – me të cilat shfaq gjithë arsenalin e vet, urrejtja akuzon pa e ditur. Urrajtja gjykon pa dëgjuar. Urrajtja dënon si t'i dojë qejfi. Ajo nuk respekton asgjë dhe beson se po përballlet me ndonjë lloj komploti universal. E rraskapitur, plot indignatë, ajo shqyen çdo gjë me goditjen e vet arbitrare dhe të fuqishme. Unë urrej, prandaj ekzistoj.

Sipas autorit, urrejtja nuk është fenomen irracional, i kufizuar në fushën e ndjenjave të errëta, por është gjuha, pikërisht ajo, edhe kur nuk u reziston dot kundërgjykitimeve ose nuk ofron arsye të mjaftueshme për justifikimin e vet, urrejtja është mënyrë e artikuluar dhe e qëllimshme të shprehuri, e cila përpunohet nëpërmjet gjuhës verbale, sikurse do të shfaqet qartë në analizën që do të paraqesim këtu.

Provat nga studimi ynë tregojnë që gjuha e urrejtjes është njëkohësisht irracionale (pa arsye të mjaftueshme etike që ta mbështesin), dhe rracionale (me gjuhë dhe argumente të artikuluar fuqishëm). Kështu, urrejtja është fenomen që duhet pranuar dhe çmontuar, për shkak të dobësisë së vet etike. Në përgjigjësi, nga pikëpamja argumentative ajo është e brishtë, por nuk duhet nënvleftësuar kapaciteti i saj për të shkatërruar marrëdhëniet sociale. Këto vëzhgime na detyrojnë të marrim në konsideratë gjuhën e urrejtjes – sidomos atë që ka shpërthyer në mediat sociale – si argument dhe çështje e domosdoshme që duhet trajtuar në studimet dhe praktikën pedagogjike.

Ekzaminimi i rasteve aktuale të gjuhës së urrejtjes – mizogjinisë, racizmit, homofobisë, fundamentalizmit dhe anti-Semitizmit – Gluckmann (2007, f. 265 – 270) prezanton shtatë përfundime rreth gjuhës së urrejtjes: (i) urrejtja ekziston, dhe nuk është thjesht mungesa e së mirës dhe e dashurisë; (ii) urrejtja maskohet, ajo e fsheh veten pas alibive të rreme që përipiqen ta justifikojnë; (iii) urrejtja është e pangopur, ajo nxit një valë të pareshtur argumentesh që nuk njohin armëpushim dhe nuk pranojnë dialog me atë çka është ndryshe; (iv) urrejtja premteton parajsën, ajo e paraqet veten si e keqja e domosdoshme për të arritur në një situatë më të mirë nga ajo ku ndodhen aktualisht; (v) urrejtja dëshiron të jetë zot krijues, ajo është vënë në gjurmët e fjalimeve moraliste fetare dhe të skepticizmit të modernizmit; (vi) urrejtja dashuron vdekjen, ajo do eliminimin e atyre që nuk ndajnë me të parakushtin e supozuar si i vetmi kod moral korrekt dhe i pranueshëm; (vii) urrejtja ushqehet duke ngrënë si e pangopur veten, ajo është gjuhë që mbyllet brenda vetvetes, që përsërit logjikën e vet të brendshme deri në rraskapitje, pa dialoguar dhe pa ndjeshmëri karshi atyre që mendojnë ndryshe.

Literatura mbi këtë temë (Daniels, 2008; Glucksmann, 2007) hedh dritë mbi disa grupe që në mënyrë të qëllimshme promovojnë gjuhën e urrejtjes nëpërmjet platformave të ndryshme digjitale dhe formave të shumta të komunikimit, të cilat përzgjidhen sipas objektivave specifike politike. Në këtë kontekst, është provuar që mediat sociale janë hapësira e preferuar e ekstremizmit për ekspansion, kjo për shkak të anonimitit që mendohet se gëzojnë si dhe vendit relativisht të pakushtueshëm për komunikim në shkallë të gjerë (Daniels, 2008). Veç kësaj, mediat sociale pavarësisht se janë hapësira publike, ruajnë disa forma komunikimi në regjistra potencialisht gjysmë private.

Duke patur këto parasysh, pranojmë që rregullorja e gjuhës së urrejtjes në median sociale është në kufijtë e dilemës etike midis lirisë së shprehjes dhe respektit për identitetin

dhe opinionet e minoriteteve, të parashikuara në parimet bazë të Deklartës Universale të Drejtave të Njeriut (Nemes, 2002). Pyetja që ngrihet atëherë mund të jetë se kur dhe si duhet ndërhyrë për të siguruar një të drejtë ose një tjetër. Ne e dimë që e drejta e fjalës nuk është e drejtë e pakufizuar dhe që ndjesia e fyerjes mund të marterjalizohet gjithmonë. Në rastin e analizuar këtu do të eksplorojmë disa dimensione midis këtyre kufijve.

Një debat online: Bolsonaro kundër Nova Escola-s

Jo gjithmonë fjala është e lirë. Pabarazitë në pushtet, të institucionalizuara nëpërmjet ekonomisë, roleve gjinore, klasave sociale dhe mediave në pronësi të korporatave sigurojnë që jo të gjithë zërat mbartin të njëjtën peshë”. (Boler, 2004, f.3). Ky vëzhgim është edhe më serioz kur aplikohet për një figurë publike, si për shembull një politikan i njohur, i cili jep opinionet e veta nëpërmjet mediave sociale, platformave si Facebook, Twitter, Youtube dhe Instagram. Ky është saktësisht rasti i debatit mediatik që ndodhi në Brazil në janar të vitit 2016, midis kongresmenit federal Jair Bolsonaro dhe revistës dukative Nova Escola.

Jair Bolsonaro është ushtarak në pension që aktualisht ka fituar mandatin e gjashtë si kongresist për Rio de Janeiro-n. Në 27 vitet e jetës së tij politike. Bolsonaro i përkiste gjashtë partive të ndryshme politike (PDC, PFL, PTB, PPB, PPR dhe PP), të cilat mund të identifikohen të gjitha si të krahut të djathtë ekstrem në skenën politike braziliane.

Bolsanaro është një nga zërat e fuqishëm të konservatorizmit në Brazil. Argumentet e tij në përgjithësi janë tejet të thjeshtëzuar dhe një dimensionale, gjë e cila bën që të angazhohet shpesh në procese gjyqësore të nisura nga organizata të të drejtave të njeriut. Shembuj të shumtë kundërshtish që përfshijnë politikanë mund të pranohen fare lehtë si shembuj të gjuhës së urrejtjes:

- Në një intervistë me revistën *Veja* (dhjetor 1998), kongresisti deklaronte që diktatura e Pinoçetit në Kil “duhet të kishte vrarë më shumë njerëz”;
- I pyetur në programin televiziv *CQC* (mars 2011), se çfarë do të kishte bërë në qoftë se i biri do të ishte ngatërruar me drogë, u përgjigj që “Do ta kishte rrahur, të jeni të sigurt për këtë”;
- Në një intervistë me revistën *Isto É* (prill 2011), ai mbështeste torturën, duke u justifikuar që ajo ka “si objektiv të lëndojë dikë deri sa të hapi gojën”;
- Në portalin *Terra* (qershor 2011), ai deklaronte që “Më mirë ta kem djalin të vdekur se homoseksual”;
- “Kam paragjykimet e mia, jam shumë krenar” ishte titulli i intervistës së tij me revistën *Época* (korrik 2011);
- “Nuk diskutoj për imoralitetin” ishte përgjigjja që raportoi portali i lajmeve *G1* (gusht 2013), për pyetjen se çfarë do të kishte bërë në qoftë se i biri martohej me një grua me ngjyrë;

- “Jam kundër kuotave raciale sepse minoritetet nuk duhen mbrojtur”, pohoi në një intervistë në programin televiziv *Programa do Ratinho* (May 2014);
- “Nuk të përdhunoj sepse nuk ti nuk ia vlen”, ishte deklarata e tij për Maria do Rosário Nunes, kongresiste federale dhe Ministre për të Drejtat e Njeriut në qeverinë e Dilma Rousseff-it (dhjetor 2014).

Siç shihet, Bolsonaro nuk i shmanget pohimeve dhe deklaratave fyese të papranueshme për korrektesën politike. Ndoshta, aty qëndron një pjesë e magjepsjes që ai ushtron mbi median dhe zgjedhësit e tij: ai thotë atë që mendojnë shumë njerëz por nuk kanë kurajon ta pranojnë publikisht. Është e rëndësishme të mos harrojmë që Bolsonaro është politikan i mirënjohur. Në vitin 2014, ai ishte kongresisti më i votuar në Rio de Janeiro (464.000 vota; 6% e elektoratit). Kjo përzierje midis të qenurit konservator dhe popullaritetit të lartë bëri që gazeta *El Pais* (tetor 2014) ta përshkruajë atë si “fenomen shqetësues i politikave braziliane”.

Për ta përmbledhur, agjendat kryesore të Bolsanaro-s kanë qenë sa vijon: opozitë kundër martesave brenda të njëjtës gjini; opozitë kundër adoptimit të fëmijëve nga çifte të së njëjtës gjini; opozitë kundër nismave për të diskutuar në shkollat publike çështje gjinore dhe seksuale, sikurse do ta shohim në rastin që analizohet në këtë material. Gjuha e tij mbron gjithmonë “familjen tradicionale” dhe “moralitetin kristian”. Padyshim, Bolsonaro është fenomen i mirënjohur dhe ultrakonservator në Brazil.

Në 10 janar 2016, duke përdorur gjuhën e urrejtjes, kongresisti nisi një debat të ri. Ai postoi në faqen e tij në Facebook një mesazh video me akuza kundër Ministrisë së Arsimit (MEC) të qeverisë së Dilma Rousseff-it, akuza që kishin të bënin me shpërndarjen e teksteve shkollore dhe të broshurave për edukimin seksual në shkollat publike. Në këtë video ai sulmonte gjithashtu revistën *Nova Escola*¹ për shkak të kopertinës (shkurt 2015) me titull “A duhet të flasim për të?”, në të cilën shfaqet një djalë 5 vjeç i veshur si princeshë. Sipas kongresistit, materialet janë pjesë e një strategjie politike të Partisë së Punëtorëve, PT, të përmbledhur në katër pika: (i) PT synon të mos njohë pedofilinë si krim; (ii) Programi *Bolsa Familia*² konsiderohet më i rëndësishëm nga PT se sa dinjiteti i fëmijëve; (iii) politikat e miratuara nga PT do të përkeqësojnë arsimin publik; (iv) shkollat publike do të transformohen nga PT në “komitete të partive politike”.


Mesazhi video pati brenda javës 7 milion shikime dhe u shpërnda në rrjetet sociale më shumë se 250 mijë herë, ai u komentua dhe u pëlqye nga mijra njerëz. Në një përpjekje të parë për të bërë analizën e debatit, ekzaminuam një ekstrakt prej 50 komentesh që kanë marrë numrin më të madh të përgjigjeve dhe të “like”-ve në ditët e para mbas postimit. Objektivi është të investigojmë se sa shpesh përdoret gjuha e urrejtjes nga komentuesit.

Rezultatet e nxjerra nga analiza paraprake mund të përmbledhen si vijon:

- Pothuajse gjysma e komenteve të analizuara (21) përdorin tone agresive, të ndezura dhe shpesh fyese, ndaj i kemi kategorizuar si gjuhë që mbart urrejtje;
- Disa komente (4) kanë tone ironike dhe provokative kundër pjesëmarrësve në debat të cilët nuk ishin dakort me mesazhin e politikanit, gjë e cila na bëri t'i lidhim këto katër komente me 21 të tjerët të përmendur më parë si shembuj të gjuhës së urrejtjes;

- Një numër konsistent komentuesish (16) fokusohet në shprehjen e mbështetjes për kongresistin, përgjithësisht me fjalë patriotike dhe mesazhe emocionale;
- Dhe në fund, një pakicë pjesëmarrësish (9) kontribuan në mënyrë më të kualifikuar në debat duke kërkuar sqarime mbi të dhënat e ofruara dhe burimet e tyre, dhe/ose duke postuar material që përfshin këtë informacion.

Figura 1. Analiza e komenteve të videos së Jair Bolsonaro-s, janar 2016



Vetëm komentet e fundit – të prezantuara në grafikun sipër si “Informacion” – shfaqnin tone respekti lidhur me perspektivat e ndryshme dhe nuk zbulonin qëllime të tjera përtej synimit për të mësuar më shumë rreth çështjes së debatuar.

Sipas Glucksmann-it (2007, f.266), shprehja eksplicite e gjuhës së urrejtjes nuk është diçka neutrale dhe as pa një drejtim. Përkundrazi, “ajo zgjedh me kujdes gjithçka që adhuron dhe urren, në mënyrë që të urrejë edhe më shumë e të gjejë mënyra për të urrerë pafund e pareshtur”. Objektivi mund të jenë gra, njerëz me ngjyrë, homoseksualë, hebrenj, të huaj, kushdo që sipas logjikës standarde shihet i ndryshëm ose devijant.

Nga të dhënat e mbledhura mund të shihet që objektivi kryesor i Bolsonaro-s është çështja gjinore në arsim. Ai dënon haptazi çdo mbrojtje që i bëhet identitetëve gjinore dhe/ose seksualitetëve që nuk i përkasin moralit mbizotërues. Në këtë kontekst, për shembull, popullsia LGTB sulmohet verbalisht. Në përgjithësi, modeli i sulmit shfaq tone moraliste të përsëritura nëpërmjet komenteve që mbështesin pozicionin e kongresistit.

Pesë ditë mbas këtij postimi, revista Nova Escola, për t’iu përgjigjur akuzave të Bolsonaro-s e për të nxjerrë në pah gabimet e tij, publikoi një video me titull “Kontrollimi i Informacionit” (Checagem de Informações).

Pikë së pari, vlen të përkujtohet mesazhi video i publikuar nga kongresisti. Bolsonaro i referohet broshurës “Shkollë pa Homofobi” (Escola sem Homofobia³) me shprehjen “kit gay”, duke ia ulur vlerat dhe duke e skualifikuar si material të papërshtatshëm për të qarkulluar në shkollë. Më pas, me tone alarmiste, ai kritikon një tjetër material mbi edukimin seksual, librin “Aparati Seksual & Co” (Aparelho Sexual e Cia) i cili, sipas tij, ishte shpërndarë nga Ministria e Arsimit (MEC) në shkollat braziliane për fëmijët e moshës 6 vjeçare e që do të sjellë si rezultat “një nxitje të hershme seksuale për fëmijët” dhe “do t’i hapë dyert pedofilisë”. Bolsonaro komenton gjithashtu mbi disa pjesë specifike të librit e

thotë që ka mbetur i habitur kur ka gjetur aty informacion që lidhet me homoseksualizmin, pasi – pohon ai – “kjo nuk është normale”. Dhe në fund, kongresisti prezanton revistën Nova Escola si një tjetër libër që ai pretendon se është blerë dhe shpërndarë nga MEC në shkollat publike të Brazilit. Ai kritikon kopertinën e saj dhe akuzon Qeverinë Federale që “po çorodit fëmijët”.

Përgjigjja me video e Nova Escola-s hedh poshtë hap pas hapi çdo pohim të bërë nga kongresisti. Duke përdorur si mjet vizual pauzat në videon origjinale, shqyrtimi që i bëhet videos përgënjeshtrohet të gjitha idetë e gabuara dhe çmonton gjuhën e urrejtjes kundër popullatës LGBTB duke treguar burimet që mbështesin një debat të hapur rreth gjinisë dhe seksualitetit në shkollë.

Së pari, gjatë shqyrtimit jepet link-u i materialit “Shkollë pa Homofobi” dhe përmenden komentet pozitive të ekspertëve në pedagogji. Për më tepër, citohet shënimi zyrtar me të cilin MEC shpjegon që ky libër nuk është material didaktik për shkollat publike⁴. Në video korigjohet gjithashtu kongresisti rreth moshës së cilës i drejtohet materiali (më shumë se 11, dhe jo 6 vjeçarë). Së dyti, revista i kujton politikanit dhe publikut të tij që Organizata Botërore e Shëndetsisë e ka hequr homoseksualitetin nga lista ndërkombëtare e sëmundjeve në vitin 1990, prandaj, “ky” pranohet publikisht si “normal”. Në fund, videoja shqyrtuese tregon që kongresisti e ngatërron Nova Escola-n dhe e quan tekst shkollor. Në përgjigje të këtij gjykimi të gabuar, videoja përgjigje shpjegon: “Nova Escola nuk u drejtohet nxënësve. Ajo është revista më e madhe që botohet për mësuesit në Brazil. Asnjë kopje e Nova Escola-s nuk është blerë nga Qeveria Federale. Nova Escola nuk mbështet PT-në, ajo i përket fondacionit Victor Civita, i cili është pjesë e grupit të biznesit privat Abril. Për më tepër, kopertina në fjalë ishte zgjedhur si kopertina më e mirë e vitit 2015 nga shoqata kombëtare braziliane e botuesve (Associacao Nacional dos Editores de Revistas⁵).

Është e qartë që ajo çfarë motivoi këtë përgjigje me video për Bolsonaro-n ishte interesi i Nova Escola-s për të mbrojtur veten nga shpifjet e lartpërmendura në sytë e audiencës. Gjithshtu, ajo që na tërheq vëmendjen është fakti që kjo iniciativë përfaqëson një mësim të vërtetë për MIL-in: të gjitha gabimet korigjohen në detaje; burimet e informacionit janë paraqitur qartazi; pavarësisht se mbrojtja bëhet nga një këndvështrim krejt i kundërt, ajo ruan tonet e respektit për opinionet e kongresistit dhe të pasuesve të tij. Ajo që mund të perceptojmë është që videoja përpiket të mos thellojë kundërshtitë, por të japë informacion që ishte fshehur në videon fillestare dhe, çka është më e rëndësishme, pa ndonjë gjurmë të gjuhës së urrejtjes. Kësisoj, Nova Escola performon një ushtrim elegant të MIL-it duke ia vënë atë përballë opinionëve plot zemërim e pa themel të paraqitura në videon fillestare.

Videoja e publikuar nga Nova Escola u pa më shumë se 4.5 milion njerëz. Në faqen e revistës në Facebook, e cila u dynd nga komentet, është shfaqur një listë rregullash për rregullimin e debatit online. Është me interes të theksohet i pari (i cili mori brenda pak minutash 5000 like): “të gjitha komentet fyese do të fshihen nga ky mur”. E kësijoj përsëri përballemi me dilemën midis lirisë së fjalës dhe fyrtjeve kundër pakicave. Pohimi merr qartazi pozicion kundër komenteve që dhunojnë dinjitetin e individëve dhe institucioneve. Megjithatë, komenti i një lexuesi tërhoqi vëmendjen tonë: “mund të prezantoni mijëra burime që e kundërshtojnë këtë njeri [Bolsonaro-n], por njerëzve të tjetërsuar u pëlqen më shumë gjuha injorante e urrejtjes”. Pra, a duhet të pranojmë që është e pamundur të kapërcehet gjuha e urrejtjes? Ne besojmë që, sado e vështirë të jetë, kjo është sfidë që duhet trajtuar, ndaj nëpërmjet MIL-it dhe edukimit propozojmë këtu tolerancë.

Edukimi i brezave të rinj: MIL dhe Toleranca

Sipas Soares-it (2002), dija është proces që shtrihet përgjatë gjithë jetës dhe që kërkon përshtatje të vazhdueshme me kontekstin social kulturor dhe gjuhët e reja. Këto praktika sociale janë në transformim konstant në një botë që ndryshon, dhe për këtë arsye, konsiderohen gjithmonë të “reja”. Padyshim, dije inovative – sikurse vlerësojmë që është edhe MIL-i- është ajo që nuk e kufizon veten e nuk transferon të njëjtat qasje drejt një teknologjie të re, por që nxit praktika të reja, sjellje, vlera dhe mënyra të menduari (Lankshear & Knobel, 2007).

Është evidente që në botën online konvergjojnë me njëra-tjetrën mjaft praktika të ndryshme sociale: informacioni dhe argëtimi; puna dhe kënaqësia; lokalja dhe globalje; publikja dhe privatja; gjuha e urrejtjes dhe gjuha e respektit. Në këtë kontekst, është urgjente të edukojmë të rinjtë në mënyrë që të bëhen kritikë në përdorimin e mediave sociale, jo vetëm lidhur me mesazhet e shkruar, por gjithashtu edhe të përmbajtjes që prodhohet në formate të tjera: audiovizive, imazh, muzikë, animacion ose hipertekst. Brezat e rinj kanë nevojë të zhvillojnë mendimin e pavarur dhe kritik, të ushtrojnë aftësitë krijuese prodhuese, duke respektuar gjithmonë opinionet e të tjerëve (Daniels, 2008; Jenkins, 2009). Kështu, duket se ka prova që tregojnë se t'u mësohet të rinjve të dëgjojnë dhe lexojnë pa rënë në gjuhën e urrejtjes, pavarësisht provokimeve, është element thelbësor i MIL-it. Këto vëzhgime na bëjnë të argumentojmë që në shoqëritë pluraliste që përdornin median për të komunikuar dhe ndërvepruar me të tjerë, toleranca është element i domosdoshëm i dijes, gjë e cila kontribuon në shmangien e gjuhës së urrejtjes.

Kur shohim më nga afër në debatin online midis kongresistit Bolsonaro dhe revistës Nova Escola, bëhet mjaft e qartë rëndësia e tolerancës, sidomos duke patur parasysh komentet e analizuar në videon e parë. Sikurse shpjegon Augras (1997, f. 78): “Kur flasim për tolerancën, në fakt flasim për intolerancën”.

Ky studim ka ngritur pyetje të rëndësishme rreth natyrës së gjuhës së urrejtjes dhe marrëdhëniet e saj me dijen dhe tolerancën. Si përfundim, ne identifikojmë tre aftësi themelore të cilat MIL-i në perspektivën e edukimit për tolerancë duhet t'i përforcojë.

Së pari, ne argumentojmë që kërkimi i informacionit dhe formimi i sensit kritik janë aftësi të domosdoshme që i përgatisin të rinjtë për kurthet e gjuhës së urrejtjes. Është shqetësuese që shumica e kometicuesve në mediat sociale të analizuar nuk i kontrollojnë të dhënat që u ofrohen, dhe kanë dhënë mbështetjen e tyre të pakushtëzuar për gjuhën agresive të Bolsonaro-s. Duhet pranuar që, në shoqëritë multikulturore si ajo braziliane, të shenjuara nga lloj-lloj diskriminimesh (racizëm, seksizëm, ksenofobi dhe homofobi), kërkimi për burime të besueshme është hapi i parë i formimit të argumenteve të vlefshëm.

Së dyti, për ne të mësohet të respektosh dhe vlerësosh dallimet konsiderohet gjithashtu si aftësi thelbësore për të shmangur shprehjet e gjuhës së urrejtjes, të cilat janë prezente në mediat sociale. Ne i konsiderojmë dallimet si vlerë kritike në shoqëritë multikulturore, si nëformën e dallimeve në opinione ashtu edhe në formën e dallimeve në identitetet që na përcaktojnë si genie njerëzore. Në këtë mënyrë, artikulimi midis MIL-it dhe edukimit për tolerancë pranon si të vërtetë që gjuha e urrejtjes bazohet mbi mohimin e identitetit të tjetrit, mbi eliminimin e dallimeve dhe mbi përpjekjen për të standardizuar sjelljen, sikur

të kishte vetëm një moral të pranueshëm në shoqëri. Përgjigja e sugjeruar do të ishte një balancë midis vlerës së dallimit dhe parimit të barazisë. Sikurse thekson Santos (2003, f. 56): “kemi të drejtë të jemi të barabartë kur dallimet mes nesh na zhvlerësojnë; dhe të drejtën për të qenë të ndryshëm sa herë që pabaraziana bën të humbasim”. Më shumë se kurrë sot jetojmë në një kontekst të përcaktuar nga dallimet të cilat pompohen nga mediat sociale. Dallimet – në gjini, seksualitet, racë, besim, breza, origjinë, plaçkë dhe kapacitete – shpesh mbeten të fshehura e të maskuara për shkak të debatit të standardizuar e të pranuar.

Së treti, ne theksojmë që aftësi që duhet zhvilluar është gjithashtu artikulumimi i drejtësisë si minimum dhe i lumturisë si maksimum. Në këtë perspektivë, në mënyrë që MIL-i të kuptohet si edukim për tolerancë, është e domosdoshme të bëhet dallimi mes asaj çka është e “drejtë” dhe çka është e “mirë” për të gjithë. Sikurse shpjegon Cortina (1999, f. 62): “Etika e drejtësisë, ose etika e minimumit, merret vetëm me dimensionin universal të fenomenit moral, që do të thotë, me ato detyrime të domosdoshme të drejtësisë që i kërkohen çdo qenieje racionale, dhe të cilat, në fakt, përbëhen vetëm nga kërkesa minimale. Në dallim me këtë, etika e lumturisë synon të ofrojë çfarë është ideale për një jetë siç duhet e të mirë, ideale të cilat prezantohen në mënyrë hierarkike dhe përfshijnë një grup të mirash që qenia njerëzore i gëzon si burim i lumturisë më të madhe të mundshme. Prandaj ato janë etika e maksimumit, e cila na këshillon të ndjekim modelin dhe na fton t’i bëjmë ato si norma të sjelljes, por nuk mund të na kërkojë t’i ndjekim, pasi lumturia ka të bëjë me këshillën dhe ftesën, jo me kërkesën”.

Duke iu përmbajtur kësaj qasjeje, barazia do të ishte ideali i “minimumit të drejtësisë” që duhet të gëzojnë të gjithë qytetarët; dhe, nga ana tjetër, dallimet e identitetit do të ishin idealet e “maksimumit të lumturisë”, të cilat gjithsecili i has privatisht. Për shembull, morali Kristian i cili supozohet të jetë në themel të gjuhës së Bolsonaro-s do ishte ideal i lumturisë për disa qytetarë, por jo për të gjithë. Kësisoj, ai mund të jetë i pranishëm në shoqëritë pluraliste, por nuk mund të mos respektojë minimumet që garantojnë moralet e tjerë të mundshëm. Si konkluzion, në qoftë se duam të sigurojmë pluralitet, një ideal i caktuar i lumturisë nuk mund të imponohet si rregull i vetëm për këdo.

Në rastin e analizuar, do ishte arritur një balancë e shëndetshme midis minimumeve dhe maksimumeve nga pjesëmarrësit në debat po të mos e kishin kufizuar veten në opinionet private, por të kishin gjetur balancën ndërmjet asaj që e konsiderojnë “të mirë” për vete (maksimumet e lumturisë) dhe asaj që konsiderojnë “të drejtë” për qytetarët e tjerë (minimumet e drejtësisë). Për shembull, në një nga komentet e analizuar, argumentohej që edukimi seksual i fëmijëve duhet bërë nga familja, sipas modelit të saj të moralit (maksimumet e lumturisë). Megjithatë, asnjë koment nuk tregonte që përtej parimeve të familjes dhe të grupit, edukimi duhet të trajtojë çështje të gjinisë dhe seksualitetit, për t’iu përgjigjur nevojave të shoqërisë ku kushdo mund të shprehë lirisht identitetin e vet gjinor dhe seksual (minimumet e drejtësisë).

Cortina (1996, f. 57) pretendon që aftësia për të “fiksuar një numër minimal vlerash të përbashkëta, në mënyrë që të merren vendime duke respektuar shumicën” është detyrë që duhet arritur nëpërmjet edukimit për tolerancë. Me pak fjalë, çfarë është “e drejtë” është e kërkueshme si detyrim moral për çdo qytetar. E “mira” është ajo çka shkakton lumturi, por nuk duhet kërkuar nga njerëzit e tjerë, pasi në thelb ajo është arritje subjektive. Të gjithë e dimë që ajo që është e mirë për një person mund të mos jetë e mirë për një tjetër. Në

këtë kuptim, e “mira” i përket fushës së mundësive (maksimumi i lumturisë) dhe asnjëherë fushës së kërkesave (minimumet e drejtësisë).

Përfundime

Rezultatet e këtij studimi tregojnë që intoleranca dhe gjuha e urrejtjes janë bërë praktika të zakonshme në mjediset e mediave sociale. Toleranca si aftësi e MIL-it si përgjigje ndaj intolerancës dhe si mjet për tu përballur me gjuhën e urrejtjes kundër atyre që janë “ndryshe”. Menezes (1997, f. 45) pohon që “intoleranca refuzon jo vetëm opinionet e të tjerëve, por edhe ekzistencën e tyre, ose të paktën ato çfarë i japin vlerë jetës: dinjiteti dhe liria e personit”. Intoleranca dhe gjuha e urrejtjes kundër atyre që perceptohen si ndryshe imponojnë mbi ta një njollë turpi dhe refuzimi social. Në po të njëjtën linjë mendimi, Eco (2001, f. 114) e sheh intolerancën si sjellje pa arsye eksplicite ose si doktrinë që e mbështet atë:

Intoleranca e vendos veten përpara çdo doktrine tjetër. Në këtë mënyrë intoleranca ka rrënjë ideologjike, e manifeston veten mes kafshëve mbasi territorialiteti bazohet mbi emocionet, shpesh marrëdhënie sipërfaqësore, - ne nuk mund t'i pranojmë ata që janë ndryshe nga ne sepse e kanë ndryshe ngjyrën e lëkurës, ose flasin një gjuhë që nuk e kuptojmë, ose kanë brekosa, qen, majmunë, derra, hudhër ose sepse kanë tatuazhe në trup...

Sipas këtij autori studjuesit merren shpesh me doktrinën e dallimeve por jo mjaftueshëm me gjuhën e intolerancës dhe të urrejtjes. Në këndvështrimin e Eco-s, arsyeja e kësaj është se të dyja këto sjellje e kanë zanafillën te çdo mundësi për diskutim dhe kritikë, pasi ato as nuk mund të shikohen në një nivel të arsyeshëm (për arsye morali), as në nivel racional (për argumente të artikuluar mirë), por vetëm në nivel emocional. Domethënë, toleranca është në përgjithësi zemërim i pakontrolluar, i pashpjegueshëm dhe impulsiv.

Dhe për ta mbyllur, në perspektivën e tolerancës MIL-i nuk është diçka opsionale, por diçka themelore. Ai mund të jetë gjithashtu më i domosdoshëm dhe produktiv nga sa mendojmë, pasi synon të ndërhyjë në qëndrimet tona, duke ndjekur etikën e drejtësisë, si dhe në ndjenjat tona dhe qëllimet duke ndjekur etikën e lumturisë.

Referenca

- Augras, M. Tolerancia: os paradoxos, in: Teixeira, F. (org.) O dialogo inter-religioso comoafirmação da vida, Sao Paulo: Paulinas, 1997, p. 77-91
- Boler, M. All Speech is Not Free: The Ethics of “Affirmative Action Pedagogy”. *Counterpoints*, Vol. 240, Democratic Dialogue in Education: TROUBLING Speech, DISTURBING Silence, 2004, pp. 3-13.

- Carpentier, N. The concept of participation. If they have access and interact, do they really participate? *Revista Fronteiras – estudos midiáticos*. Vol. 14, No. 2, 2012, pp. 164-177.
- Cortina, A. *Ética civil e religião*, Sao Paulo: Paulinas, 1997.
- Daniels, J. Race, Civil Rights, and Hate Speech in the Digital Era. In: Everett., A.; The John,D.; Catherine, T. *Learning Race and Ethnicity: Youth and Digital Media*. Edited by MacArthur Foundation Series on Digital Media and Learning. Cambridge, MA: TheMIT Press, 2008, pp. 129–154.
- Duffy, M. E. Web of Hate: a Fantasy Theme Analysis of the Rhetorical Vision of Hate GroupsOnline. *Journal of Communication Inquiry*, Vol. 27 No. 3, July 2003, pp. 291-312.
- Eco, U. *Cinco escritos morais*, Rio de Janeiro: Record, 2001.
- Gee, J. P. *A Situated Sociocultural Approach to Literacy and Technology*, 2009. Availableat:<http://www.jamespaulgee.com/node/6>.
- Gerstenfeld, P.; Grant,D.; Chiang, C. Hate Online: A Content Analysis of Extremist Internet Sites. *Analyses of Social Issues and Public Policy*, Vol. 3, Issue 1, December 2003, pp.29–44.
- Glucksmann, A. *O discurso do odio*. Rio de Janeiro: Difel, 2007
- Jenkins, H. *Confronting the Challenges of Participatory Culture: Media Education for the 21stCentury*. Chicago: The MacArthur Foundation, 2009.
- Lankshar, C.; KNOBEL, M. (Eds.). *A new literacies sampler*. New York: Peter Lang, 2007.Menezes, P. Tolerancia e religioes, in: TEIXEIRA, F. (org.) *O dialogo inter-religioso comoafirmação da vida*, Sao Paulo: Paulinas, 1997, p. 39-54.
- Santos, B. *Reconhecer para libertar: os caminhos do cosmopolitanismo multicultural*. Rio deJaneiro: Civilizacao Brasileira, 2003
- Nemes, I. Regulating Hate Speech in Cyberspace: Issues of Desirability and Efficacy. *Information& Communications Technology Law*. Vol. 11, Issue 3, 2002, pp. 193-220.
- Soares, M. *Novas praticas de leitura e escrita: letramento na cibercultura*. *Educ. Soc.*,Campinas. Vol. 23, n. 81, 2002, pp. 143-160. Available at:<http://www.cedes.unicamp.br>
- Warschauer, M. *Technology and Social Inclusion: Rethinking the Digital Divide*. Cambridge: MIT, 2003.

Shënime

1. Gazetë mujore për mësuesit e shkollave 8-vjeçare, në pronësi të grupi të biznesit Abril Editora, e cila boton përmbajtje që ka të bëjë me risitw pedagogjike dhe vështirësitë e jetë së përditshme shkollore. Shih: <http://revistaescola.abril.com.br/>. Parë për herë të fundit në janar 2016.
2. Program i kushtëzuar për transferimn e parave, i menaxhuar nga Ministria e Zhvillimit Social. Shih: mds.gov.br/assuntos/bolsa-familia. Parë për herë të fundit në janar 2016.
3. Gjendet te URL: [http://revistaescola.abril.com.br/pdf/kit-gay-escola-sem-homofobia- mec.pdf](http://revistaescola.abril.com.br/pdf/kit-gay-escola-sem-homofobia-mec.pdf). Parë për herë të fundit në janar 2016.
4. Gjendet në adresën URL: <http://www.brasil.gov.br/educacao/2016/01/mec-nao-distribuiu-nas-escolas-livro-de-ducacao-sexual-citado-em-video-na-internet>. Parë për herë të fundit në janar 2016.
5. Revista Nova Escola ofron një mënyrë të shpejtë për të marrë këtë informacion në adresën URL<http://revistaescola.abril.com.br/formacao/educacao-sexual-precisamos-falar-romeo-834861.shtml>.Parë për herë të fundit në janar 2016

Efektet Afatgjata të Simulimeve të Kompjuterizuara në Konfliktet e Zgjatur

Rasti i Konfliktit Global

Ronit Kampf

Ky artikull prezanton një studim eksperimental që ekzaminon efektet afatshkurtër dhe afatgjatë të Konfliktëve Globale mbi ndryshimin e qëndrimit kundrejt konfliktit Izrael-Palestinë. Konflikte Globale është një lojë me role në kompjuter e cila simulon këtë konflikt. Në studim morën pjesë 180 studentë universitarë nga Izraeli dhe Palestina, të cilët u ndanë në grupe që kishin kontroll dhe luajtën me lojën dhe të tjerë që nuk e luajtën. Pjesëmarrësve iu kërkua të plotësonin një pyetësor që maste qëndrimin në lidhje me konfliktin menjëherë përpara dhe mbas ndërhyrjes në lojë, si dhe 12 muaj mbas kësaj ndërhyrjeje. Rezultatet sugjeronin që pjesëmarrësit në studim që kishin luajtur me lojën, ndryshe nga ata që nuk kishin luajtur, u zhvendosën menjëherë mbas ndërhyrjes drejt një perspektive më të paanëshme, pasi kishin qenë në gjendje ta shihnin konfliktin si nga këndvështrimi i Izraelit ashtu edhe i atij të Palestinës. Ata e ruajtën këtë perspektivë edhe një vit mbas ndërhyrjes nëpërmjet lojës, pavarësisht përplasjeve serioze që kishin ndodhur ndërkohë midis Izraelit dhe palestinezëve.

Fjalëkyç: lojra për ndryshim, konflikti Izrael-Palestinë, ndryshim i qëndrimit, zgjidhje e konfliktit, efekte afatgjata, simulime të kompjuterizuar.

Hyrje

“Kam qëndrim të qartë karshi palës tjetër që është interesante. Nuk mund të them që pikëpamjet e mia kanë ndryshuar plotësisht, por kjo lojë ka ngritur mjaft pikëpyetje... Është e pamundur t'i shohësh të gjithë palestinezët njësoj, mendoj... kur dëgjoja që përmendeshin arabët frikësohesha, por tani më kujtohet kjo lojë e këndshme... jam në dilemë”.

Pjesëmarrës hebre nga Izraeli

Ky artikull investigon efektivitetin e një loje paqësore në kompjuter të quajtur Konflikte Globale, e cila simulon situatën Izrael – Palestinë, për të parë nëse loja ndihmon për ta parë konfliktin nga një perspektivë e paanëshme (i.e., të jesh në gjendje ta shohësh atë nga

këndvështrimi si të izraelitëve ashtu edhe palestinezëve) dhe nëse ky rezultat në mësim ruhet 12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë. Studimi krahason rezultatet afatshkurtra dhe afatgjata të mësimin për studentët hebrej-izraelitë dhe palestinezë që kanë luajtur lojën me ata që nuk e kanë luajtur, për të parë kështu nëse funksionon apo jo kjo ndërhyrje e bazuar në lojë. Studimi e mat mësimin duke eksploruar nëse qëndrimi i pjesëmarrësve karshi konfliktit bëhet më i paanshëm ose jo (i.e., aftësia për t'i vënë gjërat në perspektivë).

Konfliktet Globale është një lojë edukative që ka fituar çmim. Ajo është krijuar në vitin 2010 nga *Serious Games Interactive* në Danimarkë (<https://school.seriousgames.net/en/>). Loja konsiston në disa skenarë të ndryshëm, ku secili e vë lojtarin në një kontekst ndryshe dhe kërkon përdorimin e aftësive të ndryshme. Studimi zgjodhi si lojë konfliktin midis Izraelit dhe Palestinës, që ilustron tensionet midis dy palëve në skenarin e vendosur në një pikë kontrolli. Lojtari përfaqësohet nga avatari i një reportereje perëndimore e cila arrin në Jeruzalem. Detyra e saj është të shkruajë për një nga gazetaret: izraelite, palestinezë ose perëndimore. Lojtarit i kërkohet të prodhojë një lajm që i drejtohet publikut të njëjës prej këtyre gazetave duke u bazuar në intervista që zhvillon me personazhe të ndryshëm izraelitë dhe palestinezë në pikën e kontrollit në territorin palestinez. Sfidat e lojtarit është që duke qëndruar objektiv në punën e vet të mbledhë informacion të rëndësishëm për ta përdorur për lajmin. Lojtari duhet të formojë një opinion bazuar mbi veprimet e veta dhe mbasi të ketë takuar me personazhet që përfaqësojnë qëndrime të ndryshme ndaj konfliktit, pavarësisht faktit që shkruan për një gazetë specifike.

Studimet e mëparshme kanë treguar tashmë se të rinjtë izraelitë dhe palestinezë (njësoj si ata që morën pjesë në studim) nuk dinë thujse asgjë për çfarë ndodh në krahun tjetër të ndarjes izraelo-palstineze, përveç stereotipeve dhe imazheve etnocentrike të krijuar nga agjentë kyç të socializimit (e.g., media) dhe incidentet e përditshme (Wolfsfeld, Frosh & Awadby, 2008). Gjithashtu, duke qenë se këta të rinj nuk e kanë përjetuar kurrë në të vërtetë paqen, ata mund të mos e shohin atë si një vlerë të rëndësishme për të cilën duhet paguar një çmim (Rosen & Salomon, 2011).

Është interesante të theksohet që disa studime kanë treguar se simulimet e kompjuterizuara si Konfliktet Globale mund t'u ofrojnë të rinjve izraelitë dhe palestinezë një mundësi për të mësuar dhe kuptuar rreth palës "tjetër" në konflikt (Cuhadar & Kampf, 2015; Kampf & Cuhadar, 2015). Megjithatë, këto studime fokusoheshin në efektet afatshkurtra të ndërhyrjeve të bazuara në lojra si Konfliktet Globale. Me sa di unë, nuk ka asnjë studim empirik për vlerësimin e efekteve afatgjata të ndërhyrjeve me bazë lojrat në konflikte të vështira si situata midis Izraelit dhe Palestinës. Në përgjithësi, numri i studimeve mbi efektet afatgjata të laboratorëve për paqen në konflikte kaq të vështirë është jashtëzakonisht i kufizuar (e.g., Rosen & Solomon, 2011; Schroeder & Risen, 2014).

Studime të mëparshme kanë treguar që lojrat e paqes si Konfliktet Globale mund të jenë të suksesshme si mjete që i ndihmojnë të rinjtë të mësojnë rreth "tjetrit", e në veçanti të suksesshme në arritjen e rezultateve afatgjata kur bëhet fjalë për të mësuar për konfliktet e vështira, për disa arsye kyç. Së pari, Konfliktet Globale janë në gjendje t'i bëjnë lojtarët të zhyten më thellë në to, e për pasojë janë më argëtuese dhe e bëjnë më të fortë angazhimin dhe motivimin e lojtarëve (e.g., Fu, Su & Yu, 2009). Ky efekt i zhytjes krijon një mjedis brenda të cilit lojtarët fundosen dhe në mënyrë progresive e rrisin vëmendjen dhe përqëndrimin në këtë mjedis, gjë që rezultojn në efekte më pozitive mbi ruajtjen e kujtesës, ndryshimin e qëndrimit dhe zhvillimin e ndjeshmërisë (e.g., Kiili, 2005). Së dyti, Konfliktet

Globale përfaqësojnë një kornizë episodike të konfliktit, duke u fokusuar mbi vështirësitë e ushtarëve izraelitë e po ashtu të civilëve palestinezë në pikën e kontrollit në territorin palestinez, përvojë kjo që mund të prodhojë ndjeshmëri dhe identifikim nga të dyja anët, duke provokuar një perspektivë më të paanëshme në lidhje me situatën (Gross, 2008). Dhe në fund, te Konfliktet Globale, lojtari merr rolin e palës që gjendet më larg konfliktit dhe që është e detyruar ta shohë situatën nga të dyja perspektivat dhe me objektivitet (e.g., një gazetar perëndimor). Kësisoj, lojtari mund të jetë më pak i prirur të kërkojë, interpretojë, favorizojë dhe rikujtojë informacion në mënyrë të atillë që të konfirmojë atë çka beson vetë teksa i kushton në mënyrë disproporcionale më pak vëmendje informacionit që bie ndesh me të (e.g., Stanovich, West & Toplak, 2013). Si rezultat, për lojtarin mund të jetë më e lehtë ta shohë konfliktin me lentet e të dyja palëve (e.g., të kalojë në një perspektivë më të paanëshme) (e.g., Halperin et al., 2013; Halperin et al., 2014).

Hipoteza studimore

H1: Pjesëmarrësit do të ruajnë qëndrimet etnocentrike dhe stereotipike (e.g., të aftë ta shohin konfliktin vetëm nga këndvështrimi i tyre) përpara ndërhyrjes në lojë.

H2: Pjesëmarrësit që luajnë do të bëhen më të paanshëm në drejtim të konfliktit menjëherë mbas ndërhyrjes në lojë, ndërsa ata që nuk luajnë do të ruajnë gjatë kësaj kohe qëndrimet etnocentrike dhe stereotipike ndaj konfliktit.

H3: Pjesëmarrësit që luajnë do t'i ruajnë qëndrimet e paanëshme në drejtim të konfliktit edhe një vit mbas pjesëmarrjes në ndërhyrjen në lojë, ndërsa ata që nuk luajnë do të ruajnë gjatë së njëjtës periudhë qëndrimet etnocentrike dhe stereotipike karshi konfliktit.

Metodologjia

Pjesëmarrësit

Në studim morën pjesë 180 studentë universitarë. 100 pjesëmarrësit hebrenj izraelitë ishin nga Departamenti i Shkencave Politike dhe të Komunikimit në Universitetin e Tel Avivit, 80 studentët palestinezë ishin nga Departamenti i Shkencave Politike të Universitetit Al-Quds.

Lojën e luajtën 60 studentë hebrenj izraelitë dhe 45 studentë palestinezë (grupi eksperimental), ndërsa 40 studentë hebrenj izraelitë dhe 35 studentë palestinezë nuk luajtën (grupi kontrollit). Grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit nuk dallonin nga njëri-tjetri në karakteristika kyçe që mund të sillnin shpjegime alternative të rezultateve (Tabela1).

Tabela 1. Karakteristikat e grupeve eksperimentale dhe të kontrollit

	Mosha M(SD)	Meshkuj	Qëndrimet politike 1-----10 Majtas Djathtas M(SD)	Besimi fetar 1-----10 Fetar Laik M(SD)	Kanë luajtur lojë digjitale në 6 muajt e fundit
Konflikte Globale	23.1 (1.25)	36%	6.12 (2.45)	6.7 (1.17)	45%
Asnjë lojë	22.4 (1.18)	33%	5.67 (2.37)	5.79 (1.15)	47%

Dizajni dhe procedura

Të dhënat mbi studentët e Universitetit Al-Quds u mbledhën në fund të janarit të vitit 2013, dhe të dhënat e studentëve të Universitetit të Tel Avivit u mbledhën në fillim të marsit të vitit 2013. Gjatë kësaj periudhe nuk ndodhi ndonjë ngjarje madhore që mund të sillte shpjegime alternative për rezultatet.

Kushtet eksperimentale morën tre orë dhe përfshinin katër pjesë. Së pari, pjesëmarrësit u prezantuan me lojën Konflikte Globale dhe luajtën një demo të shkurtër (që nuk kishte lidhje me konfliktin Izrael – Palestinë). Së dyti, plotësuan një pyetësor të shkurtër. Së treti, pjesëmarrësit luajtën skenarin Izrael – Palestinë. Në mënyrë rastësore ata u ndanë në dy grupe, ku secili pjesëmarrës luan rolin e një gazetari perëndimor që punon në lojë ose për një gazetë izraelite ose për një gazetë palestineze. Duhet theksuar që pavarësisht se cilën gazetë përfaqëson lojtari, loja ofron perspektivat për konfliktin si të palës izraelite ashtu edhe të asaj palestineze. Dhe në fund, mbasi të kenë luajtur lojën, pjesëmarrësit plotësojnë sërish një pyetësor të shkurtër. Pyetësorët e përdorur përpara dhe mbas lojës ishin thuajse identikë në përmbajtje, me përjashtim të disa pyetjeve shtesë në pyetësorin e mbas lojës ku u kërkohej pjesëmarrësve të diskutonin mbi përvojën e tyre me lojën.

Kushtet e kontrollit morën tre orë dhe përfshinin tre pjesë. Së pari, pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor të shkurtër. Më pas ata dëgjuan një leksion rreth aspekteve politike të vendasve digjitale (që nuk lidheshin me konfliktin). Në fund, ata plotësuan përsëri një pyetësor të shkurtër. Të dy pyetësorët ishin identikë në përmbajtje dhe të ngjashëm me ata që u përdorën në kushtet eksperimentale (përveç pyetjeve ku pjesëmarrësve u kërkohej të diskutonin mbi përvojën e tyre me lojën).

Mbasi kishin plotësuar pyetësorin e dytë, si pjesëmarrësve që luajtën lojën ashtu edhe atyre që nuk e luajtën iu tha që do të kontaktoheshin me email mbas një viti për t’iu përgjigjur një pyetësori të shkurtër dhe që do të vlerësoheshin me kredite për pjesëmarrjen. Në mënyrë që të mësonin rreth efektivitetit të këtyre dy klasave, grupit eksperimental iu tha që pyetësori do të ekzaminonte atë çfarë mbanin mend nga loja dhe grupit të kontrollit iu tha që pyetësori do të ekzaminonte se çfarë mbanin mend nga leksioni rreth vendasve digjitale.

Matjet

Me matjen e qëndrimit u ekzaminua “drejtësia” e secilës palë në çështje kyç në konflikt duke përfshirë këtu ujin, refugjatët, kufijtë, ngulimet, Jeruzalemin dhe sigurinë. Për këtë u përdor shkalla e mëposhtme: 1. Palestinezët kanë absolutisht të drejtë, 2. Palestinezët kanë deri diku të drejtë, 3. Të dyja palët kanë njësoj të drejtë, 4. Izraelitët kanë deri diku të drejtë, dhe 5. Izraelitët kanë absolutisht të drejtë.

Analiza e faktorëve tregoi që në ndërhyrjen para lojës gjashtë çështjet kyç ishin ngarkuar mbi njërin faktor që shpjegon 64.38% të mosmarrëveshjeve. Në mënyrë të ngjashme, analiza e faktorëve tregonte që në ndërhyrjen mbas lojës gjashtë çështjet kyç ishin ngarkuar mbi njërin faktor që shpjegonte 66.23% të mosmarrëveshjeve. Në fund, analiza e faktorëve tregonte që 12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë gjashtë çështjet kyç ishin ngarkuar mbi njërin faktor që shpjegon 68.34% të mosmarrëveshjeve. Kësisoj, mesatarja e përgjigjeve të dhëna mbi gjashtë çështjet kyçe ishte përdorur si matëse e ndryshimit të qëndrimit kundrejt çështjeve kyç në konflikt përpara dhe mbasi u lajt loja.

Kjo mënyrë matjeje ishte përdorur edhe në studime të mëparshme të kryera me simulime të kompjuterizuara të konfliktit midis Izraelit dhe Palestinës (Cuhadar & Kampf, 2015; Kampf, 2014; Kampf 2015; Kampf & Cuhadar, 2014; Kampf & Cuhadar, 2015) dhe bazohej në pyetësorë të hartuar nga studiues për zgjidhjen e konflikteve në Izrael dhe Palestinë (e.g., Rosen & Salomon, 2011).

Qëndrimet politike mateshin nëpërmjet pyetjes që vijon: “Në qoftë se do ta vendosje veten në shkallën që vijon, ku do ta lokalizojë veten në terma politike?” Për këtë pyetje përdorej një shkallë me dhjetë pika, ku 1 përfaqëson “ekstremi i majtë” dhe 10 përfaqëson “ekstremi i djathtë”.

Qëndrimi fetar matej nëpërmjet pyetjes që vijon: “Në qoftë se do ta vendosje veten në shkallën që vijon, ku do ta lokalizojë veten në terma besimi?” Për këtë pyetje përdorej një shkallë me dhjetë pika, ku 1 përfaqëson “shumë fetar” dhe 10 përfaqëson “shumë laik”

Interesi politik matej nga një shkallë me katër pika, ku 1 përfaqëson “krejt pa interes” dhe 4 përfaqëson “jashtëzakonisht i interesuar”.

Në mënyrë që të matej familjarizimi me gjuhën e lojrave digjitale, pjesëmarrësit u pyetën nëse kishin luajtur brenda gjashtë muajve të fundit një lojë digjitale.

Rezultatet

Ndërveprimi midis kohës, luajtjes së lojës dhe kombësisë ishte domethënëse, gjë që tregon që pjesëmarrësit hebrej izraelitë dhe palestinezë që e luajtën lojën dhe ata që nuk e luajtën bënë dallim në ndryshimin e qëndrimit në lidhje me çështje kyç në konflikt ($F(3, 176)=71.03, p<.0001, \eta^2= .36$).

Përpara ndërhyrjes me lojë, pjesëmarrësit hebrej izraelitë që luajtën lojën kishin pikëpamje proizraelite, ndërsa pjesëmarrësit palestinezë që luajtën kishin pikëpamje propalestineze (i.e., qëndrime etnocentriste dhe stereotipike). Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit hebrej izraelitë që nuk luajtën kishin gjatë kësaj kohe pikëpamje proizraelite,

ndërsa pjesëmarrësit palestinezë që nuk e luajtën lojën kishin pikëpamje propalestineze (Tabela 2). Kësisoj, Hipoteza 1 konfirmohet.

Menjëherë mbas ndërhyrjes me lojë, pjesëmarrësit hebrej izraelitë dhe palestinezë që luajtën iu afruan më pranë të mendimit që si izraelitët ashtu edhe palestinezët kanë njësoj të drejtë pavarësisht çështjeve kyç në konflikt (i.e., perspektivë e paanëshme). Në kontrast me këtë, hebrejtë izraelitë dhe palestinezët që nuk e luajtën lojën ruajtën gjatë kësaj kohe qëndrimet e veta etnocentriste kundrejt konfliktit (Tabela 2). Kësisoj, hipoteza 2 konfirmohet.

12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë, pjesëmarrësit hebrej izraelitë dhe palestinezë që luajtën me lojën e kishin ruajtur perspektivën e paanëshme në lidhje me konfliktin. Në dallim me ta, pjesëmarrësit hebrej izraelitë dhe palestinezë që nuk luajtën kishin ruajtur gjatë kësaj kohe perspektivën etnocentriste në lidhje me konfliktin (Tabela 2). Kësisoj, hipoteza 3 konfirmohet.

Tabela 2. Kombësia dhe Efektet e Luajtjes së Lojës në Qëndrimet kundrejt Konfliktit

12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë M:SD	Përpara ndërhyrjes me lojë M:SD	Mbas ndërhyrjes me lojë M:SD
Hebrej izraelitë		
Luajnë 2.93: .26***	3.92: .59***	2.91: .31***
Nuk luajnë 3.52: .47***	3.71: .53***	3.62: .53***
Palestinezë		
Luajnë 1.58: .36***	1.07: .09***	1.44: .34***
Nuk luajnë 1.14: .16***	1.06: .12***	1.07: .11***

Diskutim dhe konkluzione

Duke përdorur lojën Konflikte Globale, e cila është simulim i konfliktit midis Izraelit dhe Palestinës, studimi vlerësoi nëse pjesëmarrësit mund të formojnë një perspektivë të paanëshme dhe nëse këto rezultate që u morën nga mësimi do të vazhdonin të ishin të tilla edhe 12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë. Rezultatet sugjeruan që pjesëmarrësit ruajtën qëndrimet etnocentriste dhe stereotipike kundrejt konfliktit që kishin patur përpara ndërhyrjes me lojë. Veç kësaj, pjesëmarrësit që luajtën formuan qëndrime më të paanëshme kundrejt konfliktit menjëherë mbas ndërhyrjes me lojë, ndërsa ata që nuk

luajtën ruajtën qëndrimet etnocentriste dhe stereotipike kundrejt konfliktit gjatë së njëjtës periudhë. Dhe në fund, pjesëmarrësit që luajtën i ruajtën qëndrimet e paanëshme edhe 12 muaj mbas ndërhyrjes me lojë, ndërsa ata që nuk luajtën ruajtën gjatë kësaj kohe qëndrimet etnocentriste dhe stereotipike karshi konflikti.

Rezultatet janë premtuese për sa i përket faktit që ato tregojnë se lojrat e paqes në kompjuter mund të përdoren jo vetëm për qëllime mësimore në kurse që kanë të bëjnë me studime për konfliktet dhe paqen, por gjithashtu si pjesë e trainimeve për ndërtimin e paqes. Rezultatet tregojnë që lojra të tilla janë të dobishme jo vetëm se u mësojnë një qasje më komplekse të konflikti palëve të cilat janë direkt në konflikt dhe mbajnë qëndrime të fuqishme dhe ekstreme mbi çështjet në fjalë, por gjithashtu sepse sjell ndryshim të qëndrimit, sidomos në formën e ndryshimit të perspektivës, për ta bërë atë më të paanëshme dhe në gjendje ta shohë konfliktin nga të dyja këndvështrimet, madje edhe një vit mbas ndërhyrjes me lojë, pavarësisht përplasjeve serioze të ndodhura gjatë kësaj kohe midis izraelitëve dhe palestinezëve.

Ky studim ka disa kufizime që duhen korrigjuar në hulumtimet e ardhshme. Së pari, studimi fokusohet te studentët e Shkencave Politike të cilët mund të jenë më të interesuar te politikat dhe për pasojë ka shumë të ngjarë të mos përfaqësojnë publikun e gjerë. Veç kësaj, është e paqartë nëse pjesëmarrësit do të ishin kënaqur njësoj me lojën e do ta kishin ndryshuar qëndrimin në po të njëjtën masë nëse nuk do t'u ishte premtuar një stimul në fund. Dhe në mbyllje, mbetet e paqartë se deri ku ndryshimi në qëndrim shkaktohet nga informacioni që morën studentët dhe deri në çfarë shkalle ndryshimi shkaktohej nga aspekti lojë i Konfliktëve Globale.

Hulumtime të mëtejshme mund të izolojnë dimensione të ndryshme të simulimeve të kompjuterizuara si Konfliktet Globale, për të kuptuar se si lojra të tilla i arrijnë efektet afatshkurtra dhe afatgjata nën hijen e konflikteve të vështira si situata midis Izraelit dhe Palestinës. Do kishte qenë gjithashtu interesante të ekzaminohet impakti i Konfliktëve Globale krahasuar me një tjetër format që prezanton të njëjtin informacion (e.g., një leksion, tekst i shkruar, prezantim ose video e të tjerëve që luajnë atë lojë) për të ekzaminuar në mënyrë specifike nëse aspekti lojë i Konfliktëve Globale ndikon më shumë te ndryshimi në qëndrim se sa formatet e tjera.

Mundësia për të rinjtë hebrenj izraelitë dhe palestinezë që të mësojnë dhe ndoshta kuptojnë palën “tjetër”, qoftë edhe nëpërmjet simulimeve të kompjuterizuara si Konfliktet Globale, është çështje mjaft e rëndësishme në çdo proces pajtimi në Lindjen e Mesme dhe kërkesë thelbësore për të fituar mbështetjen publike dhe legjitimitetin për çdo iniciativë për paqe.

Referenca

- Cuhadar, E., & Kampf, R. (2015). A cross-national inquiry into the Israeli-Palestinian and Guatemalan scenarios in Global Conflicts. *Negotiation and Conflict Management Research*, 8(4): 243-260.
- Fu, F.L., Su, R.S., & Yu S.C. (2009). EGameFlow: A scale to measure learners' enjoyment of e-Learning games. *Computers & Education*, 52(1): 101-112.

- Gross, K. (2008). Framing persuasive appeals: Episodic and thematic framing, emotional response, and policy opinion. *Political Psychology*, 29(2): 169–192.
- Halperin, E., Pliskin, R., Saguy, T., Lieberman, V., & Gross, J.J. (2014). Emotion regulation and the cultivation of political tolerance: Searching for a new track for intervention. *Journal of Conflict Resolution*, 58(6): 1100-1138.
- Halperin, E., Porat, R., Tamir, M., & Gross, J.J. (2013). Can emotion regulation change political attitudes in intractable conflicts? From the laboratory to the field. *Psychological Science*, 24(2): 106-111.
- Kampf, R. (2014). Playing singly, playing in dyads in a computerized simulation of the Israeli-Palestinian conflict. *Computers in Human Behavior*, 32: 9-14.
- Kampf, R. (2015). Computerized simulations of the Israeli-Palestinian conflict and attitude change. *eLearning Papers*, 43. <http://openeducationeuropa.eu/en/node/172732>
- Kampf, R., & Cuhadar, E. (2014). Learning about the Israeli-Palestinian conflict and negotiations through simulations: The case of PeaceMaker. *International Studies Perspectives*, 15(4): 509-524.
- Kampf, R., & Cuhadar, E. (2015). Do computer games enhance learning about conflicts? A Cross-national inquiry into proximate and distant scenarios in Global Conflicts. *Computers in Human Behavior*, 52, 541-549.
- Kiili, K. (2005). Digital game-based learning: Towards an experiential game model. *Internet and Higher Education*, 8(1): 1-24.
- Rosen, I., & Salomon, G. (2011). Durability of peace education effects in the shadow of conflict. *Social Psychology Education*, 14: 135-147.
- Schroeder, J., & Risen, J.L. (2014). Befriending the enemy: Outgroup friendship longitudinally predicts intergroup attitudes in a coexistence program for Israelis and Palestinians. *Group Processes & Intergroup Relations*, 4(5): 1–22.
- Stanovich, K.E., West, R.F., & Toplak, M.E. (2013). Myside bias, rational thinking, and intelligence. *Current Directions in Psychological Science*, 22(4): 259–264.
- Wolfsfeld, G., Frosh, P., & Awabdy, M. (2008). Covering death in conflicts: Coverage of the Second Intifada on Israeli and Palestinian television. *Journal of Peace Research*, 45: 401-417.

Radikalizimi dhe Ekstremizmi

Instrumentet MILID: Për të Drejtat e Njeriut. Kundër Radikalizimit

Strategjitë, Metodologjitë, Mjetet

Thomas Röhlinger

Në vjetarin e vitit 2015, autori ofronte një model teorik për MILID¹-in. Këtë herë, fokusi është te këshillat praktike lidhur me implementimin e MILID-it në terren; në luftën kundër radikalizimit, për të Drejtat e Njeriut. Këto këshilla praktike vinë në formën e "kutisë MILID të instrumenteve". Kjo kuti është Burim i Hapur Edukativ, që i kushtohet të gjithë anëtarëve të interesuar të komunitetit akademik GAPMIL dhe MILID. Ajo bazohet në më shumë se 15 vite punë të vlerësuar me çmime, në terren në gjithë botën, me fëmijë, të rinj, edukatorë, anëtarë të shoqërisë civile, dhe vendimmarrës. Lexuesit i transmetohet një vlerë e shtuar nëpërmjet vështrimeve teorike nga puna aktuale e autorit mbi tezën e vet të doktoraturës mbi MILID-in (alfabetizimi në media dhe informim dhe dialogu ndërkulturor).

Fjalëkyç: inovacion MIL, kutia e veglave MILID dhe hakerimi, rrjeta MILID e jetës, të drejtat e njeriut, strategjitë e antiradikalizimit.

Hyrje

Mjedisi Global

Trazirat globale në rritje të viteve të kaluara zbulojnë mangësira alarmante në fushën e edukimit të të drejtave të njeriut, në luftë kundër radikalizimit dhe ekstremizmit. Rezultati është një spirale e rrezikshme globale kokëposhtë, përse i përket modelit MILID të parashtruar në vjetarin 2015. Mungesa e aftësive MILID dhe e njohurive mbi të drejtat e njeriut, paqes etj., të kombinuara me mungesën e financimeve për një punë edukative dhe presionin në rritje nga ana e burimeve të propagandës radikale dhe militante, ka çuar në një spirale negative, që ka sjellë dëme sociale dhe edukativ, ndërkohë që burimet për edukimin MILID kanë ardhur duke u pakësuar. Kjo situatë po kërcënon gjithë botën, dhe është kërcënim konkret në rritje për edukatorët MILID në terren.

Qasja metodologjike

Mjetet dhe metodologjitë janë zhvilluar nëpërmjet punës në terren në katër kontinente, gjatë një procesi një vjeçar Vëzhgimi Pjesëmarrës dhe Hulumtimi me Veprim Pjesëmarrës (PAR). Rezultati u “distilua”, duke kombinuar dhe triangularizuar punën empirike dhe teorike, aspektet induktive dhe deduktive; duke ndjekur qasjen “Teoria me Themel” të shkencave sociale.

Sfondi Shkencor

Artikulli i referohet burimeve shkencore ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore, e.g. punës së John Dewey-t (Edukim i bazuar në përvojë, Demokraci, Paqe), Karlo Popper (Zgjidhja e Problemit), Norbert Elias (Procesi i Civilizimit), Bertalanffy/Luhmann (Teoria e Sistemeve), Dahrendorf (Teoria e Konfliktit), Adib – Moghaddam (Transformimi Islamik), Graduate Institute Switzerland (studime mbi Paqen), Kombet e Bashkuara (paqe, edukim), etj.

Drejt Strategjive Sistematike MILID-it Kundër Radikalizmit

Një qasje sistematike ka nevojë të lidhë objektivin moralisht legjitim të reduktimit të radikalizmit me logjikën e brendshme të të gjithë nënsistemeve sociale relevante në mënyrë që të krijojë atë që Luhmann e quante “rezonancë” në shoqëri. Në sa vijon përpiqemi ta bëjmë këtë lidhje midis MILID-it dhe nënsistemeve të ndryshme sociale në mënyrë që të krijojmë një kuptim më të mirë të karakterit sistematik, holistik, të nevojshëm në luftë kundër radikalizmit.

Ne fillojmë me një shembull më praktik nga fusha e edukimit, të zhvilluar (me disa përshtatje nga metodologjitë ekzistuese, p.sh. nga Këshilli i Europës dhe IPA Berlin) dhe testuar në terren gjatë shumë viteve.

Por më parë, le të prezantojmë strategjinë e përgjithshëm të MILID-it, duke e sjellë atë të sistemuar si më poshtë:

“Mos bëj dëm” si një strategji e përgjithshme e MILID-it

Historia na sjell plot shembuj kur probleme lindin apo dhe përkeqësohen prej veprimeve të njerëzve që nisen nga qëllime të mira. Kjo është arsyeja pse edukimi për paqen² ka zhvilluar teori të tilla si ajo “Mos bëj dëm”³. Me pak fjalë, kjo do të thotë që në mënyrë që të “mos bëjë dëm” në luftën kundër dhunës nevojiten që çdo organizëm duhet të përdorë instrumente të ndryshme në kontekste të ndryshme dhe në faza të ndryshme të një konflikti. Në rast se përdoret gabim, çdo mjet mund të shkaktojë dëme të rëndësishme

dhe ta përkeqësojë edhe më shumë një situatë të brishtë. Në faza relativisht të qeta, mund të përdorim dialogun ndërkulturor, si ç’kemi bërë me projektet tona në Rusi⁴ dhe në Shtetet e Bashkuara⁵. Ne mund të ndihmojmë parlamentet e fëmijëve dhe të zhvillojmë plane afatgjata për zhvillimin e komunitetit sikurse bëmë në Marok (për të dyja flitet më poshtë).

Në fazën e nxehtë të konfliktit, mund të jenë më të përshtatshëm mjete të tjerë që shërbejnë për të ftohur konfliktin. Për këtë arsye kemi sjellë shembuj të instrumenteve të mundshëm që komuniteti global MILID mund t’i zhvillojë, testojë dhe implementojë: “kërko MILID-in, evakuo dhe shpëto” (mjete dhe strategji për përdorimin e TIK-ut në konfliktet e armatosur për të shpëtuar fëmijët, edukatorët, popullsinë), “Paqeruajtësit MILID” (p.sh. fushatat digjitale jo-partizane për ftohjen e konfliktit) ose “MILID i heshtur” (duke punuar për paqen, pa përdorur mediat e dukshme nga ana e publikut të gjerë; gjithashtu të qëndrosh i heshtur si simbol i zisë), “armëpushimi MILID” (p.sh. për të ndarë kundërshtarët, thjesht duke ndërprerë për një kohë të caktuar komunikimin e mbushur plot urrejtje). Duke patur parasysh këtë, po sjellim disa shembuj praktikë në fushën e edukimit antiradikal në terren jashtë fazave “të nxehta” të konfliktit.

Instrumentet MILID të përzgjedhura nga Terreni

Parlamenti MILID i fëmijëve dhe Këshilli Rinor

Gjatë punës sonë në Marok, Shtetet e Bashkuara, Gjermani dhe Rusi, është provuar në mënyrë të përsëritur që mjete si parlamenti ad-hoc i fëmijëve dhe këshillat rinore kanë dëshmuar se janë shumë krijuese, të ndjeshëm dhe produktive. Nga njëra anë, fëmijët e përdorën intensivisht këtë mundësi për të zhvilluar ide, për të folur e për të diskutuar me moshatarët tyre, ndonjë herë dhe me vendimmarrësit. Nga ana tjetër, fëmijët provuan nga përvoja e tyre që demokracia është padyshim shpesh e “mërzitshme” dhe ndonjëherë edhe rraskapitëse. Ky është trainim i mirë për të fuqizuar tolerancën ndaj zhgënjimit (gjë e cila mund të përkufizohet si “aftësi për të kapërcyer pengesat dhe situatat stresuese”)⁶, durimin dhe aftësinë për kompromise. MILID-i luan këtu një rol të rëndësishëm dhe kompleks për të strukturuar idetë e fëmijëve dhe të rinjve; p.sh. në vizatime, ese dhe mesazhe individuale audio që ne i integrojmë në planet e zhvillimit të komunitetit, p.sh. Këshilli i Medias së Fëmijëve në Marok⁷ ose Këshilli Transatlantik i të Rinjve në Shtetet e Bashkuara dhe Gjermani. Këshilla të tilla të vogla lokale vendosen në mënyrë sistematike në kontekstin e SDG-ve të tilla si Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konferenca Globale e Edukimit, etj. Këto kontekste kanë mjaft rëndësi për sa i përket motivimit dhe impaktit.

Planet e zhvillimit të MILID SDG

Në projektin “Partneriteti Gjermani < - > Marok për edukim qytetar”, në mënyrë të vazhdueshme krijojmë përvoja të mira me trainimet e anëtarëve të rinj dhe të rritur të shoqërisë civile në zhvillimin e planeve SDG të zhvillimit, pavarësisht rritjes së tensioneve rajonale të shkaktuar nga grupet radikale. Pjesëmarrësit hodhën ide mbi çështje të tilla si bujqësia e qëndrueshme, eko turizmi, pasuria kulturore, edukimi dhe media. Këto ide ato i bëjnë bashkë në formën e librave të vetëkrijuar të cilët i mbajnë në qendrat e

komuniteteve lokale në mënyrë që të shërbejnë si udhëzues të përbashkët deri në vitin 2030, që është edhe afati i fundit i SDG-ve. Me këtë perspektivë sistemike të sapo fituar dhe njëkohësisht afatgjatë, ata gjithashtu bëhen gjithmonë e më të ndërgjegjshëm për atë se sa shumë mund të humbasin sikur fshatit të tyre t'i dalë nami si bastion i grupeve radikale. Në disa laboratore, udhëheqës fetarë, përfshirë dhe një Imam lokal, kontribuan intensivisht në projekt. Në këto laboratorë përfshihen gjithashtu në mënyrë aktive dhe të barabartë gratë dhe fëmijët – një tjetër arritje kjo që nuk duhet marrë si e mirëqenë, sidomos në rajonet rurale konservatore. Këtu MILID-i luan rol për të lehtësuar, strukturuar, objektëzuar, popullarizuar dhe mbështetur zhvillimin e komunitetit, në kuptimin e konceptit të Komunikimit për Ndryshim të Qëndrueshëm Social⁸ që ka lidhje me UNESCO-N.

Inovacioni MILID

Sipas Klingholz/Lutz (2016), bota Arabe dhe Afrika Subsahariane kanë mbetur mjaft mbrapa përsa i takon inovacionit, p.sh. në numrin e patentave dhe të fituesve të çmimit Nobel. Ky deficit përdoret, pjesërisht, për të shpjeguar problemet ekonomike dhe zhgënjimin. Në orën tonë laboratorike në pjesën rurale të Marokut, u treguam fëmijëve në zonat rurale të margjinalizuara që p.sh. Leonardo da Vinci projekttoi versionet e hershme të helikopterit që 500 vjet më parë – vetëm me letër dhe penë, pa pajisje të teknologjisë së lartë. Kjo qasje e teknologjisë së ulët ndihmoi për të inkurajuar fëmijët të krijojnë, në vend që të liheshin e të ndjeheshin inferiorë për shkak të mungesës së teknologjisë. Ata erdhën me shumë ide të mira, p.sh. për sisteme të reja transporti, media dhe mjedise për të ardhmen e Marokut.

Rrjeti MILID i Jetës

Metoda tjetër⁹ bazohet në punën e teorisë së sistemeve dhe të analizave të rrjetit të bazuara te vepra e Fritjof Capra-s. Ajo është një lojë, ku çdo pjesëmarrës mund të luajë një rol/funksion p.sh. në një komunitet lokal. Fillimisht i prezantojmë pjesëmarrësit me role të ndryshëm dhe i lemë të zgjedhin atë që duan. I pari mban në dorë një top të leshtë të kuq dhe thotë “Unë jam nënë. Pa njerëz si unë, fshati ynë nuk do të kishte fëmijë e për pasojë as të ardhme”. Më pas ajo ia hedh topin e leshtë tjetrit, duke mbajtur në dorë fillimin e fillit. Personi tjetër e kap topin e leshtë dhe mund të thotë “Unë jam kryetari i bashkisë. Unë jam këtu që t'i shërbej komunitetit. Në qoftë se punoj mirë, fëmijët tanë rriten në paqe, fshati përparon dhe unë mund të rizgjidhem”. Ai mban në dorë pjesën e vet të fillit dhe ia hedh lëmshin një personi tjetër. Tjetri mund të jetë fermer, mësues, vajzë, djalë, person nga media, udhëheqës fetar, studiues, madje edhe një “person natyrë” si lumi i zonës ose pyll, etj. Në fund, pjesëmarrësit kanë krijuar një rrjetë fizike duke vizualizuar kësisoj në mënyrë argëtuese, në mënyrë të barabartë dhe me profil të ulët, ndërvarësitë komplekse midis palëve lokale të interesuara. Dikush mund të prezantojë një person radikal që mund ta presë të gjithë rrjetin e ta shpërbëjë në pak sekonda. Kjo mund të ilustronjë dëmin që mund të shkaktojë një person i vetëm për gjithë komunitetin. Kësisoj, ne krijojmë sensin e ndërgjegjesimit, parandalimit dhe vetëmbrojtjes në nivel lokal. E njëjta lojë mund të luhet kur pjesëmarrësit zgjedhin palë të interesuara që i përkasin rajoneve të prekur nga konflikte, p.sh. EUROMED.

Në mënyrë të përsëritur vëzhguam që pjesëmarrësit kishin prirjen të ndjeheshin të shokuar nga grupet radikale, pasi ata që e konsiderojnë veten “njerëz të civilizuar” as që mund të arrinin të përfytyronin një sjellje kaq mizore. Këtu, ndonjëri mund të përdorë atë që mund ta quajmë “Loja Makiaveli” për të mësuar teknikat që parashikojnë sjelljen disfunktionale, p.sh. grupet dhe individët radikalë. Metoda është e thjeshtë: mblidhet informacion rreth individëve dhe grupeve të tillë dhe për një moment bëhen përpjekje për të hyrë në lëkurën e tyre: Çfarë do të bënit për të komanduar klasën, shkollën, fshatin, rajonin?

Kjo metodë mund të quhet “Njohuri Makiaveliane”: për të kuptuar, parashikuar dhe për t’iu kundërvënë logjikave dhe mekanizmave të lojrave jofunkionale të pushtetit dhe shprehjes së tyre mediatike. Kujdes: Duket se ekziston i ashtuquajtura “çrregullim i përbashkët psikotik”, i njohur gjithashtu si “marrëzi ngjitëse” ose “marrëzi infektuese”.¹⁰ Prandaj, kjo metodë duhet përdorur me kujdes dhe në mënyrë jo shumë ekstensive; pasi puna intensive me dokumente dhe ideologji esktrmiste, terroriste dhe kriminale mund të dëmtojë seriozisht botëkuptimin, karakterin dhe ekuilibrin emotiv, duke çuar kësisoj në konflikte me familjen, miqtë dhe kolegët.

“Idioti i dobishëm”¹¹

Ky term është një mekanizëm që shpjegon se çdo pushtet disfunktional ka nevojë për “idiotë të dobishëm” që të luftojnë për ta e të përmbushin misionin e tyre. Ky mund të jetë njeri që shpërndan mesazhe radikale në mediat sociale, ose madje vetëvrasës me bombë, por gjithashtu edhe staf i kompanive të caktuara që prodhojnë të mira materiale. Kjo metodë mund të përdoret në seminarët e MILID-it për të nxitur vetëreflektimin “Sokratik”: a po i shërbej vërtetë komunitetit, sfidave globale si SDG-të dhe të drejtave të fëmijëve, ose a po keqpërdoret vullneti dhe synimet e mia të mira nga një person/institucion i dyshimtë?

Shtatë Gjeneratat e MILID-it

Sipas Norbert Elias-it, zhvillimi i një vizioni afatgjatë është diçka thelbësore për një proces të suksesshëm civilizimi. Një pjesë e vendasve të Amerikës, kur marrin vendime të rëndësishme, përdorin një metodë e cila merr në konsideratë shtatë breza. Kjo metodë është transferuar në menaxhimin e qëndrueshëm¹²; dhe autori e transferoi në fushën e MILID-it dhe të ndërtimit të komunitetit. Në këtë model, brezi aktual është brezi i katërt: përpara nesh kanë qenë tre (p.sh. aktivistët e parë për fëmijët dhe të drejtat e njeriut). Fëmijët që po mësojmë janë brezi i pestë (“gjenerata SDG”). Dhe efekti i plotë i të gjitha sukseleve dhe dështimeve tona nuk do të shihet përpara brezit të shtatë. Vetëm atëherë, do të korrim dividendin e plotë pozitiv ose negativ të MILID-it (shih artikullin tim të përmendur më sipër mbi Dividendin e MILID-it në Vjetarin MILID për 2015). Kjo qasje ndihmon në krijimin e strategjive afatgjata dhe të ndjesisë së përgjegjësive për solidaritetin komunitar dhe ndërgjeneracional.

Loja "House of Cards"

Në disa laboratorë u kërkojmë pjesëmarrësve të ndërtojnë një shtëpi me letra ose gjëra të tjera. Mjaft shpejt bëhet e qartë që nevojitet shumë durim dhe aftësi për të ngritur shtëpinë dhe se fare lehtë ajo mund të shkatërrohet. Kjo lojë shërben si një metaforë e mirë për ngritjen dhe zhvillimin e paqes: progresi arrihet me vështirësi, por shkatërrohet lehtë. Me kohë gjërat prishen, mjafton vetëm të rrish e të presësh. Loja mund të duket argëtuese dhe e parëndësishme, por mjedisi teorik shkon thellë: mekanizmi që qëndron në bazë të saj është parimi fizik i entropisë, i përmendur nga Luhmann. Entropi do të thotë tendencë e gjithë universit për të ndryshuar nga nivelet më të larta të rendit në ato të rendit më të ulët. Për të krijuar ose ruajtur një lojë "ishulli të rendit" duhen përpjekje (energjia, kohë, krahë pune, para); gjë e cila sjell edhe më shumë entropi brenda gjithë sistemit. Duke e transferuar këtë në kontekstin tonë, mund të supozojmë që rendi ka më pak gjasë se kaosi; mirëkuptimi më pak gjasë se keqkuptimi; mësimi i suksesshëm më pak gjasë se e kundërta. Me këtë metodë mund t'u tregojmë njerëzve shumë thjesht dhe në mënyrë efektive se sa shumë përpjekje dhe durim duhet për ndryshimin pozitiv. Kjo ndihmon në luftën kundër iluzioneve për "botë më të mirë" dhe kundër teorive të konspiracionit të "forcave të së keqes" që sjellin zhgënjim dhe zemërim.

"Teatri Botëror"

Në qoftë kritikizmi i drejtpërdrejtë nuk është i mundur, p.sh. në shtetet autokratike, ka një opcion që t'i referohesh shembujve negativë dhe pozitivë në vende ose rajone të tjerë, pa përmendur në mënyrë direkte vendin e vetë personit. Në një proces reflektues "Sokratik" audienca mund të fillojë e të mendojë në mënyrë abstrakte e më pas të gjejë lidhjen me botën e vet. Kjo është e krahasueshme me funksionin e teatrit: përdorimi i ngjarjeve nga vende dhe kohë të tjera që mund ta bëjnë shikuesin të mendojë për veten. Kjo është arsyeja pse autori e quan këtë metodologji "Bota e Teatrit".

"Guerilja MILID"

Në luftën kundër radikalizmit, mund të jemi ndonjëherë të detyruar të përdorim teknika të ngjashme, p.sh. "taktika guerile", për të qenë virtualisht të "padukshëm" në mënyrë që të mund të përmbushim një mision të caktuar. Radijojo ka drejtuar e vazhdon të drejtojë projekte që nuk i publikon ose e bën këtë vetëm në një version shumë të reduktuar, ose vetëm për audienca të përzgjedhura. Disa aspekte që autori u mëson të tjerëve dhe i konsideron si arritje themelore dhe kritike, nuk ekzistojnë në sferën publike, në mënyrë që të mos kërcënojnë e vërë në rrezik pjesëmarrësit, ekipin, veten dhe familjen e tij.

Mësimi "Pa Justifikime"

Një ndër problemet në punën sociale mbetet kultura e vetviktimizimit. Në disa seminare, pjesë e punës sonë është "vrasja e justifikimeve", si p.sh. "jemi shumë të varfër", "nuk kemi asgjë", "askush nuk kujdeset për ne". Ne përpiqemi të sjellim kundërshe mbuj. Një

shembull i tillë është ai i Enciklopedistëve, njerëz trima në Francën e para revolucionit, të cilët rrezikuan jetën për të thyer monopolin e dijes. Tani, më në fund, pasuesit e tyre e kanë përmbushur këtë mision: kushdo ka akses në gjithë dijen e botës nëpërmjet platformave të tilla si Wikipedia dhe Open Educational Resources – pa pagesë. Asnjë gjeneratë nuk e ka patur këtë privilegj më parë. Kësisoj, ne mësojmë që u përket individëve t’i përdorin këto burime në mënyrë të vetëdijshme dhe të mençur. Justifikimet e vjetra në shumicën e rasteve nuk vlejnë më. Ne gjithashtu i bëjmë thirrje vetvlerësimit, duke iu referuar studimeve në edukimin ndërkombëtar dhe treguesve të zhvillimit, në mënyrë që të zgjojmë shpirtin konkurues të pjesëmarrësve në kuptimin “sportiv”: “Shiko vendin x ose y ose personin z. Ata ia dolën mbanë në kushte të krahasueshme ose madje edhe më të këqia. Edhe ju e vendi juaj mund t’ia dilni!”

Mësimi i vendasve të Amerikës

Ndonjëherë ne vazhdojmë me një aspekt që ka lidhje me mësimin e mëparshëm “pa justifikime”. Ne themi, “Shoh që shumica prej jush ka *smartphon*-ë. Kjo ndryshon gjithçka. Tani, me akses në të gjitha Open Educational Resources global, keni kushte fillestare më të mira teknike dhe edukative nga ç’kishim ne në moshën tuaj”. Mësimin “pa justifikime” mbyllim këtë duke përdorur qëllimisht një referencë kulturore shumë të ndryshme nga Perëndimi: kryetari i Vendasve Indianë të Amerikës, Blac Elk, tha një herë mbasi pa një vizion: “(...) qendra e universit “(...) është vërtetë kudo. Ajo është brenda secilit prej nesh.”¹³ Në një botë të globalizuar e të digjitalizuar askush nuk është më në periferi. Çdo person është në qendër. Çdo person është një nyje në rrjetën globale.

Biografia e Edukatorit si Instrument i MILID-it

Edhe teoria e sistemit pohon që roli i subjektit dhe personaliteti i mësuesit kanë rëndësi të jashtëzakonshme në edukim. Luhman thotë që biografia e një personi është medium në vetvete. Ne mund të shprehim dhe provojmë gjëra të caktuara me biografinë. Autori i ka integruar gjithmonë e më shumë aspektet biografike në punën e tij me MILID-in. Natyrisht, çdo edukator ka biografi të ndryshme, por duket se disa modele janë të dallueshëm: mund të jenë aspektet e fëmijërisë dhe të rinisë së dikujt, arrijet personale dhe dështimet, si dhe ngjarje që mund t’i japin rëndësi të posaçme dhe autenticitet edukimit të MILID-it. Këtu janë disa shembuj personalë. Duke qenë se ata janë subjektivë, autori për këtë seksion zhvendoset te forma “Unë”.

Kremtimi i Jetës në vend të Martirizimit

Në vitin 1989, duke qenë 19 vjeç, u bëra pjesë e lëvizjes së shoqërisë civile që çoi në rënien e murit dhe ribashkimin e Gjermanisë. Në fillimet e kësaj lëvizjeje, një nga grupet e fshehtë rrok të Gjermanisë Lindore, Freygang, kishte në një nga këngët e veta të titulluar «Die Bürokratie» një varg: “Ti më pyet nëse ka ndonjë gjë që të bën të vdesësh, Unë të them që ka shumë për të cilat ia vlen të jetosh”¹⁶ (Burokracia) Ky mesazh, (në formën mediatike të këngës) pati ndikim mbi mua dhe ndoshta mbi shumë të tjerë brenda lëvizjes. Këngët

për paqen të këngëtarëve si Joan Baez ndihmuan në rezistencën jo të dhunshme dhe mosbindjen popullore civile, duke festuar jetën (= “biofilia”, në termat e Erich Fromm-it). Revolucioni në Gjermaninë Lindore mbeti jo i dhundhëm. Kjo është në kundërshtim me “nekrofilinë” e sotme (Fromm) ose “kulturën pop” nihiliste të të rinjve të ISIS-it. Në seminarët e mia ua jap këtë leksion sidomos të rinjve për t’i ndihmuar të kuptojnë se si janë të ekzpozuar karshi propagandës së dhunshme.

Leksioni “Ne qëndrojmë këtu!”

Në vitin 2016, iu bashkova njëres prej partive të mëdha demokratike në Gjermani. Unë e ndaj këtë informacion me pjesëmarrësit. Unë nuk e përmend emrin e partisë, sepse nuk ka aspak rëndësi në këtë kontekst. Ajo çka ka rëndësi është që demokracia ka nevojë për demokratë që punojnë për të dhe e mbrojnë. Unë shpjegoj që padyshim puna e partisë është e mërzitshme, të ha kohë dhe është burokratike; madje mund edhe të të kushtojë disa shokë – e megjithatë ka kuptim. Me këtyre, synoj të jap edhe një herë tjetër një histori personale për të modeluar pjesëmarrjen, durimin, përpjekjet kundër zhgënjimit dhe radikalizimit; duke u përpjekur sërish të largoj justifikimet.

Instrumenti “Advocatus Diaboli”

Si student i menaxhimit të medias, unë isha i shquar si “advocatus diaboli”, pasi shpesh sfidoja konceptet e menaxhimit që bazoheshin te qëndrimet etike. Më vonë, mësova që kjo metodë rekomandohet vërtet si një mjet për të shpërbërë “mendimin në grup” në termat e I.L. Janis-it.¹⁷ p.sh. mendim i dëshiruar në termat e romantizmit social. Janis propozonte që në punën në grup, një person duhej caktuar të merrte “kundër pozicion” e të debatonte pikëpamjet dhe bindjet që kishte grupi respektiv. Transferimi i kësaj metode “skepticiiste” në punën me Radijojo-n i ka rrënjët në ekzpozimin tim ndaj ideologjive të ndryshme që në fëmijëri dhe rini, ku secila prej tyre pretendonte të ishte e vërteta absolute: komunizmi, katolicizmi, protestanizmi, kapitalizmi perëndimor. Ky mjet është i dobishëm dhe ndimon të vendosësh të njëjtën distancë ndaj të gjitha ideologjive. Në këtë, ne ndjekim John Dewey-n i cili ideologji të tilla i quante “izma”, të cilat ai s’i pranonte në konceptin e vet edukativ.¹⁸

Qasja “këmbëzbathur”

Këtu jam frymëzuar nga Bunker Roy dhe “kolegjet e tij këmbëzbathur¹⁹” në Indinë rurale, të cilët i takova dhe i intervistova dhjetë vjetë më parë.

Shumë të rinj që tani janë të lidhur në Internet shohin anën joshëse të Perëndimit/Veriut, gjë e cila çon në iluzione rreth jetës në Perëndim por po ashtu, dhe në zhgënjime. Në punën time në terren, jam mësuar të ndeshem me pikëpamje të tilla. Unë u shpjegoj fëmijëve, të rinjve dhe edukatorëve që unë vetë nuk kam makinë, por i shpenzoj paratë e mia për Radijojo-n. Unë nuk vishem me roba të shtrenjta dhe as kam pajisje digjitale të fjalës së fundit. U shpjegoj po ashtu që po t’i kisha ato, nuk do kisha qenë në gjendje t’i vizitoja në shkollën e tyre. Kjo ndihmon për të kuptuar që për të përmbushur ëndrrat tona duhet sakrifikuar kohë dhe para, dhe se që është një zgjedhje që dikush e bën me

ndërgjegje kur vendos të investojë për Paqen në vend që t'i shpenzojë paratë për të blerë gjëra luksi. Qëllimisht de në laboratorët tanë ne përdorim *low-tech* për ta bërë të qartë që për të mësuar e përparuar nuk është nevoja të kesh materjale të teknologjisë së fundit.

Strategjitë Ndërdisiplinore Antiradikale MILID

Në seksionin që vijon autori përshkruan se si MILID-i mund të përdorë qasje ndërdisiplinore për të zhvilluar dhe implementuar strategji antiradikale. Shembujt e parë përfshijnë gjithashtu disa elementë biografikë.

MILID-i dhe Psikologjia e Reklamës

“Ne pionierët e duam Republikën Demokratike të Gjermanisë. (...) Ne jemi miq me fëmijët e Bashkimit Sovjetik dhe të të gjitha vendeve të tjera”. “Betimin e Pionierit”²⁰ e mësova në Gjermaninë Lindore kur isha rreth 8 vjeç dhe e mbaj mend ende. Thirrje të tilla moraliste nga lart poshtë nuk na bënë ta duam vendin, as nuk u bëmë miq me Bashkimin Sovjetik. Përkundrazi, kjo gjë na lodhte gjithnjë e më shumë e filluam të tallemi me të. Por atëherë nuk e kuptoja këtë gjë. Sot mundem. Në psikologjinë e reklamave ky reagim legjitim për tu mbrojtur kundër propagandës së padëshiruar, p.sh. reklama, quhet reaktancë²¹. Sot mund të them që përvoja të tilla më kanë ndihmuar të zhvilloj një marrëdhënie të miqësore të veçantë me njerëz në Rusi, Poloni e në shumë shtete të tjera të ish botës komuniste ku njerëzit i ishin nënshtruar kësaj lloji propagande dhe qeverisjes totalitare. Dikush mund ta shohë këtë si proces dialektik, ose në termat e Hegelit “mohimi i mohimit”. Duke përdorur këtë mësim, unë përmend që edhe një çështje që duket krejt e parëndësishme, si për shembull promovimi i miqësisë ndërkombëtare, është çështje shumë komplekse që mund të sjellë efekte të pamenduara më parë dhe ndonjëherë të padëshiruara.

MILID-i dhe media e botës së vërtetë

Kur isha fëmijë, ndoshta në vitin 1982, mes të rinjve në oborret e shkollave qarkullonte një “barcaletë”. *“Kam uri, kam ftohtë/ dua të kthehem në Buchenwald”.* Buchenwald ishte emri i një kampi përqëndrimi nazist të dikurshëm, vetëm disa milje larg. Më kujtohet një djalë në Poloni, ndoshta në vitin 1986, i cili urinoi mbi yllin sovjetik që kishte vizatuar më parë në rënë. Tani vonë, në vitin 2016, njerëz të panjohur në qytetin tim të vogël kishin formuar me çamçakëz një kryq të thyer. Pak muaj më parë, vetëm pak kilometra larg Erfurtit, njerëz të panjohur kishin prerë barin në lëndinën në qendër të qytetit në formën e kryqit të thyer; gjë që u zbulua në një foto nga sateliti i hartës së Google-it²².

Të gjithë këta shembuj bëjnë një gjë të qartë: nuk do të kemi sukses e nuk do ta kuptojmë radikalizmin në qoftë se fokusohemi vetëm në të tashmen dhe në të ardhmen, as edhe nëse fokusohemi vetëm te media digjitale. Më pas vijojnë disa shembuj të përdorimit të strategjive jo digjitale MILID. Në Marok, studentët tanë krijuan një simbol të madh të paqes, duke lidhur duart e duke përdorur si medium trupat e tyre. Në Marok krijuam ekspozitat e vizatimeve të paqes, një tjetër medium “tradicional” e megjithatë efektiv. Në nismën tonë Shkollorë Transatlantike, fëmijët në Shtetet e Bashkuara dhe në Gjermani shkëmbyen vizatimet e tyre për të ndërtuar kësisoj partneritetin mes tyre²³. Në vitin 2016,

filluam në Marok një projekt gazete, pasi rizbuluam vlerën e medias jodigitale, sidomos në botën në zhvillim.

MILID-i dhe problemet psikologjike

Në vitin 2015 në Gjermani, autori pa një shfaqje televizive fetare ku njerëzit merrnin në telefon dhe flisnin rreth problemeve të tyre private. Në perceptimin e autorit për shfaqjen, disa nga personat treguan simptoma të rënda të problemeve psikologjike, si për shembull depresion akut. Në Rusi, raportohet që një grua vrau fëmijën dhe si arsye për këtë dha motive fetare²⁴. Rregullisht shohim se fëmijëve u mungon mbështetja psikologjike. Probleme të tilla nuk duhen shfrytëzuar nga grupe fetare (ose politike). Në kontekstin e antiradikalizimit, autori sheh nevojë të fortë – dhe në të vërtetë detyrim – për bashkëpunim sistematik të udhëheqësve fetarë dhe edukatorëve MILID me psikologët, pediatrët, punëtorët socialë; dhe po qe e nevojshme/e aplikueshme, me policinë dhe subjektet e ngarkuar për ruajtjen e sigurisë.

MILID dhe filozofia e aplikuar

Duket se disa kultura kanë tendencë drejt eskatologjisë²⁵ ose “mileniarizmit” (ose “*chiliasm*”), që do të thotë shpresa se “për gjithçka ekziston gjithmonë një zgjidhje perfekte”²⁶. Duke iu referuar shkencëtarëve si Karl Popper, ne ofrojmë një qasje ndryshe. Ne përpiqemi të krijojmë sensin e vetvendosjes dhe të modestisë; që ne të gjithë thjesht mësojmë nga sprovat dhe gabimet, që zgjidhja e një problem është parim shumë bazik në zhvillimin e natyrës dhe të njeriut, që e ardhmja është e hapur – dhe që të gjitha qeniet njerëzore gabojnë. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, shpesh zgjidhjet e djeshme shndërrohen në probleme të sotme, sip.sh. energjia fosile dhe bërthamore. Ne përdorim teknikat e skenarit për t'i ndihmuar fëmijët të krijojnë vizione konkrete dhe realiste për të ardhmen afatmesme, duke përfshirë këtu mjete të menaxhimit si analiza SWOT. Ata kontribuojnë në mënyrë praktike drejt Open Educational Societies që janë esenciale për të ardhmen e njerëzimit, sipas Klingholz/Lutz (2016).

MILID, transferimi i dijes dhe shumimi

Publikuesit e propagandës së ISIS-it online mësuam të përdorin për qëllimet e veta pajisjet IT të fjalës së fundit²⁷. Prandaj ne nuk duhet të përhapim njohuritë MIL në ambjentet e njerëzve që i konsiderojmë potencialisht radikalë. Për shembull, Radijojo refuzoi të trainojë për prodhimin e videove disa grupe të cilat nuk i njihnim dhe që nuk u besonim plotësisht; ne e bëjmë këtë edhe kur projektet janë nga ana logjistike mjaft të lehtë dhe tërheqës financiarisht për OJQ të vogla si e jona.

Detyrat e ardhshme për mjetet e përzgjedhura të MILID-it

MILID-i, Ligji dhe Ekonomia

Krijimi i mekanizmave për reduktimin e gjuhës së urrejtjes online mori shumë kohë dhe ka pak të ngjarë që kjo luftë do të mbarojë ndonjëherë. Një rekomandim është që ata

që urrejnë s'mjafton vetëm të neutralizohen e të çohen në gjyq, por duhet gjobat financiare që mbliidhen prej tyre të investohen direkt në projekte që i shërbejnë paqes dhe edukimit. Në këtë mënyrë, propaganda radikale do të subvencionojë kundërshtarin e vet. Aksioni "Urrejtja ndihmon", i cili bën dhurim për çdo koment të raportuar për përdorimin e gjuhës së urrejtjes kundër refugjatëve²⁸, është një ide në këtë drejtim; por është tepër e vogël për të patur impakt të vërtetë. Ai duhet implementuar si politikë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar në mënyrë që në mënyrë sistematike t'i detyrojë radikalët të paguajnë një kosto për gjuhën e tyre të urrejtjes dhe të terrorit, duke subvencionuar kështu komunikimin e MILID-it për paqe.

MILID-i dhe hakerimi

Grupe si Anonymus lajmëruan që do ta luftonin ISIS-in²⁹. Është e vështirë të kuptohet pse qënka e mundur të hakerohen gjithë llojet e kompanive dhe organizatave, por deri tani nuk ka qenë e mundur të hakohen e të bllokohen publikime si ato të revistave³⁰ famëkeqe online të ISIS-it. Rekomandohen për të ardhmen hulumtime dhe inovacione ndërdisiplinore. MILID-i këtu do të hynte në një dimension të ri. Kujdes: veprimtari të tilla mund të nxisin kundërsulme.

MILID-i dhe epidemiologjia

Autori ka vënë re se radikalizimi ndjek modele specifike që shfaqin paralelizma me epidemitë. Një "virus" i caktuar (në disa aspekte, virusi nuk është asgjë më shumë se një "kod", qoftë biologjik qoftë digjital) mund të fillojë të infektojë një lloj veçantë personi ose grupi, shpesh me një "periudhë të caktuar inkubacioni", të përhapet në mënyrë virale me anë të disa kanaleve të infektimit, duke shkaktuar dëme të caktuara, por vetëm në qoftë se infektohet një masë e caktuar kritike dhe në qoftë se rrethanat shoqëruuese (sociale, mjedisore, kulturore, ekonomike) mbështesin dhe përhapin sëmundjen, etj.

Kështu, puna kërkimore epidemiologjike mund të ndihmojë për të kuptuar, parashikuar dhe kundërshtuar radikalizmin. Autori e diskutoi këtë ide me Dr. Gerd Klausen nga Berlina në Gjermani, mjek i specializuar në sëmundjet e sistemit imunitar; ai e mbështeti idenë. Në këtë mënyrë, ftojme kolegët studiues për studime të përbashkëta ndërdisiplinore.

MILID-i dhe kriminologjia

Autori vëzhgoi disa struktura ku keqpërdorimi i fëmijëve dhe kufizimet në median që krijojnë të rinjtë duket se ndjekin modele të krimit të organizuar³¹. Radikalizimi politik ose fetar, terrori dhe krimi i organizuar, duke përfshirë këtu larjen e parave, duket se shpesh punojnë krah për krah dhe janë të lidhur me keqpërdorimin e mediave të krijuara nga të rinjtë; p.sh. propaganda e IS-it e ndërmjetësuar nga të rinjtë dhe që ka si objektiv të rinjtë; ose glorifikimi i bandave të drogës dhe i grupeve militante në Amerikën Latine. Mendojmë që në qoftë se përdorim qasje kriminologjike si "ndiq paratë", mund të zbulojmë struktura të caktuara në nivel ndërkombëtar dhe lokal që mund ta ndihmojnë dikë të kuptojë, zbulojë dhe kundërshtojë ndërvarësitë midis këtyre sektorëve. Kjo sferë ka nevojë për eksperimentizim

të posaçme në fushën e krimit të organizuar; kërkimi ka nevojë për kujdes të veçantë dhe mbështetje ligjore. Autori fton në këtë mënyrë institucionet kërkimore të kriminologjisë, drejtësisë, dhe institucionet e lidhura me qeverisjen e mire, të punojnë bashkë me ekspertët e MILID-it në këtë fushë.

Përfundim

Kjo është një përzgjedhje modeste mes shumë mjeteve që ne dhe të tjerët zhvillojmë në mënyrë të vazhdueshme. “Kutia e mjeteve MILID” natyrisht që nuk është formulë magjike; dhe nuk është kurrë e plotë. Por ajo ka provuar të jetë efiçente dhe efektive në nivel praktik.

Megjithatë, shumë nga mjetet e diskutuar më sipër mundet vetëm të ndihmojnë për të riparuar atë çfarë kanë shkaktuar deficitet në politika, ekonomi, media dhe shoqëri. Ne do të punojmë drejt një bote ku mjete të tilla janë të panevojshme.

“Kutia e mjeteve MILID” është tani e hapur për zhvillime të mëtejshme bashkëpunimi me komunitetin e profesionistëve GAPMIL/MILID.

Referenca:

- Capra, F. (2014): *The Systems View of Life*. Cambridge University Press. Collaborative Learning Projects (2004): *The Do No Harm Handbook*. (The Framework for Analyzing the Impact of Assistance on Conflict). Cambridge, M.A.
- Klingholz, R. and Lutz, W. (2016): *Wer überlebt? Bildung entscheidet über die Zukunft der Menschheit*. Frankfurt a.M.: Campus.
- Luhmann, N. and Lenzen, D.(Publ.) (2002): *Das Erziehungssystem der Gesellschaft*. Frankfurt am Main: Suhrkamp Taschenbuch Verlag.
- Schmidt-Salomon, M. (2006): *Manifest des evolutionären Humanismus. Plädoyer für eine zeitgemäe Leitkultur*. Aschaffenburg: Alibri.

Shënime

1. Thomas Rohlinger (2015): *The MILID Dividend: A Conceptual Framework for MILID in the Glocal Society*. In *MILID Yearbook 2015*, p. 39-48
2. Shih e.g. Salomon, Gavriel and Nevo, Baruch (Edit.) (2002): *Peace Education. The Concept, Principles and Practices Around the World*. Lawrence Erlbaum Assoc. /Psychology Press
3. E.g. Mary B. Anderson (1999): *Do No Harm: How Aid Can Support Peace - or War*. Lynne Rienner Publishers, Boulder/London,
4. <http://radijojourussia.edublogs.org/>
5. <http://the-transatlantic-school-initiative.radijojo.de/>
6. Bouman, D. E. : *Frustration Tolerance*. In: *Encyclopedia of Clinical Neuropsychology*, p. 1101-1101. Springer.
7. Shih e.g. <http://futur.edublogs.org/2014/08/13/our-future-visions-of-the-media/>

8. <http://www.unesco.org/en/university-twinning-and-networking/access-by-region/europe-and-north-america/united-states-of-america/unesco-chair-in-communicationfor-sustainable-social-change-949/>
9. Në një version bazik, kjo lojë luhet si për të “thyer akullin” në disa programe ndërkombëtare shkëmbimi për të rinj. Burimi origjinal është i panjohur për autorin. Ne e kemi përshtatur atë për konceptin tonë të zhvillimit të MILID-it dhe të komunitetit.
10. Encyclopedia of Mental Disorders. <http://www.minddisorders.com/Py-Z/Shared-psychotic-disorder.html>
11. https://en.wikipedia.org/wiki/Useful_idiot
12. https://en.wikipedia.org/wiki/Seven_generation_sustainability
13. <http://www.goodreads.com/quotes/661971-at-the-center-of-the-universe-dwells-thegreat-spirit>
14. <http://www.venganza.org/>
15. <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002315/231544e.pdf>
16. <https://plus.google.com/116937863067680655968/posts/gwjkeVq2RLi>
17. <https://en.wikipedia.org/wiki/Groupthink>
18. Dewey, J (1a938): Experience and Education, p. 8 Simon & Schuster
19. <http://www.barefootcollege.org/>
20. <http://www.ddr-geschichte.de/Bildung/Schule/Pionierorganisation/Pionier-Gebote/pionier-gebote.html>
21. <http://www.psychology48.com/deu/d/reaktanztheorie/reaktanztheorie.htm>
22. <http://www.n-tv.de/politik/Grosses-Hakenkreuz-in-Erfurter-Park-entdeckt-article17203481.html>
23. <http://the-transatlantic-school-initiative.radijojo.de/?p=2900>
24. http://www.focus.de/panorama/welt/vom-ehemann-radikalisiert-kindermaedchen-enthauptet-4-jaehrige-und-laeuft-mit-kopf-durch-moskau_id_5328920.html
25. <https://en.wikipedia.org/wiki/Eschatology>
26. <https://en.wikipedia.org/wiki/Millennialism>
27. Schmidt-Salmon (2006 f. 116) e quajti fenomenin e tij “ndriçim i përgjysmuar”: duke përdorur me mjeshtëri teknologjinë përëndimore teksa injoronte ose madje edhe luftonte vlerat humaniste (“përëndimore”)
28. <http://www.sueddeutsche.de/panorama/aktion-hass-hilft-rassisten-spenden-unfreiwillig-fuer-fluechtlinge-1.2705028>
29. <http://www.zeit.de/digital/internet/2015-11/anonymous-kollektiv-is-terrorismus-bilanz>
30. <https://www.clarionproject.org/news/islamic-state-isis-isil-propaganda-magazine-dabiq#>
31. https://en.wikipedia.org/wiki/Organized_crime

Radikalizimi i të Rinjve në Hapësirën Kibernetike

Rrjeshtimi i Alfabetizimit në Media dhe Informim në Betejë për Zemrat dhe Mendjet e Njerëzve

Tessa Jolls & Carolyn Wilson

Alfabetizimi në media dhe informim (MIL) i kapërcenë kufijtë – si ata gjeografikë ashtu edhe ata mes subjekteve dhe disiplinave – e megjithatë ai ofron një proces që shërben si katalizator për analizën, diskutimin, krijimin dhe pjesëmarrjen. (Wilson dhe Jolls, 2015) Nëpërmjet një rrjeti global të qëndrueshëm, është e mundur të strukturohet një strategji koherente, e matshme dhe e shkallëzuar. MIL ofron një kundërstrategji efektive ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit taktik, një strategji që mund të zbatohet menjëherë dhe që e ka treguar efektivitetin e vet, duke fituar zemra dhe mendje sa here që është aplikuar për qëllime sociale. Por ajo çka është më e rëndësishme në ditën e luftës kundër terrorizmit në nivel global, trainimi dhe implementimi i programeve të MIL-it mund të bëhet në mënyrë eficiente dhe në kohën e duhur.

Në ditën e perceptimeve të mësipërme, ky studim do të:

- *eksplorojë studimet e bëra në lidhje me fuqinë dhe efektivitetin e edukimit në MIL*
- *eksplorojë rëndësinë e kornizës konceptuale të MIL-it*
- *prezantojë disa raste studimore që ilustrojnë rëndësinë e MIL-it kur trajtohen çështje të tilla si të drejtat e njeriut, propaganda, indoktrinimi dhe ekstremizmi*
- *diskutojë se sa thelbësor është trajtimi i sfidave aktuale globale me të cilat përballlet MIL dhe të drejtat e njeriut në nivel global, si dhe afrimi grupeve dhe i palëve të interesuara drejt njohurive në media dhe informim.*

Fjalëkyç: Edukimi në media, njohuri në media dhe informim, edukim, ekstremizëm, antiterror, globalizëm.

Hyrje

Edukimi është katalizator i fuqishëm për ndryshim e gjithashtu një indikator për ata që angazhohen e marrin pjesë në politikë – sa më shumë arsimim, aq më shumë janë gjasat që një qytetar të jetë aktiv politikisht. Sot, parë në prizmin e arritjeve arsimore, studentët e kolegjeve janë më aktivët në fushën e pjesëmarrjes në politikë, cila përkuftizohet

si interaktive, si veprimtari mes të barabartëve nëpërmjet të cilave individët dhe grupet kërkojnë të ushtrojnë zërin dhe influencën e tyre mbi çështje të shqetësimit publik (Cohen & Kahne, 2012).

Një shënjestrim i tillë i kolegjeve aktive në politikë dhe i të rinjve të shkollave të mesme është strategjia që përdor ISIS-i dhe ekstremistë të tjerë radikalë, gjë e cila pranohet dhe nga raportime si në nivel personal ashtu edhe ato të niveleve më të larta qeveritare.

“Robert Hannigan, kreu i shërbimeve të mbikqyrjes për Mretërinë e Bashkuar, ka thënë që ISIS dhe grupe të tjera ekstremiste përdorin platformat si Twitter, Facebook dhe WhatsApp për të arritur audiancat që kanë vënë në shenjestër me një gjuhë të kuptueshme prej tyre. ‘Metodat përfshijnë shfrytëzimin e *hashtag*-eve të njohur për përhapjen e mesazhit të tyre’, tha ai.

‘ISIS përdor gjithashtu rekrutë perëndimorë për të promovuar kauzën te njerëz të tjerë në vendet nga vijnë ata.’ “Grupi ekstremist po fokusohet gjithashtu veçanërisht te vajzat, thonë analistët’. Sot shohim gra të reja nga vendet e Perëndimit që shprehin mbështetjen e tyre dhe emigrojnë në Siri në shifra të papara ndonjëherë më parë, thotë Sasha Havlicek, shefi ekzekutiv i Institutit për Dialog Strategjik. ‘Dhe do të thoja që kjo është në të vërtetë rezultat i një makinerie rekrutimi që përdor një propagandë jashtëzakonisht të sofistikuar, e cila vë në shenjestër në mënyrë shumë specifike gratë e reja.’” (Mullen, 2015)

Këto dëshmi theksojnë nevojën në rritje – disa mund të thonë urgjente – të edukimit me njohuri në media dhe informim (MIL). MIL-i, me fokusin mbi aftësitë kyç, mund të ndihmojë për t’u ofruar të rinjve aftësi, dije dhe qëndrime për të cilat ata kanë nevojë të kuptuar se si funksionon e gjithë media, përfshirë ato sociale; si mund të përdoret ajo, nga kush dhe për çfarë qëllimesh; si të vlerësojnë informacionin që prezantojnë mediat.

Mjedisi i krizës

Deri në dhjetor 2015, rreth 27,000 – 31,000 rekrutë të huaj nga të paktën 86 vende, udhëtuan në Siri dhe Irak për t’iu bashkuar Shtetit Islamik, – rritje kjo e konsiderueshme nga shifra 12,000 luftëtarë të huaj prej 81 vendeve që raportohej në qershor 2014. Europa Perëndimore, Rusia dhe Azia kanë parë gjithashtu rritje të konsiderueshme në rekrutime; shifrat në Shtetet e Bashkuara kanë mbetur të njëjta dhe shumica e rekrutimeve në SHBA arrihen nëpërmjet mediave sociale. Përqindja mesatare e atyre që kthehen në vendet e Perëndimit është rreth 20-30%. (Soufan Group, 2015). Këto të dhëna tregojnë që mbetet ende shumë për të bërë për të dekurajuar besnikërinë për Shtetin Islamik dhe një listë të gjatë organizatash të tjera terroriste në botë – Hezbollah, Boko Haram, Al-Queda, Abu Sayyaf, e të tjera me rradhë.

Kuptimi i rolit që luan Interneti në trajtimin dhe rekrutimin e ekstremistëve të rinj është kyçi për të identifikuar një strategji efektive për t’iu kundërvënë propagandës xhihadiste. Në një studim të vitit 2013 (von Behr, Reding, Edwards& Gribbon, 2013), të 15 rasteve ekstremiste dhe terroriste të identifikuara nga Shoqata e Shefave të Policisë e Mbretërisë së Bashkuar (ACPO) dhe Njësia Antiterror e Mbretërisë së Bashkuar (CTU), studjues të Rand Europe pohonin që “për të gjithë 15 individët e studjuar, interneti ka qenë burimi kyç i informacionit, i komunikimit dhe i propagandës për besimet e tyre ekstremiste

... ky akses online te njerëzimit mund të ofrojë mundësi më të mëdha se bota jashtë rrjetit për të konfirmuar besimet ekzistuese dhe për të shmangur konfrontimin me informacionin që do t'ua vështirësonte punën”. Rand Europe analizon dhe krahason pesë hipotezat lidhur me përdorimin e internetit nga radikalët; hipotezat u identifikuan nëpërmjet shqyrtimit të literaturës dhe tregohen në tabelën më poshtë. Më pas Rand Europe krahasoi këto hipoteza të të dhënave fillestare që përmbanin pesëmbëdhjetë rastet me rezultatet e mëposhtme:

Hipotezat nga literatura	A mbështeten hipotat nga të dhënat primare?
1. Interneti krijon më shumë mundësi për radikalizim	Po në të gjitha këto raste.
2. Interneti shërben si “dhomë jehone”	Po në shumicën e rasteve.
3. Interneti përshpejton procesin e radikalizimit	Duke qenë se nuk ka një marrëveshje për kohëzgjatjen dhe modelin e radikalizimit, nuk është e qartë nëse interneti ka përshpejtuar apo jo këtë proces në shumicën e rasteve; në këto raste duket se internet i mundëson por jo domosdoshmërisht përshpejton radikalizimin.
4. Interneti i jep mundësi radikalizimit të realizohet pa kontakt fizik	Jo në shumicën e këtyre rasteve; në shumicën e rasteve ka veprimtari jashtë rrjetit që mund të ketë luajtur rol në radikalizimin e individit
5. Interneti rrit mundësitë për vetëradikalizim.	Jo në shumicën e këtyre rasteve: më së shumti këto të ashtuquajtura vetëradikalizime përfshijnë komunikime virtuale dhe ndërveprime me të tjerë.

Këto gjetje mbështesin fort nocionin që interneti luan rol unik dhe të paprecedent në procesin e rekrutimit, duke filluar nga krijimi i mundësive për lidhje me të tjerë, deri te përforsimi i besimeve radikale në “dhomën virtuale të jehonës” (Shane, Apuzo dhe Schmitt, 2015). Megjithatë, kontakti personal në botën jashtë rrjetit zë gjithashtu vënd të rëndësishëm në radikalizim, dhe arsyeja pse dhe mënyra se si krijohen këto lidhje duhet të informojë strategjitë për luftën kundër terrorizmit.

Sipas Oliver Roy-t, profesor në Institutin European në Itali dhe analist i mirënjohur i terrorizmit islamik, “Radikalizimi është revoltë e të rinjve kundër shoqërisë, e artikuluar në narrativën fetare islamike të xhihadit. Ai nuk është revoltë e komunitetit mysliman si viktimë e varfërisë dhe racizmit: vetëm të rinjtë bashkohen, përfshirë të konvertuarit që nuk kanë provuar “vuajtjet” e myslimanëve në Europë. Këta rebelë pa kauzë gjejnë te xhihadi një kauzë “fisnike” dhe globale, dhe për pasojë instrumentalizohen nga një organizatë radikale (Al Qaeda, ISIS), e cila ka agjendë strategjike” (Swanson, 2015).

Sipas Roy-t, qeveritë dhe shoqëritë, përveçse të rrisin kapacitetin e shërbimeve të inteligjencës “duhet të diskreditojnë mitin që terroristët radikalë janë heronj dhe të përmbysin idenë që shteti islamik është i suksesshëm dhe shpërfillës ndaj sulmeve tona. Për më tepër, duhet të mbështesim idenë që Islami është pjesë normale e shoqërisë, jo një

minoritetet e rrezikshëm ose i shtypur. Në vend që ta bëjmë të duket si diçka e pazakontë, duhet ta “normalizojmë”.

Të rinjtë dhe kultura e medias së re

Në qendër të problemit – thelbi emotiv – janë çështje të identitetit që prej kohësh i japin drejtim sjelljes së të rinjve”. ... hiq të gjitha ankesat dhe morinë e faktorëve të veçantë që mund ta shtyjë një individ t’i bashkohet një grupi ekstremist, dhe në themel do të gjeni çështje që lidhen me identitetin dhe përkatësinë. Asgjë nga këto nuk është e re”, thotë Shiraz Maher, studjues me përvojë në Qendrën Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit dhe Dhunës Politike (Maher, 2015).

Padyshim, komercializimi i identitetit të rinisë ka qenë prej kohësh fokusi i studimeve të shtrënjta e të panumërta si dhe i fushatave të marketingut, ku kompanitë në shënjestër të rinjtë në mënyrë që t’i mbajnë lidhur mbas filmave, televizionit, muzikës, telefonëve inteligjentë, aplikacioneve dhe platformave online, në përpjekje për t’u shitur mallrat e tyre – madje edhe duke i kontaktuar të rinjtë të japin informacion mbi kontaktet e “miqve” të tyre në mënyrë që edhe ata të mund të vihen në shënjestër nga korporata. As thirrja për të qenë të “veçantë” nuk është e re në arenën komerciale: Ju kujtohet fushata klasike e Apple-it në vitin 1997 që i këshillonte të rinjtë për të “Menduar Ndryshe”? (Hormby, 2013).

Sot, kooptimi i identitetit të të rinjve është spostuar drejt një fushe më të sofistikuar e për pasojë më ideologjike, ku vajzat flasin për të “lënë pas një shoqëri imorale në kërkim të virtytit fetar dhe kuptimit,” (Bennhold, 2015) dhe djemtë motivohen nga dëshira për të qenë heronj, për të ushtruar dhunë e për tu hakmarrë”. (Swanson, 2015). Gjithashtu faktor është edhe kontaminimi social, me sjellje të kopjuara që ndonjëherë rezultojnë në grupime shokësh të rinj dhe/ose familjarë që i bashkohen xhihadit. (Bennhold, 2015; Mate 2015). Kopjimi i sjelljeve shkatërruese, madje edhe vetëvrasëse, mes të rinjve nuk është gjë e re. Raste të dokumentuara të vetëvrasjeve të të rinjtë të nxitur nga media i gjejmë qysh herët në vitin 1774 në botimin e librit sensacional të Wolfgang von Goethe-s, “Vuajtjet e të riut Werther”. (Furedi 2015). Werther, personazhi kryesor i librit, vret veten me pistoletë mbasi u refuzua nga e dashura, dhe mbas publikimit të librit, pati një rritje të dukshme të numrit të të rinjve që kryenin vetëvrasje me të njëjtat mjete, gjë që solli një lloj epidemie sociale vetëvrasëse që u quajt “Efekti Werther”.

Në mënyrë të pamëshirshme dhe efektive, ISIS përdor ushtrinë e vet online në betejën globale për të fituar zemrat dhe mendjet, si kur rekruton luftëtarë që i përdor si mish për top në terren, po ashtu edhe gra për rekrutët e vet. ISIS ka mobilizuar një perandori të decentralizuar mediatike që mbështetet te pasuesit në gjithë botën për të shpërndarë mesazhe në të paktën një gjysmë duzine gjuhësh. (Stewart& Maremont, 2016). Qëllimi i përpjekjeve të ISIS-it është i frikshëm: Vetëm Twitter “fshiu në mars (2016) më shumë se 26,000 llogari të dyshuara të shtetit pro-Islamik, thuajse katër fishi i numrit që u fshi në shtator, sipas një analize të kryer për *Wall Street Journal* nga *Recorded Future, Inc.*, një kompani sigurimi kundër kërcënimeve me bazë në Somerville, Massachusetts. Nga analiza u gjet se Mbështetësit e Shtetit Islamik janë përpjekur të ruajnë ritmin duke hapur në mars (2016) më shumë se 21,000 llogari krahasuar me rreth 7,000 në shtator”.

Ndonëse shenjat online të “suksesit” të ISIS-it dhe të radikalëve të tjerë përfshijnë prerje koke, skllavërim të grave, spastrim të të krishterëve dhe minoriteteve të tjera etnike, si dhe akte të tjera fizike barbare të cilat të gjitha janë një litani mjaft e njohur e luftës, betejat e zhvilluara online përfaqësojnë përdorimin e teknologjive të reja dhe punësime strategjike që janë padyshim pjesë e luftës – me përjashtim që këtë herë lufta online është luftë për të cilën forcat ushtarake nuk janë të pajisuara mirë për tu ndeshur si në nivel global ashtu edhe lokal.

E megjithatë beteja duhet luftuar – dhe fituar – duke përdorur po ato teknologji, media dhe informacion që përdorin edhe radikalët. Gjithsesi, nuk mjafton të mbështetesh te Twitter, Facebook ose njësitë qeveritare të antiterrorit për të filtruar mesazhet e frymëzuara nga terroristët. Sipas të dhënave të inteligjencës të nxjerra nga Stratfor, një firmë globale konsulence e shërbimeve të inteligjencës: “Qytetarët e zakonshëm duke ushtruar ndërgjegjësimin e situatës kanë shpëtuar jetë... nuk është aspak realiste të presësh që qeveria të zbulojë dhe pengojë çdo komplot. Aktorët potencialë janë të shumtë dhe po aq individët e pambrojtur të vënë në shënjestër. Individëve u duhet të marrin përsipër përgjegjësi për sigurinë e vetes dhe të komunitetit të tyre. Kjo nuk do të thotë që të jetohej në frikë dhe paranojë, por bëhet fjalë që të jetohej në një nivel qetësie dhe ndërgjegjësimi për situatën, duke qenë i vetëdijshëm për rreziqet potenciale dhe i vëmendshëm për indikatorët që sinjalizojnë ata. Njerëzit që pranojnë përgjegjësitë dhe që praktikojnë këtë ndërgjegjësim janë mbrojtësit e vërtetë në terren” (Stewart, 2013).

Roli Alfabetizimit në Media dhe Informim

Sot nevoja për edukim me njohuri në media dhe informim (MIL) është bërë imperative në nivel global, duke qenë se ideologjia është në fokus të rekrutimeve xhihadiste dhe terroriste dhe “arma e tyre e preferuar” për rekrutime janë Interneti dhe mediat sociale.

Njësoj si shekuj më parë, beteja që bëjnë mbrojtësit në bazë duhet luftuar dhe fituar nga të rinjtë të cilët janë ata që “mbathin çizmet në terren”. Por këtë herë, këta të rinj duhen armatosur me të kuptuarit kritik të mediave që përdorin. Duke qenë se politikanët dhe gjeneralët nuk kanë kontroll të drejtpërdrejtë mbi veprimtaritë dhe operacionet online; ata duhet të mbështeten në zgjuarsinë dhe zemrat e të rinjve për të sjellë një optikë kritike mbi përfaqësimet dhe mesazhin rreth botës së tyre, si dhe rreziqeve për atë botë. “Çizmet në terren” tashmë përshkojnë botën virtuale e sërish ndeshen me një armik po aq kërcënues sa dhe ai që gjendet në fushën e betejës.

Në fshatin e sotëm global, media ofron një kulturë që ka shkuar përtej bluxhinseve dhe rock’n’roll-it. Sot, shpesh globalja dhe lokalja janë të shkruara me njëra-tjetrën, e megjithatë media globale përçon vlera, stile jetese ose këndvështrime që mund të mos jenë të pajtueshme me vlerat lokale. Ndonjëherë globalja dhe lokalja informojnë njëra-tjetrën dhe ndonjëherë jo; ndonjëherë kultura lokale influencon në interpretimin e medias globale; ndonjëherë media globale përshtatet me kulturën globale ose anasjelltas, kultura lokale influencon median globale. Shpesh të rinjtë janë pa timon, lundrojnë në universin online me shumë pak drejtim prej të rriturve ose pa një spirancë institucionale (Walkosz, Jolls dhe Sund, 2008). Përgatitja për të lundruar në fshatin global – duke i bërë të rinjtë të

kuptojnë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin, si dhe rëndësinë e sundimit të ligjit për lirinë dhe përparimin ekonomik – vjen në këtë arenë të re nëpërmjet edukimit me njohuri në media dhe informim.

Rinia i merr lajmet dhe informacionin kryesisht nëpërmjet tregjeve të tilla mediatike si YouTube ose Instagram, shpesh duke shpenzuar në media më shumë se tetë orë në ditë. (Common Sense Media, 2015) Në botën mediatike të imazheve të fuqishme, fjalëve dhe tingujve, media është kultura e rinisë.

Por megjithatë rinia ende ka nevojë për filtra për lloj-lloj qëllimesh, duke filluar nga siguria në internet deri për të patur aftësinë të zgjedhë burime të besueshme informacioni. Ata (dhe ne) kemi nevojë për një mendësi që të na shkojë me festen – një sistem të brendshëm filtrimi që mund të përdoret në çdo kohë, kurdoherë; të cilin e shkëmbejmë zakonisht me njëri-tjetrin; dhe që i kapërcen kufijtë kulturorë dhe kombëtarë. Truri ynë ka nevojë për algoritme, që t'i përdorë pasi ne edhe konsumojmë edhe prodhojmë media, e njëkohësisht marrim pjesë në një shoqëri të globalizuar.

Alfabetizimi në media dhe informim ofron mjete gjykimi dhe shprehjeje si mbrojtës ashtu edhe sulmues, për të mbështetur vlerat pozitive njerëzore dhe për aksion politik, si dhe për të njohur dhe lehtësuar mesazhet dhe ndikimet e dëmshme mediatike. Edukimi me MIL-in ka treguar prej kohësh se ai është një nga strategjitë më të suksesshme të ndërhyrjes për të minimizuar pasojat negative të medias dhe për të maksimalizuar ndikimin e tij pozitiv të besimit e fëmijëve, qëndrimet dhe sjelljet. Një shqyrtim i zgjeruar meta-analitik i studimeve të bëra në këtë fushë në më shumë se tre dekada ka zbuluar që ndërhyrjet me njohuri në media i kundërvihen efekteve mediatike të lidhura me sjelljet e rrezikshme dhe antisociale, duke përfshirë dhunën dhe agresionin, abuzimin me alkoolin dhe duhanin, çrregullimet me ushqimin dhe imazhin trupor gjithashtu edhe komercializmin (Jeong, Cho & Hwant, 2012). Veç kësaj, MIL-i ndikon pozitivisht mbi aftësitë e fëmijëve për të fituar dije, qëndrime dhe sjellje rreth natyrës së medias dhe ndikimit të saj, ndërgjegjësim ky i teknikave persuazive që përdoren për të ndikuar mbi audiencat, si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar se sa real është përfaqësimi në media.

Këto aftësi të MIL-it trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë profilin e radikalizimit online të përshkruar nga Shërbimet e Policimit të Departamentit të Shtetit të Orientuara përka Komuniteti:

“Në përgjithësi, kur individët zhyten në përmbajtjen ekstremiste online, fillojnë të zhvillojnë një sens të shtrembëruar të realitetit në të cilin pikëpamjet e tyre nuk duken më radikale. Ndërveprimet online me individë me mendësi të ngjashme mund të zëvendësojnë komunitetin fizik të një individi dhe të krijojnë një mjedis social online të ngjashëm me atë të një bande në të cilën sjellja e devijuar dhe dhuna janë normale. Konsumatorët e përmbajtjes ekstremiste online mund të zhvillojnë ose të rrisin gjithashtu ndjenja superioriteti, indinjate morale, desensitizimi të dhunës dhe vullnet për të kryer akte dhune për të çuar më tej një kauzë të veçantë” (Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë, 2014).

Edukimi i MIL-it e ka provuar veten si një strategji ndërhyrjeje efektive për parandalimin e dhunës: një studim i zgjeruar i kryer nga UCLA, (Fingar & Jolls, 2013) që vlerëson kurikulën e Qendrës për kornizën e Njohurive në Media dhe parandalimin e dhunës, *Përtej Fajësimit, Sfidimi i Dhunës në Media*, gjeti rezultate konkrete nga një ndërhyrje njohëse që i bënte thirrje të kuptuarit dhe të shprehurit kritik për nxënësit e

shkollave të arsimit tetëvjeçar. Studimi zbuloi se nxënësit ishin në gjendje të dallonin Katër Efektet e Dhunës në Media – agresion i shtuar ose imitim, sens më i lartë frike për sigurinë e vetes, pandjeshmëri karshi dhimbjes dhe vuajtjes së të tjerëve, dhe të mësuarit me situatën. Veç kësaj, ata dolën me besim më të fortë që dhuna në media i prek përdoruesit dhe që njerëzit mund ta mbrojnë veten duke e përdorur më pak atë. Raporti i agresivitetit i nxënësve gjatë kohës kur u zhvillua ky studim, dhe ndryshimet specifike në sjellje përfshinin konsumimin e më pak dhune në media nga nxënësit, më pak incidente me të shtyra e të goditura nxënësit e tjerë, ose kërcënime për të goditur e për të lënduar dikë.

E megjithatë, sikurse e deklarojnë vetë të rinjtë, edukimi me njohuri në media dhe informim vazhdon të mbetet një kërkesë ende e papërbushur brenda dhe jashtë klasave: 84% e të rinjve që morën pjesë në një studim të vitit 2012 raportonin që do të përfitonin nga mësimi se si të gjykojnë mbi kredibilitetin e asaj çfarë gjejnë online (Cohen & Kahne, 2012). Sa i saktë dhe faktik është ky informacion? Çfarë këndvështrimi në botë përfaqësohet? Kush dhe çfarë është lënë jashtë? Kush përfiton (ose jo), dhe si? A mund të bëhet gjë, ose a duhet bërë diçka? Cila është përgjegjësia jonë individuale dhe kolektive? Të bësh gjykime të tilla kërkon lexime tekstuale dhe kontekstuale që bazohen në kornizën etike të analizës dhe vlerësimit – dhe me median sociale dhe prodhimin mediatik, duke aplikuar këto korniza në përmbajtjen krijuese që e prodhojnë vetë të rinjtë.

Duke qenë se të gjitha mediat janë përfaqësime të ndërtuara nga një autor(ë) për një qëllim të caktuar, dhe për një audiencë të caktuar, Konceptet Thelbësorë të Njohurive në Media – njësoj si ligjet e gravitetit të Njutonit – përshkruajnë në mënyrë konsistente e sistematike se si janë formuar mediat në çdo zhanër e çdo herë. (Wilson & Jolls, 2015) Këto Koncepte Thelbësorë zbatohen si për zberthimin (leximin) gjithashtu edhe për formimin (të shkruarit) e medias. Ato janë themelore për të kuptuar median dhe për ta analizuar atë në mënyrë kritike si për konsumatorët ashtu edhe për prodhuesit e mesazheve mediatike, të cilët “paraqesin” ose riparaqesin realitetin për audiencat.

Për të thelluar eksplorimin e natyrës së Koncepteve Thelbësorë dhe përfaqësimit, Qendra për kornizën e Pyetjeve/Këshillave që lidhen me Alfabetizimin Mediatic është shembulli i një praktike të mbështetur në prova që mundëson procesin e kërkimit. Ky kërkim mund të aplikohet mbi çdo media, në çdo kohë, për të ngritur pikëpyetje mbi autorësinë e medias, qëllimin, teknikën, kornizimin e vlerave dhe paragjykimëve, si dhe shënjestrimin e audiencës (Jolls & Wilson, 2014) Duke aplikuar dhe praktikuar këtë proces kërkimi, përdoruesit e medias zhvillojnë një sistem të brendshëm filtrimi – ose deduktimi – që mund të përdoret për të gjykuar dhe marrë vendime informuese. Nga ana tjetër, kjo analizë është pjesë e procesit të vendimmarrjes së Ndërgjegjësimit, Analizës, Reflektimit dhe Aksionit – një Spirale Fuqizuese që ofron njëdeduktim bazë për të zberthyer hapat e ndjekur për të përcaktuar nëse duhet ndërmarrë ndonjë veprim ose jo.

Për shembull, kuptimi më i thellë dhe aplikimi i Konceptit Thelbësor #5, “Shumica e mesazheve në media janë organizuar për qëllime fitimi dhe/ose pushteti”, është në veçanti me rëndësi për të luftuar terrorizmin dhe xhihadizmin, pasi përdoruesit mund të inkurajohen për të zbuluar implikimet financiare ose ideologjike të mesazheve me të cilët kanë të bëjnë. Koncepti Thelbësor #4, “Media përfshin vlera dhe pikëpamje,” i ndihmon përdoruesit të shohin se si janë futur brenda një kornize mesazhet, për të vëzhguar se çfarë përmban ose transmeton një mesazh, dhe për të kuptuar stilet e jetës, vlerat dhe pikëpamjet që kontribuojnë te përmbajtja dhe paragjykimet e pashmangshme në mesazh.

Këto Koncepte ndihmojnë për të hedhur dritë në një proces kërkimi që mund t'i çojë përdoruesit e medias mjaft përtej kuptimit sipërfaqësor të mesazhit të bartur.

Një shembull që vë në përdorim këto Koncepte Thelbësore mund ta gjejmë në identifikimin e shkaqeve të zanafillës së Pranverës Arabe, e cila filloi në vitin 2010 kur një tunizian me emrin Mohamed Bouazizi i vuri flakën vetes dhe miliona njerëz dolën në rrugë në gjithë Lindjen e Mesme. Mediat e lajmeve raportuan fuqishëm mbi përdorimin e mediave sociale në demonstrata, por mediat sociale nuk ishin shkak në rrënjët e problemit që nxori njerëzit në rrugë: “Në fund të fundit, kushdo, mendoj unë, e kupton deri diku që kjo ka qenë gjithmonë një situatë dëshpërimi. Ata djemtë që dërguan mesazhe në Twitter dhe Facebook mund të kenë marrë shumë publicitet në Pranverën Arabe”, tha Hernando de Soto, themeluesi dhe drejtuesi i Institutit për Liri dhe Demokraci. “Njerëzit e kuptojnë që mediat sociale e bëjnë lajmin të udhëtojë më shpejt, por që substanca e lajmit vjen nga një vend tjetër. Me këtë nuk dua të them që unë besoj që shkaqet ekonomike janë shpjegimi i plotë për atë që ndodhi, por është elementi që mungon (në mbulimin që i bënë mediat lajmit)”. Diagnoza e DeSoto-s për shkaqet e revolucionit është që shitësit e vegjël si Mohamed Bouazizi nuk kanë të drejta mbi pronën dhe asnjë dëmshpërblim; kur qeveria u merr pronën, atyre nuk u mbetet asgjë; ata përballen me urinë në kuptimin e vërtetë të fjalës, pa asnjë të ardhme. U mbetet vetëm dëshpërimi. De Soto duhet ta dijë: ai është veteran i luftës kundër organizatës terroriste maoiste *Shining Path* në Peru, dhe instituti i tij ka bërë intervistime në thellësi dhe hulumtime mbi rrethanat e asaj çka ndodhi me Mohamed Bouazizin dhe 49 individë të tjerë të cilët u vetësakrifikuan brenda 60 ditëve të Bouazizit (McKinsey mbi Shoqërinë, 2016). Kur kupton qartë kontekstin e komenteve mediatike e gjithë situata merr kuptim krejt të ri.

Rekomandime: Dëgjojeni Thirrjen

Organizata të rëndësishme në gjithë globin kanë bërë thirrje për edukim me njohuri në media dhe informim. Komiteti i Këshillit të Sigurisë Kundër Terrorizmit i Kombeve të Bashkuara (Counter-oTerrorism Committee, 2016) ka bërë thirrje që t'i hapet udha zërit të grave dhe të rinisë... si dhe për hartimin e programeve të edukimit që promovojnë mendimin kritik dhe të kuptuarit e kulturave të tjera”. UNESCO mbështet prej kohësh njohuritë në media dhe dialogun ndërkulturor me anë të iniciativës së vet Njohuri në Media dhe Informim. Njëpërmjet Aleancës Globale të iniciuar nga UNESCO për Njohuri në Media dhe Informim (GAPMIL), kapituj aktivë janë duke punuar në drejtim të promovimit të MIL-it në gjithë botën. UNESCO nxori kohët e fundit botimin *Udhëzues për Mësuesin mbi Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm*, dhe trajton çështjen e “njohurive online në media” si mjet në ndihmë të “nxënësve për të përdorur internetin dhe mediat sociale në mënyrë të sigurt dhe efektive” (UNESCO, 2016). Një raport i madh strategjik (Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit dhe Dhunës Politike, 2009), i bën thirrje në mënyrë specifike qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar që të “fuqizojë komunitetet online” dhe të “redukojë thirrjet” për radikalizim, duke thënë që “më shumë vëmendje i duhet kushtuar njohurive në media, dhe nevojitet jashtëzakonisht shumë një qasje gjithëpërfshirëse në këtë fushë”. Në një raport të Aspen Institute me titull “Nxënësit në

Qendër të një Bote të Lidhur në Rrjet” (The Aspen Institute, 2014) ndonëse në fokus ishte kryesisht reforma në arsim, bëhej thirrje për alfabetizimin në media dhe rekomandonte që njohuritë socio/emocionale të ishin thelbi i edukimit, duke avokatuar për qasje edukative të përshtatshme për nevojat e shekullit të 21^{te}.

E megjithatë, politikanët dhe mediat e mëdha nuk i janë bashkuar kësaj thirrjeje: “Humnera midis klasës politike dhe njerëzve të thjeshtë të shoqërisë është jashtëzakonisht e gjerë”, sipas Forumit Botëror të Botuesve (Mukuka, 2016). “Po e tillë është edhe shkëputja e mediave kryesore nga njerëzit e zakonshëm, sidomos rinia”.

Gjithashtu edhe universitetet dhe tempuj të tjerë të mësimit kanë dështuar e nuk kanë arritur të vënë si prioritet edukimin me MIL: me erozionin e fjalës së lirë në shumë kampuse si dhe censurimin e përmbajtjes, shumë pak të rinj e kuptojnë që sulmi ndaj një personi mund të jetë për dikë tjetër shprehja e të vërtetës në pushtet (Gillman dhe Chemerinsky, 2016). Për fat të keq shkollat e edukimit universitar i kanë neglizhuar njohuritë në media dhe informim, e gjithashtu MIL-i nuk është aftësi që kërkohet për të fituar një certifikatë në mësimdhënie (ABCTE, 2016).

Kompanitë e teknologjisë nuk kërkojnë rritjen e mprehtësisë së përdoruesve nëpërmjet MIL-it: ndërkohë që produkti mediatik është demokratizuar nëpërmjet promovimit dhe përdorimit të mediave sociale, njohuritë në media dhe informim bëhen edhe më thelbësore në klimën mediatike ku algoritmet janë redaktorët e rinj që mund të kufizojnë aksesin e përdoruesve në informacion të rëndësishëm nëpërmjet censurës, dhe ku kompanitë sigurojnë fitime nga shitja e të dhënave personale, teksa përdorin përmbajtjen e përdoruesve si dhe preferencat dhe historitë online të tyre (Herbst, 2016).

Ndonëse raport mbas raporti praktikuesit në gjithë globin kanë shtruar udhën për të ofruar njohuri në media dhe informim – nga Deklarata e Grunwald-it në vitin 1982 (UNESCO, 1982) deri sot (The Aspen Institute, 2014; Cohen & Kahne, 2012; Hobbs 2010; Turner, *et.al* 2016), MIL-i mbetet i margjinalizuar si zgjidhje për problemet e rëndësishme të botës dhe si lëvizje për të cilën ia vlen inkurajimi dhe investimi. Ky neglizhim duhet t’i bëjë të ndjehen me turp udhëheqësit në gjithë botën, të cilët qëndrojnë duarkryq teksa qytetarëve u mungojnë aftësitë për t’u bërë ballë pikëpamjeve të rrezikshme për botën, si dhe gjithë të lara e të palara që media mban gjallë. “Njohuritë në media janë çështje për të cilën duhet të ngrihemi të gjithë në alarm. Duhet të zgjohemi”, thotë Kevin Stratton, përfaqësues republican, anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve në Utah (Stratton, 2015).

Alfabetizimi në media dhe informim i kapërcejnë kufijtë – si gjeografikisht ashtu edhe ato midis subjekteve dhe disiplinave – dhe sigurojnë një proces që shërben si katalizator për analiza, diskutime, krijim dhe pjesëmarrje (Wilson & Jolls, 2015) Nëpërmjet përdorimit të një kornize konsistente globale, është e mundur të projektohet një strategji koherente dhe e replikueshme e cila mund të matet dhe shkallëzohet. Ajo ofron një kundërstrategji strategjike në luftë kundër radikalizmit taktik dhe ekstremizmit që mund të aplikohet menjëherë dhe që ka demonstruar se është efektive për të fituar zemrat dhe mendjet kur aplikohet për qëllime pro sociale (Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit dhe Dhunës Politike, 2009).

Kjo qasje e orientuar kah edukimi me MIL e vendos besimin te gjykimi, vendimet dhe veprimet e individëve dhe komuniteteve. Ajo është qasje demokratike ku individët dhe grupet fuqizohen për të përdorur mjete për gjykim të shëndoshë dhe bindës që punojnë për përmbushjen e objektivave të veta. Ajo nuk është direktive ose nga lart poshtë; ajo

mbështetet mbi një proces hulumtimi që ngre pyetje rreth vlerave, motiveve dhe qëllimit; ajo siguron një sens pronësie dhe veprimi për vendime dhe aksione që individët mund të ndërmarrin si rezultat i vënies në punë të kompetencave të MIL-it në çdo fushë në fjalë.

Edukimi me MIL mund të kontribuojë për zgjidhjen e problemeve të përmasave globale që po ndodhin *tani*. Nevoja për edukim me njohuri në media dhe informim është urgjente. Dhe mbi të gjitha, në dritën e urgjencës së luftës kundër terrorizmit në rang global, trainimi dhe implementimi i programeve të MIL-it mund të bëhet në mënyrë eficiente e në kohën e duhur (Fingar & Jolls, 2013). Të mësosh për MIL-in nuk është një proces linear abstrakt – ai është një proces gjatë të cilit fitohet përvojë. Është parë se programet e trainimit për mësues që zgjasin më pak se një ditë janë efektive dhe sigurojnë themelet e edukimit në MIL (Fingar & Jolls, 2013). Gjithashtu, duke qenë se korniza e njohurive në media dhe informim mund të aplikohet te çdo mesazh, kudo dhe kurdoherë, përdorimi i një kornize të tillë është tejet fleksibël, i lëvizshme dhe në kohën e duhur. Aftësitë themelore të MIL-it janë të nevojshme si një platformë mbi të cilën të ndërtohen aftësitë qytetare, kompetencat për vendin e punës dhe të merren vendime të shëndetshme për jetën.

Rritja e ISIS-it dhe e grupeve të tjera ekstremiste është konfirmim i asaj që kemi thënë prej kohësh në edukimin për MIL: që përdorimi në mënyrë efektive i teknologjive të reja mediatike është më shumë se të mësosh të klikosh ose krijosh me një të prekur të gishtit. Steka është e lartë dhe të kuptuarit e natyrës dhe përdorimi i përfaqësimit nëpërmjet medias dhe njohurive në informim është thelbësor : “Mënyra si na shohin përcakton pjesërisht mënyrën se si na trajtojnë; mënyra si trajtojmë të tjerët bazohet në mënyrën se si i shohim ata; një perceptim i tillë vjen nga përfaqësimi.” (Dyer, 1993).

Mendjet, zemrat – dhe jetët – duhen fituar, në mënyrë të atillë që të bëjnë shembull vlerat universale njerëzore. Duhet të veprojmë tani.

Referenca

- American Board for the Certification of Teacher Excellence (ABCTE), (2016). How to Enroll to Become a Teacher. Marrë nga [http://abcte.org/teach/](http://abcte.org/teach) / Aspen Institute. (2014). Learner at the Center of a Networked World. Marrë nga <http://www.medialit.org/voices-media-literacy-international-pioneers-speak>
- Bennhold, K. (2015). Jihad and Girl Power: How ISIS Lured 3 London Cohen, C & Kahne, J., (2012). Participatory Politics, New Media and Youth Political Action. Marrë nga http://dmlcentral.net/wp-content/uploads/files/ypp_survey_body_cover.pdf Common Sense Media (2016). The Common Sense Census: Media Use by Tweens and Teens. Marrë nga https://www.commonensemedia.org/sites/default/files/uploads/research/census_research_report.pdf
- Counter Terrorism Committee (2015). Conclusions, Declaration and Guiding Principles on Stemming the Flow of Foreign Terrorist Fighters, U.S. Security Council Document. Marrë nga: http://www.un.org/en/sc/ctc/news/2016-02-04_S-2015-939_FTF.html
- Dyer, R. (1993, 2002). The Matter of Images: Essays on Representation. Routledge (London), p. 1.
- Fingar, K. R. and Jolls, T. (2013). Evaluation of a School-Based Violence Prevention Media Literacy Curriculum. Marrë nga <http://www.medialit.org/sites/default/files/Injury%20Prevention%20Journal%202013.pdf>
- Furedi, F. (2015). The Media's First Moral Panic. Marrë nga: <http://www.frankfuredi.com/article/the-medias-first-moral-panic>

- Gillman, H. and Chemerinsky, E. (2016). Don't Mock or Ignore Students' Lack of Support for Free Speech. Teach Them. Marrë nga: <http://www.latimes.com/opinion/op-ed/la-oechemerinsky-gillman-free-speech-on-campus-20160331-story.html>
- Girls. Marrë nga: http://www.nytimes.com/2015/08/18/world/europe/jihad-and-girlpower-how-isis-lured-3-london-teenagers.html?_r=0
- Herbst, J. (2016). The Algorithm Is an Editor. Marrë nga: <http://www.wsj.com/articles/the-algorithm-is-an-editor-1460585346>
- Hobbs, R. (2010). Digital and Media Literacy: A Plan of Action. Marrë nga: http://www.knightcomm.org/wp-content/uploads/2010/12/Digital_and_Media_Literacy_A_Plan_of_Action.pdf
- Hormby, T. (2013). Think Different: The Ad Campaign that Restored Apple's Reputation. Marrë nga: <http://lowendmac.com/2013/think-different-ad-campaign-restored-apples-reputation/>
- International Association of Chiefs of Police (2014). Awareness Brief: Online Radicalization to Violent Extremism. Marrë nga: [http://www.theiacp.org/portals/0/pdfs/Radicalization to Violent Extremism Awareness Brief.pdf](http://www.theiacp.org/portals/0/pdfs/Radicalization%20to%20Violent%20ExtremismAwarenessBrief.pdf)
- International Centre for the Study of Radicalisation and Political Violence (ICSR), (2014). British Values in the 21st Century. Marrë nga <http://icsr.info/projects/british-values-21st-century/>
- International Centre for the Study of Radicalisation and Political Violence (ICSR), (2009). Countering Online Radicalisation: A Strategy for Action. Marrë nga: https://cst.org.uk/docs/countering_online_radicalisation1.pdf
- Jeong, S.H., Cho, H., and Hwang, Y. (2012). Media literacy interventions: A meta-analytic review. *Journal of Communication*, 62 (3): 454–472.
- Jolls, T. (2015). The New Curriculum: Propelling the Growth of Media Literacy Education. Marrë nga: <http://digitalcommons.uri.edu/jmle/vol7/iss1/7/>
- Jolls, T. and Wilson, C. (2014). The Core Concepts: Fundamental to Media Literacy Yesterday, Today and Tomorrow. Marrë nga: <http://digitalcommons.uri.edu/jmle/vol6/iss2/6/>
- Maher, S. (2015). ICSR Insight: The Roots of Radicalisation? It's Identity, Stupid. Marrë nga: <http://icsr.info/2015/06/icsr-insight-roots-radicalisation-identity-stupid/>
- Mate, A. (2015). We Spoke to a Former Jihadist About How Young People Become Radicalized. Marrë nga: <http://www.vice.com/read/we-spoke-to-a-former-toronto-jihadist-about-how-young-people-are-radicalized>
- McKinsey on Society (2016). *The Rise of Social Movements: The Economic Roots of the Arab Spring*. Marrë nga: <http://voices.mckinseyonsociety.com/economic-roots-of-the-arab-spring/>
- Mukuka, J. (2016). *Panama Papers' leaks have revealed growing anger against elite – World Editors Forum*. Marrë nga: <http://www.postzambia.com/news.php?id=17137>
- Mullen, J. (2015). *What is Isis' Appeal for Young People?* Marrë nga: <http://www.cnn.com/2015/02/25/middleeast/isis-kids-propaganda/>
- Shane, S., Apuzzo, M., and Schmitt, E. (2015). *Americans Attracted to ISIS Find an Echo Chamber on Social Media*. Marrë nga: <http://www.nytimes.com/2015/12/09/us/americans-attracted-to-isis-find-anecho-chamber-on-social-media.html?action=click&contentCollection=Europe&module=RelatedCoverage®ion=EndOfArticle&pgtype=article>
- Soufan Group, (2015). *Foreign Fighters: An Updated Assessment of the Flow of Foreign Fighters into Syria and Iraq*. Marrë nga: http://soufangroup.com/wpcontent/uploads/2015/12/TSG_ForeignFightersUpdate3.pdf
- Stewart, C.S. and Maremont, M. (2016). *Twitter and Islamic State Deadlock on Social Media Battlefield*. Marrë nga: <http://www.wsj.com/articles/twitter-and-islamic-state-deadlock-on-social-media-battlefield-1460557045>
- Stewart, S. (2013). *Ordinary Citizens: The Last Line of Defense Against Terrorism*. Marrë nga: <https://www.stratfor.com/weekly/ordinary-citizens-last-line-defense-against-terrorism>

- Stratton, K. (2015). *Even Digital Natives Need Digital Training*. Marrë nga: <https://www.facebook.com/KevenJStratton/posts/978308012212895>
- Swanson, A. (2015). *Why Young People Become Jihadists, According to a Top Expert*. Marrë nga: <https://www.washingtonpost.com/news/wonk/wp/2015/12/18/why-young-people-become-jihadists-according-to-a-top-expert/>
- The Aspen Institute (2014). *Learner at the Center of a Networked World*. Marrë nga: <http://www.aspeninstitute.org/sites/default/files/content/docs/pubs/Learner-at-the-Centerof- a-Networked-World.pdf>
- UNESCO, (1982). *Grunwald Declaration*. Marrë nga: http://www.unesco.org/education/pdf/MEDIA_E.PDF
- UNESCO. (2016). *A Teacher's Guide to the Prevention of Violent Extremism*. (nuk është ende online)
- Von Behr, I., Reding, A., Edwards, C. and Gribbon, L. (2013). *Radicalisation in the Digital Era*. Marrë nga: http://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR400/RR453/RAND_RR453.pdf
- Walkosz, B., Jolls, T. and Sund, M.A. (2008). *Global/Local: Media Literacy for the Global Village*. Paper presented at the Ofcom International Media Literacy Research Forum Inaugural Meeting, London.
- Wilson, C. & Jolls, T. (2015). *Media and Information Literacy Education: Fundamentals for Global Teaching and Learning*. Marrë nga: http://milunesco.unaoc.org/wp-content/uploads/2015/07/milid_yearbook_20151.pdf.

Alfabetizimi në Media dhe Informim Kundër Urrejtjes Online, Përmbajtjes Radikale dhe Ektremiste

Disa Gjetje Paraprake në Lidhje me Rininë dhe një Projekt Kërkimor

Alton Grizzle & Jose Manuel Perez Tornero

Numri në rritje i sulmeve terroriste në botë, luftat dhe konfliktet, sidomos në Lindjen e Mesme dhe Afrikë, kanë tërhequr vëmendjen mbi fenomenin e radikalizimit dhe nxitjes për urrejtje, dhunës dhe ekstremizmit. Ka prova të mjaftueshme empirike për të theksuar lidhjen midis gjuhës së urrejtjes dhe fenomenit të radikalizimit. Është gjithashtu evidente që rritja eksponenciale e mediave sociale dhe e Internetit po çon në shumëfishimin e fenomenit dhe impaktit të tij. Megjithatë, nuk ka një konsensus të qartë mbi mënyrën si u duhet kundërvënë impakteve negative të gjuhës së urrejtjes online nëpërmjet një strategjie sistemike. Një gjë duket qartë, edukimi dhe ndërgjegjësimi mund t'i kundërvihen efekteve negative të gjuhës së urrejtjes. Në këtë kontekst, promovimi i njohurive në media dhe informim luan rol kritik.

Ky dokument prezanton disa zbulime paraprake të një hulumtimi mbi perspektivat e 614 femrave dhe meshkujve të rinj të moshës 14 deri 25 vjeç, rreth urrejtjes online dhe përmbajtjes radikale dhe ekstremiste. Kjo punë është pjesë e një studimi më të madh mbi reagimin e qytetarëve ndaj kompetencave për njohuri në media dhe informim, i cili angazhon mbi 2,000 të rinj dhe të reja nga 100 vende të ndryshme të botës dhe që ka filluar në vitin 2015. 61% e atyre që morën pjesë në sondazh raportojnë që janë ndeshur në mënyrë aksidentale me përmbajtje radikale dhe ekstremiste online. 14% dhanë përgjigje neutrale. 56% thonë që i injorojnë këto përmbajtje kur ndeshen me to. 56% e të intervistuarve kanë hasur urrejtje në Facebook, 14% në YouTube dhe këto pasohen nga Twitter me 8%. Ky dokument sugjeron disa implikime dhe veprime kyç.

Fjalëkyç: njohuri në media dhe informim, ekstremizëm i dhunshëm, pesë ligjet e njohurive në media dhe informim, gjuha e urrejtjes online, radikalizim online, urrejtje kibernetike, ekstremizëm, internet, media sociale.

Hyrje

Ka një konsensus të gjerë mbi faktin që “rritja eksponenciale e Internetit si mjet komunikimi ka shkuar krahas rritjes në numër të faqeve në internet të ekstremit të djathë dhe të grupeve ekstremiste, gjithashtu edhe të aktiviteteve me bazë urrejtjen në hapësirën kibernetike”. (Banks, 2010). Rrjetet e mediave sociale të tilla si Facebook kanë përjetuar vitet e fundit një rritje domethënëse. Në të njëjtën kohë, ka patur rritje të grupeve të radikalizuar që përdorin internetin si sistem për të promovuar radikalizimin e dhunshëm (Awan, 2016).

Ka një tendencë të qartë rritjeje. Në vitin 2009, Qendra Simon Wiesenthal nxori raportin e saj, Facebook, YouTube +: Si ndikon tregu i mediave sociale mbi terrorizmin dhe urrejtjen digjitale, i cili nxjerr në pah se “ka një rritje prej 25% krahasuar me vitin e kaluar në shtimin e grupeve “problematike” të rrjeteve sociale në Internet”. Raporti bazohej në “mbi 10,000 website problematike, grupe të rrjeteve sociale, portale, blogje, *chat rooms*, video dhe loja që përmbajnë urrejtje në Internet të cilat promovojnë dhunën raciale, antisemitizmin, homofobinë, muzikë që përmban urrejtje dhe terrorizëm”. (sikurse citohen nga Jaishankar, 2008). MediaSmarts, e cila pason një raport të ngjashëm të Qendrës Simon Wiesenthal në vitin 2012, tërheq vëmendjen në mbi 14,000 hapësira problematike online. Sipas raportit, “rrjetet sociale po bëhen gjithmonë e më shumë arma e preferuar e ... terroristëve dhe ka patur një rritje prej 12% të 14,000 websiteve problematike të rrjeteve sociale, forumeve, blogjeve, në twitter, etj”. Kjo ka shënuar rritje nga numri 11,500, që ishte në vitin 2011.

Në një studim të kryer nga Hawdon, et al (2015), afërsisht 53 % e amerikanëve, 48 % e finlandezëve dhe 39 % e britanikëve që morën pjesë në sondazh raportonin që ishin ndeshur online me përmbajtje që kishte brenda urrejtje. Ndërsa në Gjermani numri i atyre që raportonin se kishin ndeshur përmbajtje të tillë arrinte në 31 %.

Në të njëjtën kohë, studime të kohëve të fundit kanë treguar qartë që aksesit në përmbajtje “të përdorur për të stereotipizuar grupe (...) që përqëndrohet mbi racën ose etninë, është rritur. Ky fenomen ka impakt sidomos te të rinjtë (Costello, M., Haëdon, J., Ratliff, T., & Grantham, T., 2016 dhe Matti Näsi Pekka Räsänen James Hawdon Emma Holkeri Ate Oksanen, 2015).

Gjithashtu, ka patur qeveri dhe institucione ndërkombëtare të panumërta që janë përpjekur të rrisin ndërgjegjësimin dhe të përcaktojnë politika që t'i kundërvihen efekteve negative të gjuhës së urrejtjes online. Brenda këtij konteksti, duhet theksuar që janë bërë përpjekje nga UNESCO (Brannan, 2015), Bashkimi Europian (EC, 2016), Shtetet e Bashkuara dhe shumë qeveri të vendeve të ndryshme. Më poshtë janë trajtuar disa shembuj prej tyre.

Në Pakistan, në një përpjekje për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm, qeveria ka hartuar politika dhe ka marrë masa të reja për reformimin e sistemit arsimor, të sektorit të medias dhe sigurisë (Mirahmadi & Ziad, 2015). Qeveria miratoi të parën “Politikë Kombëtare të integruar për Sigurinë e Brendshme, e cila pranon rolin CVE të qeverisë civile, të ushtrisë, palëve të interesuara të shoqërisë civile (përfshirë udhëheqësit fetarë, institucionet edukative dhe median). [Mirahmadi & Ziad, 2015, f.5]” Një iniciativë frymëzuese në Pakistan, Zërat e të Rinjve: Ide Inovative mbi të Rinjtë dhe Ekstremizmin eksploronte radikalizimin e mënyrës së të menduarit të të rinjve, dhe

ekstremizmin e dhunshëm, shkaqet e tij, kompleksitetin dhe zgjidhjet sociale. Esetë, të shkruara nga të rinjtë pakistanezë, u gjykuan nga ekspertë gjatë një konkursi kombëtar eseistik. Një angazhim i tillë i të rinjve është i ngjashëm me gjetjet e sondazhit të bërë me të rinj të përshkruar në këtë material.

Zhvillimi i një agjende veprimtarish në Horn të Afrikës, përfshinte veprimtari të planifikuara me synim fuqizimin e shoqërisë civile, medias dhe sektorit privat. Ishte planifikuar suporti i profesionistëve të mediave me ekspertë për trainimin e tyre me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit në luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Qëllimi është frymëzimi i komunitetep nëpërmjet narrativave alternative dhe sporteve, arteve dhe programeve kulturore.

Strategjia Kundër Ekstremizmit në Mbretërinë e Bashkuar ka si qëllim të mbrojtë njerëzit nga dëmet që shkakton ekstremizmi. Ajo bazohet mbi një qasje të katërfishtë. Kjo mbulon luftën kundër ideologjisë ekstremiste; ngritjen e partneriteteve me të gjithë ata që i kundërvihen ekstremizmit; të pengohen përpjekjet e ekstremistëve për të krijuar ndarje dhe për t'iu kundërvënë sundimit të ligjit në komunitete; dhe për të ndërtuar komunitete më kohezive duke adresuar problemet e identitetit dhe përqaftimin e vlerave të përbashkëta.

Shumica e qeverive dhe e palëve ndërkombëtare të interesuara të angazhuara në luftën kundër urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit identifikojnë mediat sociale dhe hapësirat online si mjete primare në përdorim të grupeve radikale dhe ekstremiste. Sikurse vëren strategjia e Mbretërisë së Bashkuar, “Gjithmonë e më shumë ekstremistët përdorin në mënyrë të sofistikuar komunikimet moderne, përfshirë mediat sociale, për të përhapur ideologjitë e tyre ekstreme dhe për të tërhequr rekrutë në shifra të larta” (po aty f.11).

UNESCO po kontribuon për ndalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit në disa fronte. Organizata vëren, “Nuk mjafton t'i kundërvihesh ekstremizmit të dhunshëm – ne duhet ta parandalojmë atë, dhe kjo kërkon forma të “pushtetit të butë”, për parandalimin e një kërcënimi të udhëhequr nga interpretime të shtrembëruara të kulturës, urrejtjes dhe injorancës”. Iniciativa të kohëve të fundit të organizatës përfshijnë fuqizimin e të rinjve për të ndërtuar paqen dhe lançimin e Udhëzuesit të Parë për Mësuesit të UNESCO-s mbi Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm nëpërmjet edukimit. Në fushën e medias dhe të teknologjisë, UNESCO mbështet rolin e medias kundër ekstremizmit. Botimi “Në luftë kundër gjuhës së urrejtjes online” jep një vështrim të përgjithshëm të dinamikave që karakterizojnë gjuhën e urrejtjes online dhe disa nga masat që janë përshtatur për t'iu kundërvënë e për ta lehtësuar atë, duke theksuar praktikatat e mira që janë shfaqur në nivel lokal dhe global.

Në këtë kontekst, edhe pse nuk ka ende prova empirike, të gjithë e pranojnë që alfabetizimi dhe njohuritë në media dhe informim janë element kyç në luftë kundër gjuhës së urrejtjes online. Për shembull, Komisioni Europian pranon që është vendimtare “lufta kundër propagandës terroriste dhe gjuhës së urrejtjes online: duke luftuar kërcënimet, duke fuqizuar mendjet kritike dhe inkurajuar angazhimin e shoqërisë civile”. Dhe, në të njëjtën kohë, “duke mbështetur alfabetizimin mediatik: një Infrastruktura Shërbimesh Digjitale më e Sigurt në Internet, e financuar nga programi Të Bashkojmë Europën (Connecting Europe), u jep mundësinë Qendrave Kombëtare për Internet më të Sigurt të rrisin ndërgjegjësimin e fëmijëve, të prindërve dhe të mësuesve, për rreziqet me të cilat mund të ndeshen fëmijët online dhe për t'i bërë ata të aftë të përballen me këto rreziqe” (EC, 2016). Kjo përpjekje për njohuri në media dhe informim duhet aplikuar si në edukimin formal ashtu edhe atë informal. Arsimi i detyruar, sikurse dhe ai i të mësuarit gjatë gjithë jetës, duhet të përfshijë njohuritë në media dhe informim.

Megjithatë, nga këndvështrimi ynë, modalitetet edukative tradicionale dhe formale (klasat ballë për ballë, tekstet shkollore dhe provimet) nuk mjaftojnë për shkak të kufizimeve në fushën e tyre dhe ngadalësisë me të cilën përvetësohen. Duket se në botën virtuale ku jetojmë sot, është e nevojshme, kësisoj, të iniciojmë strategji edukative që përdorin mundësitë e reja që ofron web-i, si për shembull rrjetet dhe pajisjet e dorës. Është mjaft e qartë që të gjitha këto media të reja duhen përshtatur ose shfrytëzuar për të promovuar MIL-in. E vërteta është që përvojat në këtë fushë nuk janë të shumta dhe as nuk ka shumë studime mbi subjektin në fjalë. Në këtë kuptim, qëllimi i tekstit tonë është që t'i hapë udhën një projekti studimor që mundëson orkestrimin e veprimtarive kundër gjuhës së urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit online duke përdorur mundësinë që ofron për edukimin konteksti virtual.

Synimi i Projektit Kërkimor

Pikërisht në këtë sfond, ky materjal i bazuar mbi një studim që vazhdon ende, nxjerr në pah një qasje e cila do të kontribuojë me dije më empirike mbi përgjigjen e qytetarëve ndaj vështirësive personale, sociale, ekonomike, politike dhe kulturore, si dhe mundësitë në rrjet dhe jashtë tij mbasi të kenë përfetësuar kompetenca që lidhen me MIL-in nëpërmjet Massive Open Online Courses (MOOC).

Në këtë kontekst, është e nevojshme të hartohen metodologji që të masin impaktin dhe vlerësojnë përfitimet e kompetencave të përftuara nëpërmjet këtyre kurseve nga nxënësit. Në dritën e mungesës së hulumtimeve në këtë fushë dhe veçanërisht duke qenë se studimet longitudinale janë thuajse joekzistente, na duhet të hartojmë teknologji inovative për të njohur dhe vlerësuar ndërveprimin qytetar me kurset MIL në terma afat mesëm dhe afat gjatë.

Ky materjal përpiket të kontribuojë në hartimin e strategjive pedagogjike në mënyrë që të krijojë dhe prodhojë kurse online mbi MIL-in me orientim luftën kundër urrejtjes dhe lëndës radikale dhe ekstremiste online. Më poshtë janë disa prej çështjeve studimore mbi të cilat është punuar.

Çështje kyç të hulumtimit

1. A janë qëndrimet e qytetarëve karshi pjesëmarrjes/angazhimit në diskutimet dhe proceset qeverisëse demokratike, mbi çështje të tilla si liria e shprehjes, liria e informimit, media cilësore, barazia gjinore dhe privatësia, dialogu ndërkulturor dhe ndërfetar, dhe ekspozimi me urrejtjen online, përmbajtjen radikale dhe ekstremiste në rrjet dhe jashtë tij konsekuenca të ndryshme të kompetencave të MIL-it?
2. Si i përgjigjen qytetarët nevojave personale studimore në dritën e kompetencave të MIL-it dhe a bëhen ata më kritikë ndaj informacionit dhe përmbajtjes mediatike?
3. A janë përgjigjet e qytetarëve për MIL-in të reflektuara në qëndrime të posaçme kundrejt dialogut kulturor, respektit për dallimet, qytetarisë globale dhe promovimit të paqes?

4. Cili është dizajni më efektiv për MIL-in në kurset online?
5. Si i përgjigjen nxënësit kurseve të ndryshme online për dizajne të ndryshme?
6. Cilat janë ndryshimet më të rëndësishme që një kurs online mund të provokojë mbi studentët?
7. Si mund të matet dhe vlerësohet impakti i kurseve online të MIL-it?

Hipoteza

Mbasi të njihen me kurset online të MIL-it pjesëmarrësit do të përmirësojnë qëndrimin në përgjithësi të tyre si qytetarë që zotërojnë një nivel të caktuar aftësish në MIL.

Ky ndryshim në qëndrim do t'i bëjë ata t'i përgjigjen ndryshe vështirësive personale, sociale, ekonomike, politike dhe kulturore, gjithashtu edhe mundësive në rrjet dhe jashtë tij.

Një Metodologji e Hulumtimit Paraprak

Dizajni i hulumtimit

Studimi vazhdon. Ai arrin të kombinojë qasje sasiore dhe cilësore të cilat do të përfshijnë elementë të kuazi-eksperimentit.

Metodologjia përfshin dy lloj detyrash:

- Dizenjimi dhe krijimi i kurseve online
- Vlerësimi dhe analiza e përgjigjes qytetare për kompetencat MIL të arritura e gjithashtu për përgjigjet e tyre ndaj dizajneve të ndryshëm të kurseve online.

Për hartimin e kurseve studjuesit përdorin **Metodologjinë e Projektimit Didaktik dhe burime multimodale** (Chen dhe Williams, 2009).

Për të vlerësuar dhe analizuar impaktin, aplikohen **qasje sasiore dhe cilësore**. Këto qasje përfshijnë:

- Sondazh online
- Ditarë dhe detyra
- Forum diskutimi
- Intervistë në thellësi
- Grupe fokusimi
- Metodë hulumtimi bazuar në veprimtari etnografike/hulumtim pjesëmarrës

- Analizë e debatit

Hulumtimi është një studim rreth reagimit qytetare ndaj aftësive të MIL-it. Ai frymëzohet nga studime të ngjashme longitudinale të kryera nga studjues si Hobbs dhe Frost (2003); Quin dhe McMahon (1995) dhe Cheung (2011) por me fokuse të ndryshëm. Hulumtimi përfshin vlerësimin e kompetencave bazike në MIL për dy grupe të veçanta të rinjsh [*Grupi 1 i Trajtimit dhe Grupi 2 i Trajtimit*] (kursi paraprak) dhe qëndrimin e tyre kundrejt vështirësive të përzgjedhura sociale dhe politike gjithashtu edhe oportuniteteve. Më pas ata do të trajnohen në MIL nëpërmjet kurseve masive të hapur online të dizajneve të ndryshëm (*Ndërhyrja 1 dhe Ndërhyrja 2*). Përgjigjet e tyre lidhur me përvetësimin e këtyre aftësive do të vlerësohen (post-kursi, Shih Figurën 1 më poshtë). Duke përdorur një qasje studimore me panel, studimi përfshin dy grupe të tjera të rinjsh nga po e njëjta popullsi (*Grupi i Kontrollit 1 dhe Grupi i Kontrollit 2*, në momente kohore të ndryshme. Paneli studimor do të krahasohet me studimin e tendencës (shih Tabelën 1 më poshtë).

Figura 1




Tabela 1

Grupi studimor	Veprimi 1	Veprimi 2	Veprimi 3	Krahasimi i
<i>Grupi 1 i Trajtimit</i>	Sondazhi i kursit paraprak	Ndërhyrja 1 (MIL MOOC 1)	Sondazhi i post-kursit	Përgjigjet përpara dhe pas kursit + testi për validitetin e brendshëm.
<i>Grupi i Panelit 1</i>	Instanca 1 e sondazhit	-	Instanca 2 e sondazhit	Përgjigjet nga të dyja instancat + testi për validitetin e brendshëm
Krahasimi				

<i>Grupi 2 i Trajtimimit</i>	Sondazhi i kursit paraprak	Ndërhyrja 2 (MIL MOOC 2)	Sondazhi i post-kursit	Përgjigjet para dhe pas kursit + testi për validitetin e brendshëm
<i>Grupi i Panelit 2</i>	Instanca 1 e sondazhit		Instanca 2 e sondazhit	Përgjigjet nga të dyja instancat + testi për validitetin e brendshëm

Pyetësoi paraprak i kursit përpiket të sigurohet për nivelin e aftësive në MIL të qytetarëve të përfshirë dhe qëndrimet e tyre karshi çështjeve të përzgjedhura sociale, personale, politike dhe kulturore sikurse është theksuar në pyetësoin relevant studimor. Ai administrohet duke përdorur një instrument të sondazhit online të dizajnuar nga studjuesit.

Sondazhi i mbas kursit bëhet duke përdorur të njëjtin instrument sondazhi. Sondazhi mbas kursit do të aplikohet tre herë përgjatë një periudhe tetë vjeçare me kampione të njëjtë reaguesish për të konstatuar ndryshimet në përgjigjet e tyre me kalimin e kohës. Veç kësaj, ai do të vlerësojë përgjigjet e qytetarëve për dizajne të ndryshme modalitetesh të kurseve online të MIL-it.

Administrimi i kurseve bëhet nga universitetet. Studjuesit ishin pjesë e një ekipi që hartoi Ndërhyrjen MIL MOOC 1 dhe që morën pjesë si mësues dhe tutorë në kurse. Dizajni didaktik i kurseve ofronte dimensione relevante të përshkruara në pyetjet e studimit.

Ndërhyrja 1 (MIL MOOC 1) u administrua mbi platformën e Universitetit Athabasca. Ndërhyrja 2 (MIL MOOC 2) do të administrohet nga Universiteti Autonom i Barcelonës. Ai është bërë gati dhe është ridizenjim i MIL MOOC 1-it bazuar në mendimet e pjesëmarrësve të Grupit 1 të Trajtimimit. Të dyja Ndërhyrjet janë bazuar në konceptualizimin e MIL-it si një koncept i përbërë, ashtu sikurse është përkrahur nga UNESCO, dhe kanë një bazë të përbashkët kurikulare. Megjithatë, mediat e ndryshme dhe mjetet e përdorura do të bëjnë të mundur analizën e impakteve të ndryshme të diversitetit të dizajnit pedagogjik.

Dizenjimi i kampionëve

Studjuesit përdorën një kombinim të përzgjedhjes së paramenduar ose të qëllimshme të kampionëve me përzgjedhjen rastësore. Studjuesit parashikuan vështirësinë potenciale për të gjetur dhe lokalizuar pjesëmarrës për vlerësimet e ardhshme, gjë që është thelbësore për këtë studim. Kësisoj, në procesin e rekrutimit, përkatësia institucionale e pjesëmarrësve eksplorohet duke kontaktuar organizata që punojnë me të rinjtë, që do të rekomandojnë persona të cilët kanë më shumë gjasa të ruajnë kontaktet me organizatën përgjatë kohës që do të zhvillohet studimi (përzgjedhja e paramenduar e kampionëve). Veç kësaj, sondazhi dhe Ndërhyrja (MIL MOOC) iu promovua rrjeteve të të rinjve, organizatave dhe rrjeteve të lidhura me MIL-in në nivel global. Kjo kishte si synim t'i vinte në ndihmë gjetjes së pjesëmarrësve për një periudhë kohore relativisht të gjatë. Organizatave do t'u kërkohet gjithashtu të asistojnë dhe të angazhohen në të gjithë procesin e studimit.

Përzgjedhja rastësore e kampionëve do të përdoret për aspektet në vijim të studimit, të tilla si intervista në thellësi dhe grupet fokus me pjesëmarrës. Një element i përzgjedhjes së qëllimshme të kampionëve do të vazhdojë të përdoret për të siguruar një përzjerje të balancuar të pjesëmarrësve me shkallë të ndryshme angazhimi në Ndërhyrje dhe mundësisht nga rajone të ndryshëm.

Studjuesit janë të vetëdijshëm që “hulumtimi eksperimental” kontestohet në shumë qarqe, duke patur parasysh konotacionin psikologjik, nxjerrjen e njerëzve nga mjedisi i tyre dhe nënshtrimi i tyre ndaj mjediseve “eksperimentale” të “testit” si në laborator. Gjithashtu, studimet për “ndryshimet në sjellje” janë tejet të debatuar, pasi edhe ato shihen tejet si psikologjike dhe kërkojnë observim të drejtpërdrejtë.

Për të trajtuar këto shqetësime, studimi u bë në kontekstin e ndryshimit social, duke pranuar që individët dhe organizatat ekzistojnë brenda një shoqërie të madhe dhe ndikohen nga shumë faktorë të jashtëm. Pikërisht për këtë arsye sondazhi do të përdoret për të vlerësuar përgjigjet e pjesëmarrësve ndaj problemeve socio-politike. Këto përgjigje mund të mos kenë lidhje domosdoshmërisht me sjelljen. Zgjedhja e një dizajni quasi-eksperimental do të ofrojë në përgjithësi më pak kontroll, që do të thotë vlefshmëri e brendshme më e ulët dhe mundëson një mjedis/qasje më të përafërt me jetën e vërtetë, e cila nënkupton vlefshmëri më të lartë të jashtme (Kamerer, 2013). Veç kësaj, studimi plotëson aspektin quasi-eksperimental (sasior) me një metodologji cilësore si grupet fokus dhe qasjet e bazuara në veprimin etnografik (EABA) ose studimin pjesëmarrës, intervistat dhe analizën e debateve. Figura 2 përmbledh EABA-n që është përdorur në këtë studim.

Figura 2



Përshtatur nga Manuali i Studimit të Veprimtarisë Etnografike, UNESCO 2003.

Pjesëmarrësit u ftuan për të marrë një vendim të vetëdijshëm për t'u angazhuar në këtë kurs dhe studim; për t'u angazhuar vërtetë në kursin dhe veprimtaritë e tij në një periudhë kohore 2-3 mujore; për të reflektuar mbi **angazhimin/veprimtarinë** e tyre; dhe për të dokumentuar mendimet e veta, përvojat dhe mundësisht veprimin e tyre personal ose të shtyrë nga grupi (përgjigjet) si pasojë e angazhimit të tyre në proces. Ky proces pjesëmarrës është ndihmuar si më poshtë:

- Studjuesi kryesor bashkë me ekspertët dhe praktikuesit e tjerë, shërben si një nga tutorët për **vëzhgimin pjesëmarrës**;
- Studjuesit ngrënë dhe moderojnë forumin e diskutimit dhe shkëmbimit ndërkulturor nga pjesëmarrësit, duke mundur reflektimin dhe dokumentimin e **angazhimit/veprimit vetjak ose të shtyrë nga grupi** (përgjigjet). Forumi i parë i diskutimit lidhet me MIL MOOC 1. Kjo ofron gjithashtu mundësi për vëzhgim pjesëmarrës nga ana e studjuesve;
- Studjuesit dizenojnë një mjet në formën e një ditari “privat” për të gjithë pjesëmarrësit (ata bien dakord që t’u japin studjuesve ditarët në përfundim të çdo moduli për të marrë shpërblime për pikët suplementare deri në notën finale);
- Pjesëmarrësit e rinj në moshë ftohen të plotësojnë quizze, detyra dhe projekte.

Përshkrimi i mjetit kryesor të studimit dhe përgjigjet nga Grupi 1 i Trajtimit


Mjeti kryesor i studimit është një sondazh me mbi 200 variabla të cilët mbulojnë 8 tematika: lirinë e shprehjes, lirinë e informimit, dialogun ndërkulturor, dialogun ndërfaqetor, median cilësore, barazinë gjinore, privatësinë si dhe materialet radikale dhe ekstremiste online që përmbajnë gjithashtu edhe urrejtje. Tematika e tetë, përmbajtja radikale, ekstremiste online e mbushur me urrejtje, e cila është edhe subjekt i këtij materiali u plotësua në mënyrë anonime nga pjesëmarrësit për të mbrojtur identitetin e tyre.

Në trajnim u angazhuan mbi 2,000 të rinj nga 120 vende të ndryshme. Pjesëmarrësit ishin të moshave nga 14 në 25 vjeç. Pyetësi u plotësua nga 1735 persona në moshë të re. Nga ky numër, 614 të rinj plotësuan në mënyrë anonime seksionin mbi përmbajtjen radikale, ekstremiste dhe me urrejtje online. Si rrjedhojë e plotësimit anonim të tematikës së referencës, të dhënat demografike të paraqitura më poshtë bazohen mbi 1735 të rinj që plotësuan pyetësin e përgjithshëm.

Përmbledhje e gjetjeve – bazuar në pyetësin përpara kursit (Seksioni mbi Perspektivën e të Rinjve mbi përmbajtjen radikale dhe ekstremiste online që përmban urrejtje)


Është e nevojshme të ritheksojmë këtu që informacioni demografik dhe informacioni tjetër i përgjithshëm që ka të bëjë me pjesëmarrësit siç paraqitet në Figurat 1 – 5 janë ekstrakte nga një listë më gjithëpërfshirëse pyetjesh në mënyrë që të jemi koncizë në këtë prezantim paraprak të gjetjeve. Ato bazohen te të rinjtë që kanë plotësuar pyetësin e përgjithshëm dhe jo vetëm seksionin që lidhet me përgjigjet e tyre për përmbajtjen radikale dhe ekstremiste online që përmban urrejtje. Kësisoj ne thjesht po nxjerrim më pas në pah këto të dhëna demografike mbi kampionin që plotësoi në të vërtetë seksionin e referencës së pyetësit në mënyrë anonime.

Figura 3




57% nga 1735 pjesëmarrës janë femra, dhe 43% janë meshkuj. Kjo tregon nivel thuajse të barabartë interesi midis vajzave dhe djemve të rinj mbi temën e njohurive në media dhe informim, rëndësinë e tyre në debatet sociale dhe demokratike si dhe angazhimin kritik qytetar.

Figura 4




41% e pjesëmarrësve në pyetësorin e përgjithshëm janë në shkollë. 27% janë në punë. 23% janë edhe në shkollë edhe punojnë ndërsa 9% as nuk janë në shkollë dhe as punojnë. Të rinjtë ndërveprojnë me mediat dhe teknologjinë pavarësisht nga statusi dhe niveli i tyre arsimor.

Figura 5




31% e pjesëmarrësve kishin diplomë të shkollës së mesme. 49% kishin diplomë universitare të nivelit të parë, 19 çerftikatë/diplomë, 16% master, ndërsa 1% kishte PhD.

Figura 6




54% e të rinjve në këtë studim nuk kishin kryer asnjë kurs lidhur me njohuritë në media dhe informim. 15% kishin bërë më parë kurse në lidhje me aftësitë TIK/njohuri digjitale ndërsa 25% kishin ndjekur një kurs për njohuri informimi, njohuri mediatike ose njohuri në media dhe informim.

Figura 7




63% e të rinjve që morën pjesë në sondazh nuk kishin ndjekur më parë asnjë kurs online. Ky është tregues i shtrirjes potenciale të Kurseve të Hapura Masive mbi MIL-in që kanë në shënjestër të rinjtë.

Figura 8




41% dhe 35% nga 614 pjesëmarrës që plotësuan seksionin mbi urrejtjen online dhe përmbajtjen radikale dhe ekstremiste ishin fuqimisht kundër që grupet radikale ose ekstremiste të kenë lirinë të postojnë përmbajtje online që synon radikalizimin e të tjerëve. 14 përqind ishin neutralë mbi këtë pozicion ndërsa 7% ishin dakord. Dy vendet e fundit të të dhënave së bashku kapin shifrën 21% të të rinjve bashkë edhe me një numër të konsiderueshëm, të cilët ose nuk janë të sigurt nëse liri të tilla duhen lejuar, nuk u intereson, ose janë dakord që grupet radikale dhe ekstremiste të kenë edhe ato të drejtën të mos censurohen. Këtu janë disa nënkuptime për mënyrën se si të rinjtë mund ta shohin censurimin e përmbajtjes radikale dhe ekstremiste si rrezik potencial që mund të çojë në forma dhe nivele të tjera censure.

Figura 9



Në figurën 9, 9.37% e të rinjve që morën pjesë në sondazh refuzuan fuqishëm ose refuzuan që shohin përmbajtje radikale dhe ekstremiste online. 19% dhanë përgjigje neutrale dhe 41% pranuan që ndonjëherë kanë parë përmbajtje ekstremiste online.

Figura 10




70% e të rinjve që morën pjesë në sondazh pranonin që ishin ndeshur aksidentalisht video ose materiale të postuara nga grupe radikale dhe ekstremiste. 13% dhanë përgjigje neutrale për këtë pozicion. 25% e kundërshtuan deri diku ose fort. Është e qartë që shumica e të rinjve me akses në Internet në të vërtetë shohin/lexojnë/dëgjojnë përmbajtje radikale dhe ekstremiste. Ndonëse këto raportohen si të rastisshme, mbetet ende sfidë mënyra se si mund ta reduktojmë këtë kërkesë nëpërmjet njohurive në media dhe informim.

Figura 11




Me të rënë veli i ekspozimit aksidental pjesëmarrësit ishin më pak të prirur të pranonin se shpërndanin video dhe materiale të postuara nga grupet ekstremiste. Shumica e tyre, 76%, e kundërshtonin këtë, 11% zgjodhën të mos prononcohen qoftë me një përgjigje neutrale qoftë duke mos u përgjigjur. Pavarësisht faktit që pyetësi ishte plotësuar nëanonimitet të plotë, vetëm 8% e të rinjve që morën pjesë në sondazh pranuan menjëherë që kishin shpërndarë përmbajtje të tilla. Këtu mund të nënkuptohet një element frike ose reperkursioni.

Figura 12




Më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar, pavarësisht nivelit arsimor, nuk dinë t'i përgjigjen urrejtjes dhe materialeve ekstremiste me të cilat ndeshen online - 54% (6% kundërshtojnë fuqishëm, 17% nuk janë dakord, dhe 31% janë neutral). Këtu qëndron pikërisht prova për të mbështetur nevojën urgjente për edukim mbi këtë tematikë. 44% e të rinjve janë të mendmi se dinë se si t'i përgjigjen urrejtjes dhe përmbajtjes ekstremiste online.

Figura 13




Pyetja e mësipërme është me natyrë hipotetike. Ajo kërkon të sqarojë se çfarë do të bënin të rinjtë në vend të asaj që bëjnë aktualisht kur ndeshen me përmbajtje radikale dhe ekstremiste online. E megjithatë gjetjet janë të rëndësishme. Në qoftë se krahasojmë gjetjet e Figurës 10 me ato të Figurës 13, do të vinim re disa konfirmime rreth njohurisë së të rinjve mbi mënyrën se si t'i përgjigjen përmbajtjes radikale dhe ekstremiste online. 56% e të rinjve që morën pjesë në sondazh thanë që do t'i injoronin, 10% që do t'ua shpërndanin miqve dhe 7% do të postonin komente negative duke sulmuar personin që kishte postuar materjalin e urryer.

Figura 14




Facebook është platforma ku të rinjtë ndeshen më shpesh “aksidentalisht” me gjuhën e urrejtjes. Këtë përgjigje e kanë dhënë 56% e të rinjve. Ky pasohet nga YouTube me 14%, faqet e rrjeteve të lajmeve me 9% dhe Twitter me 8%. Hapësirat e mediave sociale janë vendi ku të rinjtë përjetojnë më shumë urrejtje dhe material radikal.

Figura 15




Njësoj si pyetjet e tjera më sipër, në disa raste përqindja e përgjigjeve lidhet me mundësinë e përzgjedhjeve të shumëfishta. Bazuar në perspektivat e të rinjve që marrin pjesë në sondazh, presioni i moshatarëve (44%), kërkimi i identitetit (35%), kurioziteti dhe eksitimi (28% dhe 29%), si dhe dëshira për të qenë ndryshe (27%) qëndrojnë më lart midis arsyeve pse të rinjtë mund të tërhiqen drejt urrejtjes dhe përmbajtjes ekstremiste online.

Figura 16




Bazuar në perspektivat e të rinjve, në figurën 14 ka një grup të qartë përgjigjesh dhe treguesish të shumëllojshmërisë, ndërlihdshmërisë dhe kompleksitetit të faktorëve që çojnë të rinjtë drejt radikalizimit dhe ekstremizmit. Feja, çështjet kulturore, keqinformimi, pabarazitë, urrejtja dhe diskriminimi ishin arsyet më të shpeshta të cituara sipas rradhës së rëndësisë. *E kësajsoj është përsëri një grup i qartë përgjigjesh njësoj si në rastin e pyetjes përkatëse në Figurën 15.*

Figura 17




Gjysma e të rinjve që u pyetën, 50%, thanë se besonin se i kishin kompetencat për tu futur te mesazhet e transmetuara në videot ekstremiste dhe materrialin online. Një numër pak më i vogël se gjysma, 45%, ishin ose neutralë ose jo dakord ose shumë kundër pohimit që zotëronin të tilla kompetenca. Këtu del në dritë aplikimi i trainimit në MIL.

Figura 18



68% e të rinjve të pyetur treguan se ishin dakord me propozimin që interneti ofron më shumë mundësi për përhapjen e urrejtjes dhe ekstremizmit se sa mundësi për t'iu kundërvënë atyre. 17% ishin neutralë dhe 12% thanë se nuk ishin dakord me një propozim të tillë. Kjo ka implikime serioze përse i përket pozicionit të MIL-it për fuqizimin krahasuar me mbrojtjen; nëse interneti ofron më shumë mundësi qoftë për mirë qoftë për keq.

Figura 19



Shumica dërrmuese e të rinjve të pyetur, 92%, përqaftuan idenë që aftësitë e fituara me alfabetizimin në media dhe informim mund t'i fuqizojnë të rinjtë për të mbrojtur veten nga grupet radikale dhe ekstremiste dhe për t'iu kundërpërgjigjur gjuhës së urrejtjes online.

Përmbledhje e gjetjeve, rekomandime dhe konkluzione

Gjetje paraprake

- 54% e të rinjve në këtë studim nuk kishin kryer ndonjë kurs në lidhje me alfabetizimin në media dhe informim
- 63% e të rinjve të pyetur nuk kishin ndjekur asnjëherë më parë ndonjë kurs online
- 41% dhe 35% nga 614 të intervistuar që plotësuan seksionin mbi urrejtjen online dhe përmbajtjen radikale ekstremiste, nuk ishin dakord me pohimin që grupet radikale dhe ekstremiste të kenë lirinë të postojnë lëndë online.
- 41% e pranonin ose e pthonin fort që ndonjëherë kishin parë ose lexuar online materjale ekstremiste
- 70% e të rinjve të pyetur janë shumë dakord ose pranojnë pohimin që janë ndeshur aksidentalisht me video ose materjale të postuara nga grupe radikale dhe ekstremiste

- Më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar, pavarësisht nivelit arsimor, raportojnë që nuk dinë si t'i përgjigjen urrejtjes dhe materjaleve ekstremiste me të cilat ndeshen online - 54%
- 56% e të rinjve të pyetur thanë që do të injoronin, 10% që do të t'ua tregojnë miqve, dhe 7% do të postojnë komente negative duke sulmuar personin që kishte postuar materjal të mbushur me urrejtje.
- Presioni i shokëve (44%), në kërkim të identitetit (35%), janë ndër arsyet më të shpeshta pse të rinjtë mund të tërhiqen drejt urrejtjes dhe përmbajtjes ekstremiste online.
- Feja, çështjet kulturore, keqinformimi, pabarazitë, urrejtja dhe diskriminimi ishin arsyet më të shpeshta të cituara nga të rinjtë, sipas rradhës së rëndësisë së asaj që i çon të rinjtë drejt radikalizimit dhe ekstremizmit.
- 68% e të rinjve të intervistuar besojnë që Interneti ofron më shumë mundësi për përhapjen e urrejtjes dhe ekstremizmit se sa mundësi për ta luftuar atë.
- 92% e të rinjve përqafonin idenë që aftësitë e fituara prej njohurive në media dhe informim mund të ndihmojnë për të fuqizuar të rinjtë që të mbrojnë veten nga grupet radikale ekstremiste dhe për t'iu kundërvënë gjuhës së urrejtjes online.

Është pra mjaft e qartë që nevojitet në mënyrë urgjente më shumë edukim për të mësuar se si i duhet dhënë përgjigje urrejtjes dhe përmbajtjes radikale dhe ekstremiste online. Një ndërhyrje e tillë duhet të ketë në shënjestër në mënyrë të veçantë të rinjtë. Megjithatë, konceptualizimi, dizajni dhe implementimi i ndërhyrjes edukative nuk duhet bazuar vetëm mbi këshillimin me ekspertë dhe lidërsipin. Duke patur parasysh informacionin e pasur të marrë nga të rinjtë mbi dijet e tyre, qëndrimin dhe praktikën online kur ndeshen me urrejtje dhe përmbajtje radikale e ekstremiste, ata duhen angazhuar në mënyrë kritike në dizajnimin dhe përhapjen e iniciativave që lidhen me edukimin. Termi edukim përdoret gjerësisht dhe mbulon aksione dhe aktorë brenda dhe jashtë shkollës që përfshijnë disiplina të shumfishta, rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen në mjedise informale, hapësira komunitare e gjithashtu online.

Në këtë kontekst, rritja e efikasitetit të ndërhyrjeve të zhvillimit për të ndaluar urrejtjen, radikalizimin dhe ekstremizmin online duhet të bëhet pika fokale. Për ta arritur këtë, duhen gritur ura të forta që të lidhin njohuritë në media dhe informim, kompetencat ndërkulturore dhe ndërfetare, edukimin për qytetari globale dhe edukim bazë. Qasjet me fokus më të ngushtë mund të shërbejnë për të rritur ndërgjegjësimin, por nuk arrijnë të çojnë në përfitim të dijeve, aftësive dhe sjelljeve të nevojshme për t'u dhënë fuqi njerëzve të hidhen në veprim për të sjellë ndryshimin.

Të rinjtë janë të ekpozuar ndaj urrejtjes, dhe përmbajtjes radikale dhe ekstremiste online si në mënyrë të qëllimshme ashtu edhe aksidentalisht. Mediat sociale janë hapësira ku dominon një ekspozim i tillë. Kësisoj, kundërmasat duhen rritur gjithashtu edhe në mediat sociale dhe jo vetëm në hapësirat tradicionale si shkolla dhe puna. Të rinjtë janë të bindur që njohuritë në media dhe informim mund t'i ndihmojnë si për tu mbrojtur ashtu edhe për të luftuar urrejtjen dhe përmbajtjen radikale dhe ekstremiste online. Kurset tradicionale që lidhen me MIL-in janë të nevojshme dhe duhet të vazhdojnë por ka një

nevojë evidente dhe potencial për shtimin e Kurseve Masive të Hapura Online në MIL (MIL MOOCs) në gjuhë dhe dizajne të shumëllojshëm. MIL MOOCs mund të strukturohen dhe administrohen nëpërmjet institucioneve me rregulla për kohën e mbarimit, vlerësimin, etj. Ato duhet të jenë gjithashtu edhe të pavarur, ku njerëzit mund t'i ndjekin me më shumë fleksibilitet dhe bazuar në interesat dhe motivimin e tyre.

Përsa i përket ndeshjes aksidentale të të rinjve me urrejtjen dhe materjale radikale dhe ekstremiste online, është e nevojshme dhënia e aftësive në MIL në mënyrë më pak të strukturuar por njëlloj të qëllimshme nëpërmjet mediave sociale. Pikërisht për këtë arsye UNESCO ka lançuar lëvizjen MIL CLICK në mediat sociale. MIL CLICK do të thotë Njohuri në Media dhe Informim, Mendim Kritik dhe Kreativitet, Njohuri, Ndërkulturore, Qytetari, Dije dhe Qëndrueshmëri. Veç kësaj, kjo është menduar qëllimisht edhe si një lojë fjalësh për të komunikuar miliona (mil) klikime (click) e gjithashtu për sa kohë që MIL funksionon, gjithçka shkon mirë (bën klik). MIL CLICK lidhet me klikimin në mënyrë kritike, me mençuri dhe kreativitet kur jemi në Internet. Qëllimi i tij është tu vërë në dukje njerëzve dhe qytetarëve aftësitë në MIL në përdorimin e përditshëm normal të Internetit teksa klikojnë për të parë, luajtur, dëgjuar, për tu lidhur, socializuar, krijuar dhe mbështetur. Leksuesit e këtij materiali inkurajohen të shohin më shumë informacion në website-n e UNESCO-s e t'i bashkohen lëvizjes.

Dizajni, fokusimi dhe pozicionimi i kurseve të MIL-it bëhet thelbësor në qoftë se njerëzit do të aplikojnë kompetencat në MIL për të ndaluar urrejtjen dhe përmbajtjen radikale dhe ekstremiste. Kurset e MIL-it duhet t'i bëjnë njerëzit të aftë të kuptojnë që censura nuk është as e arritshme dhe as efektive për të reduktuar furnizimin me urrejtje, radikalizëm dhe ekstremizëm të përmbajtjes online. Reduktimi i kërkesës për këtë lloj përmbajtjeje dhe zëvendësimi i saj me një përmbajtje më paqësore, të larmishme dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet MIL-it, siguron një zgjidhje më të qëndrueshme. Gjithashtu, censura duhet të jetë përpjekja e fundit dhe të bazohet në standardet ndërkombëtare në mënyrë që të mos rrezikohen akuza për pakësimin e lirisë së shprehjes (cf. Bleich, 2014). Kurset në MIL duhet gjithashtu të promovojnë efektivitetin dhe forcën e zgjedhjes; efektivitetin e zgjedhjes për të mos parë ose për të mos u angazhuar me jo të moralshme. Mjaft shpesh njerëzit ndjejnë ose shtyen të besojnë që nuk kanë zgjedhje kur vjen puna për përmbajtje të caktuar online ose në mediat elektronike. Dhe si përfundim, nga gjetjet e mësipërme një numër i konsiderueshëm të rinjsh propozonin që thjesht të injorohet gjuha e urrejtjes online dhe përmbajtja radikale ekstremiste kur ndeshesh me to. Kurset në MIL duhet të theksojnë që mosveprimi ndaj urrejtjes dhe përmbajtjes radikale është i rrezikshëm dhe po ashtu është edhe luftimi i urrejtjes me urrejtje. Injorimi i një përmbajtjeje të tillë mund të sjellë që ata të bëhen narrativa mbizotëruese online. T'i përgjigjesh gjuhës së urrejtjes me sulme dhe fyerje vetëm sa do të ushqente më shumë urrejtje dhe intolerancë.

Kurset e MIL-it duhet të fokusohen më shumë në pozitivitetet e medias dhe Internetit dhe jo vetëm në netativitetet. Nga zbulimet është evidente që të rinjtë jënë më të ndërgjegjësuar për sfidat që u sjell interneti dhe media por janë më pak të vetëdijshëm për fuqinë që kanë për të promovuar paqe, tolerancë, dashuri, dialog, hulumtim, krijim të dijes dhe zgjidhje të problemit. Ky ripozicionim i MIL-it është vendimtar në trajtimin e urrejtjes online, dhe të përmbajtjes radikale dhe ekstremiste. Në po të njëjtën frymë, të rinjve duhet t'u tregohen më shumë mentorë pozitivë për të rinjtë online. Kjo kërkon një investim të qëllimshëm burimesh. Gjetjet e mësipërme zbuluan se të rinjtë e shohin

presionin nga shokët e tyre si arsye më prominente për t'u angazhuar me gjuhë të urrejtjes dhe përmbajtje radikale dhe ekstremiste. Padyshim që hapësirat pozitive online dhe aplikacionet mobile ekzistojnë për t'i angazhuar të rinjtë në mënyrë më kuptimplote. Problemi është që këto duhen integruar si tendencë, relaksuese dhe e gjallë.

Urrejtja dhe përmbajtja radikale online sa vjen e rritet dhe nuk ka për t'u larguar. Nevojiten qasje sistematike dhe të qëndrueshme në kufijtë e MIL-it:

- Politika dhe strategji kombëtare për MIL
- Kurikula Kombëtare mbi MIL-in dhe radikalizimin, plus integrimin në edukimin formal
- Monitorimi dhe vlerësimi i kornizave.

Veprimtaritë e UNESCO-s përfshijnë kurikulën MIL, udhëzime për politika, korniza vlerësimi, udhëzues për transmetuesit, MIL MOOCs, Aleanca Globale për Partneritet në MIL (GAPMIL), Rrjeti i Universiteteve MILID, studim, rritja e kapaciteteve për mësuesit, institucionet edukative, të rinjtë dhe organizatat e të rinjve, si dhe strategji për mediat sociale.

“Ju e dini që ky kurs po më ndryshon jetën, perceptimin tim, dhe po më korrigjon disa pikëpamjet të miat miope. Jam kaq i gëzuar dhe dua kaq shumë që të mund të edukoj çdo fëmijë në mënyrë që të mos rriten me disa perceptime të stereotipizuara dhe në injorancë” (Iredumare Ojengbede Opeyemi)

“Mediumi më i madh i përhapjes së informacionit janë qëndrimet tona individuale. Si e shohim veten? ... Le ta fillojmë punën nga vetja, le të ndërtojmë relevancën tonë dhe të vendosim një balancë në mënyrë që të mos krijojmë [të njëjtat] probleme kundër të cilave po luftojmë...” (Yvonne Imenger Sender)

Shënime

1. <http://mediasmarts.ca/online-hate/deconstructing-online-hate>, marrë në 30 shtator, 2016.
2. Digital Hate and Terrorism Project. (2012) Simon Wiesenthal Center. http://www.canon-igs.org/event/report/report_150728/150728_abraham_summary.pdf. marrë në 30 shtator, 2016.
3. Countering Violent Extremism and Promoting Community Resilience in the Greater Horn of Africa: An Action Agenda May 2015. http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2015/05/HOA_CVE_Action_Agenda_1o.pdf. Retrieved on September 30, 2016.
4. Counter-Extremism Strategy. This Command Paper (Cm 9148), është publikuar për të zëvendësuar Command Paper (Cm 9145) që i është paraqitur Parlamentit në 19 tetor 2015, marrë në 30 shtator, 2016. https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/470088/51859_Cm9148_Accessible.pdf.
5. Ibid (p.11)
6. <http://en.unesco.org/preventing-violent-extremism>. Marrë në 30 shtator, 2016.
7. http://www.unesco.org/new/en/media-services/singleview/news/unesco_and_you_participate_now_in_youth_survey_on_media_technology_and_peace/#.WAtKOP197Z4 . Retrieved on September 30, 2016.

8. http://www.unesco.org/new/en/media-services/singleview/news/unesco_and_you_participate_now_in_youth_survey_on_media_technology_and_peace/#.WAtKOPl97Z4 . Gjetur në 12, 2016.
9. Wilson, C., Grizzle, A et al (2011) Media and Information Literacy Curriculum for Teachers. UNESCO, Paris
10. Shih debatin mbi HIV dhe AIDS dhe ndryshimin në sjellje.
11. Countering Online Radicalization in America: Executive Summary, National Security Program Homeland Security Project (2011)

Referenca

- Awan, I. (2016). Islamophobia on Social Media: A Qualitative Analysis of the Facebook's Walls of Hate. *International Journal of Cyber Criminology*, 10 (1): 1 -20.
- Banks, J. (2010). Regulating hate speech online. *International Review of Law, Computers & Technology*, 24 (3), 233-239. doi: 10.1080/13600869.2010.522323
- Bleich, E. (2014). Freedom of Expression versus Racist Hate Speech: Explaining Differences Between High Court Regulations in the USA and Europe. *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 40 (2): 2-37. doi: 10.1080/1369183X.2013.851476
- Brennan, M. and others (2015). A White Paper for UNESCO and the United Nations Community – Youth Led Pathways from Extremism. A Global Network of UNESCO Chairs on Children, Youth, and Communities White Paper.
- Chen, Hsin-Liang and Williams, James Patrick, “Pedagogical Design for an Online Information Literacy Course: College Students’ Learning Experience with Multi-modal Objects”(2009). Libraries’ and Librarians’ Publications. Paper 1.
- Cheung, Chi-Kim (2011) A study of the impact of media education on students’ media analysis skills - an interim report. In C. Von Feilitzen, U. Carlsson & C. Bucht (Eds.), *New Questions, New Insights and New Approaches: Contribution to the Research Forum at the World Summit on Media for Children and Youth 2010* (pp. 57-67) Sweden: NORDICOM, University of Gothenburg.
- Costello, M., Hawdon, J., Ratliff, T., & Grantham, T. (2016). Who views online extremism? Individual attributes leading to exposure. *Computers in Human Behavior*, 63, 311–320.
- Costello, M., Hawdon, J. & Ratliff, T. (2016). Confronting Online Extremism: The Effect of Self-Help, Collective Efficacy, and Guardianship on Being a Target for Hate Speech. *Social Science Computer Review*, September 2, 1-19.
- Digital Hate and Terrorism Project. (2011) Simon Wiesenthal Center. European Commission (2016). Communication from the Commission to the European-Parliament, The Council, the European Economic and Social Committee and The Committee of the Regions. Brussels, Supporting the prevention of radicalisation leading to violent extremism. COM(2016) 379 final, Brussels,
- Hawdon, J., Oksanen, A., & Rasanen, P. (2016). Exposure to cross-national consideration. *Deviant Behavior*. doi:10.1080/01639625.2016.1196985
- Hawdon, J., Oksanen, A., & Rasanen, P. (2015). Online extremism and online hate: Exposure among adolescents and young adults in four nations. *Nordicom-Information*, 37, 29–37. Retrieved from: : http://www.nordicom.gu.se/sites/default/files/kapitel-pdf/nordicom-information_37_2015_3-4_29-37.pdf
- Hobbs, R., & Frost, R., (2003) Measuring the acquisition of media-literacy skills. *Reading Research Quarterly* Vol. 38, No. 3 pp. 330-355. cross-national consideration. *Deviant Behavior*. doi:10.1080/01639625.2016.1196985

- Hawdon, J., Oksanen, A., & Rasanen, P. (2015). Online extremism and online hate: Exposure among adolescents and young adults in four nations. *Nordicom-Information*, 37, 29–37. Retrieved from: http://www.nordicom.gu.se/sites/default/files/kapitel-pdf/nordicom-information_37_2015_3-4_29-37.pdf
- Hobbs, R., & Frost, R., (2003) Measuring the acquisition of media-literacy skills. *Reading Research Quarterly* Vol. 38, No. 3 pp. 330-355.
- Jaishankar, K. (2008) Editorial – Cyber Hate: Antisocial networking in the Internet *International Journal of Cyber Criminology (IJCC)* ISSN: 0974 – 2891 July - December 2008, Vol 2 (2): 16–20
- National Security Program (2012), Countering Online Radicalization in America. Matti Näsi , Pekka Räsänen , James Hawdon , Emma Holkeri , Atte Oksanen , “Exposure to online hate material and social trust among Finnish youth”, *Information Technology & People*, Vol. 28 Iss: 3, pp.607 – 622
- Quin R, McMahon B. Evaluating standards in media education. *Canadian Journal of Educational Communication*. 1995;22(1):15–25.
- Youth Voices: Innovative Ideas on Youth and Extremism. Published by Bargad – Organization for Youth Development 2013.


Të bashkojmë pikat: Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm, Objektivat Globalë për Zhvillim të Qëndrueshëm

Jordi Torrent

Shumica e përpjekjeve të bëra për të parandaluar tërheqjen e të rinjve drejt ekstremizmit të dhunshëm bien në veshë që tashmë në masë të madhe janë imunë karshi joshjes së dhunës së lidhur me disa forma të ekstremizmit fetar. Shumë hulumtime dhe studime tregojnë që përjashtimi social (i vërtetë ose i perceptuar) është në fakt motori kryesor që i shtyn të rinjtë drejt formave të dhunshme të ekstremizmit politik dhe fetar. Sikurse ka pohuar qartazi Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon, “kërcënimi më i madh për terrorizmin nuk është fuqia e predhave – por politika e përfshirjes”. Alfabetizimi në Media dhe Informim mund të sigurojë një lidhje drejt kësaj përfshirjeje, duke zhvilluar aftësitë për mendim kritik të aplikuar te mesazhet mediatike qysh në arsimin fillor, duke mbështetur zërat e të rinjve në prodhimin dhe shpërndarjen e mesazheve te tyre mediatike, por brenda kornizës etike të Njohurive në Media dhe Informim.

Fjalëkyç: Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm, PVE, terrorizëm, përfshirje sociale, edukim STEM, mendim kritik, media etike, Islami radikal, Internet, censurë.

Brown and Cows (2015), në raportin e tyre. “Kontrollo web-in: Vlerësimi i etikave dhe politikave të patrullimit të internetit për materiale ekstremiste”, përfshihej Figura 1.



Ne mund të vlerësojmë kompleksitetin dhe vështirësinë e procesit, transversalitetin dhe shumëllojshmërinë e shkaqeve të mundshme që mund ta shtyjnë një të ri t'i bashkohet një grupi të dhunshëm që synon të shkatërrojë sistemin social që kemi ngritur.

Ideja që thjesht duke zbuluar një botë të re të mediatizuar në Internet mjafton që një i ri të ndajë mendjen, të inkurajohet për të bërë gati valixhet e t'i bashkohet ISIS-it është shumë e thjeshtëzuar. Madje është shumë e thjeshtëzuar edhe të mendosh që Daesh-i përdor (një tjetër emër ky për ISIS) platforma shumë të lëmuara e të përpunuara me të cilat ata të identifikojnë veten, platforma që imitojnë marrëdhëniet publike, reklamimin dhe përdorimin e imazherisë ikonike të Perëndimit.

Shumica e përpjekjeve të Perëndimit për të trajtuar radikalizimin e të rinjve dhe vullnetin e tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet terroriste fokusohen në përdorimin e aksioneve luftarake për të izoluar dhe mposhtur grupet që tërheqin vëmendjen dhe frymëzojnë aksionet e tyre iluzore për një rend të ri botëror. Në rastet më të mira, narrativat e luftës digjitale, të tilla si video loja Abdullah-X, e zhvilluar nga një ish ekstremist islamik, promovohen nëpërmjet YouTube-it dhe narrativave të mediave sociale që, siç pritet, ndikojnë që të rinjtë të mendojnë dy herë përpara se t'i përgjigjen narrativave të ISIS-it dhe i ftojnë ata t'i qasen në mënyra aktive atij debati (<http://www.abdullahx.com/>”[www.HYPERLINK “http://www.abdullahx.com/”](http://www.abdullahx.com/).abdullahx.com). Por në masë të madhe këto përpjekje I predikojnë një audience tashmë të konvertuar, ku rezultatet kanë provuar se janë vërtetë efikase për t'u ndryshuar zemrat dhe mendjet të rinjve që mendojnë seriozisht t'i bashkohen ISIS-t ose grupeve të ngjashme terroriste. Iniciativa të tilla si “P2P: Sfida kundër Ekstremit”, e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, ku studentëve universitarë, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara, iu kërkua të krijojnë projekte digjitale të dizenuar kundër narrativave të dhunshme ekstremiste, duhet ende të provojnë se janë efektive. Kujt i drejtohen këto narrativa? Sa të efektshme janë ato për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm? Për mua nuk është e qartë që ato arrinë të ndihmojnë për t'u ndryshuar mendjen të rinjve që kanë vendosur t'i bashkohen ISIS-it ose që po bëhen gati të kryejnë akte violente në komunitetin e tyre.

Përgjigje të tjera kundër ekstremizmit të dhunshëm, si ai i propozuar nga Jared Cohen, Drejtor i Google Ideas, në një artikull të kohëve të fundit për Foreign Affairs ([https://HYPERLINK “https://www.foreignaffairs.com/articles/middle-east/digital-counterinsurgency”](https://www.foreignaffairs.com/articles/middle-east/digital-counterinsurgency)[www.HYPERLINK “https://www.foreignaffairs.com/articles/middle-east/digital-counterinsurgency”](https://www.foreignaffairs.com/articles/middle-east/digital-counterinsurgency).foreignaffairs.com/articles/middle-east/digital-counterinsurgency), sjell në botën digjitale teknika të ngjashme me ato që implementohen në terren: si organizimi në shkallë të gjerë i antirebelizmit. Një luftë digjitale në shkallë të gjerë njeh fuqinë e qasjes promociionale digjitale të ISIS-it. Shumica e betejave në këtë lloj lufte përfshijnë zbulimin e gjurmëve në mediat sociale dhe deaktivizimin e tyre në Twitter, Facebook, YouTube dhe media të tjera sociale të llogarive që mbështesin haptazi rebelët. Në këtë artikull, Cohen thekson që në vitin 2014 Njësia Referuese Britanike e Antiterrorizmit në Internet, duke punuar në lidhje të ngushtë me Google, Facebook dhe Twitter, shenjoi për t'i hequr më shumë se 46,000 materjale me përmbajtje dhune ose urrejtje. Po atë vit YouTube hoqi afërsisht 14 milion video. Në prill të vitit 2015, Twitter pezulloi brenda një dite të vetme

10,000 llogari të lidhura me ISIS-in. Cohen e pranon që ky antirebelim i gjerë global digjital do ta detyrojë ISIS-in të operojë në të ashtuquajturin dark-Web, që është pjesa e Internetit e paindeksuar nga motorët kryesorë të kërkimit dhe që mund të aksesohet vetëm nga përdorues të mirinformuar. Cohen e mbyll duke thënë që “detyrimi i organizatave terroriste të operojnë në mënyrë sekrete e bën më të vështirë interceptimin e kompleteve, por në rastin e ISIS-it, ky është një kompromis që ia vlen të bëhet”. “Çdo ditë,” vazhdon ai, “mesazhi i grupit u shkon miliona njerëzve, disa nga të cilët bëhen promotorë të ISIS-it madje edhe luftëtarë të kauzës së tij. Parandalimi i dominimit të territorit digjital prej tij do të kontribuonte për të penguar furinizimin e rradhëve fizike të tij, duke reduktuar impaktin në psiqikën publike, duke reduktuar impaktin e tij në psiqikën publike, duke e privuar kësaj nga mjete të tij më kryesorë i komunikimit”.

Por kjo formë sfidimi e ISIS-it dhe prezencave të tjera digjitale të ngjashme me ISIS-in në Internet, përveçse që ka rezultate të paprovuara, ka reperkursion serioze në nocionin e përgjithshëm të lirisë së shprehjes. Në botimin e tyre mbi patrullimin e Internetit për materjale ekstremiste, Brown dhe Cowsls pohojnë qartë që “Përcaktimi i “materialeve ekstremiste” online, që mund të jenë subjekt i vëmendjes së policisë, duke mbrojtur njëkohësisht lirinë e shprehjes dhe liritë e tjera, është detyrë sa e vështirë aq dhe e diskutueshme. Kufijtë midis materjaleve “ekstremiste” që meritojnë vëmendjen e policisë, dhe të gjuhës që, sipas formulimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, mund të “ofendojë, shokojë ose shqetësojë” – por që megjithatë vazhdon të mbetet e mbrojtur në bazë të rregullave të lirisë së shprehjes – janë jashtëzakonisht të vështira për tu përkufizuar në terma të përgjithshëm”. (Browns & Cowsls, 2015).

E vërteta është që sot ka shumë më tepër njerëz në botë që pranojnë aktet ekstremiste të dhunshme dhe terrorizmin si mjete të shprehjes kundër Perëndimit nga sa ishin në vitin 2001. Trilionat e dollarëve të shpenzuar në aksionet luftarake (dhe pasojat e kësaj) në Afganistan, Irak, Jemen, Somali, Nigeri, Mali, Libi, Siri, etj., nuk kanë patur rezultatet e pritura, dhe me këtë dua të them paqen, sigurinë, stabilitetin dhe shoqëritë e përparuar. Shtetet e Bashkuara, aleatët e tyre dhe forcat pseudo-militare (p.sh. rreshtimi i jashtëzakonshëm i kontraktorëve për sigurinë) kanë qenë tashmë në Afganistan që prej 15 vjetësh. Konflikti po shpërndahe në rajon e më tej. Edhe sa vite të tjera pritet të vazhdojë ky spektakël mizor, shkatërrues, i përgjakshëm dhe i llahtarshëm? Edhe sa miliona refugjatë të tjerë jemi gati të pranojmë në Perëndim? Duket qartë se kjo qasje nuk po funksionon.

Por atëherë çfarë mund të bëhet për të parandaluar të rinjtë që t’i bashkohen rradhëve të ISIS-it. Çfarë i shtyn ato ta bëjnë këtë?

Një raport i Mercy Corps (2015) i kohëve të fundit konkludon që:

“Çdo vit, donatorë perëndimorë shpërndajnë shuma të mëdha asistence për zhvillim në mënyrë që të zbusin apelin që u bëjnë të rinjve nëpër botë milicët, piratët dhe terroristët. Por e udhëhequr nga shumë pak prova empirike në këtë rrugëtim, kjo ndërmarrje është e paqartë dhe me pasojat të paparashikuara. Nga intervistimet dhe sondazhet me të rinj në Afganistan, Kolumbi dhe

Somali, raporti tregon që shtytësit kryesorë të dhunës politike i kanë rrënjët jo te varfëria, por në përvojat e padrejtësisë: diskriminimit, korrupsionit dhe abuzimit nga ana e forcave të sigurisë. Për shumicën e të rinjve, narrativat e ankesave kanë si bazë si bazë mungesën e vetë shtetit, i cili është i dobët, i korruptuar ose i dhunshëm. Të rinjtë marrin armët jo sepse janë të varfër, por sepse janë të zemëruar”.

Sikurse del gjithashtu në pah në raport, “Shumica mund ta pranojnë papunësinë – si rrethanë, fat i keq, vullnet i Zotit. Këto nuk janë gjëra që mund t’i luftosh”, tha një i ri afganas. Ajo që zemëron ata është korrupsioni i zyrtarëve publikë, diskriminimi e gjithashtu kur ndjehen të mashtruar e të fyer. Përvojat e hershme të dhunës – keqtrajtimi nga forcat e sigurisë, për shembull – shoqërohet me tërheqjen e të rinjve drejt grupeve të dhunshme. Gjithsesi rrallë herë bëhet zgjedhja për të rrëmbyer armët thjesht për arsye ekonomike. Duket se idetë dhe përvojat janë më të rëndësishme. Dinjiteti vlen më shumë, jo dollarët.

Një i ri afganas i tha studjuesit të Mercy Corps, “Nuk u bashkova me Talebanët sepse isha i varfër, u bashkova sepse isha i zemëruar. Sepse ata (Perëndimi) ishin të padrejtë me ne”. (Mercy Corps, 2015)

Në ditët e sotme mjaft nga debatet politike janë të ushqyer nga zemërimi; ky zemërim është i dukshëm jo vetëm te të rinjtë që bëhen gati t’i bashkohen ISIS-it, por e gjejmë gjithashtu në sheshet kryesore të arenave politike, sikurse mund ta dëshmojmë nga fushata presidenciale aktuale në Shtetet e Bashkuara dhe gjetkë. Në një nga sondazhet e fundit, 92% e votuesve republikanë në Shtetet e Bashkuara shprehen se janë të zemëruar me qeverinë federale. Noam Chomsky thotë që zemërimi është faktori kryesor i ngritjes së Donald Trump-it në peizazhin politik të Amerikës. Por jo vetëm mbështetësit e Trumpit kanë marrë energji nga zemërimi, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për shumë nga ndjekësit e kandidatit të Partisë Demokratike Bernie Sanders, edhe pse zemërimi qëndron në fusha të ndryshme të sistemit social (Leland, 2016).

Shoqata Psikologjike Amerikane e përkufizon zemërimin si “emocion të karakterizuar nga antagonizmi kundrejt dikujt ose diçkaje që ndjeni se është treguar qëllimisht i padrejtë me ju”. Në Perëndim ka patur historikisht shumë shprehje të dhunshme të zemërimit kundër sistemit social. Në fund të viteve 1800 dhe në fillim të viteve 1900, ishin të zakonshme bombat e hedhura në vendet publike nga anarkistët. (burimi?) Në vitin 1908, Barcelona u dogj për një javë kur punëtorët shprehën pakënaqësinë e tyre me shpalljen nga ana e qeverisë qendrore të rekrutimit në ushtri për luftën koloniale në veri të Marokut.

A nuk ishte një lloj forme zemërimi dhe ndjenjë përjashtimi – me të gjitha paralajmërimet e mundshme – ajo që të rinjtë shprehën duke djegur ndërtesat në Londër në verën e vitit 2011?

Pra, ndoshta është sërish zemërimi, ndjesia e vërtetë – ose e perceptuar – e përjashtimit që provojnë të rinjtë, që duhet adresuar kur mendojmë për mënyrat më të mira për t’iu kundërvënë apelit drejt ekstremizmit të dhunshëm që ndjejnë disa të rinj. Kësaj i bëhet jehonë në shumë studime, për shembull, në raportin e Institutit Ndërkombëtar të Paqes me titull “Ekstremizmi i dhunshëm: Drejt një strategjie parandalimi në rajonin frankofon”. Përfundimet e materjalit pohojnë qartë që “strategjitë mbizotëruese që udhëheqin politikatat aktuale në luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm janë krejt jo-efikase, sepse ato bazohen

kryesisht te një qasje e dhunshme e cila nga ana e vet gjeneron edhe më shumë dhunë”. Konkluzioni i raportit nxjerr gjithashtu në pah që “disa lëvizje ekstremiste u ofrojnë individëve përgjigje që as shoqëritë e tyre as qeveritë nuk kanë qenë në gjendje t’ua japin, veçanërisht përgjigje për çështje të thjeshta, gjithashtu edhe një mënyrë për të luftuar padrejtësitë dhe pabarazitë e perceptuara e njëkohësisht ndjesinë e përkatësisë”. (Instituti Ndërkombëtar e Paqes, 2016).

Në preambulën e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2178, të vitit 2014, Sekretari i Përgjithshëm pohon qartë që “në një periudhë afatgjatë, kërcënimi më i madh për terroristët nuk është fuqia e predhave – por politika e përfshirjes”. Pika 16 e rezolutës “Inkurajon Shtetet Anëtare të angazhojnë komunitetet relevante lokale dhe aktorët jo qeveritarë për të zhvilluar strategji kundër narrativës ekstremiste të dhunshme që mund të nxisë akte terroriste, të adresojë kushtet e favorshme për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, që mund të ndihmojë terrorizmin, duke përfshirë këtu fuqizimin e të rinjve, familjeve, grave, fetarëve, udhëheqësve kulturorë dhe edukativë, dhe të gjitha grupet e tjera të shqetësuara të shoqërisë civile që të përshtasin qasje të personalizuar për t’iu kundërvënë rekrutimit të këtij lloji të ekstremizmit të dhunshëm dhe duke promovuar përfshirje dhe kohezion social. (...)” Pika 19 nënvizon rolin që mund të luajë edukimi në luftën kundër narrativave terroriste. (http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf)

Në artikullin e fundit të Daniel Heinke-s “Xhihadistët gjermanë në Siri dhe Irak: Përditësim”, autori nënvizon që në masë dërrmuese të deportuarit ishin radikalizuar në “mjedise të jetës së përditshme”. Në shumicën e rasteve Interneti nuk kishte patur rol madhor, dhe vetëm pak individë kishin qenë radikalizuar vetëm nga kontaktet online (Heinke, 2016). Ky vlerësim konfirmohet nga artikulli i Benjamin Bowyer-it dhe Joseph Kahne-it “Si i kuptojnë të rinjtë mesazhet politike në videot në YouTube” ku dalin në përfundimin që nivelet “individuale” të njohurive politike dhe predispozicioni i tyre për të qenë dakord me mesazhin që përmbahet në video janë parashikues të fortë të kuptimit (...) impakti potencial i ekspozimit rastësor ndaj komunikimeve politike online është më i vogël nga çë mendonin shumica e studjuesve, veçanërisht kur mesazhi është kontradiktor në raport me besimet e mëparshme të shikuesve”. (Bowyer & Kahne, 2015)

Rezultatet e këtij studimi vetëm sa riafirmojnë idetë e mëparshme të Edward Bernays-it. Bernays, babai i marrëdhënieve bashkëkohore me publikun dhe i industrisë së reklamave, pohonte në librin e tij themelor të vitit 1929, “Propaganda”, që “propaganda nuk u shërben aspak politikanëve, po qe se nuk ka asgjë për t’i thënë publikut përveç asaj që ai në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme kërkon të dëgjojë”. (Bernays, 1929) Kjo i shkon shumë për shtat populizmit politik dhe narrativave të ndryshme të zemërimit. Audienca lidhet me narrativën me të cilën është tashmë e predispozuar të lidhet.

Kjo pikë ka rëndësi kapitale. Asnjë kundër-narrativë, qoftë kjo digjitale ose jo, nuk do të ndryshojë mendjen e vullnetarit të ardhshëm të ISIS-it në qoftë se ajo që thuhet nuk është

konform me atë që individi është i prirur të besojë për shkak të perceptimit të zemëruar që ka tashmë, i vërtetë ose jo, perceptimi i marginalizimit.

Nga kjo perspektivë, të parandalosh ekstremizmin e dhunshëm do të thotë në fakt të ndryshosh shoqëritë tona. Sikurse thekson Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara “kërcënimi i vërtetë për terroristët nuk është fuqia e predhave – por politikat e përfshirjes”. (*_2014_EN.pdf*)http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf”[wwwHYPERLINK “http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf”](http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf).un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCRHYPERLINK “http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf”%HYPERLINK “http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf”202178_2014_EN.pdf) Ky pohim i referohet përfshirjes dhe oportunitetit real, politikave që synojnë të implementimi i vërtetë i drejtësisë sociale, duke ndihmuar në fuqizimin politik të rinisë, duke mbështetur përfaqësimin gjinor, të politikave që luftojnë korrupsionin në të gjitha fushat e shoqërisë, të politikave që i japin energji edukimit, aftësive për mendim kritik, dijeve mediatike dhe kulturore, edukimit civil dhe për qytetari globale. Këto politika, reformojnë dhe riformësojnë thellësisht jo vetëm shoqëritë tona por, në një nivel global, kanë shanse shumë më të mëdha të parandalojnë efektivisht ekstremizmin e dhunshëm.

Studimi i Mercy Corps-it thekson që “ajo që zbuluam është se statusi i papunësisë është parashikues shumë i dobët i faktit nëse një person do t’i bashkohet ose jo një grupi rebel. Parashikues shumë më i mirë është përjetimi i padrejtësisë, diskriminimit, marginalizimit, të qenurit në krahun pritës të korrupsionit, kur janë keqtrajtuar nga policia, forcat e sigurisë, apo kur kanë një familjar të vrarë”. Studimi konkludon që “në qoftë se do të ishte varfëria dhe papunësia që i shtynte drejt terrorizmit, do të kishte patur shumë më tepër terrorizëm. Janë me miliona njerëzit që jetojnë në varfëri – pse nuk bashkohen më shumë prej tyre me lëvizjet e armatosura? Është fakt që shumica e të rinjve janë paqësorë. Ata duan të ardhmen dhe shpesh janë optimistë pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhen” (Mercy Corps, 2015).

Plani i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm tregon gjithashtu që investimi në edukimin dhe hartimin e programeve për përfshirjen e rinisë janë elementë kyç drejt këtij objekti. Por realiteti është që në disa zona, specifkisht në zonat në konflikt, popullatat janë jashtëzakonisht të reja; pothuajse 65% e popullsisë afganase është nën moshën 24 vjeç, në Somali, përqindja e këtij grupi moshe është 63%. Në nivel global, 25% e popullsisë botërore (thuajse 2 miliardë) është midis 10 dhe 24 vjeç.

Pavarësisht këtyre fakteve dhe alarmit global për të gjetur mënyra për të luftuar përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, pavarësisht gjithë këtyre, një raport i Liesbet Steer-it i vitit 2014 nënvizon mungesat serioze të buxheteve për edukim dhe të burimeve në nivel global. Ndërkohë, buxhetet ushtarake vazhdojnë të rriten. Të dhënat aktuale e vlerësojnë buxhetin global për qëllime ushtarake në rreth 1800 trilion dollarë. Vetëm 1.5% e kësaj shifre do të garantonte edukimin bazë për të gjithë fëmijët në 46 vendet me të ardhura më të ulta dhe të mesme. Aktualisht, këto vende kanë një hendek prej 50% në buxhetet e tyre për edukim, duke lënë miliona fëmijë dhe të rinj me shumë pak opzione. Kupton mjaft kur sheh se si shkurtohen nevojat buxhetore për arsim, ndërkohë që në të njëjtën kohë punohet për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm. Këto politika janë në kundërshtim me nevojat e kohës sonë. Shpesh deficitet në buxhetet arsimore kundërbalancohen nga mundësi të

tjera për edukim që do të njollosnin vizionin e botës me tonalitete partikolare. Maryam Abdillahi Hassan, studjuese në Qendrën e Studimeve për Zhvillim në Putland të Somalisë pohon, “Kur Salafistët filluan të furnizonin shkollat lokale me libra historie, pikëpamjet e të rinjve për botën ndryshuan. Shkolla është treg idesh, vazhdon ajo, dhe tani njerëzit flasin gjithë kohën për Izraelin dhe Palestinën. Duke i dëgjuar ata do të mendosh që myslimanët janë të shtypur dhe i vetmi opcion është lufta. (MercyCorps, 2015)

Studimi i Mercy Corps-it konkludon që “programet e angazhimit civil, të izoluar nga reformat kuptimplota qeverisëse, kanë pak të ngjarë të zbusin dhunën politike. Në të vërtetë, programe të tilla mund t’i fryjnë zjarrit të konfrontimit”. (MercyCorps, 2015).

Ndoshta si shoqëri ne mund të ngrihemi mbi sfidat që prezanton ekstremizmi i dhunshëm ndaj komuniteteve tona jo duke zhvilluar më tej një botë militariste, një shtet policor, të mbushur me censurë, burgosje dhe tortura, por duke kuptuar që ndoshta bota jonë materjaliste, obsesioni ynë me konsumizmin dhe babëzia hiper-kapitaliste që po zhvillohet mund të kenë nevojë për rivlerësim. Sot bota është e mbushur me zemërim dhe të pretendosh që rendi për të cilin kemi kontribuar të ndërtojmë është perfekt, ose gati perfekt, dhe që ky zemërim është irracional, padyshim që nuk do ta zgjidhë problemin ose nuk do të eliminojë shprehjen e tmerrshme dhe të pavend të atij zemërimi. Ndoshta duhet të mendojmë seriozisht rreth evolucionit në qoftë se duam të shmangim një revolucion të përgjakshëm. Edukimi me njohuri në media, përkrah përhapjes së reformave sociale, është një hap përpara drejt një bote me më shumë iluzione, më shumë paqe dhe kuptim të thellë të faktit që dallimet nuk janë sinonime të polarizimit dhe konfrontimit.

Njohuritë në Media dhe Informim mund të jenë platforma, kanali, për të forcuar edhe një herë edukimin humanitar që nuk është tkurrur në kurikulën e re të shkollave në mbarë botën. Një kurikul që i mëshon fort edukimit STEM (që fokusohet mbi shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën) teksa i pret fondet dhe orët e mësimi programeve që lidhen me artin dhe shkencat e tjera humane nuk do të zgjidhë problemin. Fokusimi vetëm te edukimi STEM është në dëm të komuniteteve tona dhe ka potencialin të kthehet në të kundërt, duke prodhuar mendësi që kanë më shumë tendencë të tërhiqen drejt mënyrave ekskluzive të të menduarit që shpesh shndërrohen në forma të dhunshme të shprehuri, në ekstremizëm të dhunshëm. Në raportin e Matin Rose-s të kohëve të fundit “Imunizimi i Mendjes: Si mund të kontribuojë reforma në edukim te neutralizimi i ekstremizmit të dhunshëm?”, të botuar në British Council (Rose, 2015), është ngulur këmbë fort për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik në kurikulat e edukimit fillor dhe të mesëm. Alfabetizimi në Media dhe Informim është platforma më e mirë për këtë. Politikëbërësit në të gjithë botën duhet të ndërgjegjësohen për këtë dhe të inkurajohen që të përfshirë në kurikulat e detyruara edukimin me Njohuri në Media dhe Informim. Nga kjo mund të varet një botë me më shumë paqe.

Referenca

- Bernays, E. (1929). *History is a weapon: Propaganda*. Retrieved from: <http://www.historyisaweapon.org/defcon1/bernprop.html>
- Bowyer, B. T. and Kahne, J. E. (2015). *Youth comprehension of political messages in YouTube videos*. *New Media and Society*, Retrieved from: <http://nms.sagepub.com/content/early/2015/10/14/1461444815611593.abstract>

- Brown, I and Cows J. (2015). *Check the web: Assessing the ethics and politics of policing the internet for extremist material*. VOX-Pol. Retrieved from: www.voxpol.eu/download/report/VOX-Pol_Ethics_Politics_PUBLISHED.pdf
- Heinke, Daniel H. (2016). *German Jihadists in Syria and Iraq: An Update*. ICSR Insight, February 29.
- International Peace Institute (2016). *L'extremisme violent: Vers une strategie de prevention dans l'espace francophone*. Retrieved from: https://www.ipinst.org/wp-content/uploads/2016/01/1601_Violent-Extremism.pdf
- Leland, John (2016). *Bernie Sanders and Donald Trump Voters Share Anger, but Direct it Differently*. *New York Times*, January 30, 2016
- MercyCorps (2015). *Youth and Consequences: Unemployment, Injustice and Violence*. Retrieved from: <https://www.mercycorps.org/research-resources/youth-consequencesunemployment-injustice-and-violence>
- Rose, M, (2015). *Immunising the Mind: How can education reform contribute to neutralizing violent extremism*. British Council, Retrieved from: https://www.britishcouncil.org/sites/default/files/immunising_the_mind_working_paper.pdf
- Steer L. (2014). *Seven Facts about Global Education Financing*. Retrieved from: <https://www.brookings.edu/blog/education-plus-development/2014/02/20/seven-facts-about-global-education-financing/>

Duke përfaqësuar “Ne” – Duke përfaqësuar “Ata”: Vizualizimi i Racizmit në Filmat e Shkollave Fillore në Greqi

Pavlos Valsamidis

Në Greqinë bashkëkohore kriza ekonomike, si edhe instabiliteti politik i viteve të fundit, krijuan kushtet që gjuha e urrejtjes të nxisë racizmin më shumë se kurrë. Për fat të keq fenomeni i racizmit mund të ndjehet madje edhe në jetën e shkollës fillore.

Ky artikull fokusohet në retorikat vizuale që përdorin nxënësit e shkollave fillore, te filmat që bëjnë në shkollë, për të artikuluar të kundërtën raciste të “ne”/“ata” dhe gjithashtu zgjedhjet vizuale që mbështesin për të lehtësuar pabarazitë e për të krijuar zgjidhjen e tyre të problemit. Njohuritë audiovizuale mund të ofrojnë një strategji dinamike kundër racizmit.

Fjalëkyç: njohuri audiovizuale, filma të shkollave fillore greke, pasqyrimi i racizmit dhe i pabarazive, “tekst” audiovizual

Hyrje

Greqia është e trazuar. Kriza ekonomike, papunësia, emigracioni, bashkë me refugjatët dhe instabilitetin politik kanë përshkallëzuar kushte të posaçme të cilat e përkeqësojnë racizmin. Gjuha e urrejtjes në vitet e fundit, është shtuar, duke ndezuar diskriminimin racial (ECRI, 2015:20). Media në veçanti, ka bërë të vetën gjuhën e urrejtjes dhe stereotipet negative që kanë në shënjestër emigrantët dhe romët, gjë që shkakton konflikte raciale dhe fryn kontrastin bipolar të “ne” kundrejt “atyre” (ECRI, 2015:16). Për fat të keq, ky kontrast është ndjerë edhe në jetën shkollë. Në fakt, në këta gjashtë vitet e fundit, janë shtuar sjelljet e dhunshme me ritme alarmante, madje edhe në shkollat fillore.

Ky artikull fokusohet te edukimi audioviziv si një strategji e re edukative për të lehtësuar pabarazitë; ai shikon se si e perceptojnë fëmijët kontrastin “ne”/“ata” dhe se si pasqyrohet kjo në filmat e tyre (tekstet audiovizuale).

“Ne” përkundër “Atyre” në shkollën greke

Racizmi është një sistem shtypjeje i organizuar, i cili bazohet në dallimet raciale, biologjike, etike dhe kulturore (Byrd 2011, 1008). Në thelb ai mbështetet te doktrina që një grup social, nga natyra, është superior dhe “dominues” në krahasim me një grup tjetër, i cili, nga natyra, është inferior dhe “i dominuar” (Benedict, 1983: 97).

“Ne” i referohet grupit “dominues”. Ky grup social e thekson superioritetin e vet duke fituar një rol hegjemonik dhe udhëheqës. Duke ushtruar kontrollin social dhe kufizuar lirinë e të tjerëve (Van Dijk, 1993: 21) “ne” marginalizon dhe përjashton grupe të tjerë, teksa shfrytëzon privilegjet e tyre (ibid: 22-23). “Ata” i referohet grupit të “dominuar”. Ky grup social ka tipare të dallueshme (kulturore, racore, etj.). të cilat i veçojnë nga “dominuesit”. “Dominuesi” i trajton ata si kërcënim, si minoritet i dëmshëm dhe i rrezikshëm. Si përfundim të “dominuarit” do të konsiderohen si të stigmatizuar. Për pasojë, ata e pranojnë shtypjen dhe shfrytëzimin nga grupi “superior”, duke nxitur kështu pabarazitë (Hughes & Kroehler, 2007: 387 – 388).

Kontrasti midis “ne”/“ata” thellohet më tej nëpërmjet stereotipeve negative. Stereotip është një tipar që e degradon dhe e prek një person (Hall, 1997: 258) Për ta ilustruar, duke paraqitur emigrantët si “të pistë” ose të “fëlliqur” dominuesi “ne” shfaqet i fuqishëm dhe superior ndaj figurës së dobët e të rrënuar të “atyre” (Billing, 1995: 81-83). Duke përdorur stereotipet, “ne” ndërton në të njëjtën kohë kuptimin dhe rregullsinë për vete dhe stereotipizon duke diferencuar “ata” e duke i bërë këta grupe të shfaqen si jonormalë, si të parregullt (Hall, 1997: 258).

Për shkak të kontrastit “ne”/“ata”, fenomeni racist është mjaft i pranishëm në shkollat greke. Ndonëse Ministria e Arsimit, në mesin e krizës ekonomike, bën përpjekje reale për të zbutur racizmin me përpjekje të përditësuara edukative, jeta shkollore shkundet përditë nga sjellje të dhunshme. Është imperative që të ndërmerren hapa të posaçëm që t'i bëjnë ballë problemit, pasi dhuna racore ka arritur deri aty sa të kërcënojë haptazi Republikën Greke (Avokati Grek i Popullit, 2013:66).

Në raportin e Avokatit të Popullit thuhet që ksenofobia dhe racizmi janë arsyt kryesore për nivelet aktuale të dhunës në shkollë. Kjo dhunë merr një numër të madh formash: për shembull verbale/joverbale, shikime përbuzëse dhe agresion fizik (ibid, 2013:57). Në mënyrë mjaft domethënëse, shumica e incidenteve nuk raportohen, sepse nxënësit kanë frikë nga pasojat (ibid:59).

Në të shumtën e rasteve konfliktet burojnë nga shkaqe të rëndomta, por rezultojnë në konfrontime ekstreme raciste midis nxënësve, për shkak të racës së disa individëve ose grupeve (ibid: 58). Gjithashtu, sjellje raciste mund të identifikohen në raste të izoluara kur mësuesit dhe/ose prindërit sillen në mënyrë paragjyquese kundrejt nxënësve me aftësi të kufizuara ose nxënësve nga kultura të tjera, duke shkaktuar diskriminim e tyre në jetën shkollore (ibid: 60). Raporti pohon qartë sidomos që dhuna racore është bërë një “krim i padukshëm” (ibid: 65).

Nga këndvështrimi i sa u tha më sipër, mund të kuptojmë që në vitin 2016, racizmi i shkollës greke është fakt i dhimbshëm dhe tragjik, e për më tepër mund ta identifikojmë atë si me “racizmin modern” ashtu edhe me “neoracizmin”.

Mes minoriteteve të tjera, racizmi modern vë në shënjestër emigrantët. Kjo konsiston në paraqitjen dhe stereotipet negative që riprodhohen nga media dhe që në mënyrë të pavetëdijshme adoptohen nga të rinjtë (Henry, 2010:576). I ashtuquajtura "sukses" i racizmit modern është ekzistenca e paqartë e tij. Ndonëse prezent, konfliktet e tij bëhen thujtë të padukshëm, gati natyrorë. Për shembull, shikimet përçmuese, ironia, sarkazma, tregimi me gisht, gjetet fyese, kanë të gjitha një impakt jashtëzakonisht të madh në degradimin dhe stigmatizimin e grupeve (Sue et al, 2007: 271-272).

Neoracizmi mbështetet te diskriminimet dhe pabarazitë e bazuara në konceptin e kulturës. Grupi "tjetër" ka kulturë të ndryshme dhe kërcënon "pastërtinë" e tonës, ndaj ne i marginalizojmë ata si minoritet i rrezikshëm (Lentin, 2004:91 – 92). Është thelbësore që programet primare dhe sekondare edukative greke fokusohen mbi veprimtaritë e përditshme të bazuara në parimet e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të mos-diskriminimit. Sot, më shumë se kurdoherë më parë, është e nevojshme të krijohet një strategji dinamike antiraciste që do të bashkojë dhe angazhojë në mënyrë aktive njerëzit drejt një jete në paqe dhe harmoni. Një strategji e tillë mund të jetë rezultat i njohurive audiovizuale.

Njohuritë audiovizuale në edukimin grek

Në mars të vitit 2016, gjatë dialogut kombëtar mbi çështjet madhore të edukimit, u draftua një raport lidhur me edukimin audiovizual. Raporti theksonte që ishte thelbësore përfshirja e alfabetizimit mediatic në Kurikulën e re të Edukimit Grek. Ai nënvizonte që futja e programeve edukative audiovizuale ishte "nevojë sociale", për shkak të diskriminimeve, pasi ka shumë nxënës të paditur nga ana audiovizuale (Aggelidi, Aletras, et al, 2016).

Edukimi Audiovizual (term që përdoret shpesh në vend të Alfabetizimit në Media) në Greqi është ende në fazën eksperimentale. Kriza ekonomike veprimtaritë si frenuese e zhvillimit në këtë fushë. Sido që të jetë, janë bërë disa përpjekje për zhvillimin dhe promovimin e aftësive audiovizuale si festivalet e mirënjohur vjetorë "Pame Cinema", "Camera Zizanio" dhe konkursi vjetor "Enas Planitis Mia Efkairia".

Komunikimet vizuale dominojnë jetën e përditshme. Fëmijët bien në kontakt me tekste multimodale (d.m.th. filma, videolojra, TV) përpara se të futen në arsimin e detyruar (Kress & Leeuwen, 2006: 17-18). Në fakt, ata kanë fituar një maturim të herëshëm audiovizual (Buckingham, 2000: 41), atë që kurikula shkollore e përjashton nga veprimtaritë e përditshme. Është e nevojshme që këto aftësi të zhvillohen më tej në mënyrë që të reduktohet padija vizuale (Tornero, Vapis, 2010:53). Sikurse sugjeronte Perez Tornero (ibid: 73):

"[...] Edukimi Mediatic është pjesë e të drejtave themelore për çdo qytetar në çdo vend të botës [...]"

Brenda kësaj kornize, duhet që edukimi grek jo vetëm të integrojë njohuritë audiovizuale në kurikulën e re (duke filluar nga kopështi) por gjithashtu ta promovojë atë, çdo ditë, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme. Një arritje e tillë mund të rezultojë në kultivimin një shoqërie harmonioze të mirë informuar audiovizuale, me sens të fortë qytetarie aktive dhe

me respekt për diversitetin kulturor, gjithashtu edhe për parimet demokratike të barazisë (Torner, Vapis, 2010: 122).

Synimi i edukimit audiovizual është që nxënësit të fitojnë disa aftësi në “leximin” (d.m.th. akses, analizë, vlerësim) dhe gjithashtu “shkrimin” (familjarizim me fazat e prodhimit; krijimin final) e teksteve audiovizuale (Theodoridis, 2013: 48). Duke patur parasysh këtë, është e rëndësishme të kuptojmë marrëdhëniet midis teksteve audiovizuale dhe racizmit. Për të ekzaminuar më tej këtë duhet të fokusohemi në 3 aspekte (të ashtuquajturit 3K) të njohurive në media, sikurse shprehet Bazalgette: Kritik, Kulturor dhe Krijues (Bazalgette, 2009:7).

Aspekti kritik i referohet aksesit, analizës dhe mendimit kritik për tekste audiovizuale (po aty). Përmes këtij procesi, nxënësit bien në kontakt me tekste që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, dhunë racore dhe paragjykime. Gradualisht, teksa “demistifikojnë” kuptimet dhe synimet e fshehura në këto tekste, nxënësit zhvillojnë të menduarit kritik (Masterman, 1989: 20-38). Nëpërmjet veprimtarive kritike nxënësit praktikojnë njohjen e ekzagjerimit gjithashtu edhe gjuhën vizuale të zgjedhur për të nënvizuar pabarazitë, stereotipet negative dhe për të interpretuar si duhet mesazhet.

Aspekti kulturor synon që nxënësi të përjetojë tekste audiovizuale nga vende të tjera, t’i shijojë dhe komentojë ato (Bazalgette, 2009:7). Duke parë filma në gjuhë të ndryshme, të cilët paraqesin zakone dhe kultura të tjera, nxënësit do të familjarizohen me diversitetin. Ata mësojnë që “ata” nuk janë as armiq dhe as klasë e ulët. Po njësoj, ato theksojnë të përbashkëtat që ekzistojnë, terrenin e përbashkët nëse ju pëlqen kështu, i cili përbën themelin e komunikimit të barabartë dhe paqësor në respekt të dallimeve kulturore (Torner, Vapis, 2010:122)

Aspekti krijues ka të bëjë me krijimin e teksteve audiovizuale nga vetë nxënësit (Bazalgette, 2009:7). Nga konceptimi i skenarit, hedhja e tij në letër, filmimi, editimi e deri te realizimi përfundimtar i filmit, nxënësit mësojnë know-how, mjetet dhe fazat e produksionit (Theodoridis, 2013: 48). Këto krijime të para audiovizuale janë një gjurmë krijuese alternative e mendimeve dhe shqetësimeve të fëmijëve.

Aspekti krijues në përballjen me racizmin është veçanërisht i rëndësishëm. Së pari, fëmijët vizualizojnë një histori me karaktere në situata pabarazie. Ata futen në lëkurën e minoriteteve, të emigrantëve, të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe shohin gjëra nga kënvështrimi jo vetëm i “yni” por edhe i “atyre”, duke rritur kështu ndjeshmërinë e vet.

Së dyti, krijimi i një teksti audiovizual bazohet te puna në grup dhe respekti për mendimin e të tjerëve. Kjo mund të ofrojë mundësinë për nxënës të cilët më parë ishin përjashtuar si të ndryshëm, si marginalizuar, për tu angazhuar në mënyrë më aktive e kështu të pranohen më lehtë nga shokët e klasës. Projektet krijuese synojnë jo vetëm që tu japin nxënësve aftësi audiovizuale, por edhe të zhvillojnë mendimin kritik të tyre, për t’i angazhuar në situata që zgjidhin probleme e për t’i shndërruar në qytetarë aktivë (Torner, Vapis, 2010: 57).

Aktualisht, në klasat greke ka shumë fëmijë emigrantë, të cilët sigurisht e kanë të vështirë të asimilojnë gjuhën, problem që çon në vetëmargjinalizimin dhe degradimin. Krijimi i një teksti audiovizual nuk është luks por domosdoshmëri, në mënyrë që të reduktojë në mënyrë aktive fenomenin e përditshëm racist.

Duke patur këtë në mendje, në vitet 2010 – 2011 u krijua konkursi vjetor i filmave të shkollave “Enas Planitis Mia Efkairia”. Ky ishte një bashkëpunim i zyrës për arsimin fillor

në Serres, Televizionit Edukativ Grek dhe ERT-së në përpjekje për të inkurajuar nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të krijonin tekstet e tyre audiovizuale.

Aktualisht, në klasat greke ka shumë fëmijë emigrantë, të cilët sigurisht e kanë të vështirë të asimilojnë gjuhën, problem ky që çon në vetëmargjinalizimin e tyre. Krijimi i një teksti audiovizual nuk është luks por domosdoshmëri, në mënyrë që të reduktojë në mënyrë aktive fenomenin e përditshëm racist.

Duke patur këtë në mendje, në vitet 2010 – 2011 u krijua konkursi vjetor i filmave të shkollave “Enas Planitis Mia Efkairia”. Ky ishte një bashkëpunim i zyrës për arsimin fillor në Serres, Televizionit Edukativ Grek dhe ERT-së në përpjekje për të inkurajuar nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të krijonin tekstet e tyre audiovizuale.

Çështje kërkimore dhe mjete metodologjike

Do të ekzaminojmë retorikën audiovizuale që adoptuan nxënësit e shkollës fillore greke, për të artikuluar kontrastin racist “Ne” (dominues)/”Ata” (i dominuar). Si zgjodhën ata të portretizojnë secilën palë dhe cilat janë konotacionet e fshehura?

Gjithashtu, do të xjerrim në pah shfaqjen vizuale të marrëdhënieve tëqenësishme të forcës gjithashtu edhe zgjidhjet për të eliminuar racizmin. Në mënyrë që të arrihet analiza në thellësi, do të përdorim fotografime të izoluar nga tre pika të ndryshme të komplotit (Shfaqja e parë e “ne”/”ata”, konflikti, zgjidhja përfundimtare) të filmit që do të ekzaminojmë si shembull.

Teksti audiovizual që do të analizojmë, Sagkar Simainei Thalassa [Sagkar do të thotë Det, 2012] ishte bërë nga nxënës të Shkollës së 10të Fillore të Agios Dimitrios dhe fitoi çmim special honorifik gjatë konkursit të 2të “Enas Planitis Mia Efkairia”. Filmi ndjek një fëmijë të vogël me emrin Sagkar teksa përpiqet t’i përshtatet mjedisit të vështirë e ndonjëherë mizor të shkollës greke.

Si mjete metodologjike do të përdorim teoritë e Kress & Leeuwen-it dhe Roland Barthes-it. Fillimisht, Kress & Leeuwen sugjerojnë që komunikimi vizual, si formë e semiotikës sociale, përmbush disa kritere ose meta-funksione (Konceptualja fokusohet mbi përfaqësimin semiotik të botës së përjetuar; Ndërpersonalja ka të bëjë me lidhjen sociale që formohet midis krijuesit të një imazhi dhe shikuesit të tij; dhe Tekstualja fokusohet në zgjedhjet dhe aranzhimet brenda një imazhi, për shembull kompozicionin ose këndin e kameras, si dhe mesazhet e fshehur që transmetohen) (Kress & Leeuwen, 2006: 41-43).

Së dyti, Roland Barthes thekson që çdo imazh komunikon një dualitet mesazhesh. Mesazhi i paraqitur është analogjia ekzakte e realitetit që portretizohet dhe përbën nivelin e parë, ndërsa mesazhi i nënkuptuar është i dyti, nivel më i thellë i interpretimit dhe dekriptimit. Nënkuptimi bazohet në mënyrën se si shoqëria formon disa ide rreth një imazhi që ndikon mbi marrësin e mesazhit (Barthes, 1977: 17 – 19). Kombinimi i këtyre dy teorive do të na ndihmojë të ndjekim zgjedhjet retorike vizuale të fëmijëve mbi racizmin.

Analiza

Shfaqja e parë

Figura 1 Burimi Sagkar simainei Thalassa, 2011 – 2012

<https://www.youtube.com/watch?v=y1u3eDEcipc>



Në figurë [1] shohim Sagkarin, protagonistin kryesor të filmit. Plani mesatarisht afër e prezanton atë dhe kërkon të përfshijë audiencën në historinë e tij. Nga ana tjetër, plani është i pjerrët, duke nënkuptuar që kjo botë nuk është pjesë e botës së shikuesit dhe gjithashtu vështrimi nga këndi i lartë e ul Sagkarin e vogël në sytë tanë. Kompozicioni e vendos Sagkarin në të djathtë të kuadrit, duke treguar që ai është i ri dhe i rëndësishëm e që duhet t'i kushtojmë vëmendje. Veç kësaj, ai vihet qartazi në plan të parë, ndërsa zgjedhja e sfondit është në kontradiktë me të.

Figura 2 Burimi Sagkar simainei Thalassa, 2011 – 2012:

<https://www.youtube.com/watch?v=y1u3eDEcipc>



Duke parë nga afër mise en scene-a, hartat greke, shenja stop dhe shigjeta e kuqe që tregon daljen mund të ndezin kontrastin e “ne”/”ata”. Mund të supozojmë që sfondi në mënyrë interesante krijon një koment/paragykim etnik kundër veprimit në plan të parë. Natyrisht, Sagkar nuk i përket “ne”. Dallimet kulturore përplasen brenda jetës shkollore. Nëfund të fundit, a mos vallë racizmi është i natyreshëm te vetë imazhi?

Në figurë [2] shohim Sagkarin që sheh drejt kameras dhe i kërkon shikuesit të zhvillojë një marrëdhënie fantastike me të. Marrëdhënia theksohet njëkohësisht si nga plani i afërt, i cili angazhon shikuesin të thellohet më shumë në ndjenjat e tij ashtu edhe nga niveli i këndit të syve, i cili tregon mungesën e diferencës në forcë. Këto zgjedhje formojnë një lidhje të caktuar midis “ne” – shikuesit, dhe “atyre” – Sagkarit. A mund të bashkëzistojmë pa pabarazi? A mund t’i harrojmë diferencat mes nesh e të afrohemi me njëri-tjetrin?

Kompozicioni e vendos Sagkarin në qendër, duke konfirmuar që ai ka rëndësi informative. Megjithatë, sërish, sfondi përplaslet me planin e parë. Sagkari është integruar në jetën e shkollës dhe e shohim teksa ha me shokët e klasës. Duke parë me vëmendje, distanca nga shokët e klasës e ka izoluar. Gjithashtu, shohim qartë që shpinat e tyre të kthyer nga ai, madje edhe karriget në mes, krijojnë barriera vizuale.

Edhe nëse duam të afrohemi më shumë me Sagkarin, konotacioni këtu sugjeron fort izolimin. Sagkari i vogël po përpiqet t’i bashkohet një mjedisi që i ka kthyer shpinën. Qasja vizuale kërkon një marrëdhënie direkte me shikuesin, por kontrasti “ne”/”ata” pasqyrohet nëpërmjet konfliktit sfond/plan i parë. Në veçanti, mendja na thotë që në mënyrë të pavetëdijshme filmi shfaq shenja si të “neoracizmit” ashtu edhe të “racizmit modern”.

Konflikti

Figura 3 Burimi *Sagkar simainei Thalassa, 2011 – 2012:*
<https://www.youtube.com/watch?v=y1u3eDEcfc>



Në figurë [3] shohim vajzën që sheh te Sagkari. Ajo formon një vektor diagonal me sy nëpërmjet të cilit theksohet Sagkari. Poza e vajzës gjeneron një pozicion vizual force. Ajo dominon mbi Sagkarin që qëndron ulur dhe i përkulur. Po ashtu, vështrimi i saj përfaqëson të ashtuquajturin shikim etnik të “grupit dominues” mbi të “dominuarin”. Sagkar, në pozicionin poshtë, e pranon inferioritetin e vet. Padyshim që ky imazh projekton stereotipin e “dobësisë së dominuar”.

Plani mesatarisht i gjatë e vendos shikuesin në marrëdhënie personale të largët nga ajo çka po ndodh. Kjo shkëputje theksohet më tepër nga këndi i pjerrët i shikimit (duke treguar që ajo që shohim nuk është pjesë e botës sonë), dhe me kënd të lartë, i cili i zvogëlon protagonistët. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është vizualiteti i krijuar nëpërmjet kompozimit. Pemët përreth Sagkarit e theksojnë vetminë e tij dhe e izolojnë edhe më shumë, sikur të ishin hekura burgu. Mund të deduktojmë këtu predominimin e “ne”.

Zgjidhja/Pranimi

Figura 4 Burimi *Sagkar simainei Thalassa, 2011 – 2012:*

<https://www.youtube.com/watch?v=y1u3eDEcfc>



Në figurë [4] shohim një imazh bardh e zi kur pjesëmarrësit pozojnë për ne/shikuesit. Ata janë një shoqëri gazmore dhe e afërt. Mendja na thotë që pabarazia është hequr nga ana vizuale dhe Sagkari është tani anëtar i barabartë i grupit të fëmijëve. Vështrimet drejt në kamera artikulojnë kërkesën që shikuesi të hyjë në lidhje më të afërt me ta. Kjo marrëdhënie e re e barabartë përforcohet nga plani ballor (kjo botë është pjesë e botës së shikuesit) i imazhit, si dhe nga niveli i syve i cili tregon që nuk ka më diferencë në forca.

Një tjetër pikë kyçe për tu diskutuar është heqja e ngjyrave. Imazhi nostalgjik bardh e zi (kujtesë e fotografive të shkollës së vjetër të një epoke më të pafajshme) përdoret për të theksuar momentin e zgjidhjes drejt racizmit dhe përfundimin e konfliktit. Gjithashtu, kompozimi, e vendos grupin në qendër, në mënyrë që shikuesit të fokusohen te ata. Afërsia dhe uniteti i fëmijëve vizualizon pranimin e Sagkarit nga ata, por hekurat në sfond tregojnë që ka ende pengesa për këtë lloj marrëdhënieje.

Konkluzion

Për ta përmbledhur, nxënësit e shkollës fillore greke përshkruajnë në filma fenomenin e racizmit që njohin nga përvoja e tyre. duke përforcuar situatën aktuale në jetën shkollore. Racizmi është në kundërvënien e "ne"/"ata dhe fëmijët marrin pozicion të qartë kundër tij. Megjithatë, zgjedhjet vizuale, në mënyrë të pavetëdijshme, përfaqësojnë stereotipe dhe marrëdhëniet mes forcash. Gjithsesi, në tekstet audiovizuale, fëmijët kërkojnë mënyra vizuale për të larguar pabarazitë. Në fund, "ata" bëhen pjesë e "ne", duke pranuar plot respekt diversitetin. Duke patur parasysh këtë, është imperative që njohuritë audiovizuale të bëhen strategji e re dinamike kundër racizmit në shkollat greke.

Referenca

- Aggelidi A., Aletras N., et al., (2016). Stratigikoi Axones gia tin Eisagwgi tis Optikoakoustikis Ekpaideusis sto Sxoleio. (Strategic Priorities for the Introduction of Audiovisual Education in School) Retrieved on April 01, 2016 from:http://dialogos.minedu.gov.gr/wpcontent/uploads/2016/03/AudioVisual_Education_Group_March2016_NEW.pdf
- Barthes R., (1977). Image, Music, Text. New York: Hill and Wang.
- Bazalgette C (2009). Impacts of Moving Image Education. Glasgow: Scottish Screen.Retrieved on March 10,2015 from: http://www.scottishscreen.com/images/documents/ mie_research_summary.pdf
- Benedict R., (1983). Race and Racism. London: Routledge and Keegan Paul.
- Billig M., (1995).Banal Nationalism. London: Sage.
- Buckingham D., (2000). After the Death of Childhood Growing Up in the Age of Electronic Media. Cambridge: Polity Press.
- Byrd, C., (2011). Conflating Apples and Oranges: Understanding Modern Forms of Racism.Sociology Compass, 5, 11.
- ECRI., (2015). Report about Greece Strasbourg: Council of Europe.
- Enas Planitis Mia Efkairia Greek Contest: <http://dipe.ser.sch.gr/ysd/wordpress/>
- Greek Ombudsman (Synigoros tou Politi), (2013). To Fainomeno tis Ratsistikis Vias stin Ellada kai I Antimetopisi tou (The Phenomenon of Racist Violence in Greece and how it is combated). Athens: Synigoros tou Politi- Anexartiti Arxi.
- Hall S., (1997). Representation: A Cultural Representations and Signifying Practices. London:Sage.
- Henry P., (2010). Modern Racism. In Levine J. & Hogg M. (Eds.). Encyclopedia of Group Processes and Intergroup Relations. Pittsburg: Sage.
- Hughes M. & Kroehler C., (2007). Sociology: the Core London: McGraw-Hill.
- Kress G. & Leeuwen Th., (2006). Reading Images: The Grammar of Visual Design. New York:Routledge.
- Lentin. A., (2004). Racism and Anti-Racism in Europe. London: Pluto Press.
- Materman L., (1989). Teaching the Media. London: Routledge
- Sue D., Capodilupo C., Torino G. et al, (2007). "Racial Microaggressions in Everyday Life" in American Psychologist, May- June, Vol.62, 4.the Movie Sagkar simainei Thalassa, 2011-2012: <https://www.youtube.com/watch?v=y1u3eDEcfc>
- Theodoridis M. (2013). Programma Spoudwn gia tin Optikoakoystiki Ekfrasi (School Programfor Audiovisual Expression) Athens: Kentro Ekpaideutikwn Drasewn kai DiapolitismikisEpikoinwnias.
- Tornero J.M.P, Varis T., (2010). Media Literacy and New Humanism. Russian Federation:Unesco.
- Van Dijk T., (1993). Elite Discourse and Racism London: Sage.

MILID: Ndërhyrje e domosdoshme në luftë kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Jagtar Singh

India është vend pluralist. Ai është shembulli tipik i unitetit në diversitet. Por të rinjtë indianë nuk janë të imunizuar kundër radikalizimit dhe ekstremizmit për shkak të interesave që u siguron fuqia që vjen me to. Përveç adresimit të problemeve të varfërisë, papunësisë, diskriminimit, marginalizimit dhe përjashtimit të minoriteteve, të rinjtë indianë kanë nevojë të pajisen me aftësi në MIL. Njohuritë në media dhe informim dhe dialogu ndërkulturor (MILID) mund të shërbejnë si ndërhyrje e domosdoshme për shpëtimin e të rinjve të pafajshëm indianë nga tirania e radikalizimit dhe ekstremizmit. Kjo është provuar nga pjesëmarrësit në seminarin MIL për Ndërtimin e Kapaciteteve të mbështetur nga UNESCO, që u mbaj në Patiala nga 17 deri në 19 tetor 2016.

Fjalëkyç: Njohuri në media dhe informim, MILID, radikalizim, ekstremizëm i dhunshëm, TIK dhe mediat sociale, programe që u drejtohen të rinjve, konflikte fetare.

Trendet dhe tendencat

India është kulturë e përbërë nga 22 gjuhë, me 13 shkrime të ndryshme dhe mbi 720 dialekte. Ky vend është shembulli tipik i unitetit në diversitet. Por edhe këtu, hera herës shfaqen konflikte që bazohen mbi elementë linguistikë, rajonalë, fetarë, politikë dhe kulturorë. Madje as konflikte madhore si incidentet në Gujarat dhe shembja e Babri Masjid-it nuk e kanë ndalur shumicën e myslimanëve të cilët vazhdojnë të mbeten rryma kryesore në vend. B. Raman vëzhgon, “Komuniteti mysliman indian, pavarësisht se ndjehet i lënduar për shkak të dhunës antimuslimane masive në Gujarat, ka mbetur besnik, i bindur ndaj ligjit dhe me vështrimin përpara. Ata kanë ruajtur distancën nga Al Qaeda dhe Fronti Ndërkombëtar Islamik (IIF) e gjithashtu kanë zbrapsur qasjet e organizatave xhihadiste pakistaneze të rreshtuara me Al Qaedën”. Myslimanët e Indisë janë më rezistentë, por jo të imunizuar ndaj mesazhit radikal. Për shembull, bombardimet me email në New Delhi portretizojnë fotografinë e një myslimani që është marrë në revoltat antimuslimane në Gujarat, në vitin 2002. Email-i thotë, “Mos mendo kurrë që e kemi harruar shembjen e Babri Masjid-it dhe, për atë Allah, nuk kemi për ta harruar kurrë”. Seria e shpërthimeve me bomba në vitin 2008 nga terroristë anëtarë të Indian Mujahadeen (IM) dhe Lëvizja

e Studentëve Islamikë të Indisë (SIMI), në aleancë me Lashkar-e-Taiba (LeT) me qendër në Pakistan, si dhe dyshimet për përfshirje të Abu Jundal-it në sulmin terrorist të 11/26, ishte sinjali që India të kontrollonte trendet dhe tendencat e terroristëve në vend. (Krishna Kiran, 2012). Madje ndonjëherë shteti ka përdorur forcën për t'i detyruar minoritetet të vihen në një vijë me të tjerët. Shembja e Babri Masjedit dhe sulmi i Ushtrisë Indiane mbi Tempullin e Artë, Amritsar, janë shembuj tipikë të hegjemonisë së komunitetit madhor mbi komunitetet në minoritet në Indi.

Konfliktet fetare

Është e dobishme ta kuptojmë fenë si përgjigje e konteksteve historike, kulturore dhe gjeografike, se sa si koncept fiks. Po të flasim më gjerësisht, feja është shumtorja e variave që përfshijnë: praninë e besimeve në ekzistencën e një entitetit supernatyror ose Zot(a); shkrimet e shenjta; normat hyjnore dhe udhëheqjen morale të bazuar në shkrimet dhe/ose jetën ekzemplare të një figure profetike; simbolet; ritualet që bashkojnë individët si komunitet (shpesh nën udhëheqjen e një lideri); dhe një mori praktikash që shfaqin bindje ndaj këtyre normave dhe besimeve. Tipar veçanërisht i fuqishëm i besimit duket se është aftësia për të gjeneruar pikëpamje të fuqishme për botën, të cilat i shtyjnë individët t'i përkthejnë vlerat dhe besimet e tyre në jetën e përditshme, dhe të bëjnë lidhje kuptimplote që i kapërcejnë parametrat dhe institucionet tona vdekatare të limituara.

Identifikimi i një optike të përshtatshme për të kuptuar dhe trajtuar fenë në çështjet aktuale dhe diplomaci është i vështirë për shkak të evolucionit të debatit Perëndimor/Liberal mbi fenë dhe nocionin e sekularizmit në këto dy shekujte fundit. Ky debat supozon që mentaliteti laik është e vetmja rrugë për të siguruar lirinë, demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Supozime të tilla mund të shkaktojnë bllokime kur kërkojmë të hartojmë politika për tu lidhur me idetë fetare dhe grupet e bazuara në besim, sidomos në kontekste jo perëndimore. (Silvestri, 2016) Në Indi ka shumë fe dhe sekte. Ndaj nevoja e momentit, për të mundësuar bashkekzistencën paqësore, është dialogu ndërfeetar. Edhe pse kushtetuta e Indisë e specifikon qartë në Preambulën e saj që India është vend laik, shumë parti politike po përziejnë fenë me politikat për të materializuar motivet e veta politike. Kjo shumë herë çon në konflikte fetare. Alfabetizimi në media dhe informim dhe dialogu ndërfeetar janë përgjigja më e mirë kundër interesave të tilla.

Ajo kërkon gjithashtu angazhim përtej “të dyshuarve të zakonshëm”: liderëve fetarë, institucioneve ose grupeve që mburren në emër të një feje, ose pretendojnë se punojnë për një kauzë haptazi fetare. Natyrisht, këta aktorë nuk duhen injoruar. Në fakt, shpesh elitat fetare kanë rol të privilegjuar në konflikte dhe pajtim; shpesh ato zotërojnë një status të respektuar social, lidhje të zgjeruara sociale, kuptojnë mjaft mirë kontekstin kulturor-historik-fetar, dhe zotërojnë aftësi të shkëlqyera komunikimi. Kjo do të thotë që ata janë në gjendje të mobilizojnë burime dhe njerëz për përshkallëzimin e konfliktit ose për proceset transformuese të paqes, në varësi të kontekstit. Megjithatë, shpesh këto elita mund të kenë përfitime e interesa personale dhe të udhëhiqen nga synimi për pushtet. Një fokus i tillë neglizhon idetë, zërat dhe praktikat e minoriteteve e të atyre që konkurojnë, të aktorëve më pak të fuqishëm të angazhuar në grupe jo të organizuar dhe jo hegjemonistë. Ky angazhim

i zgjeruar mund të japë gjithashtu sensin e qartë të aspiratave dhe pakënaqësive të atyre që mund të kenë të njëjtin besim fetar por e distancojnë veten nga përgjigje specifike politike të ndërmarra në emër të fesë. (Silvestri, 2016). Në Indi, ndonjëherë liderët fetarë nxisin emocionet e masave gjë që çon në situata konfliktuale. Në qoftë se arrijmë të mundësojmë të rinjtë me aftësi MIL, situata të tilla mund të shmangen fare lehtë.

Diskriminimi dhe marginalizimi

Raporti i Sachar Committee pohon që 50% e myslimanëve indianë janë analfabetë dhe jetojnë nën kufirin e varfërisë. India ka 150 milion myslimanë, por vetëm 4% janë diplomuar, 5% janë punësuar në sektorin qeveritar dhe edukimi i tyre është mjaft i limituar. Një akses i tillë kaq shumë i kufizuar te dija ka rritur zemërimin dhe antipatinë të rinjtë myslimanë dhe i hap rrugën ekstremizmit dhe terrorizmit. Për shembull, IM ka preferuar Biharin Verior si vend i mirërekrutimi për operativë të zgjedhur nga të rinjtë papunë të familjeve jashtëzakonisht të varfra. Ajo gjeti mbështetje shumë të gjerë nga rinia e papunë myslimane. (Krishna Kiran, 2012). Varfëria, analfabetizmi, papunësia, diskriminimi dhe marginalizimi i minoriteteve duhen trajtuar në nivel qeveritar. Përndryshe, rinia bëhet target i lehtë për radikalizim. MILID-i duhet promovuar përtej kufijve për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Në vend të varfërisë së sipër përmendur dhe situatës së analfabetizmit, në Indi ka një tjetër dimension për terrorizmin. Në përgjithësi, ekziston nocioni që myslimanët jo të privilegjuar, të ngulitur dhe influencuar nga grupe të debatit radikal dhe të mbështetur nga Pakistani janë thithur në aktivitete terroriste. Virtualisht, mjaft terroristë vijnë nga familje në gjendje të mirë dhe kanë arsim të nivelit universitar. Që mbas arrestimeve për shpërthimet e vitit 2003 në Mumbai, është demonstruar që varfëria nuk është terreni primar që ushqen terroristët. Nga 23 të arrestuarit, një ishte student doktore, njëri me Master në Administrim Biznesi, pesë ishin inxhinierë, tre fizikanë dhe dy të diplomuar në kolegji. Më vonë u arrestuan edhe një inxhinier i aereonautikës, dy kimistë dhe një teknik kompjuterash. Ajo çka është interesante, të gjithë këta terroristë janë manifestim i vetëdijes radikale mes klasës së mesme në Indi. Këta myslimanë të shkolluar nuk ishin materialisht të dëshpëruar; ata ishin të zhgënjyer si për arsye sociale ashtu edhe fetare. Ata janë të ndjeshëm ndaj leksikut stimulues të grupeve të papërshtatshme dhe gjykojnë që dhuna është e pranueshme kur ka një *raison d'être*. (Krishna Kiran, 2012). Kjo do të thotë që në qoftë se njerëzit diskriminohen nga forca hegjemoniste, dhimbja rritet dhe ata i bashkohen forcave antisociale.

Është domethënëse të shohësh prejardhjen e personave të akuzuar si të përfshirë në sulme terroriste në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Situata kritike e palestinezëve, ndërhyrja sovjetike në Afganistan, sulmi i Amerikës mbi Irakun, inkursioni amerikan në Afganistan, polemikat për karikaturat daneze etj. në nivel ndërkombëtar, apo ato në plan të brendshëm, incidente të tilla si trazirat komunale në Maharashtra në verën e vitit 1984, dhe dhuna brutale antimyslimane në vitin 1986, shembja e Babri Masjid-it në dhjetor 1992, revoltat në Gujarat në vitin 2002, dhe refuzimi i vizave nga ana e Ambasadës Amerikane për myslimanët e kualifikuar, mund të jenë disa prej të ashtuquajturave ankesa nga ana e

të rinjve myslimanë. Është logjike që shpesh radikalizimi ka në bazë shqetësime personale dhe jo thjeshtë irritimin për ngjarjet ndërkombëtare. Qeveria indiane duhet t'i kundërvihet rrugës së ndjekur nga këta terroristë të shkolluar nëpërmjet dialogut dhe një debati të hapur ideologjik. (Krishna Kiran, 2013). Dialogu ndërkulturor dhe ndërfaqësor është strategjia më e mirë për të futur në hulli adoleshentët dhe të rinjtë e mashtruar.

Alfabetizimi në Media dhe Informim

Universiteti Patiala i Punjabi-t organizoi me Mbështetjen e UNESCO-s dhe në bashkëpunim me Rrjetin e Universiteteve për Alfabetizim në Media dhe Informim të Indisë (MILUNI), një Workshop për Ngritjen e Kapaciteteve MIL për Organizatat Rinore në Indi. Këtu u nënshkrua një kontratë me UNESCO-n, në të cilën theksohet se aksioni kyç i strategjisë së UNESCO-s për promovimin e shoqërive të dijes, duke mbështetur “zhvillimin e mediave të lira, të pavarura e pluraliste, si dhe aksesin universal të informacionit për një qeverisje të mirë”, qëndron te konsolidimi i njohurive mediatike, si dhe i kompetencave ndërkulturore të organizatave të rinjve, mësuesve dhe palëve të tjera të interesuara. Ky aktivitet është komplementar me atë të Kursit të Hapur Online për nivelin filleshtar në MIL (MIL MOOC), nismë kjo e UNESCO-s. Kjo bëhet me shpresën për të krijuar një lidhje mes organizatave të rinjve në të gjithë botën e për të promovuar MIL-in në nivel global. Kjo, bashkë me shtrirjen e MIL MOOC në shumë gjuhë të ndryshme, si dhe bashkëpunimin mes universiteteve në të gjithë botën, ka si objektivi të kontribuojë në forcimin e dialogut ndërkulturor, paqes, mirëkuptimit, të promovojë të drejtat e njeriut (përfshirë ato online), lirinë e shprehjes, duke luftuar urrejtjen, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, etj. Nocioni i unifikuar thekson gjithashtu rëndësinë e të kuptuarit të MIL-it si thelbësor për prodhimin e dijes për qytetari demokratike, nxënie dhe qeverisje të mirë. Këtu nënkuptohet që Liria e Shprehjes dhe Liria e Informacionit janë konceptet thelbësore të MIL-it. (UNESCO, 2016).

Liria e shprehjes

Kushtetuta e Indisë siguron të drejtën e lirisë, të dhënë nga nenet 19, 20, 21 dhe 22, nga pikëpamja e garantimit të të drejtave individuale që konsideroheshin jetike nga hartuesit e kushtetutës. E drejta për liri në Nenin 19 garanton Lirinë e Fjalës dhe të Shprehjes, si një nga gjashtë liritë e saj. E Drejta për Informim (RTI) është Akt i Parlamentit të Indisë “për të mundësuar ngritjen e regjimit praktik të së drejtës për informim të qytetarëve” dhe zëvendëson Aktin 2002 të Lirisë së Informimit të vlefshëm më parë. Por këto të drejta mund të ushtrohen vetëm nëse qytetarët indianë bëhen të vetëdijshëm për këto të drejta. MIL-i mund të bëjë mjaft për të fuqizuar njerëzit në Indi me beneficin e këtyre të drejtave.

Politikat kombëtare për rininë

Politikat Kombëtare për Rininë (NYP) 2014 të Ministrisë së Çështjeve Rinore dhe Sporteve të Qeverisë së Indisë nënvizojnë qartazi që “Është thelbësore që qeveria të vazhdojë të promovojë barazinë në sistemin formal dhe të fokusohet në përfshirjen e të rinjve të pafavorizuar nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Qeveria e Indisë duhet të rishikojë programet e saj aktuale për këta të rinj dhe të identifikojë se ku kanë qenë efektive këta programe e ku kanë dështuar, si dhe arsyet për këtë. Një faktor kyç që mendohet se kontribuon në pjesëmarrjen e të rinjve në konfliktet e dhunshëm dhe ekstremizëm është mungesa e oportuniteteve të jetesës. Kështu, është thelbësore të sigurohet që këtyre të rinjve t’u ofrohen mundësi për të siguruar jetesën. Në terma afatgjatë, një program i tillë i zhvillimit të infrastrukturës për aksesin dhe ndërgjegjësimin, mund të parandalojë që të rinjtë të tërhiqen nga veprimtari të tilla. Ndonëse qeveria po punon për të krijuar sisteme mbështetëse dhe rehabilitimi për të rinjtë e rrezikuar, është thelbësore që në të njëjtën kohë të ndërtohen sisteme të cilët bëjnë të mundur që këta të rinj të mos lejohen n ta fusin veten në situata që mund të sjellin rreziqe fizike ose mendore për ta. Kjo kërkon të hartohet me prioritet një program që të ketë në qëndër ndërgjegjësimin për të rinjtë që i përkasin kësaj fashe në rrezik. Është e rëndësishme të sigurohet që të rinjtë, pavarësisht nga prejardhja, të jenë të lire nga diskriminimi dhe stigma dhe të kenë mundësi t’i drejtohen një sistemi gjyqësor të shpejtë dhe të barabartë. Është gjithashtu e rëndësishme një përpjekje që është bërë për përfshirjen e grupeve të pafavorizuara nëpërmjet aksionit afirmativ dhe programeve të tjera të targetuar. Gjithashtu, ka nevojë për monitorim më të madh dhe vëmendje mediatike për të parandaluar praktikën e paligjshme sociale si prikati, martesat e fëmijëve, vrasjet për nder, diskriminimin mbi bazën e kastës dhe stigmatizimin e të rinjve LGBTB”.

Programe për sensibilizimin e të rinjve

Kështu, është e rëndësishme të krijohen sisteme edukimi dhe transformimi moral në nivel bazë për eliminimin e praktikave të stigmatizimit dhe diskriminimit, si dhe për të mundësuar drejtësi sociale për të gjithë. Rinia e vendit mund të përdoret për të ngritur ndërgjegjësimin dhe për të siguruar edukimin në mënyrë që të eliminohen praktikën e padrejta sociale. Jo vetëm kaq, rinia mund të trajnohet gjithashtu për të monitoruar dhe raportuar mbi prevalencën e praktikave të padrejta sociale në bazë. Individëve duhet t’u jepet akses më i fuqishëm te drejtësia formale në të gjitha nivelet. Duhet të rritet shpejtësia e gjyqësorëve, në mënyrë që ndëshkimi formal të veprojë si dekurajues serioz. Përpjekje duhen bërë mbi vështirësitë aktuale dhe pengesat në nivelin bazë si dhe të ndërmeren veprimet e duhura. Është thelbësore të monitorohet dhe vlerësohet suksesi i NYP-2014 në mënyrë që të kuptohet impakti i politikave për të rinjtë dhe të përcaktohen strategjitë që do të ndiqen në të ardhmen.

TIK dhe Mediat Sociale

Duke patur parasysh diversitetin e vendit dhe nevojën për të adresuar nevojat specifike rajonale, si dhe shqetësimet e të rinjve që nuk janë reflektuar siç duhet në NYP-2014, çdonjëri nga shtetet duhet të parashtrorë Politikat e veta Shtetore për Rininë, duke ruajtur perspektivën e përgjithshme kombëtare të përcaktuar nëNYP-2014. Në dritën e faktit që shumë prej Ministrive të Qeverisë së Indisë kanë komponentë të rëndësishëm të politikave dhe programeve të tyre që janë relevante për rininë, është imperative një qasje ndërsektoriale për trajtimin e çështjeve rinore. Duke pasur këtë parasysh, NYP-2014, në përputhje me sugjerimin e bërë në dokumentet e mëparshme të Politikave, mbështet krijimin e një mekanizmi koordinues në nivel qendror dhe të shteteve të veçanta. Komiteti Koordinues Shtetëror mund të drejtohet nga Kryeministri i vendit ose një prej anëtarëve më të vjetër të kabinetit. Kjo do të sigurojë përdorimin optimal të burimeve të disponueshme me ministrinë dhe departamentet e ndryshme si dhe riorganizimin e ndërhyrjeve në politika dhe programe. TIK dhe mediat sociale janë mjete që mund të ndihmojnë për tu lidhur me të rinjtë. Duke patur parasysh penetrimin në rritje të internetit mes të rinjve, sidomos në formën e telefonëve inteligjentë, Qeveria e Indisë duhet të angazhohet në mënyrë më aktive me teknologjitë e përdorura nga të rinjtë e që ata i aksesojnë çdo ditë. Qeveria indiane duhet të iniciojë një Program premtues për Angazhimin e Komunitetit (CEP) për të riintegruar grupe si IM dhe SIMI, që po kultivojnë terroristë në shoqërinë e shëndoshë indiane. Në vende të tilla ku fshihen terroristë qeveria indiane duhet prezantojë “politika të dorëzimit dhe rehabilitimit”, dhe duhet të ndërmarrë një plan për këshillimin e të dënuarve dhe të familjarëve të të dënuarve, si dhe gjithashtu të asistojnë në rehabilitimin e këtyre familjeve. Formimi i politikave të tilla do të ndihmojë për ngritjen e një bashkëpunimi të ngushtë midis qeverisë indiane dhe komunitetit mysliman në luftën kundër terrorizmit. Ajo do të çojë drejt krijimit të një marrëdhënieje pune midis personelit të sigurisë dhe komunitetit mysliman. Një mënyrë e tillë për angazhimin e komunitetit ndihmon në marrjen e informacionit të inteligjencës për të parë prirjet dhe afinitetin e terrorizmit të brendshëm. Qeveria duhet të përdorë rininë myslimane laike, patriotike dhe inteligjente, dhe disa nga aktivistët e shkolluar nga IM dhe SIMI, që janë kapur dhe arrestuar, duhet të binden e mund të përdoren si inteligjencë njerëzore (HUMINT) për të depërtuar në grupet terroriste . Ata mund të futen në organizatat terroriste për të mbledhur informacion të besueshëm dhe të saktë mbi veprimtaritë terroriste.

“Politika e dorëzimit dhe rehabilitimit” si dhe angazhimi i myslimanëve në HUMINT është shumë i vështirë. Sipas Byrosë së Inteligjencës (IB), xhihadistët i përkasin myslimanëve sunitë të cilët i janë besnikë ideologjive Wahhabi dhe Salafi. Për këtë arsye, IB ka një akses shumë të limituar në komunitetin mysliman dhe pavarësisht përpjekjeve të shumta, nuk ka qenë e mundur të tërheqë kandidatë myslimanë në nivelin e përparuar të IB-së. Megjithatë, veprimtaritë e qeverisë indiane mendohet të jenë planifikuar për të fituar “zemrat dhe mendjet” në mënyrë të atillë që të ndikojë mbi besimin e tyre, sjelljen, qëndrimin dhe opinionin në rrugën drejt suksesit të detyrës së ndërmarrë nga agjencitë e sigurisë të implikuara në luftën kundër terrorizmit. Shoqëria myslimane indiane në rrethana të tilla mund të luajë një rol kritik, duke siguruar një platformë ku të ngrihen ankesat fetare, ekonomike dhe politike dhe për të lehtësuar debatin dhe dialogun.

Myslimanët indianë janë audiencia së cilës i drejtohen terroristët e brendshëm. Frikësimi i tyre duke vrarë hindutë me anë të shpërthimeve me bomba për të përdorur frikën, duke krijuar konflikte midis hinduve dhe myslimanëve, është tipari kryesor i terrorizmit të brendshëm. Megjithatë, në shumë nga shpërthimet viktimat nuk kanë qenë vetëm hindu por edhe myslimanë, të cilët janë aktorët e pozicionuar më mirë në luftën kundër terrorizmit të brendshëm. Qeveria indiane duhet të marrë në konsideratë rëndësinë e viktimave të komunitetit mysliman dhe rolin e tyre në luftën kundër terrorizmit të dhundhëm të brendshëm nëpërmjet një Programi për Angazhimin e Komunitetit (CEP) në fuqizimin e viktimave dhe të të mbijetuarve që i përkasin komunitetit mysliman.

India mund të përfitojë shumë nga një program CEP, i cili mund të luajë rol qendror në mënyra të shumta, nëpërmjet punës së tij në transformimin e konfliktit si dhe punës në programe për zhvillim ekonomik dhe social. Është pikërisht momenti i duhur për të ndërmarre menjëherë hapa drastike për të integruar e për tu përballur me frikën e terrorizmit dhe për të reduktuar pasojat negative duke promovuar lehtësimin dhe një qasje për manaxhimin e frikës në luftë kundër terrorizmit. Ekstremizmi ose terrorizmi i brendshëm nuk e ka gllabëruar Indinë sikurse ka ndodhur në disa vende të tjera si Algjeria, Egjipti, Pakistani dhe Arabia Saudite. (Krishna Kiran, 2013).

Ndërhyrja MILID

Alfabetizimi në media dhe informim bashkë me dialogun ndërkulturor dhe ndërfetar mund të bëjnë shumë për të siguruar paqen dhe progresin në Indi. Rinia dhe organizatat e drejtuara nga të rinjtë mund të luajnë rol esencial në integrimin e njohurive në media dhe informim në punët me praktikatat e tyre të përditshme. Kohët e fundit, Universiteti Patiala i Punjabi-t organizoi me Mbështetjen e UNESCO-s një Workshop për Ngritjen e Kapaciteteve MIL për Organizatat e drejtuara nga Rinia në Indi nga data 17 deri në 19 tetor 2016. Në këtë workshop morën pjesë gjashtëdhjetë liderë të organizatave rinore dhe të udhëhequra nga të rinjtë, nga pesë zona të ndryshme të Indisë. Liderët rinorë u trainuan në thellësi me dije, aftësi dhe qëndrime që i përkasin njohurive në media dhe informim. U hartua një Draft i Politikave për MIL-in dhe Udhëzime Strategjike për të informuar Politikat Kombëtare Rinore 2014 të Qeverisë së Indisë të cilat ka të ngjarë të rishikohen në vitin 2019. Ky draft do t'i dërgohet gjithashtu UNESCO-s. Udhëheqësit rinorë ishin gjithashtu shumë entuziastë që iu bashkuan kursit MIL MOOC të ofruar nga UNESCO. Në të njëjtën mënyrë, Z. Stanzin Dawa, Drejtor Rajonal i Institutit Kombëtar për Zhvillim Rinor Rajiv Gandhi, Chan-digarh (një institut i ngritur nga Ministria për Çështjet Rinore dhe Sportet e Qeverisë së Indisë (GOI)) ranë dakord të shërbejnë si pika ndërlidhëse për promovimin e njohurive në media dhe informim mes të rinjve në Indi. Për këtë u krijua një forum virtual për njohuri në media dhe informim si dhe për dialog ndërkulturor. Liderët rinorë ranë gjithashtu dakord të formojnë një "Aleancë Kombëtare të Organizatave Rinore" për të promovuar njohuritë në media dhe informim, e gjithashtu për të zhvilluar një partneritet me GAPMIL-in, Kapitullin për Azi-Pacifik të GAPMIL-it, dhe Rrjetin Universitar për Njohuri në Media dhe Informim të Indisë (MILUNI). Sot anëtarësimi në MILUNI është shtrirë në 15 universitete të Indisë. Ky është efekti valëzim nga vetëm

njëWorkshopi për Ngritje të Kapaciteteve në MIL për organizatat e udhëhequra nga rinia në Indi. Ky është vetëm hapi i parë në drejtimin e duhur të përdorimit të MILID-it në luftë kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Viti 2016 ishte viti i parë i Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Janë 17 objektiva sikurse renditen më poshtë:

1. Objektivi 1. T'i jepet fund varfërisë në të gjitha format e saj.
2. Objektivi 2. T'i jepet fund urisë, të arrihet siguria e ushqimit dhe të përmirësohet të ushqyerit, të promovohet bujqësia e qëndrueshme
3. Objektivi 3. Të sigurohet jetesë e shëndetshme dhe të mbështetet mirëqenia për të gjithë në të gjitha moshat
4. Objektivi 4. Të sigurohet arsim gjithëpërfshirës dhe i barabartë e cilësor, të mbështeten mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës
5. Objektivi 5. Të arrihet barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe i vajzave
6. Objektivi 6. Të sigurohet disponueshmëria dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe i kanalizimeve për të gjithë.
7. Objektivi 7. Të sigurohet akses te energjia moderne e përballeshme, e besueshme dhe e qëndrueshme për të gjithë
8. Objektivi 8. Të promovohet rritje ekonomike e qëndrueshme dhe inkluzive, punësim i plotë dhe produktiv, si dhe punë e përshtatshme për të gjithë
9. Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturës elastike, promovimi i industrializimit inkluziv dhe të qëndrueshëm dhe mbështetja e inovacionit
10. Objektivi 10. Reduktimi i pabarazisë
11. Objektivi 11. Qytetet dhe ngulimet e njerëzve të bëhen gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme
12. Objektivi 12. Të sigurohet konsumi i qëndrueshëm dhe modelet e prodhimit
13. Objektivi 13. Të merren masa urgjente në luftë kundër ndryshimeve klimaterike dhe impakteve të tyre*
14. Objektivi 14. Të konservohen e të përdoren në mënyrë të qëndrueshme oqeanet, detet dhe burimet ujore për zhvillim të qëndrueshëm
15. Objektivi 15. Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër dezertifikimit, ndalimi dhe kthimi mbrapsht i degradimit të tokës dhe pengimi i humbjes së diversitetit.

16. Objektivi 16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurohet akses te drejtësia për të gjithë dhe ngritja e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.
17. Objektivi 17. Të fuqizohen mjetet e implementimit dhe të rivitalizohet partneriteti global për zhvillim të qëndrueshëm

Midis objektivave dhe prioriteteve të Politikave Kombëtare Rinore (NYP dhe SDG-ve ka një fill të përbashkët. Liderët e të rinjve janë sensibilizuar në mënyrë sistematike dhe ngarkuar për objektivat dhe prioritetet e NYP-së e gjithashtu edhe për SDG-të. Kjo duket qartë nga komentet e pjesëmarrësve në workshop.

Përfundim

Thelbi i diskutimit të mësipërm është që rinia ka energji të jashtëzakonshme, e cila duhet kanalizuar në drejtimin e duhur. Alfabetizimi në media dhe informim dhe dialogu ndërkulturor mund të shërbejnë si një ndërhyrje e domosdoshme për përforcimin e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit. Kjo del qartë nga rezultatet dhe komentet e Workshopit për Ngritjen e Kapacitetve MIL për Organizatat e udhëhequra nga Rinia në Indi që u organizua në Universitetin Patiala të Punjabi-t.

Referenca

- Allan, H., Glazzard, A., Jespersen, S., Reddy-Tumu, S. and Winterbotham, E. (2015). *Drivers of violent extremism: Hypotheses and literature review*. London: Royal United Services Institute.
- Borum, R. (2011). *Radicalization into violent extremism II: A review of conceptual models and empirical research*. *Journal of Strategic Security*, 4(4): 37-62.
- Cavanaugh, W. T. (2004). *The Violence of "Religion": Examining a Prevalent Myth.*, Working Paper no. 310. Indiana, USA: The Helen Kellogg Institute for International Studies.
- Duffy Toft, M. (2007). *Getting Religion? The puzzling case of Islam and civil war*. *International Security*, 31(4): 97-131.
- Francis, M. (2012). *What causes radicalisation? Main lines of consensus in recent research*. *Radicalisation Research*. Lancaster, UK: Lancaster University.
- Gelfand, M., LaFree, G., Fahey, S. and Feinberg, E. (2013). *Culture and extremism*. *Journal of Social Issues*, 69 (3): 495-517.
- Glazzard, A. and Zeuthen, M. (2016). *Violent extremism*. GSDRC Professional Development Reading Pack no. 34. Birmingham, UK: University of Birmingham. Retrieved from: <http://www.gsdrc.org/professional-dev/violent-extremism/>
- Godbole, M. (2016). *Secularism: India at a Crossroads*. New Delhi: Rupa. p.1.Ibid. p.30. India. Ministry of Youth Affairs & Sports. *National Youth Policy 2014*. Retrieved from: http://www.rgniyd.gov.in/sites/default/files/pdfs/scheme/nyp_2014.pdf
- Institute for Economics and Peace. (2015). *Global Terrorism Index 2015: Measuring and understanding the impact of terrorism*. Sydney, Australia: IEP.

- Khalil, J. and Zeuthen, M. (2014). *A Case Study of Counter Violent Extremism (CVE) Programming: Lessons from OTI's Kenya Transition Initiative*. *Stability: International Journal of Security & Development*, 3(1), p.Art. 31. Doi: <http://doi.org/10.5334/sta.ee>
- Kiran, K. R. B. (2012). Radicalization, Terrorism and Community Engagement in India-I. Retrieved from: http://www.sspconline.org/opinion/Radicalization_Terrorism%2526CommunityEngagement_India_31122012%20
- Kiran, K. R. B. (2013). Radicalization, Terrorism and Community Engagement in India - II. Retrieved from: http://www.sspconline.org/opinion/Radicalization_TerrorismCommunityEngagement_India_10012013#.V9WSO5tmDfo.gmail
- Philpott, D. and Cox, B. (2006). *What faith-based diplomacy can offer in Kashmir*. In D. Smock (Ed.), *Religious contributions to peacemaking: When religion brings peace, not war*. Washington DC, USA: US Institute of Peace. Radicalisation Awareness Network. (2016). *Preventing radicalisation to terrorism and violent extremism: Approaches and practices*. The Netherlands: Radicalisation Awareness Network.
- Schmid, A. P. (2014). *Violent and non-violent extremism: Two sides of the same coin*. ICCT Research Paper. The Hague: International Center for Counterterrorism (ICCT).
- Sedgwick, M. (2012). *Radicalism isn't the problem: it's the move to violence we need to counter*. Lancaster/London: Westminster Faith Debates.
- Silvestri, S. (2016). *Religion and conflict*. GSDRC Professional Development Reading Pack no.30. Birmingham, UK: University of Birmingham. Retrieved from: <http://www.gsdr.org/professional-dev/religion-and-conflict/>
- Silvestri, S. and Mayall, J. (2015). *The role of religion in conflict and peace building*. London, UK: British Academy.
- Smock, D. (2006). *Introduction*. In D. Smock (Ed.), *Religious contributions to peacemaking: When religion brings peace, not war*. Washington DC, USA: US Institute of Peace.
- Thomas, S. (2010, November/December). *A Globalized God*. *Foreign Affairs*.
- USAID. (2011). *The development response to violent extremism and insurgency*. USAID Policy. Washington D.C.: USAID.
- Wolffe, J. and Moorhead, G. (2014). *Religion, security and global uncertainties*. Milton Keynes: The Open University.
- UNESCO (2016). *Contract No. 4500303563*. Paris: UNESCO
- United Nations. Department of Economic and Social Affairs. Sustainable Development Knowledge Platform. <https://sustainable.development.un.org/post2015/transforming-our-world>

Twitteri si Pëllumb në Zi për Gonxhet e Sapoçelura: Analizë e Reagimit të Twitter-it ndaj Sulmit në Shkollë në Peshawar

Sumeer Gul & Sheikh Shueb

Media sociale në kohën e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu shihet si platformë potenciale për të shkëmbyer informacion, për të publikuar opinione dhe promovuar fushata. Ajo pasqyron opinionet e ndjenjat e publikut dhe vepron si agjent i ndryshimit për masat. Media sociale ofron një rrjet të dendur komunikimi, dhe vepron në mënyrë komplementare me mediat tradicionale, duke u dhënë mundësi përdoruesve të marrin informacion për komunitetin, familjen dhe miqtë e tyre gjatë krizave. Ajo ka marrë vëmendje të konsiderueshme nga bota shkencore, pasi mundëson analizat multidimensionale të çështjeve me një vlerësim në kohë reale dhe akses të zgjeruar. Si e tillë, është e nevojshme të eksplorohej mënyra se si ajo përdoret nga njerëzit që përballen me situata emergjence, si i shprehin ata ndjenjat e tyre dhe se si reagon audienca globale. Në peizazhin që ndryshon të mediave sociale, Twitter, njëri nga shërbimet mikro-bloguese, është shfaqur si një burim i rëndësishëm informacioni. Jo shumë larg në kohë, një nga sulmet më vdekjeprurëse në Pakistan, "Sulmi në një shkollë në Peshawar" që ndodhi në 16 dhjetor 2014, me 141 vetë të vdekur, nga të cilët 132 fëmijë, tërhoqi një lumë reagimesh anembanë globit në mediat sociale, duke përfshirë Twitter. Studimi kryen analiza sasiore dhe cilësore të përmbajtjes së tuiteve të postuar pas masakrës në shkollë. Studimi zbulon se 37.2 % e reagimeve janë të natyrës emocionale e më pas vijnë ata që ngrenë pyetje. Çuditërisht, tuitet janë kryesisht nga SHBA-ja, pasuar nga Pakistani dhe Britania e Madhe, ku pjesa më e madhe e atyre emocionale janë nga Pakistani. Megjithatë, duket se sulmi ishte më tronditës për komunitetin global se për Pakistanin vetë. Gjithashtu, në masë të madhe që shprehin protestë vinin më shumë nga jashtë se sa nga vetë Pakistani.

Fjalëkyç: media sociale, sulme terroriste, masakër e fëmijëve, analizë e sentimentit

Hyrje dhe historiku

Ndjenja e humbjes që vjen nga vdekja e një njeriu të dashur ose të njohur është e dhimbshme dhe evokon te individët një shumëllojshmëri emocionesh, përfshirë trishtimin, shokun, zemërimin dhe fajin (Kubler-Ross, 1969). Gjithkush, kur është i trishtuar, ka nevojë për mbështetje sociale, që të ndajë problemet e të lehtësohet. Janë bërë studime të shumta për të nxjerrë në pah rëndësinë e suportit social në momente pikëllimi (Cohen & Hoberman, 1983; Di Giulio, 1995). Më parë suportit social kufizohet vetëm në ndërveprimin ballë për ballë, por me futjen e teknologjive të bazuara në web, u zhvillua filozofia e suportit virtual dhe niveli i ndërveprimit midis elementëve të ndryshëm të shoqërisë u bë më i dukshëm për shkak të sistemeve online të suportit social, si për shembull mediat sociale. Në mbarë globin njerëzit e përdorin këtë platformë interaktive për të shprehur ndjenjat dhe sentimentet, qofshin këto zemërim, lumturi, keqardhje, hidhërim ose dhimbje. Sistemet online të suportit social si Facebook dhe Twitter kanë fituar më shumë popullaritet sepse bazohen fort te përdoruesi dhe kanë evoluar si platforma të suksesshme të familjes së mediave sociale, sepse shprehin sentimentet njerëzore, përfshirë hidhërimin dhe keqardhjen. Ato janë bërë platformat unike të komunikimit për zinë. Në mënyrë të pashmangshme njerëzit përjetojnë dhimbje mbas vdekjes së një miku të ngushtë, një të afërmi ose njeriu të dashur (Bonanno & Kaltmann, 2001). Në mjaft raste zia është private dhe zakonisht e kufizuar te antarët e familjes, e ndoshta te miqtë e ngushtë dhe bashkëpunëtorët. Megjithatë, mund të ketë zi publike në lidhje me vdekjen e një personi me popullaritet, zyrtari të lartë të qeverisë, individëve të mirënjohur, e madje edhe mes të huajve që në njëfarë mënyre kanë një lidhje me komunitetin (Brennan, 2008). Hulumtimet për zinë publike kanë treguar që vdekja e një figure publike, mund të jetë njësoj e stresueshme dhe emocionale (Fu dhe Yip, 2007; Goh & Lee, 2011; Sheridan, North, Maltby & Gillet, 2007), duke prekur njerëz përtej atyre të përfshirë drejtpërdrejt në një komunitet të caktuar. Prania e sistemit të suportit social luan rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit të dhimbjes brenda një komuniteti duke përballuar stresin pasi gjithkush është në gjendje të shprehë ndjenjat e veta (Massimi & Baecker, 2010). Përfitimi më i madh nga sistemet e suportit social online është se ata nuk janë të kufizuar nga limitimet kohore dhe ato gjeografike.

Masakra në shkollë në Peshawar, në vitin 2014

Në 14 dhjetor 2014, shtatë burra të armatosur, anëtarë të Tehrik-i-Taliban (TTP), kryen një sulm terrorist në një Shkollë Ushtarake Publike në Peshawar, qytet ky në veriperëndim të Pakistanit. Ata hynë në shkollë dha hapën zjarr mbi stafin e shkollës dhe fëmijët, duke vrarë 141 vetë, përfshirë 132 fëmijë të shkollës të moshave nga tetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Ky ishte sulmi terrorist më vdekjeprurës që kishte ndodhur në Pakistan, duke ia kaluar edhe sulmit në Karsaz, në vitin 2007. Sipas agjencive të lajmeve dhe komentuesve, natyra dhe përgatitja e sulmit ishin shumë të ngjashme me krizën e pengjeve në shkollën e

Beslanit, në Osetinë Veriore – në rajonin Alania të Federatës Ruse, në vitin 2004 (Masakra e shkollës në Peshawar në vitin 2014, 2016). Kasaphana te të pafajshmit tronditi jo vetëm Pakistanin por botën mbarë. Masakra e fëmijëve të pafajshëm lemerisi një vend tashmë të lodhur nga sulmet terroriste që nuk kishin të sosur (Sulmi në Peshawar, 2014).

Mbështetja sociale online dhe sulmi në shkollë në Peshawar

Askush në botë nuk është i përgatitur të përballet me vdekjen e një fëmije, pasi vdekja e një fëmije është vdekja e të ardhmes së një vendi dhe humbje e jashtëzakonshme dhe e pandreqshme për familjen së cilës ai i përket. Dhimbja dhe reagimet në mbarë globin për humbjen nga vdekjen e nxënësve të vrarë gjatë Sulmit në Peshawar, nuk mund të shprehen dot me fjalë. Gjithmonë kur flitet për dhimbjen nga sytë e dikujt rrëshqasin lot dhe njerëzimi ka parë raste të tilla edhe më parë. Ngjarja megjithatë mori mbështetje të madhe sociale dhe dëshmoi gjithashtu një prani të jashtëzakonshme të shprehur në platforma të ndryshme të suportit social online, përfshirë këtu dhe Twitter. Ngjarja e tmerrshme tërhoqi vëmendjen e mbarë botës dhe u mbulua gjerësisht nga platforma të ndryshme të mediave sociale. Vdekja e fëmijëve nga masakra në shkollë në Peshawar nxiti një lumë reagimesh në sisteme të ndryshëm suporti social online.

Metodologjia

Përpara se të merreshin të dhënat nga Twitter, u ndërmor një hetim paraprak për identifikimin e hashtagëve popullorë të përdorur për të shprehur ndjenjat lidhur me sulmin. U zbulua se hashtgu më i përdorur ishte *#PeshawarAttack*, prandaj u kërkua në të për të nxjerrë tuite që lidheshin me ngjarjen. Në mënyrë specifike, mbledhja e të dhënave përfshiu tuite të postuar në ditën e sulmit. Ky interval kohor ishte ideal për të vizualizuar përgjigjen imediate kundrejt sulmit, pasi ishte shenjuar nga raportimi për vrasjen e fëmijëve në radion e Pakistanit dhe operacioni që po zhvillohej. Gjatë kësaj periudhe u morën në total 514 tuite dhe mbas filtrimit të tyre, duke përjashtuar re-tuitet, numri i vërtetë shkoi në 500. Ky grupim të dhënash u përzgjedh për të bërë analizën sasiore dhe cilësore të përmbajtjes me avantazhin që kampionët e vegjël mundësojnë ekzaminimin e tuiteve në mënyrë të atillë që do të kishte qenë e pamundur me kampionë të mëdhenj (Denzin & Lincoln, 2005).

Informacioni i kërkuar i secilit prej tuiteve u regjistrua në mënyrë manuale në Microsoft Excel dhe analiza e përmbajtjes së secilin nga tuitet u bë në përputhje me kornizën e paracaktuar të ndërtuar nga Goh dhe Lee (2011); Lee dhe Goh (2013). Kjo ishte moduluar në përputhje me studimin dhe rezultonte në formimin e 10 kategorive që shprehnin sentimente të ndryshme që lidheshin me sulmin. Megjithatë, mbas reflektimeve të shumta, u eliminuan dy kategori, pasi asnjëri nga tuitet nuk i përkiste ndonjërit prej tyre, duke e kufizuar kështu kornizën finale në 8 kategori (Tabela 1). Shuma e tuiteve e kapërcen shifrën

500 pasi shumica e tuiteve përfaqësojnë më shumë se një kategori shprehjesh. Rezultati duhet marrë me shumë rezervë, pasi studimi analizoi vetëm një numër të vogël tuitesh për një periudhë të shkurtër kohore.

Tabela 1 Korniza e kodimit

Shprehja	Lloji i informacionit
Shpërndarja e lajmit dhe e informacionit	Përhapja e lajmeve dhe e informacioneve të tjera që kanë të bëjnë me sulmin
Shfaqja e emocioneve	Njerëzit shprehin keqardhje, dhimbje, simpati dhe shkrim emocional për viktimat
Regjistrimi i protestës	Njerëzit protestojnë kundër sulmeve dhe organizatave terroriste. Përfshihen gjithashtu narrativat fetare për të denoncuar sulmin
Shprehja e tronditjes dhe e habisë	Njerëzit shprehin tronditje ose mosbesim për vrasjen e fëmijëve të pafajshëm
Kritika ndaj qeverisë	Kritikojnë qeverinë dhe makinerinë e saj për politikën e veta dhe vakumin në shërbimet e inteligjencës.
Ngrihen pyetje	Njerëzit bëjnë pyetje rreth sulmit duke përfshirë edhe pyetje për ideologjitë ekstremiste.
Postim	Postime që bëjnë sugjerime për qeverinë e Pakistanit, terroristët dhe botën mbarë.
Spam ose i parëndësishëm	Postime që nuk kanë lidhje me ngjarjen.

Analiza Përdorimi i Twitter-it dhe shprehjet e tuiteve

Twitter-i u përdor gjatë rrethimit të shkollës në Peshawar për të shprehur ndjenja të ndryshme në lidhje me incidentin e tmerrshëm (Tabela 2). Si reflektim i masakrës me një numër të madh fëmijësh, shumica e tuiteve (37.2%) janë të natyrës emocionale e shprehin dhimbje dhe keqardhje. Pritet që në lidhje me masakrën e fëmijëve të pafajshëm përqindja më e madhe në kategorinë emocionale variojnë nga ngushëllimet, deri te postimet me zemër (*Qefinët më të vegjël peshojnë më shumë. #PeshawarAttack*). Përfshihen gjithashtu edhe tuite që shprehin keqardhje (*Zemra më loton me nënat e këtyre fëmijëve të pafajshëm. Do të doja t'ua sillja sërish të voglin tuaj. #PeshawarAttack*); simpati (*Zemra na është thyer dhe kokën e mbajmë varur. Mendimet tona për familjet e fëmijëve të vrarë brutalisht në #PeshawarAttack #PrayForPeshawar*); lutje (*Për prindërit që humbën fëmijët, urojmë që zemra juaj të gjejë*

paqe. Për vrasësit e fëmijëve, le të digjen në ferr shpirtrat tuaj#PeshawarAttack); dhe një premtim ose përkujtim (16 dhjetor 2014. Thuhet që koha shëron gjithçka, por kjo ditë nuk do të shërohet#PeshawarAttack).

Kategoria e dytë përfshin tuite me natyrë pyetëse (20.4%). Ajo përfshin pyetje për vrasjen e fëmijëve (si, “Si mund të vrasësh 130 fëmijë? Ka ca njerëz që janë të sëmurë nga trutë, shumica e njerëzve paqësorë janë të heshtur. Bota jonë ka nevojë të tubohet si I#PeshawarAttack’); çështje rreth medias (#PeshawarAttack gazetarët nuk prisnin dot sa të largohej nga ngjarja por e bombarduan një student që kishte qenë dëshmitar i krimit të urryer); vëzhgime rreth botës (E kam të pamundur të fle sot. Sa shumë jetë të mrekullueshme të humbura... për hiçgjë. Çfarë po ndodh me botën? #PeshawarAttack); dhe pyetje rreth njerëzimit (Këtu nuk bëhet fjalë as për kulturën, as për fenë dhe as për vendin. Bëhet fjalë për njerëzimin!#PeshawarAttack). Tuitet që shprehin tronditje ose habi llogariten në 18.2% dhe përfshijnë tuite si “lotët më rrjedhin rrëke teksa lexoj për #PeshawarAttack”; “Nuk e besoj dot se çfarë po ndodh në botë këtë javë. Bëhem keq kur lexoj çfarë shkruhet për #PeshawarAttack”etj.

Tabela 2 Shprehjet e tuiteve

Kategoria e tuitit	Numri i tuiteve	%
Shfaqin emocione	186	37.2
Ngrenë pyetje	102	20.4
Shprehin tronditje dhe habi	91	18.2
Shkëmbejnë lajme dhe informacion	77	15.4
Regjistrojnë protestë	77	15.4
Ofrojnë sugjerime	21	4.2
Kritikohet qeveria	15	3
Spam ose i parëndësishëm	15	3

Një numër i barabartë tuitesh (15.4%) raporton lajmin e sulmit dhe gjithashtu regjistrohen si protestë. Tuitet që ofrojnë informacion rreth sulmit përfshijnë linke për të ngjarje që tregohen nga të mbijetuarit e sulmit, pohime të personaliteteve të famshëm që dënojnë sulmin, citime rreth numrit të vdekjeve dhe fotografi të fëmijëve të vdekur.

Megjithatë, një numër i vogël tuitesh përmbajnë sugjerime (4.2%); kritika (3%) ose janë të një natyre të parëndësishme (3%). Interesante është që Twitteri nuk përdoret për të përhapur thashetheme gjatë sulmit. Gjithashtu, asnjë nga postimet nuk ofron prëditësime për statusin e sulmit dhe ndoshta arsyeja për këtë është që njerëzit aty rrotull do të kenë qenë të zënë të ndihmojnë viktimat.

Përhapja gjeografike e tuiteve

Vendndodhja gjeografike e një numri të madh tuitesh (157,31%) nuk zbulohet nga të gjithë përdoruesit e Twitter-it duke e kufizuar kështu analizën e hartëzimit gjeografik në 343 tuite që shtrihen vetëm në 35 vende. Hartëzimi gjeografik i tuiteve tregon interesin e botës karshi sulmit. Është e habitshme që Shtetet e Bashkuara kryesojnë në shqetësimin e treguar për sulmin me numrin maksimal të tuiteve (17%). Një numër i barabartë tuitesh vinin nga vende të goditura nga terrorizmi, Pakistani si dhe Mbretëria e Bashkuar, të dy zënë të njëjtin pozicion (12%). India si vend kufitar, renditet i katërti, me pesë përqind të numrit të tuiteve.

Përhapja gjeografike dhe shprehjet e tuiteve

Tabela 3 zbulon që arsyt emocionale të derdhura në Twitter qëndrojnë në vend të parë dhe kontributin më të madh e ka Pakistani (39.3%) në krahasim me komunitetin global (34.4%) duke treguar kështu që vendi i goditur nga terrori është më shumë i kapluar nga hidhërimi dhe zia. Tuitet emocionale pasoheshin nga tuite që ngrinin pyetje që kishin të bënin kryesisht me vrasjen e fëmijëve të pafajshëm në përqindje të barabartë nga e gjithë bota dhe nga Pakistani (21.3%). Ajo tregon gjithashtu që sulmi në shkollë në Peshawar është më tronditës për botën (19.5%) se sa për Pakistanin (13.1%) dhe tuitet që regjistrojnë protestë nga bota janë në raport më të lartë (14.5%) në krahasim me Pakistanin (11.5%). Megjithatë, duke qenë se Pakistani është vendi i sulmit, tuitet nga kjo pjesë e botës udhëheqin për shpërndarjen e lajmeve dhe të informacionit (19.7%) krahasuar me botën (16.7%).

Tabela 3 Përhapja gjeografike e shprehjeve të tuiteve

Shprehjet e tuiteve	Bota	Pakistani
Shfaqin emocione	97 (34.4%)	24 (39.3%)
Ngrenë pyetje	60 (21.3%)	13 (21.3%)
Shprehin tronditje dhe habi	55 (19.5%)	8 (13.1%)
Shkëmbejnë lajme dhe informacion	47 (16.7%)	12 (19.7%)
Regjistrojnë protestë	41 (14.5%)	7 (11.5%)
Ofrojnë sugjerime	15 (5.3%)	4 (6.5%)
Kritikohet qeveria	8 (2.8%)	2 (3.3%)
Spam ose i parëndësishëm	9 (3.2%)	1 (1.6%)

Shprehjet e tuiteve dhe impakti

Rituitet dhe pëlqimet përdoren për të matur impaktin e tuiteve. Sa më i lartë numri i rituitëve dhe i pëlqimeve, aq më i lartë është impakti. 186 (37.2%) e tuiteve u rituituan dhe u pëlqyen. Këto përbajnë tuite kryesisht të natyrës emocionale (36%) të pasuara nga tuite që përhapin lajme dhe informacion (19.9%). 18.8% e tuiteve pyetëse dhe 4.3% e tuiteve të natyrës sugjeruese u rituitën dhe u pëlqyen, duke treguar kështu që tuitet me natyrë sugjeruese nuk arritën të tërheqin vëmendjen e shumë tuituesve e për pasojë kanë më pak impakt. U rituitën dhe u pëlqyen përkatësisht 117 (23.4%) dhe 82 (16.4%) tuite. Tuitet që as nuk u rituitën dhe as nuk u pëlqyen, përbëjnë 23% të numrit të përgjithshëm të tuiteve. Kjo shifër përfshin gjithashtu kontributin e madh të tuiteve me natyrë emocionale (41.7%) të ndjekur nga tuitet që ngrenë pyetje (20.9%). Tuitet që raportojnë lajmin dhe informacionin dhe tuitet tregojnë protestë kontribuojnë njësoj me 14.8% të korpusit të tuiteve që nuk arrijnë të kenë impakt (Tabela 4). Tuitet me numrin më të lartë të rituitëve dhe të pëlqimeve që tregojnë popullaritetin e tyre (Top 5) tregohen në Figurën 2.

Tabela 4 Shprehjet e tuiteve dhe impakti

Kategoria e tuitit	Numri i tuiteve	Numri i tuiteve që u rituitën	Numri i tuiteve që u pëlqyen	Të dyja	Asnjëra
Shfaqin emocione	186	29 (35.4%)	42(35.9%)	67 (36%)	48 (41.7%)
Ngrenë pyetje	102	16 (19.5%)	27 (23.1%)	35 (18.8%)	24 (20.9%)
Shprehin tronditje dhe habi	91	19 (23.2%)	27 (23.1%)	27 (14.5%)	18 (15.6%)
Shkëmbejnë lajme dhe informacion	77	15 (18.3%)	8 (6.8%)	37 (19.9%)	17 (14.8%)
Regjistrojnë protestë	77	10 (12.2%)	23 (19.6%)	27 (14.5%)	17 (14.8%)
Ofrjnë sugjerime	21	2 (2.4%)	3(2.6%)	8 (4.3%)	8 (6.9%)
Kritikohet qeveria	15	2 (2.4%)	(0.8%)	9 (4.8%)	3 (2.6%)
Spam ose i parëndësishëm	15	4 (4.9%)	3(2.6%)	5 (2.7%)	3 (2.6%)

Lloji i përmbajtjes

Numri maksimal i tuiteve bazohen në tekst (76.2%). Tuitet që përmbajnë si tekst ashtu edhe imazh për të përcjellë mesazhin dhe emocionet e sulmit, llogariten në 23.8% të totalit me maksimumim e kontributin nga Pakistani (32.3%) (Tabela 5)

Tabela 5 Lloji i përmbajtjes

Lloji i përmbajtjes	Bota	Pakistani	Totali
Tekst	339 (77.4%)	42 (67.7%)	381 (76.2%)
Tekst dhe imazh	99 (22.6%)	20 (32.3%)	119 (23.8%)

Burimi i tuiteve dhe i hashtageve specifike të efentit

Hashtagu u mundëson përdoruesve të gjejnë postime rreth një përmbajtjeje ose tematike të veçantë. Përveç tagut të përdorur zakonisht d.m.th. #PeshawarAttack, përdoruesit kanë përdorur në tuitet e tyre 88 hashtage të ndryshëm. “#PrayForPeshawar”u gjet me një numër maksimal tuitesh (24), i pasuar nga #CrushTTP; #PrayForPakistan në 10 tuite respektivisht. Hashtage të tjerë të përdorur përfshijnë #BlackDay; #Taliban; and #RIP etj. Gjithashtu, në përqindje më të lartë kontributi me tuite ka qenë i civilëve/individëve (94.2%) dhe një përqindje e dobët (5.8%) e tuiteve është nga organizatat e ndryshme përfshirë edhe ato të asociuara me lajmin.

Diskutim/konkluzion

Përdorimi në rritje i mediave sociale në botën tekno-centriste i shton botës studimore dimensione të reja. Mikroblogjet, në veçanti Twitter, me vetëm 140 fjalë, mundëson në kohë reale shprehjen e pikëpamjeve, emocioneve, opinioneve dhe përhapjen e informacionit. Për të përmirësuar këtë funksion, Twitter zbuloi një shërbim të ri të quajtur Twitter Alert, që ka si synim t'i japë prioritet informacionit nga organizata të besueshme gjatë krizave kur kanale të tjera komunikimi nuk janë të aksesueshëm. (Twitter, 2013). Me një mbulim global prej 500 milion tuitesh të transmetuar çdo ditë nga më shumë se 320 milion përdorues në nivel global (Twitter, 2016), Twitter shihet si mjet potencial për analizimin e ndjenjave të njerëzve karshi gamës së gjerë të tematikave dhe eventeve qofshin natyrore ose të shkaktuar nga njeriu.

Në këtë studim, është përdorur analiza e sasiore dhe cilësore e përmbajtjes në 500 tuite të postuar gjatë sulmit vdekjeprurës në shkollë në Peshawar. Tuitet janë shkruar kryesisht nga individë dhe konsiderohen si tejet emocionalë, që shprehin keqardhje, evokojnë lutje për viktimat dhe ofrojnë ngushëllime. Ato ngrenë gjithashtu pyetje në lidhje me vrasjen e fëmijëve të pafajshëm dhe përgjigjen e vakët të botës dhe të qeverisë pakistaneze kundrejt organizatave terroriste. Një numër i madh tuituesish shfaqin gjithashtu tronditjen dhe habinë karshi sulmit dhe shfaqin zemërimin e tyre. Twitter dëshmon gjithashtu se është platformë për përhapjen e lajmeve dhe të informacionit. Kësisoj, gjatë krizave ose situatave të emergjencës Twitter dëshmon përdorime të shumëfishta, duke përfshirë këtu ofrimin e informacionit dhe të asistencës në përgjigje të situatës, gjithashtu shprehje të dhimbjes, mbështetjes dhe përkujtimit për të prekurit (Takahashi, Tandoc Jr & Carmichael, 2015) si dhe zgjeron më tej ndërgjegjësimin për situatën (Vieweg, Hughes, Starbird & Palen, 2010). Tuitet nga natyra janë kryesisht tekste, me më pak se një të katërtën e tuiteve që përmbajnë edhe tekst edhe figurë. Rezultatet janë gjithashtu në një linjë me Cheong dhe

Lee (2011), të cilët e raportojnë Twitterin si kanal ku individët përhapin lajmet më të fundit për veprimtaritë terroriste dhe e përdorin atë si burim informacioni.

Reagimi kundrejt sulmit erdhi nga 35 vende, ku numri më i lartë i postimeve ishte nga Shtetet e Bashkuara, pasuar nga Pakistani, Mbretëria e Bashkuar dhe India. Shtetet e Bashkuara udhëheqin ndoshta për shkak të faktit që një numër i madh pakistanezësh punojnë aty ose për shkak të lidhjeve të ngushta midis dy vendeve. Tuitet që tregojnë pikëllim dhe dhimbje; lajme dhe informacion janë kryesisht nga Pakistani, po ta krahasojmë atë me vendet e tjera. Ndonëse sulmi u pa se ishte më tronditës për komunitetin global se sa për Pakistanin sikurse provohet nga tuitet, si Pakistani ashtu edhe komuniteti global ngritën pyetje në raporte të barabarta. Një llokmë e madhe tuitesh janë rituitur dhe pëlqyer, duke shfaqur kështu një impakt të mirë. Numrin më të madh të rishpërndarjes e zënë tuitet emocionale dhe tuitet që përmbajnë lajme dhe informacion, dhe pjesa e mbetur e tuiteve i përkasin kategorisë së “rituiteve” dhe “pëlqimeve”. Rezultatet tregojnë gjithashtu që Twitteri nuk ishte përdorur për të kërkuar ndihmë, për të përhapur fjalën dhe për të ofruar përditësim në lidhje me statusin e sulmit. Pra, është e evidente nga studimi që Twitteri është më shumë se një platformë për përhapjen e informacionit dhe shprehjen e emocioneve. Ai mund të veprojë si detektor për mik-armik e gjithashtu si kuti sugjerimesh.

Referenca

- 2014 Peshawar school massacre. (2016). *Wikipedia Free Online Encyclopedia*. Retrieved from https://en.wikipedia.org/wiki/2014_Peshawar_school_massacre
- Bonanno, G. A. & Kaltman, S. (2001). The varieties of grief experience. *Clinical Psychology Review*, 21 (5), 705–734. DOI: 10.1016/S0272-7358(00)00062-3
- Brennan, M. (2008). Condolence books: language and meaning in the mourning for Hillsborough and Diana. *Death Studies*, 32 (4), 326–351. DOI: 10.1080/07481180801974729
- Cheong, M., & Lee, V. C. S. (2011). A microblogging-based approach to terrorism informatics: Exploration and chronicling civilian sentiment and response to terrorism events via Twitter. *Information Systems Frontiers*, 13, 45–59. DOI: 10.1007/s10796-010-9273-x
- Cohen, S., & Hoberman, H. (1983). Positive events and social supports as buffers of life change stress. *Journal of Applied Social Psychology*, 13 (2), 99–125. DOI: 10.1111/j.1559-1816.1983.tb02325.x
- Coursaris, C. K., & Liu, M. (2009). An analysis of social support exchanges in online HIV/AIDS self-help groups. *Computers in Human Behavior*, 25 (4), 911–918. DOI: 10.1016/j.chb.2009.03.006
- Denzin, N. K. & Lincoln, Y. S. (Eds.). (2005). *The Sage Handbook of Qualitative Research* (3rd ed). Thousand Oaks, CA: Sage.
- Di Giulio, J. F. (1995). A more human workplace: responding to child welfare workers' personal losses. *Child Welfare*, 74 (4), 877–888.
- Fu, K. W. & Yip, P. S. F. (2007). Long-term impact of celebrity suicide on suicidal ideation: results from a population-based study. *Journal of Epidemiology and Community Health*, 61 (6), 540–546. DOI: 10.1136/jech.2005.045005
- Goh, D. H. & Lee, C. S. (2011). An analysis of tweets on the death of Michael Jackson. *Aslib Proceedings*, 63 (5), 432–444. DOI: 10.1108/00012531111164941
- Hersberger, J. A., Murray, A. L., & Rioux, K.S. (2007). Examining information exchange and virtual communities: an emergent framework. *Online Information Review*, 31 (2), 135–147. DOI: 10.1108/14684520710747194

- Kubler-Ross, E. (1969). *On Death and Dying*. Routledge: London.
- Lee, C. S., & Goh, D. H. L. (2013). "Gone too soon": did Twitter grieve for Michael Jackson?. *Online Information Review*, 37 (3), 462 – 478. DOI: 10.1108/OIR-05-2012-0082
- Massimi, M. & Baecker, R.M. (2010). A death in the family: opportunities for designing technologies for the bereaved. *Proceedings of the 28th International Conference on Human Factors in Computing Systems* (pp. 1821–1830), New York, ACM Press. DOI:10.1145/1753326.1753600
- Peshawar attack. (2014). Peshawar attack: 132 children among 141 killed, all 7 Talibangunmen dead. *The Indian Express*. Retrieved from <http://indianexpress.com/article/world/neighbours/live-6-terrorists-storm-pakistan-army-school-take-children-hostage/>
- Sheridan, L., North, A., Maltby, J., & Gillett, R. (2007). Celebrity worship, addiction and criminality. *Psychology, Crime & Law*, 13 (6), 559–571.
- Takahashi, B., Tandoc Jr, E. C., Carmichael, C. (2015). Communicating on Twitter during a disaster: An analysis of tweets during Typhoon Haiyan in the Philippines. *Computers in Human Behavior*, 50, 392–398. DOI: 10.1080/10683160601160653
- Twitter. (2013). *Twitter alerts: Critical information when you need it most*. Retrieved from <https://blog.twitter.com/2013/twitter-alerts-critical-information-when-you-need-it-most>
- Twitter. (2015). *Twitter usage/company facts*. Retrieved from <https://about.twitter.com/company>.
- Vieweg, S., Hughes, A. L., Starbird, K., & Palen, L. (2010). Microblogging during two natural hazards events: what twitter may contribute to situational awareness. *In Proceedings of the SIGCHI Conference on Human Factors in Computing Systems* (pp. 1079-1088). DOI:10.1145/1753326.1753486

Të drejtat e njeriut
dhe barazia gjinore

Sulmet në Internet: (Internet trolling): Sfidë për gazetaret dhe aktivistet femra

Anubhuti Yadav

Në tetor 2015 në Indi vetëm 29 % e përdoruesve të Internetit ishin femra. Shumica dërmuese e përdoruesve të internetit janë meshkuj. Në zonat urbane hendeku është më i vogël, duke qenë se 38 % e femrave janë online ndërsa në ato rurale vetëm 12 % e tyre janë online (IAMAI 2015). E megjithatë si pjesë e fushatës Digital India janë bërë një sërë përpjekjesh për të afruar gjithnjë e më shumë femra me internetin, ndërkohë që mbeten ende shumë probleme që e pengojnë praninë e grave online. Problemet në fjalë kanë të bëjnë me analfabetizmin, aksesin në Internet, analfabetizmin digjital dhe mungesën e kohës. Një tjetër problem jashtëzakonisht i rëndësishëm që bëhet pengesë për praninë aktive të femrave në internet janë edhe sulmet në internet. Vitet e fundit bashkësia online ka qenë dëshmitare e rasteve të sulmeve në internet. Ka pasur femrash që i kanë fshirë adresat e tyre për shkak të abuzimit online, por në të njëjtën kohë ka pasur edhe shembuj që ia vlejné për t'u krenuar për përballimin me eficiencë të rasteve të fyerjes në internet. Ato kanë shfrytëzuar një miriadë strategjish, duke nisur nga sjellja diplomatike ndaj fyerjeve, te turpërimi në publik i rasteve për të përfunduar me zbatimin e ligjeve të vendit. Ky studim eksploron konceptin e fyerjes në internet, arsyet e kësaj dukurie, si dhe faktin pse femrat janë viktima të saj. Në studim bëhet fjalë gjithashtu për disa raste sesi është vepruar me fyerjet në internet në botë. Është dëshmuar se ato gra që e kanë ngritur zërin dhe i shprehin fuqishëm opinionet e tyre janë bërë objekt i sulmeve në internet. Kësisoj sulmet në internet janë shndërruar në një kërcënim për gazetaret dhe aktivistet femra. Ndërsa nga njëra anë keqbërësit sjellin shqetësim, nga ana tjetër mungesa e qartësisë në trajtimin e sulmeve në internet e ka dëmtuar keq hapësirën online. Studimi dokumenton disa raste tipike në Indi dhe tregon sesi femrat gazetare dhe aktiviste i kanë përballuar sulmet dhe mbështetja që ato kanë marrë prej bashkësive online.

Fjalëkyç: sulme në internet, abuzim online, ngacmim online, frenimi online

Hyrje

Interneti ua ka bërë jetën të lehtë të gjithë atyre që duan ta përdorin për synime konstruktive, por ua ka bërë më të lehtë edhe atyre që duan ta përdorin në mënyrë keqdashëse dhe shkatërrimtare. Praktika e përdorimit të Internetit në mënyrë destruktive në një mjedis social pa ndonjë qëllim instrumental të dukshëm quhet Sulm në Internet. Ky koncept është shfaqur kohët e fundit ose ndoshta duhet thënë se është bërë më i shpeshtë kohët e fundit, duke qenë se nuk ka shumë kërkime lidhur me dukurinë e Sulmeve në Internet. Qëllimi dhe synimi i sulmeve, psikologjia dhe procesi i krijimit të kaosit online është një fushë e rëndësishme studimesh po të kemi parasysh rritjen drastike të numrit të këtyre rasteve në botën mbarë. Një vështrim nga afër i sulmeve dhe i komenteve të tyre

tregon një model. Duke nisur nga personi që kërkon të tërheqë vëmendjen duke u bërë keqdashës për të shkuar tek ai që gëzohet kur lëndon të tjerët, duke shfaqur sadizëm, si dhe ai që përfiton nga të qenit anonim online, kështu që sulmet në internet mund të kategorizohen në një sërë mënyrash.

Cilat janë sulmuesit në Internet?

Sulmues në Internet janë ata individë që lidhen në rrjet për të krijuar kaos. Sipas Dr. Claire Hardaker, studiuese akademike, sulmues është “një përdorues kompjuteri që krijon një identitet me dëshirën e singertë për të qenë pjesë e grupit në fjalë... ndërkohë që synimi real i tij është të shkaktojë pështjellim, si dhe/ose të ngjallë konflikt me qëllim për t’u zbavitur”.

Dr. Claire i kategorizon sulmuesit në tipat e mëposhtëm sipas synimeve, njerëzve ose çështjeve që ata bëjnë objekt të sulmeve të tyre.

1. Sulmues RIP, që e shkojnë kohën duke shkaktuar shqetësime në sajtet memorialë.
2. Sulmues për famë, të cilët i fokusojnë gjithë energjitë duke provokuar njerëzit e shquar.
3. Sulmues të të miturve, qëllimi i të cilëve është të abuzojnë në çdo ndërhyrje me fëmijë ose kafshë.
4. Sulmues të politikanëve, të cilët iu nxijnë jetën deputetëve jashtë funksionit të tyre; por edhe shumë të tjerëve si këta.

Në artikullin e saj “Kush janë sulmuesit”, të botuar në New Statesman, Helen Lewis (2014) shtonte edhe dy kategori të tjera që janë si më poshtë:

1. Sulmuesit nënkulturorë – ose trollët e “vërtetë” – ata që mësyjnë forumet e mbushur me njerëz të ndershëm dhe prishin bisedat, duke bërë pyetje të pakuptimta, ose hakerat.
2. Sulmuesit profesionistë ose “trollumnistët” – shkrimtarë ose personalitete publike karriera mediatike e të cilëve ndërtohet mbi vullnetin për të “thënë të pathënshmet”; ose më mirë, për të thënë diçka që tërheq në mënyrë të jashtëzakonshme vëmendjen (ndonëse negativisht) dhe godet.

Këtyre mund t’iu shtohet edhe një kategori tjetër e quajtur sulmues anti-femër; këtu bëhet fjalë për sulmues që e përftojnë kënaqësinë duke sulmuar femrat, sidomos ato që kanë një zë publik, në mënyrë të veçantë feministet. Kohët e fundit ka pasur një numër në rritje të gjurmimeve, gjuhës së urrejtjes, dhunës, kërcënimeve me vdekje kundër atyre grave që e ngrenë zërin. Në fakt në disa forume online anonimati i kombinuar me mizogjininë mund të shpjë si mendësi në krijimin e bandave të përdhunuesve.

Arsyet e sulmeve në internet

Studiuesja nga SHBA Alice Marwick jep shpjegimin e mëposhtëm për sulmet në internet: “Ekziston mundësia shqetësuese që njerëzit po krijojnë në mjedise online thjesht për të shprehur atë lloj gjuhe raciste, homofobe ose seksiste për të cilën nuk ka më vend në mjedisin shoqëror, në punë qoftë edhe në shtëpi”. Kështu që arsyeja më e madhe për sulmet në internet është anonimati. Anonimati çon në agresivitetin online çka edhe është njëri prej tipareve të sulmeve në internet. Sipas psikologut John Suller (2004), disa njerëz e shpalosin vetveten ose shpërthejnë më shpesh dhe në mënyrë më intensive kur gjenden online. Ai eksploro gjashtë faktorë që ndërveprojnë me njëri-tjetrin në krijimin e efektit të agresivitetit online: anonimati disociativ, dhe minimizimi i autoritetit. Variablet e personalitetit ndikojnë gjithashtu mbi shkallën e shtrirjes së këtij agresiviteti. Më fort se të mendojmë për agresivitetin si shpalosje të një nënshtrese të “vetvetes së vërtetë”, ne mund ta conceptualizojmë atë si një shmangie nga konstelacioni brenda vetë-strukturës, çka përmbledh grumbuj afeksioni dhe kognicioni që dallojnë prej konstelacionit të personit në vetvete. Të gjithë faktorët e përshkruar këtu më sipër prej Sullerit i japin shkas sulmit në Internet.

Gratë në luftë kundër sulmeve në internet

Afro dy të tretat e grave gazetare të pyetura kanë pësuar kërcënime, shantazhe ose abuzime për shkak të profesionit. Më shumë se 25% e “shantazheve verbale, të shkruara dhe/ose fizike, duke përfshirë këtu edhe për pjesëtarët e familjes ose miqtë” kanë ndodhur online. (Fondacioni Mediatik Ndërkombëtar i Grave dhe Instituti Ndërkombëtar i Sigurisë së Lajmeve, dhjetor 2013). Sipas Qendrës së Kërkimeve Pew, qershor 2014, njëzet e pesë % e femrave të reja janë ngacmuar seksualisht online, ndërsa 26% janë bërë objekt gjurmimi. Për më tepër, femrat përgjithësisht janë bërë objekt i formave më të dhunshme të abuzimeve online, duke përfshirë atë që quhet doxxing dhe kërcënime të dhunshme. Ka pasur një numër të madh ngacmimesh online kundër grave. Këtu më poshtë bëhet fjalë për një rast nga India, i cili dëfton jo vetëm sesi gratë bëhen objekt i sulmeve, por edhe se sa kurajoze u tregua një femër gazetare në luftën kundër sulmeve, duke sjellë ndryshime pozitive.

Studimi i rastit të gazetareve femra në Indi

Sulmet në internet janë shndërruar në një rrezik për gazetaret dhe aktivistet femra në Indi. Teksa nga njëra anë keqbërësit janë duke sjellë shqetësime, nga ana tjetër mungesa e qartësisë në trajtimin e sulmeve në internet ka sjellë rrudhjen hapësirës online. Më 22 nëntor 2015 VP Rajena, shkrimtare dhe gazetare e njohur, fituese e çmimit prestigjioz Goenka, e cila i përket një familje muslimane të shtresës së mesme në Kozhikode, shkroi në FB sesi studentët e të dy sekseve, femra e meshkuj, janë bërë objekt i ngacmimeve seksuale nga ana e mësuesve meshkuj në Medrese. Një pjesë i dolën në krah pas këtij postimi, por

pjesa më e madhe e trajtuan si një përpjekje për të hedhur baltë mbi një religjion të caktuar. Sulmet online që vijuan më pas ishin të pabesueshme. Madje jo vetëm nga njerëz me një mendësi të kufizuar, por edhe nga platforma e medias sociale që e promovon veten si një medium që i lejon njerëzit të thonë fjalën e tyre. Pas ankesave e pakënaqësive, Faaja e saj u bllokua, çka, më pas, u pranua se kishte qenë një gabim. Ajo çka duhet vlerësuar në gjithë këtë episod është kurajoja e jashtëzakonshme që tregoi Rajeena dhe mbështetja nga bashkësia dhe media.

Sfondi

Postimi që shkaktoi stuhinë në internet u shfaq më 22 nëntor 2015, ndërsa ai që shkoi e trazoi follenë e grenxave ishte ai i VP Rajeenas, një gazetare që punon me Media One Group. Përmbajtja e përkthyer e postimit është si më poshtë vijon:

Post 1: Ka të bëj me një incident që ka ndodhur para 20 vjetësh. Unë studioja në Medresenë sunite. Mos e mundo veten të kuptosh se për cilin prej kongregacioneve sunite flitet: EK Samastha Suni. Kam studiuar atje deri në klasën e pestë. Ditën e parë të klasës së parë, një Ustad trupmadh e i shëndoshë hyri në klasë. Duhet të ishte diku te 40-45 vjeç. I risjell nëpër mend këto gjëra nga koha kur isha 7 vjeçe, kështu që kjo është ajo çka më kujtohet tani. Emri i tij ishte ai i Khalifas së 4-t. Dita e parë e shkollës pati një fillim të mbarë. I ulur në karrigen pas tavolinës, Ustadi iu kërkoi djemve të klasës të vendoseshin në një resht. Mandej i thirri të gjithë një nga një. Ne vajzat, ulur në bankat tona, pamë shprehjet e lumtura në fytyrat e djemve të pafajshëm të ndryshonin dalëngadalë. Ndërkohë që i pyeste për emrat duart e Ustadi u zhvendosën në pjesa e poshtme e trupit të tyre. Kjo ishte koha kur djemtë kalonin nga pantallonat e shkurtra te të gjatat. Ne pamë me sytë tona Ustadi t'iu hapte zinxhirin e pantallonave dhe të verifikonte ngadalë. Duke i parë djemtë të skuqeshin e të viheshin në siklet, edhe ne vajzat s'po dinim nga t'ia mbanim. "Mos ki turp. Eja këtu", i urdhëronte Ustadi gjithë dashuri. Ai u ndal vetëm atëherë mbasi inspektoi edhe djalin e fundit të klasës. Mbj mend që kjo gjë vazhdoi për disa ditë me radhë. Ai njeri na dha mësim vetëm për një kohë të shkurtër. Pas tij erdhi një Ustad i ri. Ndërkohë disa prej djemve e kishin lënë Medresen.

Post 2: Kjo ndodhi kur isha në klasën e katërt ose të pestë. Më të rriturit asokohe bënin mësim edhe natën. Ato ditë kishte ndërprerje të energjisë elektrike gjatë ditës. Kështu që për afro një gjysmë ore tavolina e Ustadi ndriçohej me qiri. Nuk kishte as recitime, as lexime. Ne vajzave nuk na zbaviste edhe aq kjo gjë, duke qenë se kishim frikë nga errësira. Ustadi na mësonte Kuranin e shenjtë, besimin, ritet, moralin, historinë dhe traditat. Ai kishte emrin e njërit prej nipërve të Profetit. Ishte rreth të gjashtëdhjetave. Drita në atë klasë të madhe ishte e vagullt, krejt si drita e një llampe të dobët. Kur ikin dritat, Ustadi çohet nga vendi i tij dhe na afrohej ne vajzave e na ngacmonte me shkop. Ai prekte e zbulonte pjesë të trupit të vajzave me shkopin e tij. Najma, e cila kishte ngelur dikur në klasën e dytë dhe të tretë e tani ishte në klasën e pestë ishte bukuroshja e klasës. Ne flisnim me zë të ulët dhe thoshim me njëra-tjetrën se ai e ngelte qëllimisht. Por edhe kishim parë disa gjëra të ndodhnin. Një ditë ajo u ngrit më këmbë e kapi shkopin dhe thirri: "Ustad, boll me ato që bën ose do të shkoj t'ia them të gjitha KryeUstadit". Edhe pse ishte errësirë i pamë sytë e saj të përshkëndisnin. Pamë edhe ustadin

të ngrinte supet. Ai i tha: “Unë s’kam bërë ndonjë gjë!” dhe u mbështet të karrigia e tij. Kur erdhën dritat, ai ishte ende lulëkuq në surrat. Qysh nga ajo ditë e më pas, Najma do të hante dajak për një arsye a një tjetër. Paskësaj ajo nuk i vazhdoi studimet për një kohë të gjatë. Ndërkohë që Ustadi i moshuar na dha mësim për një kohë të gjatë. Edhe pse jo si më parë, prapëseprapë na u desh t’i duronim ngacmimet e tij shkop përgjatë gjithë vitit. Por ne ishim tmerrësisht të trembura të hapnim gojë e t’i kallëzonim njeriu për atë që ndodhte. Edhe sot kur i sheh vajzat e rritura të kalojnë nga klasat e natës në Medrese nuk çlirohem dot prej atyre kujtimeve. Ne nuk kishim frikë nga çunat e klasës, por prej ustadëve që na jepnin mësim. Kur disa prej organizatave fetare të komunitetit tonë shprehen se barazia gjinore do të shkaktojë anarki, them me vete se “sa e bukur” ka qenë kjo shoqëria jonë aspak anarkiste e gjithë këtyre viteve!”

Mbasi i postoi këto shënime ajo nisi të marrë një sërë mesazhesh që përmbanin gjuhë urrejtje, ndërsa njerëzit nisën të shkruajnë e të postojnë komente përcmuese në postën e saj në Facebook. Ja disa prej këtyre komenteve më poshtë:

1. Pse nuk u ankove dhe ta raportoje atëherë Ustadin? Pse sot, pas 23 vjetësh.
2. Ka gra që ngacmojnë burrat. Pse nuk flet edhe për ato?
3. Vëllezër, zushka me birirë ka nevojë serioze për ndihmë. Le t’i ofrojmë shërbimet tona. 4. Kjo grua ka për të bërë karrierë në shkrimin e skenarëve për filma soft porno.
5. Mos akuzo krejt sistemin e mësimin në Medrese dhe disa ustadë ngaqë ti ke pasur një përvojë “minore”.
6. Uau! Postimi yt paska marrë kaq shumë likes. Ti je ylli i RI i FB!
6. Ti duhesh flakur nga Madhyamam (vendi ku punon).
7. Të gjitha këto janë fantazi e kulluar.

Por ajo jo vetëm që u përçmua dhe u fye nga pjesëtarët e bashkësisë muslimane, por dhe Facebooku i bllokoi adresën. Edhe pse më vonë Facebooku e pranoi gabimin dhe e çbllokoi adresën e saj. Ndërkohë që një numër i madh njerëzish e mësynë faqen e saj me komente poshtëruese, në të njëjtën kohë atë e mbështetën edhe një sërë aktivistësh dhe shkrimtarësh. Zoti BRP Bhaskar, një gazetar, postoi në faqen e vet në Facebook “Veprimi i ndërmarrë nga Facebooku për të bllokuar adresën e V P Rajeenas është vërtet për të ardhur keq. Rajeena, e cila e përdor në mënyrë të përgjegjshme platformën mediatike u bë objekt sulmesh të ashpra dhe të turpshme nga fondamentalistët mbasi shkroi rreth përvojave të hidhura të përjetuara në një institucion religjioz. Në shenjë solidariteti me Rajeena po ndaj me ju të gjithë postimin e Babu KP që riprodhon postimin e Rajeenas”, duke shpërndarë postimin kontrovers të Rajeenas të riprodhuar nga Babu KP.

Një tjetër platformë në gjirin e Facebookut (Për një FB më të mirë, për një faqe FB më të mirë), shprehte solidaritetin dhe mbështetjen e vet për V. P. Rajeenan dhe dënonte sulmet online me të cilat ajo po përballlej. Ata e publikuan këtë çështje në faqen e tyre dhe

patën më shumë se 13 milion kontakte. Rajeena e falenderoi për zemërsisht bashkësinë për mbështetjen e dhënë në përballimin e një situatë kaq të vështirë për të.

Më lejoni të marr disa momente tuajat për të shprehur mirënjohjen e thellë dhe falenderimet e mia për të gjithë ata që më mbështetën në luftën time, si dhe më dolën në krah për të drejtat e mia individuale si grua dhe qenie njerëzore. Një falenderim shumë i veçantë shkon për ekipin 'për një fushatë më të mirë në FB', si dhe për të gjitha përpjekjet e tyre që të rifitoja adresën time... ju njerëz Rock!!!

Në një intervistë për "Indian Express", ajo u shpreh se nuk pati as edhe një problem në organizatën mediatike për të cilën punon. Ajo tha: "Kam përkrahjen e një shumice që nuk është aktive në Facebook. Kjo është shenjë pozitive. Kështu marrim më shumë energji për të punuar edhe më mirë".

Momenti fitimtar

Postimi i saj i fundit ka të bëjë me titullin 'AIMPLB do të merret me çështjen e "abuzimeve seksuale" në Medresë', publikuar më 2 dhjetor 2015 te "Indian Express", çka lidhet me Bordi Ligjor për të gjithë Muslimanët e Indisë (AIMPLB) – kulmi i organizmit të Sheriatit Islamik në vend, i cili do ta trajtojë këtë çështje gjatë zhvillimit të punimeve të komitetit në takimin e datës 9 dhjetor në Amroha.

Përfundim

Agresiviteti në Internet është një kërcënim për vetë Internetin. Është shumë e vështirë ta kontrollosh agresivitetin. Përsa kohë që media online ofron mundësinë për të krijuar adresa të rreme anonime, përdoruesit e dhunshëm do të jenë të pranishëm atje dhe do të vijnë duke u rritur. Se si e qysh duhet trajtuar puna e sulmeve në Internet është diçka që duhet ta dinë të gjithë. Zgjidhja nuk është t'iu druhen sulmeve ose të fshish adresën, siç edhe kanë bërë shumë vetë. Lufta për dinjitet në hapësirën online është diçka që duhet inkurajuar. Ka një sërë mënyrash sesi të veprosh me sulmet në Internet, por mënyra më e rëndësishme është t'i injorosh. Ata që kërkojnë të tërheqin vëmendjen, duke dhunuar hapësirën online është e mira të injorohen. Por duhet të ketë edhe mënyra të tjera të reja për t'iu vënë fre sulmeve në internet.

Susan Carland, një akademike nga Australia, u zotua t'iu dhuronte një dollar për bamirësi UNICEF-it për çdo mesazh me gjuhën e urrejtjes që do të merrte në Twitter. Këtu më poshtë twit i saj i fundit dhe llogaria në dollarë që i janë dhuruar UNICEF-it për të gjithë mesazhet me gjuhë urrejtje që ajo ka marrë në twitter:



Referenca

- Hardaker, C. (2010). Trolling in asynchronous computer-mediated communication: From user discussions to academic definitions. *Journal of Politeness Research. Language, Behaviour, Culture*
- Helen L. (2014). Who are the trolls. *New Statesman*, Retrieved from: <http://www.newstatesman.com/helen-lewis/2013/07/who-are-trolls>
- India Today (2015). What sparked the madarsa controversy? What did VP Rajeev write?, Retrieved from: <http://indiatoday.intoday.in/story/what-sparked-the-madarsa-controversy-what-did-vp-rajeena-write/1/532132.html>
- Jessica Velinti, (2007). How the web became a sexist's paradise. *The Guardian*. Retrieved from: <https://www.theguardian.com/world/2007/apr/06/gender.blogging>
- Suller, J. (2004). *The Psychology of Cyber Space*. Retrieved from: <http://truecenterpublishing.com/psyber/disinhibit.html>.
- The Internet and Mobile Association of India (IAMAI) and IMRB (2015). 'Internet in India 2015' Retrieved from: <http://www.iamai.in/media/details/4486#>

Ligjërimit ndërfetare
dhe ndërkulturore
në media

Edukimi me median digjitale dhe roli i tij kundërvënës ndaj ndarjeve dhe fuqizimit të identitetit kombëtar në botën arabe

Ahmed Al-Rawi

Një ndër sfidat më serioze me të cilat përballen sot shumë prej vendeve arabe si Iraku, Libani, Bahreini, Siria dhe Jemeni është rreziku i ndarjeve sektare, një rrezik ky që i kanoset thelbit të ekzistencës së këtyre vendeve. Në këtë kontekst tensionet e ndryshme politike dhe religjioze, si dhe ndarjet, gjejnë shpesh jehonë në media dhe veçanërisht në rrjetet sociale (SNS). Acarimi online krijon dhe shpije në shkëmbime pafund të gjuhës së urrejtjes mes sekteve, grupeve dhe bashkësive të ndryshme të cilat kanë dallime të prekshme. Për fat të keq ky është një realitet i pashmangshëm. Ky diskutim shtjellon se njohuritë e medias digjitale dhe, në mënyrë specifike, njohuritë religjioze mund të përdoren si një instrument për të përforcuar ndjenjën e harmonisë kombëtare mes religjioneve dhe sekteve të ndryshme për të luftuar radikalizimin religjioz online, duke u fokusuar tek ata elementë që i ofrojnë qytetarët me njëri-tjetrin dhe jo tek ata që i ndajnë e i përçajnë. Me fjalë të tjera, mishërimi i kurrikulimit të njohurive mediatike qysh në fazat e hershme të edukimit mund të përdoret për të rritur vetëdijën e mundësive dhe rreziqeve të mediave sociale, si dhe për të përhapur konceptin e identitetit kombëtar që ngrihet mbi ndarjet politike dhe religjioze, por edhe mbi dallimet etnike. Të gjitha këto përpjekje mund të sponsorizohen nga shteti, duke qenë se nevojitet mbështetje financiare dhe logjistike për t'i vënë në jetë këto programe; por ato mund të mbështeten ose të drejtohen edhe nga Divizioni i Medias dhe Komunikimit të Lidhjes Arabe.

Fjalëkyç: edukimi mediatik, ekstremizëm, radikalizëm, njohuri religjioze, Lindje e Mesme.

Njohuri në fushën e medias digjitale

Në botën tonë të mbingopur mediatike, po vjen duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme të qenit i vetëdijshëm rreth mjedisit mediatik që rrethon çdo cep e qoshk të jetë sonë. Sipas W. Potter përftimi i njohurive në fushën mediatike është i rëndësishëm për shkak se “sa më shumë të jeni të vetëdijshëm sesi vepron dhe ju afekton masmedia, aq më shumë ju i kontrolloni ato efekte, si dhe aq më shumë e ndani veten prej përdoruesve tipikë të medias, të cilët e kanë lejuar masmedia të programojë mënyrën sesi ata sillen e mendojnë” (2016, f. 7). Me fjalë të tjera, njohuritë mediatike kanë të bëjnë me programimin e mendjes për të përthithur automatikisht dhe analizuar mesazhet e medias. Në përgjithësi njohuritë

mediatike përkufizohen si një tërësi kapacitetesh që përftohen në lidhje me përvojën, mesazhet dhe angazhimin mediatik. Zakonisht ka pesë dimensione: akses, analizë, krijim, reflektim dhe veprim (Hobbs, 2011, f. 12). Sidoqoftë një tjetër pakicë studiuesish e zgjerojnë këtë dimension në tetë: akses, mirëkuptim, vetëdijë, analizë, vlerësim, krijim, reflektim dhe pjesëmarrje (Scheibe & Rogow 2012, fq. 19-20). W. Potter e përpunon duke theksuar se alfabetizmi mediatik përmban tri blloqe kryesore: pozicionin personal, strukturën e dijes dhe aftësitë (2014). Pozicioni personal është i lidhur me objektivat dhe motivimet; ato “formësojnë detyrat e procesimit të informacionit duke përcaktuar se çfarë filtrohet e hyn brenda dhe çfarë filtrohet e del jashtë” (2014, f. 17). Veç kësaj strukturat e dijes janë të lidhura me “informacionin e organizuar” në kujtesën tonë, e cila ndihmon në kuptimin e modeleve ose të hartës kognitive që ekziston bazuar në dijen e mëparshme (ibid., fq. 17-18). Përfundimisht në përgjithësi na nevojiten shtatë aftësi për të kuptuar dhe analizuar në mënyrë adekuate mesazhet e medias: analiza, vlerësimi, grupimi, induksioni, deduksioni, sinteza dhe abstraksioni (ibid., f. 20). Shkurtimeisht, njohuritë mediatike përftohen me vetëdijë dhe përvojë në media, si dhe me një analizë të mesazheve të vazhdueshme që na bombardojnë.

Rritja e sektarizmit & politikave përçarëse

Menjëherë pas Pranverës Arabe përçarja midis shiitëve dhe sunitëve në disa vende si Bahreini dhe Siria u rrit në mënyrë të ndjeshme. Çdo grup i inkuadron protestat në atë mënyrë që i vjen për shtat dhe u shërben interesave të tij. Për shembull, shtetet e Gjirit Arabik në pjesën më të madhe i paraqitën protestuesit në Bahrein si tradhtarë dhe mbështetës të agjendës politike të Iranit. Një prej medimtarëve religjiozë më të rëndësishëm sunitë Yusuf Al-Qaradawi, deklaroi një herë se protestat në Bahrein janë kundër sunitëve me që kanë një dimension sektar (CNN në arabisht, 2013). Al- Qaradawi vetëm është i lidhur ngushtë me Vëllazërinë Muslimane në Egjipt, si dhe me kanalën në arabisht të Al-Jazeera me qendër në Katar. Ia vlen të përmendim se kanali në arabisht i Al-Jazeera pothuajse nuk raportoi për protestat e shiitëve; i njëjti kanal dikur ishte akuzuar se se favorizonte sunitët dhe i nxiste ata kundër shiitëve në vendet të tjera si puna e Irakut (Lynch, 2006, f. 198). Mos raportimi i protestave të shiitëve në Bahrein u denoncua në disa intervista televizive nga katër ish-punonjës të Al-Jazeera, të cilët dhanë dorëheqjen në shenjë proteste ndaj mbulimit të njëanshëm të ngjarjeve në Bahrein dhe Siri, siç qenë Ghassan bin Jeddo dhe Hassan Shaaban (Rusia sot, 2012). Veç kësaj Ali Hashem, një tjetër gazetar që punonte për Al-Jazeera dhe dha dorëheqjen, i tha The Guardianit: “Ishte e qartë se kanalet televizive të financuara nga shtetet e Gjirit ishin më të interesuara në sigurinë rajonale se në ëndrrën e bahreinasve për demokraci e liri dhe për revoltën e tyre kundër tiranisë”, (Hashem, 2012). Ironikisht Katari dhe Arabia Saudite, dy vende që mbështetën shumë prej protestave të Pranverës Arabe, kanë kundërshtuar rreptësisht çdo shfaqje disidence online në vendet e tyre, çka është një tregues i standardeve të dyfishtë (Codrescu, 2012), ashtu edhe në vende të tjera të Gjirit, si Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara (Murphy, 2013).

Nga ana tjetër një numër kanalesh televizivë satelitorë shiite në mënyrë krejt subjektive u rreshtuan me protestuesit në Bahrein, duke hedhur dritë vetëm te mizoritë e kryera kundër shiitëve. Për shembull, kanali satelitor iranian Al-Alam (që transmeton në

arabisht) i kushton një segment të konsiderueshëm të emisioneve informative të veta, por edhe shumë prej programeve me debate, luftimeve midis shiitëve hauthis në Jemen dhe forcave qeveritare, si dhe protestave të shiitëve në Bahrein e Arabinë Saudite; mendohet që 90 përqind e shiitëve të Bahreinit shohin kanalën Al-Alam ngaqë iu jep zë problemeve të tyre (Sedarat, 2011). Gjatë Pranverës Arabe kanali Al-Alam u rreshtua njëlloj si Al-Jazeera dhe Al-Arabyia. Prej këndej erdhi akuza për hipokrizi dhe standard të dyfishtë kundër Iranit, meqenëse inkurajonte rebelimin në Bahrein dhe në Arabinë Saudite, por jo në Siri dhe në Iran (AFP, 2011). Siç pohon Sebastian Usher, Irani e shfrytëzon kanalën Al-Alam në mënyrë që të “ndikojë dhe të nxisë opinionin publik në botën arabe e më tej – ashtu siç përpiqet të kontrollojë informacionin për njerëzit e vet brenda vendit” (Usher, 2006). E vërteta është se kanali Al-Alam funksiononte si një kanal mediatik alternativ për aktivistët shiitë arabë, një kanal që iu kundërvu mediave kryesore arabe dhe ia doli të krijonte hapësirë për pikëpamjet e tyre, ndonëse shpesh në kurriz të objektivitetit. Për më tepër, kanali televiziv i hezbollahëve libanez, Al-Manar, si dhe shumë prej stacioneve televizive shiite në Irak, duke përfshirë edhe kanalën televiziv shtetëror Al-Iraqiya, vazhdimisht kanë shprehur simpati për protestuesit dhe kanë kritikuar Arabinë Saudite si dhe monarkinë sunitë në Bahrein. Në fakt, kur Arabia Saudite dërgoi trupat e veta në Bahrein shumë prej shiitëve irakenë protestuan në Qerbala dhe gjetkë kundër këtij vendimi (Chulov, 2011). Krahasuar me rebelimin aktual në Siri kundër qeverisjes së Bashar Assadit, të gjithë këto kanale irakene nuk dëshmuar të njëjtën shkallë vëmendjeje dhe interesi edhe për kauzën e protestuesve dhe rebelëve sunitë. Në fakt rebelët e moderuar etiketohen rëndom si terroristë ngaqë luftojnë të përmbysin sundimin e Bashar Assadit, besimi Alawit i të cilit është reshtuar fuqimisht përkrah shiizmit.

Në këtë botë tejet të polarizuar rrjetet sociale online po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, kryesisht duke i thelluar edhe më shumë ndarjet mes grupeve të besimeve të ndryshme etnike dhe religjioze (Al-Rawi, 2015a, 2015b & 2017). Siç shpjegohet këtu më poshtë, madje edhe organe mediatike tradicionale si Al-Jazeera dhe Al-Arabiya janë pjesë e këtij realiteti të ri, i cili dëfton se rivalitetet politike dhe dallimet religjioze i japin formë retorikës mediatike.

Sikur të mos mjaftonin dallimet religjioze në botën arabe ekzistojnë edhe ndarjet politike, të cilat theksohen dhe ngandonjëherë shkaktohen nga organet e mediave. Pavarërisht pretendimit se një pjesë e kanaleve pan-arabike janë të ekuilibruar meqenëse ndjekin parimet e gazetarisë, fakti është se shumica e tyre është drejtpërdrejt e lidhur me sponsorët shtetërorë (Mellor, 2011, fq. 17-18). Në fakt këto kanale përdoren si instrumente politikë në duart e qeverive përkatëse për të ushtruar presion ndaj vendeve të tjera të rajonit, ndaj rivaletit politik dhe diferencat ideologjike mes vendeve të ndryshme arabe manifestohen drejtpërdrejt në peizazhin mediatik (Fandy, 2007, fq. 39-40). Për shembull, drejtori rajonal i Saudi_MBC, që zotëron kanalën Al-Arabiya, i tha një herë një diplomati amerikan se ishin të shqetësuar lidhur me kanalën televiziv të Katarit Al-Jazeera, për shkak të influencës në rajon, kështu që u mor vendimi që Al-Arabiya të kishte një politikë të re editoriale, e cila “t’i kundërvihet influencës së al-Jazeeras dhe të nxiste një perspektivë të ‘moderuar’ te të rinjtë e vendit”, (Wikileaks, 2009). E vërteta është se të dy kanalet televizive ndjekin politikën e shteteve në pronësi të të cilëve janë, kështu që mes tyre ekziston një konkurrencë e qartë që vazhdon prej shumë kohësh (Seib, 2008, f. 22). Për më tepër konkurrenca midis dy vendeve dhe kanaleve televizive ka çuar në krijimin e një klime

të tensionuar dhe mosbesimi. Për shembull, gazetarët e Al Jazeera para se të hyjnë në Mbretërinë e Arabisë Saudite duhet gjithnjë të filtrohen përmes Ministrisë së Brendshme të këtij vendi, sipas zbulimit më të fundit të gjetur në Wikileaks “Dosjet Saudite” (Wikileaks, 2015a). Po kështu, këto dosje zbulojnë se Katari ka mbështetur lëvizjet radikale në Sudan dhe në Siri, ashtu siç mbështeti partitë e opozitës në zgjedhjet e vitit 2009 në Liban, ndryshe nga Arabia Saudite, Jordania, EMA dhe Egjipti që përkrahën partitë e moderuara (Wikileaks, 2015b). Për më tepër, zyrtarët sauditë në mënyrë të përsëritur kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me përdorimin e Al Jazeera nga Katari si një instrument politik në krejt rajonin; për shembull, ata nxorën në pah se Katari, i cili është qendra e Unionit Ndërkombëtar të Studiuesve Muslimanë (IUMS) përpiket aktivisht të promovojë “Projektin e Katarit”, një projekt ky që e vë theksin tek Islami politik si një alternativë më e mirë ndaj sundimit totalitar dhe diktaturave në botën arabe (Wikileaks, 2015c). Kjo ngjan të jetë njëra prej arsyeve se përse Al Qaradawi e drejton IUMS-në nga Katari. Me fjalë të tjera disa prej organeve tradicionale të medias si dhe sajtet e rrjeteve sociale mendohet se nxisin dhunë, krijojnë përçarje dhe shkaktojnë trazira te grupe të caktuar. Duke qenë se moderimi ose ndryshimi i retorikës së këtyre kanaleve mediatike ngjan të jetë diçka e vështirë, ofrimi i kurseve të njohurive mediatike dhe edukimi i të rinjve arabë për të qenë kritikë ndaj asaj se çfarë konsumojnë prej medias përbëjnë mjetet më efektive për të minimizuar impaktin që ato mund të kenë në jetën e tyre.

Edukimi në fushën e medias digjitale & Sfidat që shtrihen përpara

Retorika sektare që ka gjetur vend në mediat tradicionale arabe, si dhe rritja e popullaritetit të rrjeteve të medias sociale, të cilat po vijnë duke e rritur gjuhën e urrejtjes, e bën të domosdoshme për edukatorët e medias që t’i përmirësojnë përpjekjet e tyre për të implementuar në mënyrë aktive projektet e njohurive mediatike. Duke qenë se është e pamundur t’i vësh fre retorikës së urrejtjes dhe të sektarizmit, e mira është të përftohen vende që ofrojnë edukim mediatik për grupmosha të ndryshme. Duke qenë se njohuritë në fushën e medias në botën arabe ballafaqohen me sfida të mëdha, po kështu edhe vështirësitë janë të mëdha. Aktualisht ka disa përpjekje të pakta e modeste për t’i përfshirë kurset e njohurive mediatike në programet mësimore të disa prej universiteteve, kryesisht në Liban (Melki, 2013 & 2011). Në këtë këndvështrim janë identifikuar katër elementë kryesorë që e ngadalësojnë zhvillimin e njohurive mediatike në botën arabe, duke përfshirë “mungesën e instruktorëve të kualifikuar dhe mungesën lëndës mësimore në arabisht” (Melki, 2013, f. 84), si dhe kufizimet teknologjike, por edhe “reagimin konservator ndaj disa prej topikëve të njohurive mediatike dhe metodave të mësimdhënies” (ibid., f. 85).

Për shkak të rritjes së frymës sektare në botën arabe ka ardhur dhe është më imperative mësimi i lëndëve religjioze, duke qenë se kjo gjë mund të jetë një prej rrugëve më efektive për t’iu kundërvënë retorikës përçarëse që haset në media. Sipas Ali Asanit, padija në çështje të religjionit mund të përkufizohet si:

Paafësi për ta konceptuar religjionin si një dukuri kulturore të lidhur ngushtësisht në matriksa komplekse kulturore. Si rrjedhojë e padijes një person është i paaftë të vlerësojë rolin kuptimplotë që faktorë si varfëria, statusi social, gjinia dhe ideologjitë politike mund të luajnë në formësimin e atyre që konceptohen si shprehje thellësisht religjioze. Padija në fushë të religjioneve është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e dështimit të sistemit edukativ për t'i pajisur studentët me mundësi për t'u angazhuar në mënyrë kritike në studimin akademik të religjionit (2011, f. 1).

Njohuritë religjioze, nga ana tjetër, shpjegohen edhe si aftësi për t'i trajtuar respekt e dinjitetet njerëzit që u përkasin sekteve dhe religjioneve të ndryshme. Çështje e vërteta, ky është një lloj edukimi jashtëzakonisht i nevojshëm, duke pasur parasysh luftrat në Jemen dhe në Siri, si dhe tensionet religjioze që nxjerrin krye herë pas here në vende si Egjipti, Iraku dhe Libani. Përveç se përforcon identitetin kombëtar, njohuritë në fushën e religjioneve janë gjithashtu në gjendje të “nxisë kohezionin social” madje t'i vërë fre terrorizmit, ashtu siç ngjau pas 9/11 në Mbretërinë e Bashkuar (Moore, 2014). Lidhur me ngjarjet më të fundit, Vivienne Baumfield reflekton rreth peshës së sulmeve, duke pohuar se “në qoftë se besimet fetare dhe qëndrimet ndaj religjionit shihen si pjesë e problemit, atëherë edukimi religjioz është pjesë e zgjidhjes” (Baumfield 2002, 8). Ky lloj edukimi religjioz duhet studiuar në shkollë dhe përfshirë në programet mësimore, asaj çka Patel dhe Meyer (2011) i referohen si “alfabetizimi i ndërbesimeve”. Për shembull, Iraku ka ende nevojë për përmirësime të ndjeshme në forcimin e rolit edukativ të religjioneve, si dhe të njohurive në këtë fushë në programet mësimore (al-Tikriti, 2010), duke qenë se “Pjesa më e madhe e teksteve shkollore janë ende pjesë e problemit... e fragmentimit social e kulturor dhe tensioneve sektare që i kanosen ekzistencës së vendit” (Rohde, 2013, f. 726).

Çka është më e rëndësishme, hapi i parë duhet të jetë identifikimi i vlerave pozitive, asish që mund të ndihmojnë në vendosjen e paqes dhe krijimin e unitetit kombëtar, si dhe të harmonisë etnike e asaj religjioze. Paskëtaj këto vlera duhet të përfshihen me kujdes dhe të bëhen pjesë e programit mësimor të njohurive mediatike, duke ndriçuar rëndësinë, peshën dhe impaktin e tyre, pa rënë në gjuhë propagandistike. Një pjesë e këtyre vlerave mund të përfshinë tolerancën politike dhe religjioze, ndërtimin e një mjedisi paqësor, hapjen kundrejt perspektivave të ndryshme dhe respekt për debatin demokratik. Në qoftë se studentët nuk e kuptojnë plotësisht plotkuptueshmërinë e këtyre vlerave, ata nuk do të jenë në gjendje t'i riprodhojnë më vonë. Për hir të së vërtetës një pjesë e këtyre përpjekjeve të medias duhet të mbështeten nga shteti për shkak se për t'i vënë në jetë ka një kosto financiare si dhe mbështetje logjistike, ndërsa Divizioni për Median dhe Komunikimin e Lidhjes Arabe mund të jap një dorë për këto përpjekje si e si për të pasur një organizëm referimi dhe një njësi mbështetëse rajonale. Në përgjithësi njohuritë mediatike duhet të përvetësohen qysh në fazat e hershme të arsimimit, mundësisht qysh në shkollën fillore, duke qenë se mirëkuptimi, vetëdijshmëria, analiza dhe vlerësimi i mesazheve të medias, ashtu si dhe zhvillimi i aftësive për të pasur një gjykim kritik kërkojnë kohë para se të shndërrohen e bëhen procese automatike. Avantazh plus në trupëzimin e këtyre aftësive në programin mësimor është krijimi i një brezi të mirëinformuar dhe të mirëarsimuar meditikisht, i cili mund të sjellë ndryshime pozitive në skenën mediatike të botës arabe.

Për ta përmbledhur njohuritë në fushën e religjioneve dhe të politikës ngjajnë të jenë mjetet më efektive për t'i vënë fre retorikës së medias sektare dhe frymës përçarëse me të cilat bombardohen masat e popullsisë arabe. Këto lloj njohurish nevojiten më shumë se kurrë për shkak të rritjes së gjuhës së urrejtjes, injorancës dhe izolimit me të cilat ballafaqohen një numër i madh komunitetesh si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Me fjalë të tjera, njohuritë mediatike janë kyçi për të forcuar unitetin kombëtar, paqen dhe harmoninë mes popujve.

Referenca

- Al-Rawi, A. K. (2015a). Sectarianism and the Arab Spring: Framing the popular protests in Bahrain. *Global Media and Communication*, 11(1), 25-42.
- Al-Rawi, A. (2015b). *Online Reactions to the Muhammed Cartoons: YouTube and the virtualUmmah. Journal for the Scientific Study of Religion*, 54(2), 1-30.
- Al-Rawi, A. (2017, forthcoming). Online political activism in Syria: Sentiment analysis of social media. *Sage Research Studies Cases*, 1-20.
- al-Tikriti, Nabil. (2010). War, State Collapse and the Predicament of Education in Iraq. In A. Mazawi & R. Sultana (Eds.). *Education and the Arab "World": Political Projects, Struggles, and Geometries of Power*. London: Routledge.
- Asani, Ali. (2011). The Harvard Sampler: Liberal education for the Twenty-First Century. In J. Shephard, S. Kosslyn & E. Hammonds (Eds.). *Enhancing religious literacy in a liberal arts education through the study of Islam and Muslim societies* (pp. 1-31). Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press.
- Baumfield, V. (2002). Editorial. *British Journal of Religious Education*, 24(2), 82-84.
- Chulov, Martin. (2011, March 17). Bahrain arrests six opposition leaders for 'contacting foreign agents'. *The Guardian*. Retrieved from <http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/17/bahrain-arrests-opposition-leaders-crackdown>
- CNN Arabic. (2013, February 7). Bahrain's revolution is sectarian that targets Sunnis. Retrieved from <http://arabic.cnn.com/2011/bahrain.2011/3/19/qaradawi.bahrain/>
- Fandy, M. (2007). *(Un) civil war of words: media and politics in the Arab world*. New York: Greenwood Publishing Group.
- Hashem, Ali, (2012, April 3). The Arab Spring Has Shaken Arab TV's Credibility. *The Guardian*. Retrieved from <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2012/apr/03/arab-spring-arab-tv-credibility>
- Hobbs, R. (2011). *Digital and media literacy: Connecting culture and classroom*. California: Sage publication, Corwin.
- Lynch, M. (2006). *Voices of the new Arab public: Iraq, Al-Jazeera, and Middle East politics today*. Columbia: Columbia University Press.
- Melki, J. (2011). The Plight of Media Education and Research in Arab Higher Education. In Chi-Kim Cheung (Ed.), *Research in media education* (pp. 83-108). New York: Nova Science Publishers.
- Melki, J. (2013). Sowing the seeds of digital and media literacy in Lebanon and the Arab world. In B. S. De Abreu & P. Mihailidis (Eds.). *Media literacy education in action: Theoretical and pedagogical perspectives* (pp. 77-86). London: Routledge.
- Mellor, N. (2011). *Arab media: Globalization and emerging media industries*. Cambridge: Polity.
- Moore, D. L. (2014). Overcoming Religious Illiteracy: Expanding the Boundaries of Religious Education. *Religious Education*, 109(4), 379-389.
- Murphy, Brian. (2013, January 19). Gulf rulers take sharper aim at Web dissent. *Associated Press*.

- Patel, E., & Meyer, C. (2011). Interfaith cooperation on campus: Teaching interfaith literacy. *Journal of College and Character*, 12(4).
- Potter, W. (2014). *Media Literacy* (7th edition). California: Sage publication.
- Potter, W. (2016). *Introduction to media literacy*. California: Sage publication.
- Rohde, A. (2013). Change and continuity in Arab Iraqi education: Sunni and Shi'i discourses in Iraqi textbooks before and after 2003. *Comparative Education Review*, 57(4), 711-734.
- Russia Today. (2012, March 12). Al Jazeera exodus: Channel losing staff over 'bias'. Retrieved from <http://rt.com/news/al-jazeera-loses-staff-335/Ahmed-Al-Rawi>
- Scheibe, C. & Rogow, F. (2012). *The teacher's guide to media literacy: Critical thinking in a multimedia world*. California: Sage publications, Corwin.
- Sedarat, Firouz. (2011, December 14). Satellite TV news, serials widen Iranian-Arab gulf. *Reuters*.
- Seib, P. (2008). *The Al Jazeera effect: How the new global media are reshaping world politics*. New York: Potomac Books, Inc.
- Wikileaks. (2009). Ideological and ownership trends in the Saudi media. 09RIYADH651 May11. E.O. 12958. *Embassy Riyadh*. Retrieved from <http://wikileaks.org/cable/2009/05/09RIYADH651.html>
- Wikileaks. (2015a). Saud Al Faysal cable to the Ministry of Interior. Retrieved from <https://wikileaks.org/saudi-cables/doc118353.html>
- Wikileaks. (2015b). Royal Embassy of Saudi Arabia – Doha. Retrieved from <https://wikileaks.org/saudi-cables/doc67345.html>
- Wikileaks. (2015c). Directorate of General Intelligence – Kingdom of Saudi Arabia. Retrieved from <https://wikileaks.org/saudi-cables/doc85590.html>

Edukimi në fushën e medias dhe të komunikimit për të trajtuar polarizimin social në Europë

Jessica Cohen & Jose Maria Blanco

“Në qoftë se nuk tregoheni të kujdesshëm gazetat mund t’ju bëjnë të urreni njerëzit e shtypur dhe të bini në dashuri me shtypësit”.

Malcolm X

Polarizimi social me të cilin ballafaqohemi në Europë, po ashtu rreziku që paraqet terrorizmi, emigracioni masiv dhe kriza e refugjatëve, por edhe ekstremizmi, radikalizmi, nacionalizmi e populizmi janë një terren pjellor që mund të prodhojë efekte të dëmshme: pabarazi urbane, geto, trazira sociale, rritje të esktrimizmit të dhunshëm, si dhe akte urrejtjeje kundër minoriteteve dhe bashkësive. Të gjitha këto situata mund të vënë në lëvizje dhe të përshpejtojnë procese të një radikalizmi të dhunshëm në një qerthull të vazhdueshëm.

Ky artikull bën fjalë për polarizimin social që ka prekur aktualisht Europën. Një pjesë e akteve të kryera nga njerëz me një farë besimi ose një origjinë të caktuar gjeografike konsiderohen automatikisht terrorizëm, ndërkohë që akte të tjera të së njëjtës natyrë, duke përfshirë edhe motivimin, autorëve të të cilave iu ndryshon vetëm ideologjia, klasifikohen si krime urrejtjeje dhe nuk ngjallin të njëjtën vëmendje të medias. Përcaktimi ndryshe i dy fakteve të njëjlojtë nuk bën gjë tjetër veçse prodhon paqartësi dhe pasiguri ligjore.

Njohuritë në fushë të medias dhe të komunikimit (NJMK) bazuar në konceptualizimin e bërë nga UNESCO (2011), mund të ofrojnë një sërë mundësish për t’i bërë më të aftë qytetarët, komunitetet dhe minoritetet të luftojnë krimin e urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe radikalizmin e dhunshëm, duke iu dhënë dorë të vlerësojnë dhe krijojnë përmbajtje etike të reja për të fuqizuar kohezionin social në shoqëritë tona multikulturore dhe të shumëllojshme. Në këtë punim propozojmë përvijimin e një qasjeje strategjike për të përballuar situatën e rënduar të polarizimit social në Europë dhe efektet publike të kësaj situatë, duke kombinuar NJMK dhe disiplinat e një analize inteligjente.

Fjalëkyç: radikalizim, terrorizëm, gjuhë urrejtje, krime urrejtje, shoqëri, njohuri mediatike.

Një analizë kritike e kontekstit aktual europian

Dy fenomene janë shfaqur gjatë vitit 2015 si sfida të mëdha për Europën. Nga njëra anë terrorizmi xhihadist, i cili ka goditur veçanërisht Francën dhe Belgjikën. Nga ana tjetër, kriza e refugjatëve, një dyndje masive nga disa vende të përfshira nga luftrat, që kërkojnë të mbërrijnë në Europë në kërkim të një jete më të mirë.

Masmedia, politikanët dhe qytetarët e kanë vënë theksin mbi këto çështje, duke i argumentuar në mënyra të ndryshme, por jo gjithmonë në mënyrë racionale. Efektet e të dyja dukurive gjenerojnë impakte politike, ekonomike dhe sociale, ndaj duhen matur e peshuar jo vetëm nga numri i viktimave të shkaktuara nga sulmet terroriste, por edhe nga një numër i madh debatesh të shfaqur rreth parimeve dhe vlerave që lidhen me terrorizmin në shoqëritë tona, pasigurinë për të ardhmen në Europë, frika nga e panjohura. Përmes një analize të masmedias dhe asaj të rrjeteve sociale është e mundur të vlerësojmë se sa e si Europa është duke vuajtur nga një polarizim i fortë politik dhe social.

Këto impakte afektojnë dukuri të tjera të asociuara me më pak vëmendje nga ana e mediave. Gjatë vitit 2015, vende si Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Spanja kanë përjetuar një rritje të ndjeshme në përqindje të krimeve të motivuara nga urrejtja. Mediat sociale, por edhe organet e mediave tradicionale, janë shfrytëzuar si amplifikatorë të gjuhës së urrejtjes kundër minoriteteve dhe bashkësive të tjera, falë përdorimit të kollajtë dhe një shkalle anonimatit. Faktorët lëvizës të këtij fenomeni janë shfrytëzimi arbitrar i krizës, stërpërdorimi i problemeve sociale, thjeshtëzimi i informacionit dhe shfaqja e një armiku me një fytyrë të re.

Përdorimi arbitrar i krizës

Kriza aktuale e refugjatëve është një shembull i rëndësishëm i kësaj situatë polarizimi. Nga veriu në jug, nga lindja në perëndim të Bashkimit Europian, situata ka shërbyer për t'iu dhënë zë edhe zërave më intolerant. Në Gjermani, fjala vjen, ku gjuha e urrejtjes ndëshkohet rreptësisht, rritja e këtyre qëndrimeve intolerante sot e kësaj dite, ka bërë që autoritetet t'iu drejtohen e t'iu kërkojnë rrjeteve sociale si Twiteer, Facebook ose Google të ushtrojnë një kontroll më të madh lidhur me përmbajtjet fyerëse, duke ua përshtatur ligjet në vend operacioneve të ndërmarra në këtë drejtim. Kështu që nuk ka asgjë për t'iu befusuar kur merr vesh se policia gjermane ka numëruar 906 sulme ndaj qendrave të refugjatëve në vitin 2015, katër herë më shumë nga çka pasur një vit më parë.

Për shkak të këtij evoluimi dramatik qeveria gjermane ka ngritur një grup pune të posaçëm ku bëjnë pjesë organet kryesore të medias, aktivistë, pjesëtarë të qeverisë, sipërmarrës dhe grupe të tjera të interesit, për t'iu marrë me këtë fenomen. Rezultatet e zgjedhjeve të fundit lokale të zhvilluara më 13 mars 2016, ku e djathta ekstreme triumfoi mbi partinë në pushtet (CDU), përbën një tjetër alarm rreth polarizimit politik në Europë.

Me mijëra refugjatë hynë në territorin e Europës gjatë vitit 2015 (përmbi një milion njerëz). E gjithë kjo situatë u menaxhua me mjaft vonesë dhe nën trusninë e komenteve të vazhdueshme lidhur me mundësinë e mbërritjes së terroristëve si refugjatë, çka shpuri në marrjen e një sërë masash kontroverze. Të gjitha këto masa u paraqitën si imperative sociale në një sërë partish politike. Por lidhur me ligjshmërinë e tyre ka dyshime serioze.

Stërpërdorimi i problemeve sociale

Një sërë çështjesh objekt kauzash jo racionale janë harruar. Nga njëra ditë në tjetrën një sërë çështjesh me peshë dalin jashtë përdorimit, ndërkohë që të tjera ua zënë vendin. Herë pas here situata jashtëzakonisht të rëndësishme anashkalohen, pa u marrë me shkaqet e tyre. Një rast i këtillë është, fjala vjen, kriza aktuale e refugjatëve në Europë.

Herë të tjera dështimet e mëdha nuk meritojnë të njëjtin nivel veprimtarie komunikimi që ngjalli informacioni i gabuar, sidomos atëherë kur ky informacion i kundërvihet asaj ndjesie sociale që ka ekzistuar më parë. Diçka e tillë ndodhi para pak kohësh, kur policia e Këlnit konfirmoi se sulmet seksuale të kryera në prag të vitit të ri nuk ishin punë refugjatësh, siç u raportua nga mediat në të gjithë botën.

Tejthjeshtëzimi i informacionit

Për shkak të afërsisë së dukshme gjeografike, në rastin më të mirë, dhuna terroriste trajtohet si informacion rutinë me përjashtim të atyre rasteve kur ajo vjen e materializohet në Europë. Iraku, Afganistani, Somalia dhe Egjipti përbëjnë sfondin e lajmeve në mediat Perëndimore.

Opinionin publik afektohet gjithashtu nga mbulimi mediatik. Një studim i kryer më 2011 hetoi nëse konteksti i ndryshëm, ndaj të cilit është i ekspozuar publiku në rastin e lajmeve të lidhura me terrorizmin, kishte ndonjë efekt në perceptimin e tij (Woods, 2011). Krahasuar me rrezikun e terrorizmit të brendshëm, subjektet treguan një nivel të lartë kanosjeje kur ekspozoheshin ndaj rreziqeve të lidhura me “grupet radikale Islamike”.

Këto karakteristika, atje ku në mungesë të sulmeve në pjesën më të madhe të territoreve perëndimore shoqërohet me një ekspozim të vazhdueshëm mediatik të rrezikut, bën që terrorizmi të jetë vazhdimisht i pranishëm në ndërgjegjen e publikut dhe të qëndrojë në agjendën politike dhe sociale. E panjohura që shoqëron rrezikun e bën më të prekshëm ekzagjerimin (The Soufan Group, 2015).

Rrjeti i Etikës Gazetareske (White, 2015) në një trajtesë të vetën lidhur me trajtimin që iu bë nga shtypi ndërkombëtar krizës së refugjatëve, evidentoi mungesën e dukurisë në shtypin dhe radiot ndërkombëtare deri ditën e vdekjes së një të mituri, Aylan Kurdi, në një plazh të Turqisë dhe sesi shumë prej agjencive as që i mbulojnë krizat humanitare, deri në çastin që ato marrin përmasa të mëdha, si rrjedhojë e mungesës së reporterëve në terren.

Fytyra e armikut

Sulmet terroriste, ashtu si të gjitha katastrofat e mëdha, i japin trajtë psikës shoqërore. Sipas studimit të Craik dhe Lockhart (1972) rreth kujtimeve, sulmet terroriste, ngjarjet tejet negative janë përvoja me impakte më të mëdha në vlerësimin dhe gjykimin e situatave që

vijojnë, dhe ajo ato me impakt pozitiv, që e bëjnë kujtesën të aksesueshme. Një prej këtyre ndryshimeve e afekton imazhin e brendshëm (figurën mendore) rreth popullsisë nga vende të tjera, veçanërisht atyre prej nga vijnë terroristët. Kjo situatë krijon besime negative dhe armiqësore kundrejt shoqërive të treta (Bar-Tal dhe Labin, 2001), dhe përforcon identitetin e qytetarëve të një shteti.

Kjo predispozitë për ta refuzuar të huajin amplifikohet nga performanca e memories kolektive (Pennebaker, 1993). Halbwachs, një sociolog francez, shprehet se faktet që kanë impakt mbi bashkësitë mbahen mend dhe ushqehen kolektivisht. Përkujtimet dhe përvjetorët, si dhe gjetja e pyetjeve dhe e përgjigjeve së bashku, janë rituale që i rrisin këto modele shoqërore. Kjo gjë konfigurron një histori sociale të nëndheshme (Ulsar Pietri, 1992), duke gjeneruar urrejtje ndërgrupe.

Media europiane. Informimi rreth Krimeve të Urrejtjes dhe Gjuhës së Urrejtjes

Gjuha e urrejtjes përpiket të vendosë disa grupe shoqërore mbi të tjerët, duke i konsideruar disa njerëz sipërorë mbi të tjerët, duke dëmtur në mënyrë të drejtëpërdrejtë kohezionin social dhe nxitur akte diskriminimi dhe dhune. Nisur nga ky skenar është e mundshme të identifikosh de facto një rritje të intolerancës kundër minoriteteve, por gjithashtu kundër të gjithë grupeve sociale, si dhe krejt nacionaliteteve.

Edhe nuk duhet kuptuar sipas termave të shkakut dhe pasojës, ekzistenca e gjuhës së urrejtjes (si shprehje publike) duhet vlerësuar dhe hulumtuar sipas termave të një faktori potencial të krimit të urrejtjes (si aksione konkrete të drejtuara kundër njerëzve), duke mbajtur e promovuar një diskutim rreth marrëdhënieve të tyre, por edhe dukurive të tjera, si ekstremizmi i dhunshëm ose radikalizimi i dhunshëm.

Rreptësia dhe përgjegjshmëria vijnë e bëhen më të nevojshme dhe më të vështira për t'u arritur se kurrëndonjëherë. Një prej karakteristikave inherente në kontekstin aktual social është aftësia e medias, asaj tradicionale dhe të re, për ta imponuar vetveten si opinion krijuese. Kështu opinionimi publik shndërrohet në opinion të dhënë nga media.

Polarizimi social nuk mund të studiohet nga një pikëvështrim mono-shkakësor, ashtu si as edhe një prej dukurive që ndodhin në botën globale. Ligjërimi politik, interesat e ndryshme tregtare ose objektivat e lobistëve janë disa prej variableve që afektojnë ndërtimin e tij. Media është e angazhuar në krijimin e këtij opinionimi publik, ngandonjëherë si lojtar shtesë, ngandonjëherë duke inkurajuar dhe ushqyer skenarin aktual të polarizuar. Lehtësia e aksesit të kanalet e informacionit, kapaciteti i jashtëzakonshëm për të shpërndarë mesazhet nga kanale të ndryshme, si dhe kostoja e ulët, veprojnë si lehtësues për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe të frikësimit.

Sidoqoftë edhe ata gazetarë ose media që ushtrojnë profesionin e tyre me korrektësinë e duhur duhet të jenë të vetëdijshëm për lehtësinë me të cilën platformat, televizionet ose rrjetet e tyre online mund të shfrytëzohen për të përçuar mesazhin e urrejtjes. Kjo situatë vjen prej aftësisë së përdoruesit për të ndërvepruar me mjedise të ndryshme, duke postuar komente, tuite ose elementë të tjerë që ushqejnë urrejtjen dhe diskriminimin.

Për të shmangur këto situata, të shtyrë nga nevoja për të moderuar çfarëdolloj mesazhi publik dhe parandaluar këto aksione, në vitin 2011 u lind Shoqata Carta di Roma, që synon të sensibilizojë gazetarët për përdorimin e Kodit të Sjelljes së Gazetarit për Emigracionin.

Rrjeti i Etikës së Gazetarisë është një tjetër iniciativë. I lindur më 2011 ai punon për të krijuar besim tek opinioni publik, për gazetari të përgjegjshme dhe kredibilitet. Ky Rrjet synon t'i kundërvihet kontrollit, censurës ose propagandës që ushtrojnë disa qeveri, si dhe të denoncojë e të parandalojë dobësinë e gazetarëve kur ballafaqohen me një mjedis të korruptuar.

Shpejtësia në rritje e informacionit është një tjetër pengesë në këtë luftë, e cila shpije në publikimin e lajmit dhe të përmbajtjes së tij pa kurrëfarë verifikimi dhe vlerësimi. Parandalimi i kësaj narrative dhe ndëshkimi i gjuhës së urrejtjes nuk përputhet me ruajtjen e lirisë së shtypit, siç thuhet në direktivat e fundit të nxjerra nga Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI, 2016).

E megjithatë nevojiten edhe më shumë hulumtime për të vlerësuar pavarësinë reale të medias aktualisht, e cila ngandonjëherë iu nënshtrohet interesave të partive politike ose varet prej konglomerateve gjigante të biznesit objektivat e të cilëve nuk përkojnë ekzakhtësisht me lirinë e komunikimit dhe të shtypit.

Një strategji për Alfabetizimin në Media dhe Komunikim (NJMK) kundër Urrejtjes, Ekstremizmit dhe Radikalizmit

Europa ballafaqohet me një problem serioz që kërkon një përcaktim të qartë të termave, si dhe një angazhim social për të mos nënvlerësuar gjuhën dhe krimet e urrejtjes, denoncimin publik dhe hetimin policor. Palët e interesuara e këtij angazhimi të nevojshëm janë politikanët, komunitetet dhe minoritetet, media, agjencitë e zbatimit të ligjit, organizmat ligjorë, prokuratorët dhe qytetarët. Në një shoqëri ku mesazhi është imazhi, roli i medias është kyç për të formësuar perceptimet sociale të rrezikut dhe kërcënimeve që godasin shoqëritë tona sot e kësaj dite. Përfundimisht, shoqëritë tona duhet të përvijojnë politika shtruese ku dimensionin bashkiak, social dhe arsimor përbëjnë kyçin për një bashkekzistencë në të ardhmen me diversitetin.

Ne propozojmë hartimin e një qasjeje strategjike për të përballuar situatën e rëndë të polarizimit në Europë dhe efektet e mundshme të tij: rritjen e ekstremizmit dhe të populizmit, marginalizimin social, rritjen e pabarazive në një sërë fushash (ekonomike, sociale dhe teknologjike), zhvillimin e getove urbane, konflikteve sociale, dhe përplasjeve mes komuniteteve, rritjen e krimit të urrejtjes dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Një pjesë e mirë e vendeve të Europës janë multikulturore, çka e rrit sfidën e të ndihmës ndaj njerëzve me origjinë, situata kulturore dhe ekonomike të ndryshme që të jenë pjesëmarrës në botën globale. Ky synim mund të rritet duke bërë të mundur që të kenë akses në informacion dhe të krijojnë substancën e tyre (UNESCO, 2013).

Një tjetër çështje e rëndësishme është rritja e hendekut midis brezave, për shkak të ndryshimeve të shpejta dhe dhe evoluimit të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit. Kjo gjë shpije në krijimin e një hendeku midis të anëtarëve të rinj dhe të moshuarve në komunitete, si dhe minoriteteve në Europë. Të rinjtë kërkojnë të gjejnë një

vend midis traditës së prindërve të tyre dhe modernizimit të shoqërive ku jetojnë, një proces ky që gjeneron tensione dhe shpije në krizë identiteti.

Ka disa elementë që janë themelore në hartimin e strategjisë: misioni (çfarë duhet të arrijmë), vizioni (si ta arrijmë) dhe vlerat (parime e përgjithshme që drejojnë aksionet tona). Misioni ynë duhet të jetë fuqizimi i individit, komuniteteve dhe shoqërisë për të pasur akses dhe vlerësuar informacionin që lidhet me krimet e urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke iu dhënë mundësi të gjenerojnë substanca mediatike për të luftuar polarizimin social, si dhe për të thyer ciklin e urrejtjes ku jetojnë sot shoqëritë tona. Sulmet terroriste, kriza e refugjatëve, kriza ekonomike ose pozicionet politike radikale, populiste dhe nacionaliste e fuqizojnë të gjithë këtë cikël të urrejtjes. Neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut pohon se: “çdokush ka të drejtë për lirinë e shprehjes dhe të opinionit; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione pa ndërhyrje për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion e ide përmes medias pavarësisht kufijve”.

Vizioni i kësaj strategjie sugjeron se, në mënyrë që procesi të zhvillohet ai duhet të jetë holistik, i hapur, pjesëmarrës, pluralist dhe gjithëpërfshirës (UNESCO, 2013). Ky është kuptimi përmes të cilit UNESCO futi konceptin e Shoqërive të Ditura (2013).

Vlerat e supozuara që një strategji kundër urrejtjes duhet të ketë parasysh si kornizë të vetën janë: respekti për të drejtat e njeriut, barazia, liria dhe toleranca.

Në vijimësi të një procesi Inteligjence (disiplinë, art ose profesion të aplikuar në fushën e sigurisë), do të bëhej e mundur krijimi i një procesi të NJMK-së për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm përmes fazave që vijnë, jo gjithmonë ciklike ose ndjekin njëra-tjetrën: planifikimi i detyrës, menaxhimi i informacionit, analiza e informacionit, përhapja e informacionit (kanale të reja dhe informacion i ri që kontribuojnë për diversitetin e shprehjes kulturore dhe kohezionit social) në mënyrë etike, si dhe vlerësimi i impakteve të një përmbajtjeje të re të përhapur. Ky model është kompatibël, fjala vjen, me modelet e propozuara nga Boekhorst (2013), SCONUL-i britanik 7 shtyllat e njohurive të informacionit (1999) ose komponentët kritikë të propozuar nga paneli i mbledhur nga Paneli Ndërkombëtar i Njohurive ITC (2001);

Tabela 1: Njohuritë në Media dhe Informacion sipas Procesit të një Analize Inteligjente.

Procesi	NJMK
Planifikim	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i objektivave, kohës në dispozicion dhe burimeve të caktuara • Kuptimi i rolit dhe i funksioneve të ofruesve të informacionit dhe të medias, si dhe të kushteve përmes të cilave këto funksione mund të realizohen. • Njohja e nevojës për informacion.
Menxhimi i informacionit	<p>Akses në informacion</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedhja e burimeve të informacionit: shtypi, materiale audiovizuale, forume, blllogje, media sociale, biblioteka... • Përzgjedhja e instrumenteve për të mbledhur informacion: motor të dhënash, alarme, kurimi i përmbajtjes, internet... <p>Mbledhja e informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi dhe skanimi

Analiza e informacionit	<p>Vlerësimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Besueshmëria e burimeve dhe kredibiliteti i informacionit. Të gjykuar për cilësinë, peshën, frytshmërinë ose eficiencën e informacionit <p>Informacion i integruar</p> <ul style="list-style-type: none"> Integrimi i informacionit të gjetur: përmbledhja, krahasimi dhe kontrastimi. <p>Analiza e informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Kuptimi i informacionit Aplikimi i metodologjive të analizës: sasiore, cilësore, teknika të strukturuar të analizës
Shpërndarja	<p>Krijimi i kanaleve të rinj</p> <ul style="list-style-type: none"> Lidhja me ofruesit e informacionit dhe median për vetëshprehje dhe pjesëmarrje demokratike. Promovimi i përdorimit të bibliotekave me shërbime të reja teknologjike. <p>Krijimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i përmbajtjes së përshtatshme për kanale të ndryshme. Krijimi i rasteve, ngjarjeve, diskutimeve dhe ideve.
Vlerësimi	<ul style="list-style-type: none"> Matja e impaktit të përmbajtjeve të reja Përzgjedhja e treguesve që matin arritjet Kontrastimi i këtyre impakteve me impaktin e krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes

Kuzmin (2013) nxori në pah se “informacioni krijohet, shpërndahet dhe na imponohet nga një numër i madh njerëzish injorantë, kokëtrashë, të papërgjegjshëm dhe të ligj ose thjesht të çmendur. Për rrjedhojë, interneti është plot e përplot si me informacion të vlefshëm e të vërtetë ashtu edhe me informacion të dëmshëm e të rremë”. Duke bërë fjalë për gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes, duhet thënë se sasia e informacionit të dëmshëm ka ardhur duke u rritur.

NJMI nuk është vetëm çështje njohurish teknologjike. Aftësitë kognitive dhe njohuritë e përgjithshme duhet të jenë pjesë e kurrikulumit. Shumica e strategjive të përpunuara nga qeveritë janë të fokusuara mbi teknologjitë e reja, aplikimet e reja, harduerët dhe softuerët, si dhe përdorimin e Internetit. Vetëm teknologjia nuk mjafton për të luftuar krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes. Teknologjitë e reja janë mjete me vlerë të madhe për të arritur objektiva kompleks dhe u përballur me kërcënime transnacionale, si ato që përfaqësojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe polarizimin social. Mediumi nuk duhet shndërruar në objektiv, në një çështje tejet të përbashkët në epokën tonë digjitale. Në qoftë se aftësitë teknologjike janë të nevojshme, aftësitë kognitive janë të domosdoshme. Motorët e kërkimit mund ta ndihmojnë një hulumtues, një mësues ose një analist inteligjence për të mbledhur informacion të mirë, por vetëm atëherë kur ai e di si të planifikojë një strategji kërkimi. Kreativiteti, aftësitë për të menduar dhe komunikuar ose zgjidhja e problemeve janë faktorët kyç për mbërritjen e suksesit. UNESCO (2011) në një dokument me titull “Njohuritë mediatike dhe të informacionit. Kurrikulum për mësuesit”, përpilon një takëm të plotë kompetencash për mësuesit që mund të aplikohen edhe nga palë të tjera të interesuara (bibliotekarë, komunitete dhe minoritete, ofrues të shërbimeve digjitale ose qytetarë.)

Në vazhdim të procesit të mëparshëm, njohuritë dhe aftësitë e domosdoshme për çdonjërin fazë mund të jenë:

Tabela 2. Aftësitë NJMnë një Proces Analize Inteligjente.

Procesi	Njohuri dhe aftësi
Planifikimi	<p>Njohuritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krimi i urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes. Shkaqet dhe efektet. • Shtyllat e epokës digjitale. • Informacioni dhe burimet e medias. • Etika në përdorimin e informacionit. <p>Aftësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizion holistik • Të menduar sistematik • Lidërship
Menaxhimi i informacionit	<p>Njohuritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi i burimeve. Përpunimi i një doracaku burimesh për të monitoruar krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes. • Menaxhimi i dokumenteve. • Instrumente për të mbledhur informacion rreth krimet të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes: mbledhës, RSS, kurimi i përmbajtjes, sisteme alarmi. • Hulimtues interneti dhe përdorimi i Internetit për qëllime hetimi. • Përkthyes dhe fjalorë. <p>Aftësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të menduar sistematik.
Analiza e informacionit	<p>Njohuritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modele të vlerësimit të informacionit. • Metoda shkencore. • Metodologji nga shkencat shoqërore: sasiore, cilësore dhe të përziera. • Instrumente për të integruar informacionin (nxjerrja e entiteve, analiza semantike, analiza e rrjeteve sociale) <p>Aftësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kreativitet • Të menduar kritik • Të menduar logjik
Shpërndarja	<p>Njohuri:</p> <p>Krijimi i përmbajtjeve digjitale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshtatja e përmbajtjeve për median • Infografika dhe harta • Informacion vizual: imazhe dhe video • Etika në përdorimin e informacionit • Privatësia dhe përdorimi i të dhënave personale • Instrumente për të shpërndarë informacionin <p>Aftësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Logjikë dhe argumentim • Kreativitet • Aftësi komunikimi • Inteligjencë emocionale • Kallëzim ngjarësh

Procesi	Njohuri dhe aftësi
Vlerësim	<ul style="list-style-type: none"> • Matja e impaktit të përmbajtjes së re • Përzgjedhja e treguesve që masin arritjet • Kontrastimi i këtyre impakteve me impaktet e krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes

Aplikimet, gjithnjë me objektivin e ballafaqimit të krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, mund të orientohen në fusha si studimet inteligjente, si një rast praktik i aplikimit, kriminologji, punë sociale, gazetari, trajnim pas diplomues si një specifike e njohurive dhe, veçanërisht, mund të fokusohet te OJQ-të, punëtorët socialë, psikologët, komunitetet dhe minoritetet.

NJMI në Europë. Analiza kritike dhe mundësi të reja

Ndërtimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse mund të arrihet vetëm përmes një politike të orientuar. Edhe pse ka disa politika të lidhura me NJMI-në në Europë, siç edhe pohohet në studimin “Prirje dhe qasje aktuale ndaj njohurive mediatike në Europë”, kryer për Komisionin në gjysmën e dytë të vitit 2007, ekzistojnë disa barriera për zhvillime në fushën e njohurive mediatike në rrafshin europian. Këto barriera përfshijnë në veçanti mungesën e një vizioni të përbashkët, mungesën e një vizibiliteti europian iniciativash nacionale, rajonale e lokale, mungesën e rrjeteve europiane dhe bashkërendimin mes palëve të interesuara.

Pas një analize të kornizave rregullatore ekzistuese të materialit në Bashkimin Europian, mund të vihen re mundësitë në rritje nga kapacitetet e organizatave të ndryshme për ta avancuar çështjen. Është e vërtetë që ka disa aktivitete, shumë të përgjithshme, për të forcuar komunitetet dhe grupet me synime gjithëpërfshirëse, por jo në atë kuptim siç ka vënë në pah dhe kërkon UNESCO.

Në sferën rregullatore njëra prej masave më të rëndësishme ishte Direktiva Audiovizuale e Shërbimeve në Media (2007), e cila mbron disa interesa publike, duke theksuar se: “Njohuritë në media iu referohen aftësive, njohurive dhe kuptimit që i lejon konsumatorët ta përdorin median në mënyrë efektive dhe të sigurt... Për këtë arsye zhvillimi i njohurive mediatike duhet të promovohet dhe të monitorohet në të gjithë sektorët e shoqërisë”.

Rekomandimi i Parlamentit Europian dhe i Këshillit lidhur me mbrojtjen e të miturve në lidhje me konkurrencën në industrinë e shërbimeve audiovizuale dhe të informacionit on-line (2006) rekomandon që Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e të miturve dhe të dinjitetit njerëzor në të gjitha shërbimet audiovizuale dhe të informacionit, duke promovuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesuara dhe me një qëndrim të përgjegjshëm nga ana e profesionistëve, ndërmjetësve dhe përdorimit të medias së re komunikuese siç është Interneti.

Në një Rekomandim të ri (20 gusht 2009) Komisioni shprehet: “Njohuritë në media janë një çështje gjithpërfshirje dhe qytetarie në shoqërinë e sotme të informacionit. Ato janë një mjet themelor jo vetëm për të rinjtë, por edhe për të rriturit dhe të moshuarit, prindërit, mësuesit dhe profesionistët në fushën e medias. Falë Internetit dhe teknologjisë digjitale, një numër gjithnjë e më i madh europianësh sot janë në gjendje të krijojnë dhe të shpërndajnë imazhe, informacion dhe përmbajtje. Njohuritë mediatike sot këqyren si një prej prerekuizitave kryesore për një qytetari aktive dhe të plotë për të parandaluar dhe pakësuar rrezikun e përjashtimit nga jeta në komunitet”. Konkluzionet e Këshillit për njohuritë në media në mjedisin digjital (2009), ishin në të njëjtën radhë, një manifestim gjenerik synimesh.

Nisma të tjera rreth NJMI ishin Iniciativa i2010, një takëm i gjerë direktivash politikash për shoqërinë e informacionit, Forumi Europian i eAftësive dhe Programi i Financimit të KE, për të organizuar një sërë seminaresh rreth Njohurive Mediatike.

Komisioni Europian mbështet iniciativa dhe çmime, menaxhon projekte, programe (MEDIA dhe MEDIA Mundus Program) si dhe financon skema si Europa Kreative, porositi raporte dhe vëzhgime, përmirëson legjislacionin, bashkërendon me shtetet reth politikave dhe praktikave më të mira dhe zhvillon politika të reja bazuar në gjetjet e grupeve të ekspertëve, si dhe publikon raporte rreth njohurive mediatike.

Të gjitha këto nisma të lëvdueshme janë shumë të rralla dhe me një karakter shumë gjenerik, duke u fokusuar në politikën audiovizuale dhe në industrinë kulturore. Përpjekjet fokusohen përmes Programeve të Europën Kreative, çka, siç e kemi vënë në dukje tashmë, nuk konsideron të njëjtat objektiva siç i ka përcaktuar UNESCO në programet e veta për NJMI-në. Ndonëse është e qartë se NJMI-a “ka të bëjë me mbrojtjen dhe fuqizimin, në mënyrë që njerëzit gjysmë të shkolluar të jenë në gjendje të mbrojnë veten dhe familjet prej përmbajtjeve të dëmshme, ofensive dhe të padëshiruara” (Zacchetti, 2007), nuk është se ekzistojnë shumë aplikime konkrete, sidomos në fushën e krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes ose radikalizmit të dhunshëm.

Kohët e fundit (Bruksel, 19 prill 2016), Komisioni Europian bëri të ditur planin e tij për të krijuar një Treg të Vetëm Digjital për t’i ardhur në ndihmë industrisë europiane, SME-ve, hulumtuesve dhe autoriteteve publike që prodhojnë pjesën më të madhe të teknologjive të reja, por ky plan është hartuar nga këndvështrimi industrial, ndaj dhe në të nuk ka shumë referenca për qytetarët dhe NJMI si një mjet për fuqizimin e njerëzve dhe të bashkësive. Komisioni do të krijojë një Re Europiane, çka do të lejojë përdorimin shfrytëzimin e një mjedisi virtual për të depozituar dhe menaxhuar të dhënat e 1.7 milion hulumtuesve dhe ato të 70 milion profesionistëve të shkencës e të teknologjisë në të gjithë Europën. Një mundësi që mund të përdoret për qëllimin e analizuar në këtë punim. Komisioni do të paraqisë një agjendë të aftësive europiane, një tjetër mundësi për të përvijuar aftësitë e duhura në epokën digjitale që mund të specializohet duke marrë pjesë në objektivat e dëshiruara konkrete.

2016 do të paraqisë dy mundësi të reja për të avancuar në zhvillimin e NJMI-së: Konferencën Globale NJMI dhe GAPMIL Asamblenë e Parë të Përgjithshme, 3-5 nëntor 2016 në Sao Paulo, Brazil, si dhe Forumin e dytë europian mbi Njohuritë në Fushën e Medias dhe të Informacionit (EMELINFO II, 27-29 qershor, Riga, Letoni), i cili pason Forumin e Parë mbi Njohuritë në Fushën e Medias dhe të Informacionit të zhvilluar në Paris (ku pjesëmarrësit miratuan Deklaratën e Parisit mbi Njohuritë në Fushë të Medias

dhe të Informacionit në Epokën Digjitale), me synimin për të përshkruar situatën aktuale të NJMI-së në Europë dhe nxitur krijimin e një kornize për aksion të përbashkët në lidhje me politikën dhe strategjitë për NJMI-në.

Përfundime

UNESCO-ja e promovon NJMI-në si një koncept që trajton çështje me të cilat të gjithë ne ballafaqohemi sot. Siç e shpjeguem në pjesën e parë të këtij punimi krimi i urrejtjes, gjuha e urrejtjes dhe radikalizmi i dhunshëm janë tendenca kritike që shfaqen në shoqëritë europiane sot. Boekhorst (2013), duke iu referuar nevojës së njerëzve për të mbrojtur vetveten ndaj shtrëngimeve fizike dhe agresionit të të tjerëve, pohonte ekzistencën e barrierave politike. NJMI-ja mund të ndihmojë për t'i shembur këto barrirera, si dhe për të forcuar nevojat afektive (njerëzit ndjejnë nevojën e afeksionit nga të tjerët) dhe kognitive (njerëzit varen prej njëri-tjetrit, duke qenë se mësojnë prej njëri-tjetrit.)

Ekziston një mundësi e madhe për ta përdorur këtë disiplinë për të luftuar polarizimin në rritje në shoqëritë tona. Lulëzimi i mediave të reja po gjeneron rreziqe të reja për luftën kundër problemeve që kanë të bëjnë me diskriminimin, veçanërisht gjuhën e urrejtjes, shtrembërimin e opinionit publik dhe çuarjen drejt rrezikut të krimeve të urrejtjes. Ndonëse në BE ka deklarata të forta rreth kontributit të NJMI-së për kohezionin shoqëror, ekziston mungesa e një aplikimi konkret. Programet e financuara nga Komisioni Europian, veçanërisht pas publikimit të kohëve të fundit të përmbajtjes së planit të saj për të krijuar një Treg të Vetëm Digjital, mund të jetë një mënyrë për t'u përballur me këtë situatë. Projekti PRISM do të ishte një praktikë e mirë, ndonëse objektivi i tij është që të rrisë mundësitë e viktimave për të pasur drejtësi civile dhe penale për gjithë çka të bëjë me këto çështje (www.unicri.it/special_topic/hate_crimes.) Një thirrje e kohëve të fundit për projekte (http://ec.europa.eu/justice/grants1/files/2015_action_grants/2015_rrac_ag/just_2015_rrac_ag_call_notice_en.pdf) shfaq shqetësimet rreth situatës dhe nevojën për t'i fuqizuar viktimat, ndonëse njohuritë në fushë të medias dhe të informacionit nuk i konsideron si një mënyrë për të vepruar.

Referenca

- Bar-Tal, D. and Labin, D. (2001). The effect of a major event on stereotyping: terrorist attacks in Israel and Israeli adolescents' perceptions of Palestinians, Jordanians and Arabs. *European Journal of Social Psychology*. Vol. 31, Issue 3, pages 265-280.
- Boekhorst, A. (2013). MIL and Its Kind. In UNESCO (2013). *Media and Information Literacy for Knowledge Societies*. Moscow: UNESCO. Retrieved from: http://www.ifapcom.ru/files/News/Images/2013/mil_eng_web.pdf
- Cohen, J. (2015). *Efectos Sociales del Terrorismo. Crisis de Refugiados y ArgumentacionErronea*. Instituto Espanol de Estudios Estrategicos. Documento de Opinion 112/2015 Retrieved from http://www.ieee.es/Galerias/fichero/docs_opinion/2015/DIEEEO112-2015_EfectosSociales_terrorismo_JessicaCohen.pdf
- Craik, F. I. M. and Lockhart, R. S. (1972). Levels of processing: A framework for memory

- research. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior*. Vol. 11, Issue 6, Pages 671-684 Jessica Cohen & José María Blanco
- COST (2013). Media literacy research and policy in Europe. A review of recent, current and planned activities. Report of a meeting of the COST Action: Transforming Audiences, Transforming Societies, held on 12 September 2013. Retrieved from: <http://www.lse.ac.uk/media@lse/documents/MPP/COST-Media-literacy-research-and-policy-in-Europe-final.pdf>
- ECRI (2016). ECRI General Policy Recommendation No. 15 on Combating Hate Speech. Adopted on 8 December 2015. Council of Europe. Retrieved from https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/GPR/EN/Recommendation_N15/REC-15-2016-015-ENG.Pdf
- European Commission (2009). Council conclusions on media literacy in the digital environment. Retrieved from: <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST%2015441%202009%20INIT>
- European Commission (2011). Testing and Refining Criteria to Assess Media Literacy Levels in Europe. European Association for Viewers Interests and Danish Technological Institute. Retrieved from: http://www.eavi.eu/joomla/images/stories/Publications/study_testing_and_refining_ml_levels_in_europe.pdf
- European Commission (2016). Commission sets out path to digitise European industry. Retrieved from: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1407_en.htm
- European Parliament (2007). Directive 2007/65/EC of the European Parliament and of the Council of 11 December 2007 amending Council Directive 89/552/EEC on the coordination of certain provisions laid down by law, regulation or administrative action in Member States concerning the pursuit of television broadcasting activities. Retrieved from: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2007.332.01.0027.01.ENG
- European Union (2009). Commission Recommendation of 20 August 2009 on media literacy in the digital environment for a more competitive audiovisual and content industry and an inclusive knowledge society. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32009H0625>
- Gotev, G. (2015). Commission wants member states to criminalise hate speech. Euractive. Retrieved from <http://www.euractiv.com/section/justice-home-affairs/news/commission-wants-member-states-to-criminalise-hate-speech/>
- International ICT Literacy Panel (2002). Digital Transformation. A Framework for ICT Literacy. Retrieved from: https://www.ets.org/research/policy_research_reports/publications/report/2002/cjik
- Kuzmin, E. (2013). Media and Information Competence in the Context of Challenges of Information Society and Knowledge Society Building. In UNESCO (2013). Media and Information Literacy for Knowledge Societies. Moscow: UNESCO. Retrieved from: http://www.ifapcom.ru/files/News/Images/2013/mil_eng_web.pdf
- Pennebaker, J. W. (1993). Creacion y mantenimiento de las memorias colectivas. *Revista de Psicología Política* 6, pg. 35-51.
- The Soufan Group (2015). Terrorism and the Refugee Crisis. TSG Intel Brief Retrieved from <http://soufangroup.com/tsg-intelbrief-terrorism-and-the-refugee-crisis/>
- Ulsar Pietri, A. (1992). La Historia Sumergida. *El Correo Espanol – El Pueblo Vasco*, 23 de octubre.
- UNESCO (2008). Towards Information Literacy Indicators. Paris: UNESCO. Retrieved from: http://www.uis.unesco.org/Library/Documents/wp08_InfoLit_en.pdf
- UNESCO (2011). Media and Information Literacy. Curriculum for teachers. Retrieved from: http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/pdf/media_and_information_literacy_curriculum_for_teachers_en.pdf
- Jessica Cohen & José María Blanco
- UNESCO (2011). Towards Media and Information Literacy Indicators. Retrieved from:

<http://www.ifla.org/files/assets/information-literacy/publications/towards-media-and-Information-literacy-indicators.pdf>

UNESCO (2013). Media and Information Literacy for Knowledge Societies. Moscow:

UNESCO. Retrieved from: *http://www.ifapcom.ru/files/News/Images/2013/mil_eng_web.pdf*

White, A. (2015). Moving Stories. International Review of How Media Cover Migration.

Ethical Journalism Network Retrieved from *<http://ethicaljournalismnetwork.org/assets/docs/054/198/8feb836-108e6c6.pdf>*

Woods, J. (2011). Framing Terror: an experimental framing effects study of the perceived threat of terrorism. Critical Studies on Terrorism. Vol. 4, Issue 2, Retrieved from *http://www.researchgate.net/publication/254369158_Framing_terror_an_experimental_framing_effects_study_of_the_perceived_threat_of_terrorism*

Zacchetti, M. (2007). Media Literacy: A European approach. Mediempulse n. 61,

September 2007. Retrieved from: *<http://www2.mediamanual.at/themen/kompetenz/61Zacchetti-Media-Literacy-European-approach.pdf>*

Kontribuesit

Ahmed Al-Rawi

Assistant Professor, Department of Communication Studies, Concordia University, Canada; Research Fellow, Media and Communication Department, Erasmus University, Netherlands. ahmed.alrawi@concordia.ca

Alton Grizzle

Programme Specialist, Communication and Information, UNESCO HQ, Paris, France. a.grizzle@unesco.org

Anubhuti Yadav

Associate Professor, Indian Institute of Mass Communication, New Delhi, India. anub-hutiy@gmail.com

Carolyn Wilson

Instructor and Program Coordinator, Faculty of Education at Western University, Canada. cwils66@uwo.ca

Egara Kabaji

Professor, Literary Communication, Department of Journalism and Mass Communication, Masinde Muliro University of Science and Technology, Department of Journalism and Mass Communication, Kakamega, Kenya. egarakabaji@yahoo.com

Francesco Fabbro

Researcher, Department of Philosophy, Psychology and Pedagogy, University of Verona, Verona VR, Italy. itfrancesco.fabbro@univr.i

Humberto Darwin Franco Miguez

Educator and Journalist, University of Guadalajara, Mexico. micorreoformal@hotmail.com

Inder Vir Malhan

Professor and Head, Department of Library and Information Science, Central University of Himachal Pradesh, Dharamshala, India. imalhan_47@rediffmail.com

Jagtar Singh

Professor, Department of Library and Information Science; Professor In-charge, Bhai Kahn Singh Nabha Library, Punjabi University, Patiala, India. jagtardeep@gmail.com

Jessica Cohen

Intelligence Analyst, Private Sector, Madrid, Spain. mail@jessicacohen.es

Jordi Torrent

Project Manager, *Media & Information Literacy*, United Nations Alliance of Civilizations (UNAOC), New York. jordit@unops.org

Jose Manuel Perez Tornero

Director, Department of Journalism and the Gabinete de Comunicacion y Educacion(UAB).
josep.manuel@uab.cat

José María Blanco

Head, The Centre of Analysis and Foresight, Guardia Civil, Madrid, Spain. *blanco.josemaria@gmail.com*

Jun Sakamoto

Professor, Director for Librarian Training Course, Faculty of Lifelong Learning and Career Studies, Hosei University in Tokyo, Japan. *sakamoto@hosei.ac.jp*

Kyoko Murakami

Director, Asia-Pacific Media and Information Literacy Education Centre, Program Manager, CultureQuest Japan, and Lecturer, Hosei University, Japan.
mkyoko520@yahoo.co.jp

Li Xiguang

Professor and Director, Tsinghua University International Center for Communication, Beijing, China. *xiguang@tsinghua.edu.cn*

Lucy K.L. Mandillah

Lecturer, English language, Linguistics and Communication Studies, Masinde Muliro University of Science and Technology, Department of Language and Literature Education, Kakamega, Kenya. *mandila1978@yahoo.com*

Magda Pischetola

Assistant Professor, Department of Education, Pontificia Universidade Catolica, Rio de Janeiro, PUC-Rio, Brazil. *magda@puc-rio.br*

Marcelo Andrade

Associate Professor, Department of Education, Pontificia Universidade Catolica, Rio de Janeiro, PUC-Rio, Brazil. *marcelo-andrade@puc-rio.br*

Maria Ranieri

Associate Professor, Educational Methods and Technology, Department of Education and Psychology, University of Florence, Firenze, Italy. *maria.ranieri@unifi*

Matthew Johnson

Director of Education, MediaSmarts, Canada's Centre for Digital and Media Literacy, Ottawa, Canada. *mjohnson@mediasmarts.ca*

Melda N. Yildiz

Global Scholar, Walden University, Minneapolis, Minnesota. *melda.yildiz@fulbrightmail.org*

Palvos Valsamidis

GR Lambrakis, Stixos 2B 15351, Pallini, Athens, Greece. *pvalsa77@yahoo.gr*

Ronit Kampf

Lecturer, Department of Communication and the Program in Research of Child and Youth Culture, Tel Aviv University, Israel. ronitkampf@gmail.com

Sheikh Shueb

Research Scholar, Department of Library & Information Science, University of Kashmir, Jammu and Kashmir, India. shkshsb@gmail.com

Sidra Tariq Jamil

Research Fellow, Tsinghua University International Center for Communication, Beijing, China. sidra.jamil@umt.edu.pk

Sumeer Gul

Senior Assistant Professor, Department of Library & Information Science, University of Kashmir, Jammu and Kashmir, India. sumeersuheel@gmail.com

Sun Lizhou

Senior Lecturer, Southwestern University of Political Science and Law, Chongqing, China. sunlizhou@pku.edu.cn

Tessa Jolls

President and CEO of the Center for Media Literacy, Malibu, California.
tjolls@medialit.com

Thomas Rohlinger

Founder and Editor in Chief, Radijojo World Children's Media Network, Germany.
roehlitom@yahoo.de

Vedabhyas Kundu

Programme Officer, Gandhi Smriti and Darshan Samiti, New Delhi, India.
vedabhyas@gmail.com

Wu Yanmei

Graduate Student, Tsinghua University International Center for Communication, Beijing, China. wuym11@mails.tsinghua.edu.cn

